



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 11 dhe 18 QERSHOR 2009**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
11. i 18 JUNA 2009. GODINE**

**QERSHOR – JUN
2009**

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
I nderuar Kabinet qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 81 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar të gjitha kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj së në bazë të rregullave 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,
Kolegë të nderuar,
Ajo që desha të vë theksin, është pikërisht rendi i ditës, pika e tetë e rendit të ditës që ka të bëjë me Shqyrtimin e raportit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2008.

Siç i keni marrë dokumentet, Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, më 8 maj 2009, e në të njëjtën datë edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e kanë trajtuar Raportin e RTK-së për vitin 2008 dhe i kanë rekomanduar Kryesisë që t'i kthehet ky raport Radiotelevizionit të Kosovës, sepse nuk e plotëson asnjë kusht, as formal, as përmbajtjesor.

Unë, për të mos ju marrë kohë, nuk po i lexoj rekomandimet, edhe pse Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa është edhe më i drejtpërdrejtë, domethënë kërkon edhe masa të caktuara ndaj përgjegjësve të RTK-së. Unë çuditem se si është proceduar për t'u shqyrtuar në këtë seancë plenare dhe nuk është marrë në konsideratë qëndrimi i asnjërit komision.

Në këtë rast, unë kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës, zoti Kryetar, të tërhiqet dhe t'i kthehet Raporti Radiotelevizionit të Kosovës për t'u plotësuar. Thërras deputetët që të jenë dakord me këtë propozim timin edhe në emër të Komisionit, edhe në emër të Grupit Parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ne e kemi pasur raportin me rekomandime dhe heqja nga rendi i ditës është e drejtë e Kuvendit dhe Kuvendi tani këtë mocion mund ta votojë për ta hequr pikën e tetë nga rendi i ditës.

Fjalën e ka kërkuar Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti Kryetar,
I nderuar zoti Kryeministër,
I nderuar Kabinet Qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Një kërkesë të ngjashme kam edhe unë për të hequr një pikë të rendit të ditës -Shqyrtimin e Projekt-Rregullores së Kuvendit, meqë Grupi Parlamentar i PDK-së ka konsideruar që kjo rregullore duhet rishikuar dhe duhet korrigjuar diçka, në mos shumëçka nga ajo dhe ta lëmë në një seancë të ardhshme të Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Do të thotë, këtu i kemi dy mocione për të cilat do të votojmë, por kanë kërkuar fjalën edhe tre deputetë të tjerë. Po, një gjë duhet ta dimë, nuk jemi në debat, kemi dy mocione për të cilat duhet të votojmë.

Votojmë së pari mocionin e deputetit Esat Brajshori, që të hiqet nga rendi i ditës - Shqyrtimi i raportit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2008.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Do të thotë, sipas kërkesës së dy komisioneve, të Komisionit për Media dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Radiotelevizioni obligohet që ta ripunojë Raportin financiar dhe në afatin sa më të shpejtë t'ia sjellë Kuvendit.

Konstatohet se me 53 vota "për", 19 vota "kundër" dhe 3 abstenime, kjo pikë e rendit të ditës hiqet nga seanca e sotshme për t'u ripunuar raporti.

Mocioni i dytë është i shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetit Ramë Buja, për heqjen nga rendi i ditës të seancës së sotme - Shqyrtimi i Rregullores së Punës së Kuvendit, për t'u ripunuar. Ju e dini që për këtë Rregullore për t'u votuar duhen 2/3 e deputetëve, kështu që edhe këtë e hedhim në votim.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 56 vota "për", 20 "kundër" dhe 1 abstenim, Kuvendi heq nga rendi i ditës pikën e gjashtë -Shqyrtimi i Projekt-Rregullores së Kuvendit, për t'u ripunuar.

Për fjalë është lajmëruar deputeti Branislav Grbić.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem, predsedavajući!

Poštovanje gospodo ministri,

Dame i spospodo, narodni poslanici,

Ono što bih ja izneo, to je samo u vezi tačke dnevnog reda, a to je zadnja tačka rdenvnog reda u vezi Poslaničke grupe „Zajedno“.

Ovo što je jako bitno, ovde se radi samo o izveštaju o rasformiranju Poslaničke grupe, a smatram da je trebalo staviti i detalj razloga rasformiranja Poslaničke grupe, da se upoznaju poslanici sa nemogućnošću opstanka dve srpske poslaničke grupe, koje bi u tom smislu davale dva člana Predsedništva. U Ahtisarijevom plana jasno stoji i u Ustavu Kosova da deset srpskih poslanika imaju prava na jednog člana Predsedništva. To je zagaratovano Ustavom i ono što je simptomatično jako da srpski predstavnici srpskih zajednica u tom smislu, u skladu sa Ahtisarijevim planom ne mogu da se dele i da dve poslaničke grupe daju dva člana Predsedništva. Što znači da, gospodine Predsedniče, ono što je bitno i ono što ćemo mi kao partija tražiti da se utvrdi da li i u opšte je moguće da pet člana jedne poslaničke grupe sa ... jedne partije mogu predstavljati interesnu grupu Srpske zajednice od 10 članova u skladu sa Ahtisarijevim planom. I ja vas molim da ako imate vremena da nas primite i da i u pisemnoj formi mi ćemo dostaviti i razmotriti. Jednostavno znači, to je nemoguće i dalji rad Srpske zajednice je onemogućen na ovaj način, jer 5 Srba ne mogu da imaju člana Predsedništva, samo 10 predstavnika Srpske

zajednice u okviru jedne poslaničke grupe mogu da imaju člana Predsedništva. Jer, zamislite situaciju da imate po tri Srba se dele i uzmite po jednog predstavnika drugih zajednica. Znači, trebate imati četiri člana iz reda Srpske zajednice a to je nemoguće. Ovo je dosta nejasnaća materija i zahteva zaista jednu dobru analizua i ja vas molim da ...

KRYETARI: Faleminderit!

Bëjeni kërkesën me shkrim, unë jam i gatshëm t'ju pranoj, po një gjë është, do të thotë e drejta e deputetëve është të formojnë grupe dhe të lëvizin nga grupet parlamentare. Ne s'mund t'ua marrim atë të drejtë.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, Kryetar!

Unë fjalën e kam kërkuar më herët, me qenë se u kërkuar dy mocione, e mendoj se do të ishte parlamentarizëm në rregull që nëse ka dikush që ka mendim tjetër, të paktën, të provojë të ndikojë te deputetët. Tani nuk ka arsye për të folur, për shkak se dy pika u hoqën prej rendit të ditës, po edhe një herë po përsëris, parlamentarizmi kërkon që nëse dikush ka mendim tjetër, duhet ta thotë mendimin e vet dhe të provojë t'i bindë deputetët që nuk është mirë për t'i hequr dy pika prej rendit të ditës për çdo seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Rregulla 30, Mocionet procedural: "Për mocionin për ta shtyrë debatin për një datë të caktuar në një debat të ardhshëm dhe për mocionin për ta shtyrë seancën menjëherë bëhet votim pa debat". Rregulla 30.2 e Rregullores së Punës së Kuvendit.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë pata një kërkesë për ta shikuar mundësinë që Qeveria që është e pranishme sot për një informim ose njoftim para fillimit të punës lidhur me vendimin që ka marrë për ndarjen e mjeteve për të sanuar atë fatkeqësi natyrore që ka goditur Gjilanin. Kanë nevojë qytetarët, e kam porosinë dhe do të kisha kërkuar, në qoftë se ka mundësi, Qeveria ta paraqesë shkurtimisht një informatë se çfarë mendon dhe kur do të ndahen ato mjete? Faleminderit!

KRYETARI: A ka përgjigje? Urdhëro, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Faleminderit për pyetje, zoti Rexhepi!

Qeveria ka marrë një vendim në mbledhjen e kaluar që ta themelojë një komision për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në komunën e Gjilanit. Komisioni është i përbërë nga Ministria e Ambientit, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Pushteti Lokal dhe Kuvendi Komunal i Gjilanit. Presim që shumë shpejt ai komision ta bëjë vlerësimin adekuat në Qeveri dhe ta procedojmë në Kuvend. Qeveria ka gatishmërinë dhe vullnetin që ta ndihmojë qytetarin e Gjilanit në atë fatkeqësi.

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër!

Atëherë, procedojmë sipas rendit të ditës. Pasi nuk kemi të paraqitur për fjalë.

Pika e parë e rendit të ditës është:

Miratimi i procesverbaleve të seancës plenare të mbajtur më 14, 15, 22 dhe 27 dhe 28 maj 2009 dhe të seancës plenare të mbajtur më 4 qershor 2009

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se procesverbalet dhe transkriptet e seancave plenare të mbajtura më 14, 15, 22, 27 dhe 28 maj 2009 dhe të seancës plenare të mbajtur më 4 qershor 2009 u janë shpërndarë deputetëve. Pyes deputetët nëse kanë vërejtje në këto procesverbale?

Nuk ka. Atëherë, konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave të përmendura.

Pika e dytë e rendit të ditës:

- Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në mes dy seancave është parashtruar një numër i madh i pyetjeve parlamentare, saktësisht 33 pyetje, ndërsa koha e paraparë është e kufizuar në 50 minuta. Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

Për pyetjen e parë, me kërkesën e saj, Suzan Novobrdaliu e ka fjalën. Pyetja është për ministrin Zenun Pajaziti. Deputete, e keni fjalën!

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit!

Përshëndetje për të gjithë!

I referohem datës së paraqitjes së pyetjes. Para pak ditësh mediat komunikuan një lajm tepër skandaloz të një institucioni që udhëhiqet nga kjo qeveri. Fjala është për vjedhjen e dhjetëra kilogramëve lëndë narkotike dhe të provave të tjera materiale në ndërtesën e quajtur ish- Qendra për Trajnim Policor afër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Kur vjedhja mund të bëhet edhe në këto qendra, imagjinojeni sa e sigurt është pasuria e qytetarëve në shtëpitë e tyre, pa koment. Thuhet se dyshohet që hajnat kanë hyrë në këtë objekt përmes shkallëve emergjente prapa kësaj ndërtese. Pa shaka, kjo skenë do t'i ngjante filmit "Agjenti 007" të Xhems Bondit. Një gjë është e sigurt, se nëse këtë vepër nuk e kanë kryer punonjësit e këtij institucioni, atëherë del se të paktën i kanë dhënë dikujt informacione për mënyrën se si mund të vidhen provat materiale dhe dhjetëra kilogramë narkotikë.

Zotëri ministër,

Këtu ka vetëm dy rrugë, të pranoni dështimin personal dhe të merrni përgjegjësinë morale për këtë skandal të radhës, ose të deklaroni se pavarësisht nga angazhimi juaj...

KRYETARI: Faleminderit!

Nëse pyetja është bërë, ju e dini se në një seancë të ardhshme do të jetë një informatë që do ta japë ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, por megjithatë, ministri me siguri mund të përgjigjet në këtë pyetje.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë në listën e pyetjeve sot kisha të adresuara pyetje të tjera. T'ju informoj, po ashtu, se me ftesën që më është bërë nga Kuvendi që ta bëj një informim lidhur me këtë rast,

unë kam angazhuar një ekip të Ministrisë së Brendshme e të Policisë së Kosovës që të përgatisin një informatë të detajuar për rastin e vjedhjes që ka ndodhur në polici.

Fatkeqësisht, një informatë e tillë, e cila do t'i marrë disa minuta në këtë Parlament, do të bëjë fjalë për një rast i cili nuk është i mirë për opinionin e policisë, përkundër faktit që ka disa mijëra pjesëtarë të policisë, oficerë të policisë që kryejnë detyrën me përkushtim dhe shpeshherë na mungon hapësira për t' u dhënë komplimente për punën e tyre me përkushtim, për një punë të mirë që kanë bërë sot e 9 vjet në Kosovë.

Fatkeqësisht, rasti që ka ndodhur në polici ka dëmtuar imazhin e policisë. Menjëherë pas rastit, unë kam kërkuar nga Menaxhmenti i Policisë që të merret më seriozisht me rastin dhe të bëjë një task-forcë, në mënyrë që hetimi i brendshëm të bëhet jo vetëm nga ata persona që janë drejtpërdrejt të lidhur me Menaxhmentin e Policisë, por që të bëhet edhe nga institucionet e tjera, siç janë Prokuroria dhe departamentet e tjera të Policisë, që rasti të hetohet në mënyrë të paanshme.

Siç e dini, kohëve të fundit Policia ka marrë disa aktivitete rreth këtij rasti, ka edhe disa pista të hetimit. Po ashtu, janë bërë edhe disa arrestime, ku përveç tjerash, policia posedon fakte të cilat i ka deponuar në prokurori që qojnë edhe te rasti që ka ndodhur në polici. Në anën tjetër, unë po ashtu kam kërkuar në mënyrë urgjente prej policisë përgjegjësinë menaxheriale. Siç e dini, menjëherë pas rastit ka pasur disa shkarkime në polici, nga ekspertë edhe të policisë edhe të partnerëve që na mbështesin në këtë fushë. Me gjithë insistimin tim që të ketë ende përgjegjësi, edhe përgjegjësia të shkojë deri në fund, kemi konstatuar, kemi konsideruar që është mirë t'i lëmë hapësirë tanimë procesit të hetimit, në mënyrë që hetimi të shkojë sa më mirë, sa më shpejt dhe zbardhja sa më e shpejtë e rastit do të na krijojë më shumë komoditet, pastaj, për të shkuar deri në fund edhe në përgjegjësi menaxheriale sa i përket rastit. Siç e dini, po ashtu është mirë t'ju informoj se ky është një departament që kompetencat janë bartur më së fundi...

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Pyetje shtesë? Urdhëro, deputete!

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, Kryetar!

Pyetjen time, zoti ministër, e keni pasur qysh nga data 28 prill, do të thotë, që afër 2 muaj. Nuk m'u përgjigjët konkretisht, a jeni ju fajtor apo menaxhmenti të cilin e drejtoni, që është në mbikëqyrjen tuaj dhe përafërsisht sa kohë ju nevojitet për ta ndriçuar këtë rast?

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Pa dashur që të heqim përgjegjësinë, askush nga ne nuk mund të lirohet nga përgjegjësitë që i kemi në punën tonë të përditshme, me Ligjin që është aprovuar për policinë këtu nga ju, e dini fort mirë cila është struktura organizative, cilat janë përgjegjësitë e policisë dhe cilat janë kompetencat dhe pavarësia e policisë, jo vetëm në menaxhimin e strukturës së vet, por edhe përgjegjësitë operacionale që i kanë edhe për operacione që i kryen.

Sa do të zgjasë ky hetim, është çështje tanimë krejt e hetuesisë. Po ju siguroj që hetuesit më të mirë, punëtorët më të mirë të policisë kanë punuar ditën dhe natën dhe janë duke punuar vazhdimisht për ta ndriçuar sa më shpejt këtë rast. Dëshiroj t'ju them, po ashtu, kanë një presion jashtëzakonisht të madh nga ne, por edhe nga opinioni publik që ta hetojnë sa më shpejt rastin dhe ta përfundojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja Edita Tahiri, ka dy pyetje për ministrin Limaj, por as deputetja, as ministri nuk janë këtu. Vazhdojmë. Deputeti i radhës është Naser Rugova, ka pyetje për ministrin e Administratës së Pushtetit Lokal, zotin Sadri Ferati. Zoti deputet, e ke fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kolegë deputetë,

Zoti ministër, banorët e fshatrave Koshtovë, Cerajë, Bistricë të komunës së Leposaviqit, me popullatë shqiptare, jetojnë në kushte të rënda ekonomike- sociale. Para 17 shkurtit 2008, pozita e banorëve të këtyre fshatrave ka qenë më e favorshme pasi që ka pasur edhe disa investime të vogla dhe pëlqim për rindërtim të shtëpive të shkatërruara nga lufta. Pas 17 shkurtit 2008, atje funksionon komuna paralele, që punon me ligje të një shteti tjetër dhe jeta e banorëve të këtyre fshatrave dhe të kësaj pjese të vendit tonë po thuaj se është paralizuar, kurse për rindërtim të shtëpive dhe kthim në pronat e tyre ka vështirësi serioze të cilat, mbase, po bëjnë përpjekje t'i kuptojmë. Por, zoti ministër, cilat janë veprimet e Qeverisë dhe të Ministrisë që ju e drejtoni për normalizimin e jetës dhe përkujdesjen institucionale për banorët e këtyre fshatrave dhe përmirësimin e jetës së tyre? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën! Mund t'i shfrytëzoni edhe mikrofonat që i keni përpara.

MINISTRI SADRI FERATI: I nderuar Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

I nderuar deputet Rugova,

Edhe përkundër të gjitha njohurive që i kemi në lidhje me situatën në atë pjesë, me çka solidarizohemi me kërkesat dhe me nevojat e qytetarëve të asaj pjese, do të përgjigjem në pjesën që lidhet me përgjegjësitë e Ministrisë, ndërsa për gjithë aktivitetin e Qeverisë, ndoshta një herë tjetër do ta thonë fjalën personat më kompetent.

Përveç pjesës mandatore, pra, që ne po përkujdesemi që komunat në përgjithësi të marrin një mbështetje më të fuqishme në ndërtimin e kapaciteteve dhe sundimin, respektimin e ligjit, kur është fjala te komuna e Leposaviqit, posaçërisht, jemi kujdesur që Zyra Lokale për Komunitete e vetmja që ka mbetur në funksion, në jetë aktive dhe që ajo të mund të marrë gjithë mbështetjen financiare që parashikohet me ligj, në mënyrë që të mos mbetet pasojë e situatës që e kemi atje. Përveç kësaj, kemi bërë edhe nga ato mjete, pra Ministria që nuk ka shumë, siç dihet, nga ato mjete kemi financiar edhe disa projekte me infrastrukturë të fortë, në mënyrë që drejtpërsëdrejti sado kudo të ndikojë në kualitetin e jetës në atë pjesë, siç janë pajisja dhe furnizimi i Zyrës Lokale për Komunitete, pastaj financimi i rrethojës për shkollën, ndërsa tani kemi ndarë një shumë të mjeteve që do të financojmë ujësjellësin, një pjesë të ujësjellësit në atë pjesë, me dëshirat më të mira që në të ardhmen do të ndihmojmë edhe më tepër.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Fjala e deputetit, Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, ministër!

Kërkesat dhe ankesat më të mëdha të qytetarëve të kësaj zone nuk janë tani në lëvizjen e lirë, sepse atje i kemi disa lëvizje pozitive, por pushteti lokal atje dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, që ju e drejtoni, thjesht, shteti i Republikës së

Kosovës, duhet të vejë dorë në ato pjesë dhe përpos ujësjellësit, kanë probleme me komunikim, me rrugë e probleme të tjera që i takojnë infrastrukturës, sepse ju e dini pozicionin e tyre, jetën e vështirësuar të tyre dhe ata njerëz po migrojnë drejt Mitrovice dhe qyteteve të tjera, andaj është përgjegjësi institucionale që thjesht atyre njerëzve vetëm t'u krijohen kushte normale për jetë.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ministër, keni përgjigje shtesë?

MINISTRI SADRI FERATI - Jo si përgjigje, se nuk dëgjova pyetjen, por plotësisht solidarizohen me nevojat që i kanë ata qytetarë. Çështja e gjendjes në atë pjesë të Kosovës dhe në ato fshatra nuk është çështje e një informacioni, por është çështje e shumë veprimeve që duhet bërë derisa institucionet e Republikës së Kosovës të kenë një qasje të plotë atje, por përkundër asaj gjendjeje që është do të thotë e jashtëzakonshme, ne do të bëjmë gjithçka që është e mundur që ata qytetarë të mbahen atje dhe sado kudo të financojmë në projektet veç e veç, sipas specifikave dhe nevojave të tyre që i kanë.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

DRITA MALIQI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëndetje për të gjithë!

Zoti ministër, pse nuk po e përshpejtoni procedimin e Ligjit për pensionistët, pasi që gjendja ekonomike e tyre është shumë e rëndë, sepse pensionistët nuk marrin pensione, por lëmoshë, plus mund të themi edhe për sigurime shëndetësore, e tjerë. Pra, zoti ministër, kur konkretisht do ta kemi në Kuvend Ligjin për pensionistët? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Poštovani predsjedniče,

Poštovani zamenici permijera,

Poštovane kolege ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Gospodo Maliqi,

Ja sam pre 10 dana pomenuo da sam pre možda dvadesetak dana bio u Briselu na jednoj konferenciji koju je organizovala Svetska banka, i koja je za cilj je imala predstavljanje sistema i predstavljanje problema koji su ekonomska kriza i drugi negativni činioci uradili od penzionih sistema u zemljama Evropske Unije, zemljama u regionu i čak i zemljama sveta.

Ekonomska kriza je napravila stvarno jedan vrlo razorni efekat na sve penzione sisteme sveta, tako da je po zaključcima i po preporukama iz Svetske banke i ostalih, a po predstavljanju tih odredjenih zemalja koje su konkretno pokazale koliko su njihovi gubici bili i koliko je bila slabost njihovih penzionih sistema, a samim tim i načini sa kojima će se boriti sa tom krizom, koji su jasno pokazali da prvo što će uraditi je zamrzavanje svojih penzija, to pričam za zemlje u regionu, a posle toga ponovna indeksacija i smanjenje tih istih penzija. Meni je stvarno žao što ću ja biti taj koji će ovo prvo reći, ali na osnovu zaključaka sa te konferencije, i na osnovu zaključaka šire grupe koji su bili i posetioci na toj konferenciji, mislim da je u ovom momentu nerealno očekivati da penzioni zakon ili Zakon o penzionom i invalidskom osiguranju, koji košta,

koji bi koštao 56 miliona evra godišnje, nije realno očekivati da će biti u ovoj godini ili u jednoj bliskoj budućnosti usvojen.

Ja, još jednom naglašavam da je na osnovu detalja, na osnovu podataka, na osnovu indikatora i problema koji su se javili u sistemima, u penzionim sistemima zemalja Evropske Unije i zemalja u regionu, postoji jedna snažna preporuka njima da svoju penziju smanje, nama da svoj penzioni sistem zadržimo ovakvim kakav jeste. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë?

DRITA MALIQI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Vetëm desha të shtoj për ju, zoti Kryetar, unë e kam pasur një pyetje për shkatërrimin e ambientit, kështu që është tejkaluar para kësaj, domethënë më datën 4.5.2009, kështu që kërkoj nëse ka mundësi, t'ia parashtroj pyetjen ministrit Yagcilar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Pyetja e kaluar do të botohen në "Buletin". Po shkojmë sipas radhës. Radha është për deputeten Nerxhivane Dauti, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi. Deputete, i ke dy pyetje njëërën pas tjetrës, mund t'i parashtrosh të dy pyetjet, që pastaj ministria të përgjigjet në të dy pyetjet.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Duke u bazuar në Rregullën 26.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, parashtroj pyetje për përgjigje me gojë.

Çështja: Ligji kundër dhunës në familje, sipas strategjisë legislative të Qeverisë së Kosovës duhet t'i paraqitet Kuvendit për miratim në qershor të këtij viti. Duke pasur parasysh shfaqjen e dukurisë së dhunës në familjet kosovare dhe duke e pasur parasysh nevojën e mbrojtjes ligjore të familjes, si dhe duke marrë parasysh rëndësinë e këtij ligji për sistemin juridik të Kosovës, për ministren e Drejtësisë e bëj këtë pyetje: Në cilën fazë të përgatitjes gjendet ky ligj? Ju faleminderit!

KRYETARI: I jepet fjala deputetes për të bërë pyetjen e dytë.

NERXHIVANE DAUTI: Pyetjen e dytë, e tërheq.

KRYETARI: Ju faleminderit! Zonja ministre, e keni fjalën!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: I nderuar, zoti Kryetar i Parlamentit!
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,
E nderuara deputete Nerxhivane Dauti,

Ju falënderoj për pyetjen që e keni shtruar. Ligji për të cilin ju pyesni se në çfarë faze është, nuk është në strategjinë e Ministrisë së Drejtësisë, është në strategjinë e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, përkatësisht në Komisionin e Kryeministrit për Çështje Gjimore. Ai ligj tani është duke u punuar dhe besoj se do të dalë së shpejti në Parlament. Nëse ka nevojë, ne si Ministri e Drejtësisë do të japim kontributin tonë edhe në atë ligj.

KRYETARI: Ju faleminderit ministre!

Deputete, a keni pyetje shtesë? Ju faleminderit. Vazhdojmë me pyetjen e radhës. Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin e Shërbimeve Publike, të Administratës Publike tash, zotin Arsim Bajramin. Deputete, e ke fjalën!

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, Kryetar!

Zoti ministër, pyetja ime ka të bëjë me një çështje shumë të rëndësishme për vendin dhe popullin e Kosovës, e ky është regjistrimi i popullatës. Tanimë gati 30 vjet nuk është bërë regjistrimi i popullatës në Kosovë dhe dihet se regjistrimi, pos rëndësive tjera që ka, një ndër to është se nga të dhënat që nxirren, bëhet caktimi i parametrave ekonomik zhvillimor për Kosovën. Prandaj, pyetja ime është: Kur do të fillojë dhe do të përfundojë regjistrimi i popullsisë, i ekonomive familjare dhe i banesave në Kosovë?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Fillimisht dëshiroj ta falënderoj Kryetarin e Kuvendit për informatën që Ministria e Shërbimeve Publike është transformuar, në bazë të vendimit të Qeverisë dhe në bazë të rishikimit funksional, në një ministri të Administratës Publike.

Gjithashtu, falënderoj deputeten Gjylnaze Syla për një pyetje shumë të rëndësishme dhe aktuale, për një pyetje kapitale për Kosovën, - regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Qeveria e Republikën e Kosovës, ka vendosur në prioritetet parësore të programit të saj regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave dhe ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që ky proces të zhvillohet me standarde më të larta evropiane, me metodologjinë bashkëkohore, duke koordinuar aktivitetet e saj me partnerët ndërkombëtarë, në radhë të parë me Agjencionin Evropian për Statistika, Komisionin Evropian dhe shumë faktorë të tjerë që po e ndihmojnë përgatitjen e procesit të regjistrimit të popullsisë.

Tanimë nuk ka dyshim që regjistrimi i popullsisë është bërë një domosdoshmëri e kohës, është bërë një proces i cili po mban, ndoshta, peng edhe proceset e zhvillimit ekonomik, proceset e planifikimit strategjik dhe ky operacion nuk është një operacion i thjeshtë demografik, por është edhe një parakusht i zhvillimit ekonomik.

Dëshiroj të fokusoj vëmendjen në dy momente, që janë vendimtare për regjistrimin e popullsisë: momenti i parë është legal dhe momenti i dytë është politik. Momenti legal ka të bëjë me Pakon e Ahtisarit, e cila shprehimisht thotë se një vit pas hyrjes në fuqi të Pakos të Ahtisarit, prezenca civile ndërkombëtare, së bashku me Qeverinë, do të koordinojnë datën e saktë të regjistrimit të popullsisë. Pra, momenti politik ka të bëjë me një regjistrim gjithëpërfshirës, një regjistrim i cili përfshinë të gjitha komunitet dhe i cili, si i tillë, paraqet një pasqyrë reale, demografike të gjendjes së popullsisë.

Enti i Statistikave, që është një agjencion brenda Ministrisë së Administratës Publike, në vitin e kaluar ka bërë të gjitha përgatitjet dhe ka bërë menaxhimin e plotë të procesit. Ne kemi pasur në vjeshtën e kaluar regjistrimin e fundit testues, regjistrim i cili ka prodhuar rezultate inkurajuese edhe sa i përket daljes së minoriteteve, përgjigjes së

minoriteteve në këtë proces, me qenë se mbi 70% e respondentëve të testuar iu kanë përgjigjur ftesës së regjistrimit të popullsisë.

Gjithashtu, Euro - Stati ka dhënë vlerësimin që metodologjia që e ka zbatuar Qeveria e Kosovës, përgatitja, prodhimi i mostrave, janë të standardeve të larta evropiane. Ne këto ditë kemi promovuar disa projekte të cilat këtë regjistrim do ta bëjnë elektronik dhe digjital. Dëshirojmë që ky regjistrim, i cili është vonuar 30 vjet, të bëhet me metodat më të reja dhe ai plotësisht të jetë i krahasueshëm me shtetet e Bashkimit Evropian.

Tani, më lejoni të jem krejt i sigurtë, do të thotë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka përgatitur regjistrimin për këtë vit, i ka bërë të gjitha proceset në koordinim me Euro Statin, me Zyrën e Komisionit Evropian dhe me përfaqësuesit e prezencës civile jemi në proces...

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! Pyetje shtesë? Deputete, a ke pyetje shtesë?

GJYLNaze SYLA: Zoti ministër, esenca e pyetjes sime është data, kur fillon dhe kur mbaron dhe pse, së fundi, gjithnjë e më shumë po flitet për vitin 2011, na shpjegoni?

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Pikërisht aty u ndërpre mikrofonin, do të vazhdoj, data është bërë diçka shumë interesante në Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës i ka bërë të gjitha përgatitjet që këtë proces ta përfundojë sivjet. Rekomandimet e fundit të Komisionit Evropian janë që, duke u bazuar në Rregulloren e Parlamentit Evropian, Rregullore e miratuar në qershor të vitit 2008, regjistrimi ynë të lidhet me ciklin e regjistrimeve evropiane, në mënyrë që me këtë ndërlidhje të regjistrimit tonë, me regjistrimin që do të ndodhë në shtetet evropiane, ne të bëhemi pjesë e Eurozonës dhe të prodhojmë statistika të cilat do të jenë plotësisht të krahasueshme dhe të pranueshme në nivel të Bashkimit Evropian.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Vazhdojmë, deputetja Synavere Rysha, pyetje për ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, zotin Sadri Ferati. Deputete, mund ta parashtroni pyetjen!

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Padrejtësisht është larguar nga vendi i saj i punës drejtoresha e Çerdhes së Fëmijëve të Kaçanikut, me një vendim të pushtetarëve lokal të Kaçanikut. Pas ankesës që i ka bërë pala e dëmtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, nga ky organ është konstatuar se e njëjta është larguar nga vendi i saj i punës në mënyrë të padrejtë. Edhe pse Komisioni i Pavarur Mbikëqyrës ka vendosur për ta kthyer drejtoreshën në vendin e saj të punës, kthimi i kësaj po pengohet nga ana e organeve komunale, kryetarit, zëvendëskryetarit dhe drejtorit të Drejtorisë së Arsimit.

Zoti ministër, a keni ndërmarrë ju hapa konkret për zhbllokimin e situatës që drejtoresha e Çerdhes së Fëmijëve të kthehet në vendin e saj të punës, kur këtu shihet qartë se kemi të bëjmë me moszbatim dhe shkelje të ligjit nga ana e zyrtarëve komunalë të Kaçanikut.

KRYETARI: Zoti ministër, a e doni fjalën?

MINISTRI SADRI FERATI: Ju faleminderit, Kryetar!

E nderuara deputete Rysha,

Duke u bazuar në Rregulloren 2008/12 për ndryshimin e Rregullores 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, neni 7.2, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës është njësi e pavarur që i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores 2008/12, në rastet kur organi i punësimit nuk i përmbahet vendimit të Këshillit, Këshilli ia paraqet rastin Kuvendit, i cili ia përcjell raportin Këshillit të Kryeministrit. Sido që të jetë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në pajtim me mandatin ligjor, është e gatshme dhe e përkushtuar për të bashkëpunuar dhe ndihmuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për zbatimin e vendimeve nga autoritetet lokale në të gjitha rastet kur kërkohen veprime nga ana e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës apo nga ana e Kryeministrit.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti ministër!

Ju po e përmendni se keni bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës. Me qenë se pyetja ka më tepër se një muaj e gjysmë që është parashtruar, çka keni bërë konkretisht për rastin në fjalë?

KRYETARI: Ministër, a e doni fjalën? Mirë. Urdhëro!

MINISTRI SADRI FERATI: Nuk kemi qenë në situatë që të bëjmë më tepër se vullnetin që e shprehja ngase nuk është kërkuar, por adresa më e mirë kishte qenë në rast se Këshilli Mbikëqyrës i Pavarur ka parë se ka kaluar mandati i moszbatimit të vendimit të tij, t’iu kishte drejtuar Kryeministrit, Kryeministri në Kabinet kishte marrë vendim dhe na kishim bërë diçka pak më shumë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ju faleminderit!

Por, vendimet e Komisionit të Pavarur Mbikëqyrës që dy mandate kanë këtë fat që e kanë. Gjykata duhet të merret me këtë çështje.

Deputetja Sanije Aliaj, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Kryeministri nuk është. Deputete, doni ta bëni pyetjen?

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Deputetë të nderuar,

Kabinet qeveritar,

Këto dy pyetje që sot janë të adresuara në emrin tim, i kam bërë në seancën e kaluar. Njëra ka të bëjë me moszbatimin e rekomandimeve të miratuara më 7 korrik 2005 për pensionistët nga puna dhe si rezultat i punës, tjetra ka të bëjë rreth asaj a ka Qeveria strategji dhe projekte konkrete për ruajtjen e resurseve kombëtare në “Trepçë”? Pyetjet do t’i përsëris derisa të marrë nga Kryeministri përgjigje. Ju faleminderit!

KRYETARI: I lexon pyetjet dhe përgjigjet i lexon në Buletin.

Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për ministrin e Transportit dhe Postë – Telekomunikacionit, zotin Fatmir Limaj, por ministri s’është këtu. A doni ta lexoni pyetjen? Jo. Faleminderit!

Deputetja Sanije Aliaj, pyetje për Kryeministrin.... E the, faleminderit!

Deputetja Dritë Maliqi, pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj. Ministri s'është këtu. A doni ta lexoni pyetjen? Për ministrin Yagcillarin. Po mirë, urdhëro, parashtroje pyetjen për ministrin Yagcillar.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe një herë përshëndetje.

Se legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e ambientit dhe ruajtjen e natyrës nuk po respektohet dhe po shkelet çdo ditë, tanimë kjo është bërë përditshmëri. Më shqetëson fakti se pse institucionet tona po i mbyllin sytë dhe kur po shkatërrohet natyra dhe ambienti edhe në zonat që janë shpallur si zona për zhvillim rural të turizmit, siç është rasti me punën ilegale të gurthyesit në fshatin Vllasali të komunës së Artanës, vetëm 300 metra larg shtëpive të banorëve të fshatit dhe disa metra nga kalaja pothuajse më e vjetra në Kosovë? Zoti ministër: Kur do ta ndërpritni punën e këtyre shkatërruesve të natyrës, të ambientit dhe zonave me rëndësi të veçantë për zhvillimin e turizmit dhe në afërsi të monumenteve më të rëndësishme kulturore dhe historike? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke përgjigje? Fjala për ministrin Yagcillar.

MAHIR YAGCILAR: Po, faleminderit zoti Kryetar!

I nderuar Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Kryeministër, zëvendëskryeministra, të nderuar ministra,

E nderuara deputete Maliqi,

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor sipas Ligjit të vlerësimit të ndikimit në mjedis është e obliguar që t'i japë pëlqimet mjedisore për operatorët ekonomik, të cilët dëshirojnë të fillojnë biznesin e tyre dhe ai biznes lidhet me ligjet të cilat janë aprovuar për mjedisin. Ky pëlqim i lëshohet operatorit ekonomik i cili i plotëson të gjitha kriteret të cilat janë të parapara me Ligjin për vlerësimin në ndikim në mjedis dhe të shqyrtuara nga ekspertët e fushave ku kërkohet. Në kuadër të këtyre procedurave ka kaluar edhe pëlqimi mjedisor për gurthyesin për të cilin më është drejtuar kjo pyetje parlamentare. Prandaj, më duhet t'ju them se janë plotësuar të gjitha dokumentet e kërkuara sipas ligjit, pëlqimi i është dhënë kompanisë “Afirmi Company” dhe ky ka të bëjë me hapjen e rrugës për plotësimin e dhe të dokumenteve të tjera që kërkohen për marrjen e licencës për punë. Ky pëlqim i është lëshuar kësaj kompanie si dhe kompanive të tjera me disa kushte të cilat duhet të plotësohen, ku në vazhdimësi bëhet mbikëqyrja nga ana e inspektoratit mjedisor dhe nëse vërehet se ndonjëra nga këto pika të cekura në pëlqim mjedisor nuk është plotësuar, atëherë inicohet procedura për marrjen e këtij pëlqimi. Gjithashtu, është vërtetuar në bazë të dhënave në GIS që posedon Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor se ky gurthyes është jashtë zonës së mbrojtur të kalasë. Në vazhdim janë të përshkruara kushtet me të cilat është dhënë pëlqimi mjedisor. Edhe pse gurorja gjendet në largësi 250 metra nga kufiri ose perimetri i caktuar sipas Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura, aplikuesi është i obliguar që minimin e parë ta bëjë si minim testues me matje, ku matjet do të bëhen afër kalasë dhe nga rezultatet e fituara do të bëhet studimi për efektet e plasjes në kala. Për datën e minimit testues do të lajmërohet me kohë Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor. Nëse merret vendimi për zgjerimin e perimetrit të zonës së veçantë të mbrojtur nga organet përgjegjësie vendimi për pëlqim mjedisor do të anulohet.

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, a ke pyetje shtesë?

DRITË MALIQI: Po, zoti Kryetar! Faleminderit! Vetëm edhe dy çështje shumë të shkurtra, sepse nuk mora përgjigje kur ishte çështja - pse afër vendbanimeve, domethënë, vendbanimit të fshatarëve të cilët ky është zëri i banorëve të atij fshati, fshatit Villasali, 300 metra dhe çështja më me rëndësi është që e ceka edhe më herët, çështja e kalasë që është 250 metra, domethënë? Kur e tha edhe ministri që do të bëhet minimi apo si e tha, çfarë shkatërrimi do të marrë kalaja më e vjetër në Kosovë, domethënë në Republikën e Kosovës, kjo është çështja dhe pse po shkelet kjo zonë aq e rëndësishme historike për banorët e Republikës së Kosovës? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, mund ta vazhdosh.

MAHIR YAGCILAR: Unë i lexova ato çështjet kryesore. Ekziston grupi i ekspertëve ose përgjegjës brenda Ministrisë i cili në bazë të dokumentacionit edhe daljes në terren e bën vlerësimin, kështu që unë sipas ligjit edhe për çështjet e tjera kam dhënë përgjigje.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputetja Sanije Aliaj pyetje për kryeministrin, zotin Thaçi.

Deputete, mund ta parashtroni pyetjen.

SANIE ALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë pyetjen e kam bërë në seancën e kaluar. Natyrisht, me veti s'i kam pyetjet, por e di përmbajtjen, sepse kam qenë thellësisht e interesuar të marrë përgjigjen nga Kryeministri. Ditë më parë, Kryesia e Sindikatës së Pensionistëve në Ferizaj ka organizuar një takim me anëtarësinë dhe, ndër të tjera, kanë dalë disa rekomandime, me deputetë ai takim ka qenë. Njëri prej rekomandimeve ka qenë - pse nuk zbatohen rekomandimet e miratuara më 7 korrik 2005 nga Qeveria e Kosovës dhe pyetja e dytë është, a mund të përshpejtohet Ligji për sigurime pensionale, sepse është i paraparë diku në nëntor, në mënyrë që pensionistët të gëzojnë të drejtën si rezultat i punës dhe nga vetë puna. Ju faleminderit, zoti Kryeministër!

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, e nderuara deputete!

I nderuar Kryetar i Parlamentit,

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i zbatojë të gjitha obligimet që i ka për çdo qytetar të Kosovës.

Unë kam takuar një pjesë të këtyre pensionistëve edhe personalisht, edhe i kam vizituar më herët, i njoh, i kuptoj dhe po punojmë që të zgjidhen ato shqetësime, ato preokupime që i ngritët me të drejtë. Punëtorët e pensionuar së shpejti do ta kenë Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor, një ligj i cili është prioritet yni dhe një ligj që kërkon mbështetje të madhe, mund të them, financiare nga ne.

Projektligji për sigurimin pensional dhe invalidor gjendet në fazën përfundimtare të hartimit dhe do të procedohet sa më parë që është e mundur për miratim këtu në Kuvend. Së bashku me Ministrinë përkatëse do t'i tejkalojmë sfidat apo pengesat procedurale për procedimin e këtij ligji.

Si Kryeministër, edhe personalisht, përpos kontakteve që kam pasur, do të mundohem të përshpejtoj këtë projektligj, në mënyrë që punëtorët e pensionuar të kenë edhe bazën e nevojshme ligjore për t'i realizuar të gjitha të drejtat e tyre që u takojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, a keni pyetje shtesë? E ka fjalën deputetja Aliaj.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti Kryeministër për përgjigjen. Ne kemi marrë një përgjegjësi nga ai takim me pensionistët e Ferizajt që pas 3 muajve ta kontaktojmë Kryesinë e Sindikatës së Pensionistëve dhe të japim përgjigje konkrete pse nuk zbatohen rekomandimet e miratuara më 7 korrik 2005. Ky është ai interesimi i tyre thelbësor edhe çështja e tyre të rregullohet me ligj. Do të thotë, ju falënderoj, kam besim në deklarinimin tuaj që keni synime konkrete në këtë çështje, por, thjesht, edhe ne jemi deputetë që duhet zërin e tyre ta jetësojmë në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, e nderuara deputete që e ngrite çështjen. Kjo punë rregullohet me ligj. Unë kam diskutuar edhe me dy deputetë të tjerë që vijnë nga kjo zonë, që kanë qenë në zyrën time, me Hajdin Abazin dhe Bahri Hysenin, që e kanë ngritur këtë çështje dhe ju që e keni zyrtarizuar këtë shqetësim, prandaj ndajmë shqetësimin e përbashkët për të gjetur zgjidhjen e mundshme dhe të procedohet sa më shpejt në mënyrë që kjo çështje të rregullohet me ligj.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryeministër!

Deputetja Kosara Nikoliq, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotin Yaghillar.

KOSARA NIKOLIĆ: Poštovane kolege i kolegince,

Gospodine minsitre,

Obraćam se u ime Srpske zajednice koja živi u ruralnim sredinama, za objašnjenje kada mogu očekivati postavljanje kontejnera i kanti za smeće. Svakoga dana su sve veće deponije djubrišta pored puteva, što ugrožava životnu sredinu. Smatram da je vreme da umesto plastičnih kesa, raznih boja okačenih po drveću i razbacanih po njivama i pašnjacima, imamo kontejnere u koje će se odlagati smeće.

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MAHIR YAGCILAR: I nderuar Kryetar!

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar zëvendësministra, ministra,

E nderuara deputete Nikoliq,

Në përgjigje të pyetjes tuaj, e nderuara deputete, mund t'ju them se bazuar në legjislacionin mjedisor, në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, Ligjin për mbeturinat dhe aktet tjera nënligjore që kanë dalë nga këto ligje, përgjegjësinë për infrastrukturën për mbeturinat e kanë kompanitë publike që merren me mbeturina në komuna. Ndërsa, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin e gjendjes në lëmin e mbeturinave. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor gjithashtu e ka identifikuar si një prej problemeve edhe mungesën e infrastrukturës për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave, andaj për këtë problematikë ka përgatitur projektin për infrastrukturën e mbeturinave me theks të veçantë në vendbanimet rurale dhe me këtë projekt ka konkurruar në IPA dhe gjithashtu e

ka futur në projektet prioritare edhe në KASH për vitin e ardhshëm. Sa për informim tuaj desha t'ju njoftoj se prej 5 qershorit që është Dita Ndërkombëtare e Mjedisit kemi filluar aksionin, së bashku me Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për pastrimin e rrugëve magjistrale nëpër tërë Kosovën. Kjo kampanjë do të zgjasë deri në fund të muajit, gjithashtu kam nënshkruar edhe disa udhëzime administrative si Udhëzimin administrativ për gjambat mandatore, gjoba këto për hedhjen e mbeturinave në vendet publike. Por, gjithashtu, jemi të gatshëm si Ministri të bashkë financojmë ose të përkrahim edhe projekte të cilat dalin prej komunitetit e gjithashtu edhe nga komunat.

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, a ke pyetje shtesë? Jo. Faleminderit!
Deputeti Riza Smaka, pyetje për zëvendëskryeministrin, zotin Hajredin Kuçi. Deputet, mund ta parashtroni pyetjen.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri Kryetar!

Të nderuar qeveritarë,

Zotëri Kuçi, pyetje kuvendore për përgjigjen gojore referuar shkallës së ulët të besimit të qytetarëve kosovarë në institucionet publike vendore. Ky është një konkludim që e kam marrë nga shumë raporte, ndër të tjera, edhe nga raporti për paralajmëronin e hershëm numër 241/8, shtypin ditor s'po e citoj, se fundi i fundit të dhënat nga shtypi edhe nuk janë gjithmonë të sakta, mirëpo megjithatë edhe në shtypin ditor të datës 21 maj 2009. Ju lutem, si e valorizoni, si e stimoni konkluzionin e këtillë dhe referuar këtij çfarë mendoni se do të duhej bërë në mënyrë që besimi i qytetarëve kosovarë në institucionet tona të rritet ashtu si do të duhej të ishte? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti zëvendëskryeministër, e keni fjalën. Zëvendëskryeministri e ka fjalën. Pyetja është për zëvendëskryeministrin, Hajredin Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Më duket, deputeti Smaka e ka bërë pyetjen e përafërt edhe me Kryeministrin dhe besoj se Kryeministri do të japë përgjigje për të dyja. Kur është rendi i Kryeministrit, ai mund ta marrë fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

I nderuar deputet,

Sot, qytetarët e Kosovës janë qytetarët më optimistë, mund të them, në Evropë, nga të gjitha sondazhet që kanë dalë të organizuara nga mekanizma të përgjegjshëm ndërkombëtarë. Dua të theksoj se vetëm sondazhi Gallup Polls, ku qytetarët e Kosovës 62% prej tyre janë përgjigjur se janë optimistë duke vlerësuar se zhvillimi i përgjithshëm i vendit të tyre është duke ecur në drejtim të duhur. Kjo tregon, kjo shifër tregon se qytetarët e Kosovës janë qytetarët më optimistë. Gjithashtu, dua të potencoj se njohjet nga 60 shtete të botës që e kanë njohur shtetin e pavarur të Kosovës e kanë shtuar optimizmin se vendi ynë është duke shkuar në drejtim të njohur për qytetarët e Kosovës.

Gjithashtu, rritja ekonomike për rreth 6% për vitin 2008 e ka shtuar optimizmin e qytetarëve se vendi po ecën në drejtim të duhur. Gjithashtu, anëtarësimi i shpejtë që do të ndodhë në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore dhe IBRD e ka shtuar optimizmin e qytetarëve se Kosova po ecën në drejtim të duhur dhe do të ketë edhe efekte të zhvillimit ekonomik, jo vetëm të mbështetjes politike. Reformat që po ndodhin, reformat demokratike edhe në legjislacion, edhe në ekonomi, edhe në politikë e kanë shtuar optimizmin, e kanë rritur optimizmin e qytetarëve se Kosova është në rrugë të

drejtë për t'u integruar në strukturat, pra është në agjendën evropiane dhe për në NATO. Gjithashtu, dua të theksoj se edhe vetë sondazhet e tjera ndërkombëtare si Trans-International që e vlerëson se Kosova është vendi i fundit në rajon për korrupsion, e ka rritur optimizmin e qytetarëve se në Kosovë ka sundim të ligjit, ka luftë pa kompromis kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ka qeverisje efikase, ka qeverisje të mirë dhe nëse e bëjmë vetëm në krahasim me vitin 2007, ku 67% të qytetarëve për të kryer një punë kanë dhënë ryshfet, zvogëlimi që del nga ky sondazh del se kemi 5 herë më pak për vitin 2007 apo krahasuar me përqindje 500 herë, prandaj jemi në rrugë të drejtë dhe do të implementojmë agjendën tonë për të mirën e qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!
Deputet, a ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Unë pyetjen ia pata adresuar zotëri zëvendësministrit, a zëvendëskryeministrit, kërkoj falje për këtë, ndërsa zotëri Kryeministri u përgjigj në pyetjen që ia kam adresuar pikërisht zotëri Kryeministrit. Kështu që janë dy pyetje, pyetja e parë ishte e datës 26 maj 2009, drejtuar zotëri zëvendëskryeministrit Kuçi dhe tash u bë një konfuzion, por megjithatë unë po e shfrytëzoj rastin, për hir të respektit ndaj zotëri Kryeministrit, meqenëse u përgjigj në pyetjen e tij, nëse më lejohet, atëherë unë do të kisha shtruar një pyetje plotësuese, me kërkesë që zotëri Kuçi le të përgjigjet në pyetjen e vet, nëse është përgatitur.

Zotëri Kryeministër, unë të dhënat zyrtare, natyrisht, nuk i kam marrë me kënaqësi, por me pakënaqësi ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zoti Kryeministër, a keni përgjigje në pyetjen shtesë?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari deputet, Unë vetëm ju ftoj që duke vlerësuar kontributin tuaj personal profesional dhe përgjegjësitë që ke treguar vazhdimisht edhe në botën akademike dhe politike, ju ftoj se ishte jo bash e mirë në kuptimin e dëgjimit, që shifrat nuk ishin bash të pëlqyeshme për ju. Ky është sukses edhe i juaji, ky është sukses i Kosovës, është sukses i të gjithëve, prandaj gëzohemi dhe ndihemi krenarë secili me të arriturat e vendit tonë, qoftë pozitive, qoftë opozitive. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Me këtë përgjigje veç është tejkaluar koha e rezervuar për pyetje parlamentare dhe e mbylлим këtë pikë të rendit të ditës. Në radhë është pika e tretë e rendit të ditës që do të udhëhiqet nga anëtar i Kryesisë, Naim Maloku.

Drejtimin e seancës e merr zoti Naim Maloku, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit, i nderuar deputet,
Vazhdojmë seancën, pika e radhës:

**- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit
Numër 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë**

Konstatime hyrëse: Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rshiq, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Ja bih hteo da zamolim sve vas, poštovane dame i gospodo narodni poslanici, da ovaj zakon odložimo na mesec dana. Dozvolite da vam objasnim, to je zbog toga što u konsultacijama i sa gospodinom Ahmetom Šaljom, ministrom zy Finansije i Ekonomiju, a i zbog završne faze Belog papira, koji smo mi uradili na jednom nivou i koji je, po meni, a i po ostalima, vrlo dobar, ja mislim da bi trebali da odložimo ovaj zakon zbog toga što je ovaj zakon već i predvidjen u Belom papiru. Mislim da ćemo Beli papir moći usvojiti, mi kao Vlada prvo, u narednih nekoliko nedelja, tako da samim usvajanjem Belog papira, ova svera socijalne podrške i socijalne obuhvatnosti je mnogo šira i mnogo će biti više funkcionalna u sužbi naših gradjana. Znači, predlažem, jer ipak mislim da je u pitanju jedno ili dve nedelje, ali za svaki slučaj, ja sam predložio da zakon odložimo za mesec dana, ukoliko bude nekih zastoja sa belim papirom, koje ja iskreno ne očekujem. Ja sam još jednom potvrdio stav sa gospodinom ministrom Finansija, da li će Beli papir biti usvojen, ja mislim da hoće, prema tome usvajanje Belog papira će biti još značajnije nego što bi potencijalno mogao da bude zakon o poboljšanju socijalnih asistencija. Hvala puno!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Më lejoni që deputetëve t'ua lexoj Rregullën 35 të Rregullores së Punës të Kuvendit, paragrafi 3, ku thotë, citoj: “Propozuesi mund ta tërheq projektligjin gjatë shqyrtimit të parë, deri para fillimit të procedurës së votimit, për miratim në parim. Pra, kjo rregullore e kufizon mundësinë që ky propozim të qitet në debat. Me një vërejtje, zoti ministër, që tërheqja ka qenë më korrekte të bëhej në fillim të seancës. Pra, propozuesi e tërheq Projektligjin nga procedura e mëtejme. Ju faleminderit!

Unë, ua lexova Rregulloren, mund ta ndryshoni kur të vjen puna për ta ndryshuar Rregulloren.

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë**

Konstatimet hyrëse. Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. E keni fjalën, zonja ministre.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të Ministrisë së Drejtësisë t'i paraqes për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës Projektligjin për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë.

Ky projektligj është rezultat i punës dhe i përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e saj, në veçanti për kontributin e saj me pakon ligjore që do të miratohet nga ky Kuvend për luftimin e korrupsionit dhe të dukurive të tjera negative. Në gjendjen shumë delikate sa i përket kontrollit dhe prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, me anë të këtij projektligji synohet që të gjithë zyrtarët e lartë publikë të deklarojnë pasurinë e tyre dhe prejardhjen e saj me rastin e punësimit në shërbimin publik gjatë ushtrimit të pozitës së tyre si zyrtarë dhe pas largimit të tyre nga funksioni publik. Projektligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë paraqet jo vetëm një masë ndihmëse, por një domosdoshmëri si për faktin se është ligj i ri dhe modern, por edhe për faktin se ky ligj është ndërhyrje komplementare e fuqishme në përmirësimin e gjendjes ekzistuese, pa të cilin sot nuk mund të paramendohet sundimi i ligjit as në vend, e as në vendet më të përparuara të botës.

Ky projektligj është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me ekspertë të shquar të brendshëm dhe ndërkombëtarë.

Ky projektligj përcakton parimet themelore dhe krijon mekanizma efikas për mbikëqyrjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, të anëtarëve të ngushtë të familjes së tyre, si dhe të personave të lidhur me ta, duke synuar krijimin e një baze të mirëfilltë ligjore.

Fuqizimi i këtij projektligji është i një rëndësie të veçantë sepse do t'i hapte rrugën shtimit të efikasitetit në punën e prokurorive dhe të Gjyqësorit, në përgjithësi, për zbulimin e veprave të ndryshme penale të korrupsionit, marrjes së mitos dhe formave të tjera të kundërligjshme, gjë e cila do të ndikonte si preventivë dhe do të shtonte besimin tek qytetarët në punën e zyrtarëve të lartë publikë dhe të zyrtarëve në përgjithësi.

Desha të jap edhe një sqarim tjetër. Është përfunduar edhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit kundër korrupsionit. Në atë ligj është përfshirë një kapitull i tërë për regjistrimin e dhuratave. Në këtë ligj nuk ekziston ai. Nëse ju, si kuvendarë, si parlamentarë, e mendoni se duhet ai kapitull pasi të vjen ai ligj në shqyrtim, në ndërkohë në mes dy leximeve, pas leximit të parë, mund të amendamentohen dhe të kalojë i tërë ai kapitull në këtë ligj ose të mbetet në Ligjin antikorrupsion, i cili do të vijë së shpejti në procedurë parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja ministre!

Hapi debatin për diskutim, në parim. Për fjalë është lajmëruar, si duket në emër të Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi e ka shqyrtuar para se të vjen sot, në parim, Ligjin për deklarimin e pasurisë, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe ka konstatuar se Projektligji në fjalë i plotëson kriteret e përgjithshme për t'u lexuar sot në leximin e parë dhe për t'u miratuar, duke marrë parasysh që e ka deklaraten shpjeguese, e cila qartazi tregon përmbajtjen, qëllimin dhe natyrisht edhe mundësinë që e ka projektligji, ka deklaraten financiare që tregon se buxheti i cili do të harxhohet për këtë ligj është i pranueshëm për buxhetin e Kosovës dhe, natyrisht, ka deklaraten që ky projektligj është në përputhje me standardet evropiane.

Natyrisht që komisioni ka pasur edhe disa vërejtje rreth projektligjit, duke pasur parasysh se projektligji rregullon 3 fusha – deklarimin e pasurisë, prejardhjen e pasurisë dhe kontrollin e pasurisë.

Vërejtjet tona kanë qenë që sa i përket deklarimit të pasurisë, konsiderojmë se projektligji shumë mirë e ka rregulluar këtë çështje dhe flet pothuajse në pjesën më të madhe të neneve dhe të paragrafëve për deklarimin e pasurisë. Sa i përket prejardhjes së pasurisë, natyrisht që ka nene që e përmendin, mirëpo ndoshta do të duhej që në shqyrtimin e dytë apo me kontributin e deputetëve të Parlamentit të Kosovës dhe të mekanizmave të tjerë të shikojnë që të pasurohet kjo çështje, sepse flet shumë pak, mos të them fare dhe, natyrisht, ndoshta një kontroll të veçantë duhet të kemi edhe sa i përket kontrollit të pasurisë.

Vlen të përmendet se në Projektligj, edhe pse është paraparë një numër i caktuar i zyrtarëve të lartë që duhet të deklarojnë pasurinë, vlen të përmendet që ka vend edhe për zyrtarë që nuk janë paraparë dhe mendoj se duhet të merren parasysh në të ardhmen në deklarimin e pasurisë të jenë edhe menaxherët e prokurimit, udhëheqësit e ndërmarrjeve publike, sepse aktualisht në këtë projektligj nuk janë paraparë.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi do të jetë i gatshëm të bashkëpunojë edhe me Zyrën ndërlidhëse të Komisionit Evropian, i cili para se të vjen këtu ky projektligj, ka pru disa rekomandime të cilat i konsiderojmë të rëndësishme dhe natyrisht që kemi premtuar që, si komision funksional, në bashkëpunim edhe me komisionet tjera, do t'i marrin parasysh të gjitha rekomandimet që i ka pru Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian, të cilat konsiderojmë se janë të rëndësishme duke pas parasysh që Komisioni Evropian ka një rol të rëndësishëm sa i përket çështjes së këtyre ligjeve të cilat e plotësojnë, po them, pakon e projektligjeve në luftën kundër korrupsionit. Natyrisht që sot e kemi edhe amendamentimin e Ligjit për konfliktin e interesit dhe së shpejti, siç jemi në dijeni, do të vjen edhe Ligji bazë për antikorrupsionin.

Duke kërkuar që të aprovohet projektligji, në parim, kërkojmë që deputetët gjatë fazës së amendamentimit të projektligjit të japin kontributin për projektligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së i kam të lajmëruar deputetë. Unë e ftoj deputetin Ramadan Gashi ta marrë fjalën.

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe konsiderojmë se projektligji në fjalë i përmban kriteret bazë për të proceduar me procedurë të mëtutjeshme, duke pasur parasysh se projektligji vërtet i ka edhe të gjitha aktet shpjeguese të cilat e kompletojnë procedimin e tij dhe të cilat kryetari i Komisionit gjerësisht i sqaroi. Ne si Grup Parlamentar e përkrahim këtë ligj që të aprovohet, në parim, dhe kontributin tonë do ta japim në komisionet funksionale përkatëse.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ftoj deputetin Armend Zemaj, ta marrë fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Ky projektligj shumë i përfolur, pak edhe i vonuar, por është i domosdoshëm, i rëndësishëm së veçantë në kuadër të plotësimit të infrastrukturës ligjore të ngritjes së masave për kontroll efikas në luftimin e krijimit të pasurisë në mënyrë të paligjshme të zyrtarëve të lartë publikë. Edhe pse qëllimi kryesor është vënia e transparencës së detyrueshme duke detyruar deklarimin e pasurisë, ne mendojmë se amendamentet që kanë të bëjnë me prejardhjen e pasurisë duhet të saktësohen dhe të amendamentohen nga komisioni funksional në këshillim të ekspertëve të kësaj lëmie si vendës ashtu edhe ndërkombëtarë. Për të pasur kontroll efektiv të përfitimeve të zyrtarëve publikë, ne mendojmë se duhet saktësisht të precizohet mënyra detyruese për deklarimin e pasurisë së fituar, sidomos që nga viti 99 e këndej, prandaj neni 7 dhe 8 duhet të detajizohen dhe të plotësohen që ky projektligj të marrë formën koncize dhe për të cilën i referohet. Nevoja për plotësimin e kësaj fushe me ligj adekuat obligon Grupin Parlamentar të LDK-së për përkrahje në parim, duke u zotuar se me gjithë kapacitetin do të kontribuojë në komisionin funksional që ky projektligj të ketë qartë të definuar qëllimin dhe fushëveprimtarinë e vet. Pra, Grupi Parlamentar i LDK-së i jep përkrahje, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ftoj deputeten Zylfije Hundozi ta marrë fjalën.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti kryesues, zotëri ministra, kolegë deputetë,

Ky projektligj është mjaft mirë i konceptuar, mirëpo unë dhe Grupi im Parlamentar do t'i paraqesim disa vërejtje konkrete dhe propozime për komisionin funksional. Në neni 3 të këtij projektligji, lista e mëparshme e personave të cilët duhet të deklarojnë pasurinë zgjerohet mjaft dhe me këtë arsye se një numër i madh i nëpunësve civilë ka profesione vulnerable, të cilat mund t'i çojnë në korrupsion, gjë që nuk është dukuri e rrallë në Kosovë. Mirëpo, lista që është dhënë në këtë nen është shumë e gjerë dhe nëse nisemi nga fakti që paraqitja e pasurisë së zyrtarëve publikë duhet të bëhet sa më detajisht dhe në mënyrë transparente, atëherë Agjencioni Antikorrupsion nuk do të ketë mjaft resurse njerëzore që të vlerësojë saktësinë e të dhënave dhe t'i zbatojë procedurat me saktësi që kërkohet me këtë ligj. Zgjidhja më e mirë do të ishte që pasuria e nëpunësve civilë të mbikëqyret gjithsesi, se mundësia e tyre për t'u korruptuar është shumëfish më e madhe se e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, por kjo të bëhet me rregullat që do të paraqiten në Ligjin për shërbyesit civilë dhe të hiqen nga lista në Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

Një çështje tjetër, me të cilën merret kapitulli II, neni 3 dhe 4, është se sa gjerë duhet të aplikohen kërkesat për deklarimin e pasurisë në persona tjerë, gjegjësisht në anëtarët e familjes dhe të personave që janë në marrëdhënie të afërt. Nuk është praktikë dhe nuk është e drejtë që anëtarët e familjes ta deklarojnë pasurinë vetë, sidomos nëse fëmijët e personit publik janë të moshës së mitur. Gjithashtu, me definicionin që është dhënë për personat që kanë marrëdhënie të afërt me zyrtarin publik, i tejkalon standardet evropiane që nevojiten për deklarimin e pasurisë. Nëse nisemi nga definicioni në nenin 3 të këtij projektligji, është e padrejtë të kërkohet nga zyrtari publik të jetë në dijeni për pasurinë, të ardhurat të një numri të konsiderueshëm të personave që kanë marrëdhënie të afërt me të. Gjithashtu, personat e tillë kanë të drejtë të mos ia ekspozojnë publikut pasurinë e tyre se pasi që nuk janë persona publikë, atëherë pasuria e tyre është çështje e tyre personale.

Dhe, prapë, a do të ketë Agjencioni Antikorrupsion kapacitete që të përpunojë një numër kaq të madh të të dhënave? Nëse konsultohen ligjet për deklarimin e pasurive të shteteve të Bashkimit Evropian, do të shihet se definicioni për personat që kanë marrëdhënie të afërt me zyrtarin publik, ka një domethënie më të ngushtë, e jo si në projektligjin tonë. Prandaj, gjatë punimit në komisionet funksionale duhet të jepet definicioni korrekt se çka nënkuptohet me personat që kanë marrëdhënie të afërt me zyrtarin publik, gjegjësisht deklarimin e pasurisë ta bëjnë vetëm anëtarët e ngushtë të familjes.

Në kapitullin III, neni 10, paragrafi 3, flitet për të drejtën e çdo qytetari që të ketë qasje në deklarimin e pasurive të zyrtarëve publikë dhe kjo është një hap me rëndësi që t'i sigurohet transparenca e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

Në nenin 10, paragrafi 3 dhe 5, kërkohet që për njoftim publik të deklaratës së pasurisë të zyrtarëve publikë duhet të bëhet kërkesë me shkrim. Nuk e mundëson që qasja në këto dokumente të jetë e plotë. Nëse publiku nuk ka informatë për pasurinë e deklaruar dhe nëse nuk ka mbikëqyrje efikase të deklaratave, atëherë procesi i deklarimit të pasurisë do ta humbë rëndësinë e vet. Prandaj, një propozim tjetër, të gjitha të dhënat duhet të publikohen në internet gjegjësisht në ueb-faqen e Agjencionit kundër Korrupsionit.

Kreu V, dispozitat ndëshkimore janë shkruar në mënyrë konfuze dhe të paqëndrueshme. Nuk është e qartë se cilat janë kompetencat e gjyqit. Nëse ky ligj nuk respektohet, gjegjësisht cilat janë rregullat procedurale të gjyqit në lidhje me deklarimin e pasurisë, gjegjësisht nuk është e qartë cili është raporti në mes të fuqisë ndëshkuese të agjencionit dhe kompetencave të gjyqit sa i përket deklarimit të pasurisë.

Ndoshta është menduar që agjencioni ta luaj rolin e gjyqit të shkallës së parë, e gjyqi instancën më të lartë, por kjo gjë nuk është precizuar askund në këtë projektligj. Disa sanksione të paraqitura duken problematike, si ato në nenin 8, paragrafi 3, dhe neni 15, paragrafi 5, ku thuhet se “nëse zyrtari i lartë publik nuk e deklaroi pasurinë, do t'i konfiskohet pasuria dhe do të përjashtohet nga puna”. Kjo bie ndesh me ligjet tjera, si për shembull, nëse kjo iu referohet deputetëve ose kryetarit të shtetit, nuk do të mund të zbatohet. Prandaj, këto duhet të hiqen nga projektligji.

Me gjithë këto vërejtje, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah projektligjin dhe do ta japë kontributin e vet në komisionin funksional.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, ftoj deputetin dhe shefin e Grupit, Ibrahim Makolli, ta marrë fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Projektligji në fjalë shkon kah kompletimi i legjislacionit të kësaj natyre, që ka qenë shumë i domosdoshëm në Kosovë. Do të përmend vetëm dy-tri çështje, të cilat konsideroj se do të duhej t'i kishin parasysh. Në radhë të parë, draftligji ka mangësi, sepse flet për tri komponentë, e në të vërtetë përmban vetëm dy komponentë. Nuk është e precizuar komponenti i prejardhjes së pasurisë, që është shumë e rëndësishme në këtë vend, sidomos në këtë fazë nëpër të cilën po kalojmë. Dhe, mendoj se duhet të jenë këto plotësime edhe me këtë shtyllë, por nuk jam i bindur se këtë mund ta kryej komisioni.

Një çështje që, po ashtu, u përmend edhe këtu nga kolegët, janë masat ndëshkimore, të cilat janë në Kreun V, neni 14. Unë po shtroj vetëm një pyetje: - a mendoni se me këto masa kaq të ulëta ndëshkimore për mosdeklarim të rregullt të pasurisë, qoftë vjetore, qoftë të tjera, me një dënim prej 150 eurove ose 300 eurove, mund të kemi detyrim për deklarimin e pasurisë? Prandaj, propozojmë që këto masa ndëshkimore të jenë më të larta, sepse kështu do të kishte mundësi të deklarimit më të rregullt të pasurisë dhe njerëzit, natyrisht, do ta kishin parasysh. Si Grup Parlamentar e mbështesim në parim këtë draftligj, por po ashtu kërkojmë nga komisionet që ta pasurojnë dhe të kompletohet një legjislacion i cili do të mundësojë edhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë, por në veçanti prejardhjen e pasurisë, sepse në këtë vend ka mjaft zyrtarë të lartë, pasuria e të cilëve konsiderohet se është e dyshimtë ose prejardhja e pasurisë, prandaj ka shumë nevojë që të precizohet qartazi edhe prejardhja e pasurisë. Faleminderit!

KRYESUEIS: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar LDD-së, deputeti Adem Salihaj e ka fjalën.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe ka marrë qëndrimet e veta lidhur me te. Siç e thanë edhe kolegët, edhe kryetari i Komisionit, ky projektligj ka tri fusha të ndryshme, pra deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë, por përmbajtja e projektligjit nuk është në përputhje me vetë titullin. Pra, projektligji trajton në mënyrë deri diku adekuate kontrollin dhe deklarimin, por nuk merret me çështjen e prejardhjes së pasurisë, përveç se e përmend shkarazi në dy vende të Projektligjit. Prandaj, mendimi dhe qëndrimi ynë është që ky projektligj, për të qenë komplet dhe për ta kryer me sukses misionin e tij në legjislacionin e Kosovës, duhet ta përfshijë edhe kapitullin e prejardhjes së pasurisë. Pra, ky kapitull duhet të trajtohet si kapitull i veçantë, me nene të ndryshme, në mënyrë që të plotësohet në tërësi përmbajtja e Ligjit në bazë të titullit që ka.

Mendojmë që pjesa që do të duhej të bënte fjalë për prejardhjen e pasurisë, është një pjesë tepër e rëndësishme, duke marrë parasysh se është shumë me rëndësi që zyrtarët e lartë të të gjitha institucioneve të Kosovës do të duhej të ishin plotësisht transparent dhe ta bënin publike dhe transparente prejardhjen e pasurisë së tyre, aq më tepër kur ka aq shumë përfolje, ka aq shumë komente në shtyp edhe gjithkund në opinion për pasurinë e zyrtarëve të lartë. Kjo do të ndihmonte shumë që kjo çështje të sqarohet mirë para opinionit. Veçanërisht, po e zëmë, ka plotë zyrtarë të lartë të institucioneve të ndryshme të Kosovës që para katër-pesë vjetësh kishin një pasuri të themi gati zero, kurse sot kanë pasuri të madhe dhe ne dhe opinionin e Kosovës do të duhej ta dinte prej nga për një kohë kaq të shkurtër ka ardhur një person i caktuar deri te gjithë kjo pasuri. Prandaj, mendimi dhe qëndrimi ynë është që ky ligj, krejt për qëllime plotësisht të mira, të kthehet dhe të plotësohet nga Ministria e Drejtësisë edhe me kapitullin që do të bënte fjalë për prejardhjen e pasurisë dhe pastaj ky ligj do ta kryente me sukses të plotë edhe misionin e tij në shoqërinë Kosovare.

Po ashtu, mendojmë që ka vend edhe për futjen ose zgjerimin e listës së zyrtarëve të lartë edhe me zyrtarë të ndërmarrjeve publike, me zyrtarë të Trustit të Pensioneve të Kosovës dhe ndoshta edhe të segmenteve tjera. Po ashtu, nuk janë mjaft të qarta edhe dispozitat ndëshkimore nga Gjykata, pra nuk janë paraparë në mënyrë të qartë çka ndodhë, çfarë ndëshkimi merr personi i caktuar që të bëjë përpjekje të mos e deklarojë ose ta fshehë pasurinë e tij ose prejardhjen e pasurisë së tij, kështu që edhe në këtë aspekt mendoj që ka nevojë të bëhen plotësime të ndryshme.

Do të mundej, ndoshta, Komisioni për Legjislacion ta jepte një kontribut, por jo në këtë masë sa e kërkon ky ligj. Pra, Komisioni mund të bëjë amendamente të ndryshme, por mendoj që nuk ka kapacitete të mjaftueshme ta fus një kapitull të tërë të ligjit që do të bënte fjalë për prejardhjen e pasurisë. Prandaj, është e dobishme, mendoj, që Ministria ta ripunojë plotësisht, ta fus këtë segment dhe ky ligj, mundësisht për një kohë shumë të shkurtër, ndoshta dy deri tri javë, të vijë sërish në Kuvend dhe të aprovet pa asnjë problem. Këto janë, zoti kryesues. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+” ftoj deputetin Xhezair Murati, ta marrë fjalën.

DŽEZIR MURATI: Hvala, gospodine predsedavajući!

Pozdrav prisutnim ministrima i kolegama,

Mislim da je ovaj od izuzetno značajnih zakona koji se posebno reflektuje u javnosti, gradjanstvu, jer se dotiče jedne velike aktuelne oblasti, a to je javna kontrola imovine visokih javnih zvaničnika, dakle nas i ne samo nas, priroda, dobiti, obaveze i tako dalje. On se odnosi na prijavljivanje imovine od momenta preuzimanja dužnosti, redovno godišnje podnošenje izveštaja dok smo ili su na dužnosti, i izjave nakon odlaska sa javnih funkcija.

Oblast koja se reguliše ovim zakonom, osim osetljivosti je i odgovornost, a u slučaju kršenja, predivdja i kaznene odredbe. Zakon je posebno značajan, jer Agencija protiv korupcije je nadležna za njegovo sprovođenje. S toga, on je i modifikovan sa zakonodavstvom Evropske Unije, kako staoji u memorandumu priloženom uz Zakon i on ima 5 poglavlja i 19 članova. Ko ga malo pažljivije analizira, svakako će utvrditi neke jezičke nejasnoće, ali u svakom slučaju radi se o dosta stručno urađenom pravnom tekstu.

Njegova primena svakako će zavisiti i najbolje pokazati zrelost, ozbilnost, i odgovornost naših institucija i našeg društva. Parlamentarna grupa „7+“ ga u načelu prihvata, naravno uz primedbe i dopune koje će uslediti tokom njegove analize. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Bojan Stojanović e ka fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Uvažene kolege poslanici,

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke takodje podržava u načelu ulazak jednog ovakvog zakona u skupštinsku proceduru i smatramo da su ministar, kao i predsednik komisije imali adekvatno objašnjenje za neophodnost ovakvog zakona. Šta će on regulisati, koliko je to bitno za omogućavanje kvalitetnijeg rada sudova i da se javnost bolje informiše, jako je bitno i dobro što će ti podaci biti transparaentni i javni, tako da će skrivanje imovine verovatno biti manje i teže zbog toga što će i javnost moći da uloži svoje primedbe vezano za to. Naravno, postoje neke stvari koje treba dopuniti i doraditi, ali za to ima vremena na komisijama. Ja ne bih puno da ozumem vremena zato što su moje kolege uglavnom rekle dosta vezano za to i nama je potrebno još malo vremena da tu jezičku terminološku neusaglašenost, koja ponekada izgubi i smisao kada se ovakvo uradi prevod, da jasno razjasnimo šta je to i da svoje predloge damo kroz funkcionalne komisije. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Suzan Novobrdaliu, le të përgatitet deputetja Sanije Alijaja.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Duke u bazuar në gjendjen aktuale në Kosovë, mendoj se ligjet për parandalimin e korrupsionit dhe luftimin e korrupsionit janë shumë, shumë, shumë të nevojshme.

Paraprakisht dëshiroj të them se e përkrah këtë Projektligj, mirëpo vërejtjet e mia kanë të bëjnë, si vijon: Tek neni 3, tek zyrtarët e lartë publikë përfshihen, do të thotë përpos personave që janë përfshirë këtu, të shtohen edhe menaxherët e prokurimit, sepse të njëjtët nuk janë të përfshirë.

Neni 9, deklarimi pas largimit nga funksioni. Pas përfundimit të punës në shërbimin publik, zyrtari i lartë publik brenda 30 ditëve paraqet deklarin e pasurisë, ashtu siç është paraparë në nenin 4 dhe 5 të këtij ligji. Do të thotë se deklarimi i fundit pas përfundimit të punës është 30 ditë. Mendoj që afati prej 30 ditësh, është afat shumë i shkurtër dhe i njëjti propozoj të zgjatet për një vit.

Pas nenit 9, propozoj të shtohet edhe një nen, do të thotë të jetë neni 10, i cili do të përfshijë:

10.1 “Çdo subjekt që ka për obligim ta deklarojë pasurinë, është i detyruar të deklarojë edhe prejardhjen e saj. Barra e provës për deklarimin e prejardhjes së pasurisë, i bie subjektit deklarues të pasurisë”.

10.2 “Në rast se subjekti deklarues nuk është në gjendje ta arsyetoj prejardhjen e pasurisë së tij, Agjencia obligohet të parashtrojë kërkesë në gjykatën kompetente për të kërkuar konfiskimin e pasurisë dhe lënda si e tillë të dërgohet në Prokurori të shtetit, për hetimet e mëtutjeshme”.

Neni 10 tani kishte për të qenë neni 11. Pas pikës 5.3, të shtohet një pikë, arsyet e kërimit të informacionit.

Neni 15, kemi të bëjmë me sanksionet për personat të cilët nuk e deklarojnë pasurinë. Pika 5 thotë: “Nëse zyrtari i lartë publik nuk dorëzon formularin për gjendjen e pasurisë edhe pas ekzekutimit të detyrueshëm të sanksionit nga institucioni ku është i punësuar, Agjencia njofton organin përgjegjës për fillimin e procedurës për shkarkimin nga detyra”.

Tani unë parashtroj pyetjen: Çka nëse presidenti, kryeministri, ministrat, deputetët nuk e deklarojnë pasurinë, çfarë sanksionesh do t’u shqiptohen atyre, kur në Kushtetutë janë të përshkruara rasatet kur mund të shkarkohet presidenti, kur mund t’i merret mandati apo imuniteti një deputeti. Do të thotë, kjo çështje duhet të rregullohet, duhet të parashihen sanksionet pikërisht për këta zyrtarë të lartë.

Neni 16, është një gabim teknik, ai duhet të përmirësohet. Krejt në fund, dëshiroj të theksoj se krejt ligjet të cilat miratohen në Kuvend, është me rëndësi të aplikohen apo të implementohen, sidomos këto ligje këtu. Në lidhje me këtë dëshiroj të them se Qeveria duhet të paraqesë vullnet të mirë dhe ta forcojë Agjencionin kundër Korrupsionit, sepse në Republikën e Shqipërisë, është Inspektorati i lartë për kontrollin e prejardhjes dhe deklarimin e pasurisë, në të cilën inspektorat janë të punësuar afër 50 persona, ndërsa në

Agjencionin kundër Korrupsionit, Divizionin për parandalimin e konfliktit të interesit dhe deklarimin e pasurisë janë të punësuar vetëm 8 persona. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Para se t'ua jap fjalën deputetes në radhë, të nderuar deputetë, më lejoni t'ua lexoj Rregullën 35, shqyrtimi i parë i projektligjeve, paragrafi 2, citoj: "Shqyrtimi i parë nënkupton miratimin në parim të projektligjit. Në shqyrtimin e parë nuk propozohen amendamente në Projektligj". Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Sanije Alijaj, le të përgatitet deputeti Emrush Xhemajli.

SANIJE ALIJAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra të pranishëm,

Shqyrtimin e parë të Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë e konsideroj një hap të rëndësishëm për Ministrinë e Drejtësisë, sepse është një ligj bazik që vë nën kontroll ligjor të hyrat dhe përfitimet tjera të zyrtarëve të lartë publikë dhe të familjeve të tyre. Ajo çka e bën të veçantë këtë projektligj, është se parasheh masat ndëshkimore që do të ndërmerren ndaj zyrtarëve të lartë publikë për mos deklarimin e pasurisë së tyre që, për fat të keq, me rastin e prezantimit të raportit të Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit, pothuaj se nga të gjitha institucionet kishte zyrtarë të lartë, të cilët nuk e kishin kryer këtë obligim që tani me këtë Projektligj synon të zyrtarizohet.

Projektligji synon të rregullojë obligimin e zyrtarëve të lartë publikë për deklarimin, ndër të tjera, të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, borxhet si dhe të hyrat vjetore. Njëherësh, me nenin 5, Projektligji parasheh llojet e deklarimit, që është deklarim vjetor, me rastin e marrjes së funksionit, deklarimet që kërkohen nga Angjencioni dhe deklarimet pas përfundimit të funksionit.

Ditë më parë, në Kuvend shqyrtuam Raportin e Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit, që la për të kuptuar se korrupsioni edhe më tej gjen shtrirje në shoqërinë tonë, e në veçanti në institucione. Me këtë projektligj i jepet hapësirë mënyrës së organizimit dhe aplikimit të metodave të veprimit si dhe mekanizmat që vejnë nën kontroll prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, e në mënyrë indirekte parandalon dhe lufton korrupsionin.

Në kreun 3, neni 10 dhe 11 përcaktojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e Agjencionit. Agjencioni ka të drejtë të kërkojë nga zyrtari i lartë deklarimin e pasurisë, burimin e krijimit dhe të urdhërojë kontrollin e vërtetësisë së deklarimit.

Ministre e nderuar,

Kolegë deputetë,

Si mund ta zbatojë këtë Projektligj Agjencioni si mekanizëm kryesor për zbatimin e tij, kur nga raporti po i citoj disa të dhëna: Agjencioni ka një menaxhment prej 35 zyrtarëve, në mungesë të hapësirës me koordinim jo të mirë me prokuroritë, në mungesë të sigurisë për zyrtarët të cilët e zbatojnë këtë Ligj dhe me një buxhet shumë të limituar. Pasurimi i zyrtarëve të lartë brenda nate është sinonim i pandershmërisë. Po qe se nuk i shembet dheu nën këmbë të pandershmit, vështirë do ta ketë shoqëria e Kosovës të shkojë përpara.

Projektligji lë përshtypjen që korrupsioni prek vetëm politikën dhe politikanët. Unë do të thosha se korrupsioni, në qoftë se ekziston në radhët e institucioneve të Kosovës, ai përfshin edhe bashkëpunëtorët që ndihmojnë në këtë drejtim për ta jetësuar korrupsionin. Prandaj, konsideroj se me disa nene, Ligji duhet të begatohet, në veçanti të plotësohet me nene lidhur me prejardhjen e pasurisë, t'i japë fuqi Agjencionit të monitorojë pasurimin e paligjshëm të zyrtarëve të lartë dhe mundësinë tjetër që të bashkëpunojnë me agjencionet tjera, në mënyrë që në përpikëri të zbatojë ligjin.

Masat ndëshkuese me të holla, të parapara si vërejtje për moskryerjen e zyrtarëve të lartë për deklarimin, janë simbolike, po them janë simbolike, sepse zyrtari i lartë është përgjegjës i institucionit, prandaj bën vepër penale në qoftë se nuk ka transparencë në deklarimin e pasurisë së tij.

Në fund, Projektligjin e përkrah në parim, se e përcjellë deklarata, se është në harmoni me ligjet e Bashkimit Evropian, njëherësh nuk ka kosto buxhetore, sepse është mekanizmi, Agjencioni, ai i cili e ka përgjegjësinë kryesore për ta zbatuar, por edhe mbës me një shpresë që në procedimin e mëtejshëm, në komisionet funksionale, Ligji do të begatohet dhe do të bëhet funksional për luftimin dhe parandalimin e kësaj dukurie që synojmë ta ç'rrenjosim nga radhët tona. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli, le të përgatitet deputetja Gjylnaze Sylja.

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përschëndetje, zoti ministër!

Kolegë deputetë dhe të pranishëm, të gjithëve ju përschendes!

Unë, në parim e përkrah Projektligjin që ka ardhur për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë.

Ne e dimë se disa nga zyrtarët e lartë publikë kanë pasuri jashtë vendit ose, në të ardhmen, të tjerë mund t'i shtohen kësaj liste. Këtu nuk është pasqyruar se si do të veprohet sipas ligjit procedimi i deklarimit të prejardhjes dhe të kontrollit të pasurisë. Është e vetëkuptueshme se pjesa e tretë, do me thënë kontrolli, është shumë i vështirë, sepse ka të bëjë me shtetet tjera, por në ligj nuk thuhet cila është mënyra, do me thënë, e para, e dyta dhe e treta pjesë, ta quaj, e këtij Ligji, edhe pjesa e kontrollit si do të rregullohej, a do të tentohej të rregullohej në bashkëpunim me shtetet tjera përmes marrëveshjeve të mirëkuptimit apo në forma tjera. Por, në përgjithësi, nuk flitet asgjë në ligj lidhur me këtë. Ma merr mendja se këta që e kanë hartuar ligjin, e kanë menduar se ai që mund e nxjerr pasurinë jashtë, i shpëton çdo lloj kontrolli. Nuk e besoj.

Tash, kështu siç është ky ligj, gati përafërsisht kështu është edhe në zbatim, në praktikë. Ka tash i treti vit, apo i dyti, që rregullisht bëjnë deklarimin e pasurisë, kush është zyrtar i lartë i vendit dhe mendoj se nuk ka shumë ndryshime nga kjo praktikë që sot ndiqet. Pajtohem me ato që u thanë këtu. Këtu në fakt vetëm për deklarimin flitet, edhe për kontrollin deri diku. Sa i përket prejardhjes, nuk ka nene të shquara që kishim për të thënë se kjo është procedura edhe sanksionet lidhur me këtë.

Unë, krejt në fund, do të thosha diçka lidhur me këtë zyrën që po bën, që po jep certifikata lidhur me përputhshmërinë me *acquis-communitaire*. Është duke e bërë punën mirë, sipas mendimit tim, bile më tepër ndoshta se që duhet, sepse nuk ka nevojë, për mendimin tim, që të na i bie edhe vërejtjet që i ka në përkthimin anglisht edhe shqip. E

kam fjalën për këtë memorandum shpjegues që po na vjen dhe pjesët lidhur me këtë. Është mirë që çka kanë vërejtje në dallimet mes gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze, t'ua qojnë përkthyesve, se megjithëse gjuhët mund t'i njohin deputetët, por nuk janë kompetent t'i marrin në shqyrtim ato edhe nuk ka nevojë të harxhohet as letër, as të na i sillen neve këtu. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla, përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Po e shqyrtojmë në Ligj të një rëndësie mjaft të madhe, gjegjësisht Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve publikë. Personalisht e mirëpres këtë Projektligj për arsye se krijon kornizën ligjore për të parandaluar dhe luftuar pasurimin e njerëzve të cilët kanë pozita publike të larta, në mënyrë të paligjshme. Çka synon ky projektligj? Projektligji synon që përmes mekanizmave kontrollues të mbikëqyrjes dhe të kontrollit, të vë kontrollin mbi pasurinë e zyrtarëve të lartë publikë, të familjarëve të afërm dhe të personave të tjerë të lidhur ngushtë me ta. Do të thotë se zyrtarët e lartë publikë duhet të deklarojnë pasurinë e tyre dhe prejardhjen e tyre me rastin e punësimit ose të marrjes së funksionit publik, gjatë ushtrimit të funksionit dhe pas largimit nga funksioni publik.

Efektet në praktikë do të jenë të dobishme dhe të rëndësishme dhe po ashtu në interes të përgjithshëm. Do të rritet efikasiteti dhe puna e prokurorisë në përndjekjen e veprave të paligjshme të veprimeve të ndryshme korruptive, po ashtu edhe të gjykatave, natyrisht. Kjo do të ndihmojë që edhe transparenca të rritet, që popullata të fitojë besimin në zyrtarët e lartë publikë, e po ashtu edhe në institucionet e larta publike.

Megjithatë, e kam një dilemë sa i përket kapacitetit të Agjencionit Antikorrupsion në përgjegjësitë të cilat i ka në këtë projektligj. Me qenë se ky është një autoritet qendror në projektligj për hetimin, evidentimin, procedimin e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve, nuk jam shumë e bindur që me dispozitat ligjore të cilat qëndrojnë se mund t'i kryej funksionet, sidomos dy funksionet e fundit, siç janë ato të kontrollit të pasurisë dhe të prejardhjes.

Një mangësi të projektligjit e shoh në sferën e rregullimit të prejardhjes. Nuk ka shumë nene ose dispozita ligjore të cilat e rregullojnë këtë, prandaj, kjo duhet të shtohet.

Në fund, mendoj po ashtu, si edhe disa kolegë të tjerë të mi këtu, se dispozitat ndëshkimore janë paksa të paqarta dhe se janë të buta. Gjobat duhet të rriten në mënyrë që të sigurojmë se do të zbatohet projektligji.

Sa i përket regjistrimit të pasurisë, sipas mendimit... duhet të jetë pjesë e këtij projektligji, sepse edhe në formularët të cilët plotësohen dhe që i sjell nga zyrtarët publikë, e që i sjell agjencioni, gjithashtu përfshihen dhuratat. Kjo nënkupton, megjithatë, ndihmesën dhe rritjen e kapacitetit të agjencionit si me resurset humane, ashtu edhe me buxhet.

Në fund, me qenë se projektligji është i përballueshëm nga aspekti buxhetor, në parim e mbështes. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, le të përgatitet deputeti Bajram Kosumi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, bashkë me përkrahjen në parim, për qëllimin e këtij projektligji lidhur me deklarinin dhe transparencën për pasurinë, për zyrtarët e lartë shtetërorë, kam edhe dy vërejtje parimore që kanë të bëjnë:

E para, me nenin 4, që mendoj duhet të ndryshohet vetë trajtimi, forma dhe deklarimi për anëtarë tjerë të familjes. Mendoj që tejkalon atë kornizën dhe praktikën e mira në mbrojtje të lirive individuale.

E dyta vërejtje është, po ashtu, tek neni 5, ku kërkohen deklarinimet e pasurisë, në kohë vjetore, pastaj kur e merr detyrën dhe kur e lenë detyrën, por kujtoj që duhet të hiqet pika e tretë, sepse ajo mundëson që të keqpërdoret nga ana e autoriteteve të agjencionit. Pra, deklarimi sipas kërkesës së agjencionit, kur ne e dimë qysh janë përbërjet dhe veprimet e mundshme, ndikimet e mundshme dhe hilet e mundshme, prandaj është mirë ajo të hiqet.

Vërejtja tjetër e imja parimore është tek neni 10 apo pika 4, e cila po ashtu duhet të riformulohet dhe të ndryshohet, që të mos mundësojë sërish keqpërdorim qoftë nga individët, nga grupet e përgatitjes së informatave, apo të shantazheve dhe të skenarëve që na dimë t'i bëjmë për njerëz dhe për zyrtarë të lartë.

Prandaj, mendoj dhe shpresoj që këto të ndryshohen nga komisioni funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi, le të përgatitet deputetja Flora Brovina.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Jam prej atyre deputetëve që realisht kam mirëpritur hartimin e një ligji të tillë dhe jam angazhuar që ky projektligj të vijë në Kuvendin e Kosovës, edhe pse tash duhet të them se nuk jam tërësisht i kënaqur me atë që është afruar në këtë projektligj, për të mos thënë që jam pak i zhgënjyer.

Projektligji, në fakt, nuk sjell asgjë të re, pothuajse asgjë të re nga ajo që e gëzon sot në rregulloret dhe atë që e kemi bërë ne, si deputetë, me deklarinin e pasurisë sa herë që jemi kandiduar dhe sa herë kemi marrë mandatin tonë për deputetë.

Titulli i projektligjit është mjaft shpresëdhënës, Ligj për deklarinin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë, ndërsa siç është vërejtur me të drejtë, edhe prej disa diskutuesve më herët, në ligj mungon pjesa që ka të bëjë me prejardhjen e pasurisë. Për të qenë më i saktë, është përmendur shkarazi te neni 7 dhe te neni 8, origjina dhe prejardhja, mirëpo aq pak dhe aq ngushtë është përmendur sa që nuk lë asnjë hapësirë për të shpresuar se agjencia apo institucionet tjera, gjykatat, do të mund të hulumtojnë prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. Kjo është çështja thelbësore në këtë ligj dhe sidomos është thelbësore kur dihet shkalla e korrupsionit në vendin tonë, kur dihet deklarimi verbal i Qeverisë për tolerancë zero ndaj korrupsionit, e në fakt me këtë ligj nuk i jepet shans shumë luftës kundër korrupsionit, me këtë ligj ndihmohet pak, por ngushtohet hapësira e luftës kundër korrupsionit. Krijohet njëfarë rregulli në deklarinin dhe kontrollin e pasurisë, mirëpo nuk i jepet shans hulumtimit të prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë.

Unë mendoj se kjo është çështja thelbësore për derisa Kuvendi i Kosovës nuk ka një qëndrim tjetër që të shpallë, ta zëmë, një pikë zero prej ku do të fillojë kontrolli i pasurisë, atëherë ky ligj duhet t'ia bëjë të mundshme qoftë agjencisë, qoftë gjykatave që të hulumtojnë prejardhjen e pasurisë zyrtarëve të lartë publikë në Kosovë. Ne nuk kemi të drejtë heshtazi t'i falim ato raste, ato procese të cilat pasuria është krijuar eventualisht jashtë ligjit dhe në mënyrë të pandershme.

Prandaj, në këtë pikë unë mbështes të gjithë ata diskutues që propozuan që t'i shtohet një kapitull projektligjit, që t'i shtohet kapitulli ku do t'i jepet kompetenca për hulumtimin e prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

Çështja e dytë, në të cilën duhet të ndalem, ka të bëjë me përfshirjen ose me përkufizimet që kanë të bëjnë me zyrtarët e lartë publikë. Është një përfshirje e gjerë, madje nganjëherë krijohet përshtypja se është tepër e gjerë dhe në disa raste, do të thotë, në disa pozicione është pa nevojë e zgjeruar. Ndërsa, në anën tjetër, disa pika kyçe, ku ka qarkullim të financave publike, janë lënë anash këtij ligji. Konkretisht, ndërmarrjet publike, bordet e ndërmarrjeve, drejtoritë e ndërmarrjeve, drejtorët e departamenteve të ndërmarrjeve publike nuk janë të precizuara në këtë ligj. E, këto ndërmarrje janë pikat kyçe ku bëhet qarkullimi i financave publike, të mos përmend tash por do të thotë janë disa dhjetëra ndërmarrje publike në Kosovë, ndonjë prej tyre, si PTK-ja, ka buxhetin sa buxheti vjetor, po thuaj se sa buxheti vjetor i Kosovës, ndërsa ato kanë mbetur anash këtij projektligji.

Po ashtu, në këtë përfshirje duhet të jenë edhe funksionarët e lartë të partive politike. Nëse janë për t'u besuar hulumtimeve që po bëjnë organizatat e ndryshme për transparencë, gjë që është gjithmonë me një pikë dyshimi se kush i bën ato hulumtime në Kosovë dhe sa janë të sakta rezultatet e tyre, por nëse është për t'u besuar, partitë politike në Kosovës kanë dalë ndër mekanizmat më të korruptuar. Ndërsa, funksionarët e lartë të partive politike kanë mbetur jashtë këtij ligji. Duhet të futen edhe funksionarët e lartë të partive politike, anëtarët e Kryesisë, në radhë të parë, janë zyrtarë të lartë publikë dhe duhet të jenë pjesë e këtij ligji edhe ata duhet ta deklarojnë pasurinë.

Çështja e tretë, që duhet të them ka të bëjë me vjetërsinë e lëndëve, them kushtimisht, që flitet te neni 17, sepse është fol në atë mënyrë sa që është lënë shumë e pa kuptuar.

Sipas nenit 17, Agjencia ka të drejtë të fillojë një procedurë ndaj një lënde që është 5 vjet dhe më e re, por jo më shumë se 5 vjet. Nuk e kam të qartë pse është marrë ky kufi prej 5 vjetëve. Një lëndë nuk mund të vjetrohët për 5 vjet, është diku një kufi që mund të mirët që praktikohet të merret, por lënda që ka të bëjë me përfitimin e padrejtë të pasurisë, nuk mund të kufizohet në 5 vjet. Agjencia ka të drejtë, do të duhej të kishte drejtë që të fillojë procedurën për hulumtimin e pasurisë të cilitdo zyrtarë të lartë publikë, pavarësisht prej vjetërsisë së lëndës. Mund të jetë edhe 10 vjet e vjetër, por nëse është fituar në mënyrë të pandershme, personi duhet të japë llogari para gjykatës.

Dhe, çështja e fundit, që po ashtu e megjullon pak ligjin, është çështja e dënimeve që u përmend shumë këtu. Agjencia shqipton disa dënime, ndërsa gjykata është lënë anash ose vetëm në rastet kur personi të cilit iu ka shqiptua dënimi, nuk i përgjigjet dënimit, e tjera, e tjera. Është krijuar pak një konfuzion te këto dënime.

Për shembull, te neni 8 flet për konfiskimin e pasurisë nga ana e agjencisë. Shikoni një kundërthënie. Agjencisë i janë dhënë kompetenca të mëdha për t'i shqiptuar dënimet, ndërsa nuk ju ka dhënë kompetenca për të hulumtuar prejardhjen e pasurisë. Mendoj që këtu është një gabim konceptual, një gabim në qasje. Agjencisë duhet t'i jepen të drejta shumë për të hulumtuar prejardhjen e pasurisë. Ndërsa, shqiptimin e dënimeve, konfiskimin e pasurisë dhe masat e tjera duhet ta bëjë gjykata. Gjykata duhet të jetë vendi ku duhet të merret vendimi final për krijimin e pasurisë në mënyrë të pandershme.

Dhe, unë kisha futua ministrinë, me qenë se tash ligji është në këtë fazë dhe nuk mund të flasim për një ripunim të ligjit, kisha ftuar ministrinë që bashkë me Komisionin për Legjislacion të bashkëpunojnë ngushtë që të shtohet një kapitull i ri për hulumtimin e prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. Nëse nuk shtohet ky kapitull për hulumtimin e prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve, ky ligji është i kotë, krejt janë të kota fjalët që i flet Qeveria për luftë kundër korrupsionit. Pa këtë kapitull, fjalët e Qeverisë mbeten propagandë e thatë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Deputetja Flora Brovina, nuk është këtu. Deputetja Edita Tahiri, urdhëroni! Përgatitet pastaj deputeti Riza Smaka.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje të gjithëve!

Mendoj që është një projektligj, i cili i duhet Kosovës dhe në parim e mbështes, por ato që desha t'i them është që një qartësi më e madhe në formulim të ligjit duhet të bëhet në pjesën ku, në qoftë se zyrtarët e lartë nuk i deklarojnë pasuritë, çfarë janë sanksionet dhe ndëshkimet ndaj tyre, si dhe po ashtu te puna e fenomeneve që njerëzit pasurohen brenda natës, e kjo ndodh në Kosovë. I kemi përjetuar krejt këto vitet e pasluftës, sepse shkalla e korrupsionit, për fat të keq, nuk po zbret. Edhe pse Agjencioni Transparency International dha një situatë për Kosovës pak më të mirë se në rajon, megjithatë indeksi është 3.4, që tregon se mbi gjysma, pra është situatë e rëndë, gati 75% vazhdon të ketë në këtë vend korrupsion. Nuk ka vend për kënaqësi në qoftë se ne jemi në pozicionin 3.4, e maksimumi është 5. Nuk mendoj që për të keq duhet të krahasohemi dhe të gëzohemi. Prandaj, mendoj që kontrolli dhe ndëshkimet duhet të precizohen mirë dhe, në anën tjetër, Agjencioni Kundërkorrupsion të ketë rolë të qartë dhe gjyqësia të marrë rolin e vet.

Përderisa nuk fillon në Kosovë sundimi i ligjit, gjithë këto përpjekje tona për të nxjerrë ligjet po mbeten në ajër. Kosova me të vërtetë ka nevojë që të fillojë një fazë të re, ku ka vullnet politik për të zbatuar ligjet dhe ka vullnet politik sinqerisht të luftohet korrupsioni. Kështu qysh është, do ta pengojë Kosovën shumë në proceset e integriteteve evropiane. Ne jemi në Komisionin për Integritete Evropiane, jemi duke përgatitur raportin tash dhe, siç e dini, del Raporti i progresit në vitin 2009, në tetor pritet, është faza e studimit të fizibilitetit, korrupsioni do të jetë një pengesë e madhe për vendin tonë për të ecën përpara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputeti Naser Rugova, është i parafundit, se po lajmërohen vazhdimisht deputetë për fjalë.

RIZA SMAKA: I nderuari zoti kryesues!

Kolegë të nderuar,

Natyrishisht se ky ligj është i nevojshëm, i dobishëm, me kusht që do të plotësohej dhe do të riformuloheshin shumë dispozita që janë nebuloze, një. Veçanërisht plotësimi do të duhej të pasonte nëpërmjet dispozitave apo kaptinës së posaçme, siç e tha zoti Kosumi, për hulumtimin e pasurisë dhe më pastaj plus edhe evaluimi apo valorizimi, që të ketë Agjencioni aso autorizimevesh. Ndryshe, do ta bënim një ligj, do të thirrëshim në ligj, ama ligji nuk do të kishte efekte juridike, a norma juridike nuk është në qoftë se nuk do të prodhonte e nuk do të siguronte efekte juridike të dëshiruara.

Disa vërejtje parimore, kështu, po zëmë te anëtarët e familjes, është çështje esenciale në kontekstin e ligjit. Ekziston apo do të duhej të ekzistonte ligji i veçantë për familjen, prandaj nuk do të duhej të jepnim ne definicione se kush janë anëtarët e familjes ad- hoc, prej rastit në rast, se mund të krijohen edhe diskrepanca të normave që me këtë ligj kësi soji, me atë tjetrin asi soji.

Kur është fjala te pasuria e luajtshme, resmobiles, bie fjala është thënë atje që mbi 3000 euro. Po mirë, çka në qoftë se individ i caktuar ka pasuri të paluajtshme, ama shumë numerikisht, po që janë 2999 euro, po e zëmë, dhe kush e bënë këtë evoluim. Prandaj, për këtë edhe u angazhova që do të duhej të inkorporohej një kaptinë që do t'i precizonte këto çështje.

Sa i përket agjencionit, agjencioni do të duhej të ishte i definuar qartë dhe të kishte kompetencat e përcaktuara taksativisht sipas enumeracionit, ndryshe do të kishte, qysh janë hapat e parë, do të kishte dilema dhe me procedurë do të kontestohesh me baza, por edhe pa bazë, mirëpo do të krijoheshin situatë e paqartë për institucionet që do të duhej t'i zgjidhnin kontestet.

Masat ndëshkimore janë aq të ulëta, qesharake anglisht ridiculous, 300 euro nëse nuk e paraqet, po e zëmë, e tjera, e tjera. Do me thënë, kjo duhet të rishikohet me një seriozitet tjetër fare, masat duhen të jenë adekuate, nuk angazhohem që të jenë masat rigoroze e tjera, po adekuate, e adekuate nuk janë këto që janë propozuar.

Më pastaj, thuhet -gjykatë kompetente. Po cila është gjykata kompetente, me ligj. Ky është ligj i veçantë, duhet të adresohet gjykata, ju lutem, se do të krijoheshin situata të paqarta në praktikë, aq më parë kur shpeshherë nuk ekziston vullneti politik i mirë, bonafidej.

Edhe te çështja kur jepet autorizim për të pasur qasje në të dhëna cili do qytetarë, mendoj se është çështje shumë problematike. E marrim, po e zëmë, se çdo shoqëri politike ka, për fat, shumë njerëz të ndershëm, po ka edhe të pandershëm. Po e marrim numrin më të vogël që mund të jenë, po e zëmë, nga radha e gängeve të ndryshme, që shkon bie fjala, e merr dhe e incizon, e merr dokumentin, më pastaj koncentrohet për kidnapime e tjera. Aty do të duhej të jemi shumë të kujdesshëm, ju lutem, mos të ketë të drejtë çdo qytetar, qoftë edhe deputeti të mos ketë të drejtë për deputetin, po të kenë vetëm institucionet e autorizuar që kanë kompetenca, kanë ingerenca, kanë prerogativa për ta konstatuar kompleksin dhe vlerën e pasurisë dhe për të vepruar sipas ligjit, po jo edhe çdo qytetar. Qoftë edhe një qytetar që do të kishte qëllim të keq, po e zëmë, do të ishte mjaft që kjo dispozitë të rishikohet. Unë do të isha angazhuar që të hiqet. Në parim flas.

Ne e dimë fare mirë se ka njerëz, ka entitete qoftë natyrale, qoftë legale që kanë jashtë vendit pasuri. Le të kenë, por ne jemi të interesuar që të jenë të regjistruara, të jenë legalisht të fituara. Ne i përshëndesim ato, ku është të marrim, ku është të kemi

mundësinë që qytetarët tanë të kenë pasuri këtu, jashtë e tjera, e tjera. Po, qëllimi ynë është, intencja jonë thelbësore është që pasuria që posedohet, që disponohet të jetë e ligjshme, e fituar ligjërisht. Në këto pika do të isha angazhuar, zoti kryesues, që në parim në etapat që e presin përpunimin e këtij ligji, të bëhet një koncentrim më i madh. Në të tri gjuhët tekstet nuk përkojnë, kjo është një sëmundje e rregullt. Përkthimet janë të dobëta, nuk di në cilën gjuhë është shkruar në origjinal, ama edhe në tekstin në gjuhën shqipe ka pothuaj se çdo dispozitë ka shprehje të papërshtatshme juridike dhe gjuhësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Deputet!
Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, le të përgatitet deputeti Ardian Gjini.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,
Anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Sot po diskutojmë për një projektligj shumë të rëndësishëm për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe nëse është analizuar me vëmendje, ky ligj nuk përkon me titullin e projektligjit që, sipas meje, titulli është shumë i qëlluar dhe përfshin në vete të gjitha ato që do të duhej t'i përfshijë një ligj që e ka kompetencë dhe e mbulon këtë fushë nga aspekti legjislativ.

Vërejtjet e mia substanciale janë te prejardhja, te konfuzioni, te vakuumet ligjore, te paqartësia që do të pamundësojnë zbatimin në praktikë të këtij ligji dhe nuk do të japin informata të qarta se si një zyrtar i lartë publik, një udhëheqës politik, institucional ka ardhur deri te ajo pasuri. Pastaj, kompetencat e Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit, tek gjrobat apo dënimet, sanksionet, nuk korrespondojnë në aspektin edhe ligjor. Duhet të jenë gjykatat që shqiptojnë dënime e gjoba, sepse është përgjegjësi edhe publike, po edhe ligjore, do të thotë. Pastaj, te ndërmarrjet publike, bordet dhe agjencione mbikëqyrëse, të cilat menaxhojnë shuma të konsiderueshme të parave publike. Duhet të përfshihen edhe menaxherët ekzekutiv apo drejtorët e atyre kompanive dhe të shikohet që më vonë të hartohen edhe akte nënligjore. Kolegu Kosumi e ceku, edhe te partitë politike. Partitë politike i përbëjnë institucionet dhe në qoftë se mekanizma relevantë serioz ndërkombëtarë thonë që partitë politike janë të korrupsionit në një masë të madhe, atëherë çka ndodhë me institucionet e vendit dhe këtu është çështja. Partitë politike i dërgojnë njerëzit e vet edhe nëpër ndërmarrje publike, edhe në borde meanxhuese, edhe në agjencione tjera të pavarura e tjera, që do të thotë se kontrollojnë pjesën dërrmuese të parasë publike të një vendi. Pastaj, edhe te hulumtimi i lëndëve, që është përcaktuar 5 vite. 10 vite dhe duket pak, sepse kemi shembuj të rasteve të vendeve fqinje që i kanë proceduar dhe miratuar këto ligje në parlamentet e tyre. Ne jemi Republikë parlamentare dhe kemi rastin e sekuestrimit të pasurisë së ish-zyrtarëve të lartë dhe të funksionarëve të lartë publikë institucional edhe pas 10 viteve dhe kujt po i konvenon kjo mjegull me ligje të tilla. Konform agjendës evropiane, te deklarimi i pasurisë, origjina dhe prejardhja e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë duhet të ekzistojë një transparencë. Këtu shihet edhe mungesë e qasjes së publikut në pasurinë e personave zyrtarë. Andaj, unë insisto që te aspekti i origjinës së pasurisë të draftohet, zonja ministre dhe zyrtarë të Qeverisë, në mënyrë shumë më precize, duke anashkaluar vakuumet ligjore dhe konfliktet e tjera edhe juridike, edhe politike, po edhe konfliktet e interesit dhe të jetë një ligj vërtet i zbatueshëm pasi që nuk kemi të bëjmë me kosto buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini, le të përgatitet deputeti Ethem Çeku.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë të nderuar,

Duke mos dashur të kontestoj qëllimin e Ministrisë për sjelljen e këtij ligji para nesh, më duhet të konstatoj se edhe ky është ligj i administratës, nuk është ligj politik dhe bota demokratike me qindra vjet më përpara e ka shpikur politikën dhe vullnetin politik, që u përmend disa herë këtu, për të hartuar ligje. Administrata e përkthen vullnetin politik në ligj, por administrata nuk guxon të sjellë vullnet sa u përket ligjeve. Shihni ju, pjesa më e madhe e këtij ligji merret me deklarimin ose mosdeklarimin e pasurisë. Mosdeklarimi është delikt. Nëse dikush vonohet me deklarim ose mosdeklarim është një delikt, kurrëgjë ma tepër. Ama, krijimi i pasurisë në mënyrë të paligjshme është krim dhe ligji nuk merret me krijimin se si është krijuar pasuria, por merret se a është deklaruar apo nuk është deklaruar dhe Agjencioni merr përsipër t'i botojë emrat e zyrtarëve të lartë publikë që janë vonuar ndoshta një javë ose dy javë për të deklaruar pasurinë që e kanë krijuar. Domethënë, ky është problemi i ligjit, se nuk po merret me esencën. Nëse në ndonjë moment do ta përsëris një prej kolegëve, më vjen keq, është për shkak të ndërtimit të kontekstit. U përmend edhe prej kolegëve më përpara se a ka prerje kur deklarohet prejardhja e pasurisë, cila është prerja, a do të themi ne në Kosovë që çdo zyrtar publik, që bëhet zyrtar publik, se mund të ndodhë që nesër dikush që nuk është mes nesh, një deputet i ri, zgjedhet, bëhet zyrtar publik, a do të kërkojmë ne nga ai që të deklarojë se si e ka krijuar pasurinë që e deklaroi, apo do të mjaftohemi vetëm me deklarim të pasurisë. Mendoj se prapë ne po merremi me një delikt, a e ka deklaruar apo jo, po nuk po merremi me diçka që mund të jetë krim në esencë, e që është krijimi i pasurisë në mënyrë të paligjshme.

Tani do të ndalem te disa çështje të ligjit. Për shembull, nenin 3, nëse e shihni, thotë: deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe të emëruarit nga ata, thotë janë zyrtarë publikë. Te definicionet se kush janë zyrtarët e lartë publikë, kënd e emëroni ju, kënd e emërojnë deputetët e Kuvendit të Kosovës, çfarë kompetenca kanë për të emëruar dikë legalisht, por nëse kanë, atëherë ne duhet ta kemi të qartë.

Çështja tjetër është te familja. Nëse ka vullnet politik për të sjellë një ligj kaq të saktë, ligj i cili esencialisht shërben për të ndaluar korrupsionin ose për ta ulur korrupsionin, atëherë ne në Kosovë duhet të tregojmë që për ne familje nuk janë vetëm bashkëshorti dhe fëmijët. Familjet tona janë pak më ndryshe se familjet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose të ndonjë vend të Unionit Evropian. Te na familje janë edhe vëllezërit. Dhe, çka bëjmë ne nëse vëllai i dikujt çuditshëm, diku për nja dy vjet pasurohet për dy ose tre milionë, vëllai ose motra e një zyrtari publik. A kemi ne mekanizëm i cili punon në dy ose tre paragrafe ose nene, më vonë janë thënë disa çështje, por nuk lënë asnjë vend për të shprehur se me të vërtetë kjo çështje është e rregulluar.

Çështja tjetër që nuk rregullohet dhe që u përmend këtu, është pasuria jashtë shtetit. Çdo qytetar i Kosovës ka të drejtë të ketë pasuri jashtë shtetit dhe ne duhet ta regjistrojmë atë pasuri, të zyrtarëve publikë është fjala. Tani, a ka Kosova provizion ligjor, sipas të cilit do të kërkojë nga cilido shtet në botë që të na sjellë të dhëna mbi pasurinë e cilitdo zyrtar të lartë të shtetit për të cilin ndoshta dikush në Kosovë supozon se ka krijuar pasuri jashtë shtetit, rishtazi ose më herët. Çështje tjetër është se lihen shumë mundësi prapë për të vendosur arbitrarisht në çështje të ndryshme. Një agjencion i cili esencialisht është agjencion i shtetit të Kosovës, nuk thuhet në shumë pika, do të thotë është fjalori i ligjit ku thuhet: “Agjencioni mundet”, “Agjencioni kërkon” dhe nuk ka taksativisht provizionet të cilat thonë se Agjencioni obligohet në rastet e tilla dhe kur thuhet

“mundet” i lihet Agjencionit të vendosë se për cilin zyrtar publik ka për të kërkuar dhe për cilin zyrtar publik nuk ka për të kërkuar.

Çështja tjetër është, që është tepër e rëndësishme, është regjistrimi i konfidencialitetit të kërkuarit dhe është një pjesë e ligjit që është tepër e paqartë. Tani, është shumë e qartë, ma merr mendja, për secilin prej nesh që duhet pasur regjistër të të gjithë njerëzve që kërkojnë të dhëna për zyrtarin publik, duhet të ekzistuar, se nuk guxon pa kurrfarë regjistri, ama a ka konfidencialitet edhe për kërkuarin. Sa kohë ruhet shënimi se kush është individ i cili ka kërkuar shënime për një zyrtar të lartë publik, të themi për shembull, për Ardian Gjinin, apo mund të bëhet publik menjëherë dhe atëherë personat ose institucionet ose mediat që kërkojnë shënim, duhet të frikohen se ndoshta emri do t’ju del në publik. Tani, shumë kush mund të thotë -çka ka lidhje nëse del emri në publik. Po këtu është esenca e vullnetit politik, se njerëzit po frikohen në Kosovë me ose pa të drejtë. Percepti i tyre është i rëndësishëm. Ata mundin të mos kenë të drejtë të frikohen, por derisa të frikohen, ne duhet krijuar kushte që ata të jenë, të ndihen konfident, se nëse kërkojnë diçka, nuk do të kthehet kundër tyre, në esencë.

Çështje tjetër është, sa vjet u përmend këtu më përpara, sa vjet pas lëshimit të detyrës zyrtare, zyrtarit të lartë publik duhet t’i përcillet pasuria. Paramendoni ju sikur një zyrtar publik e lëshon zyrën publike, postin publik dhe pas dy vitesh shpejt e shpejt i krijon disa milionë euro. A ka mekanizëm ligjor Kosova kësi soji për t’i përcjellë. Ky ligj nuk e mundëson një gjë të tillë dhe unë mendoj se është e domosdoshme për të pasur mekanizëm që pasuria e zyrtarëve publikë të përcillet edhe pasi ta lëshojnë pozicionin, realisht.

Tjetra është, do me thënë, edhe përpara e përmenda se sa para se një zyrtar publik të jetë zyrtar publik, duhet ta paraqes prejardhjen e pasurisë, si e ka krijuar, jo vetëm ta deklarojë pasurinë. Për shembull, edhe një çështje që e tregon se administrata e ka bërë këtë ligj, e jo politika. E keni nenin 18, e shpjegon në njëfarë forme të mendjes administrative, jo politike, e po them edhe një herë, ligjet i bënë politika, administrata vetëm i përkthen në gjuhë administrative. E ka një fjali që thotë: “i jep të drejtë gjykatës”. Kush i jep të drejtë gjykatës, ju lutem, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës. Gjykata ka të drejtë kur të do vet, nuk ka nevojë një agjencion çfarëdo qoftë ose një qeveri çfarëdo qoftë t’i japë të drejtë gjykatës. Shihni nenin 18, e tregon domethënë një mendësi ligji, që nuk guxon të jetë në ligjet të cilat i prodhojnë ne.

E përmenda në fillim vullnetin politik dhe deklaratën politike. Një deklaratë politike për ligjin nuk ekziston. Sikur të kishte ekzistuar, do të thoshte kështu, me tri fjali, cilido zyrtarë publik, kryeministri, ministri, do të kishte dalë para publikut dhe do të kishte thënë: “me këtë ligj po kërkojmë që të paktën 20 vjet ose të paktën 10 vjet, para se ta marrin detyrën, ose 2 vjet, nuk është me rëndësi, zyrtarët publikë ta deklarojnë prejardhjen. Kjo fjali tregon një vullnet politik, po fjalia: “duhet paraqitur pasurinë” nuk tregon vullnet politik, do me thënë nuk tregon kurrfarë vullneti politik.

Një problem tjetër që e kam me ligjin, është edhe e fundit që do ta përmendi sot, është një problem i cili po përcillet, i Agjencionit për Integritet Evropian. Shihni Raportin e Agjencionit për Integritet Evropian. Ai është sikur raporti i një agjencioni për përkthim. Të gjitha vërejtjet edhe sugjerimet, kanë të bëjnë me përkthimin prej gjuhës shqipe në gjuhën angleze edhe thotë *acquisi-communitaire*, nuk parasheh ligje të këtilla. Tani po ju them, *acquisi-communitaire* nuk është vetëm në ligje, por me definicion, të paktën këtë e kam profesion, është trupi i ligjeve, rregullave, normave dhe praktikave të

Unionit Evropian. Kjo është *acquis-communitaire*, se përndryshe i thonë Ligji i Evropës, por nuk është veç ligji, janë rregullat, praktika edhe normat edhe ligjet, në fund të fundit.

Agjencioninuk nuk na jep kurrëgjë se cilat janë praktikat e Unionit Evropian. E ka për detyrë se përndryshe pse është agjencion, pse nuk po bëhet zyre. Agjencioni neve na bien një listë, e cila thotë se në këtë vend është përkthyer keq prej shqipes në anglisht, në këtë vendin tjetër prapë keq prej shqipes në anglisht. Ju lutem, merreni lexojeni, e keni në letër, që do të thotë se dikush nuk e ka marrë absolutisht seriozisht çështjen e këtij ligji. Fundi i fundit, ne e dimë se ka nevojë Kosova për një ligj të tillë, e dimë të gjithë se sa shumë ka nevojë për një ligj të tillë, mirëpo mendojmë se ligji kështu qysh ka ardhur, me keqardhje më duhet të them, nuk i përmbush nevojat e Kosovës, por vetëm i përmbush nevojat e thjeshta të momentit për deklaram të pasurisë pa u marrë fare me çështjen se si është krijuar pasuria dhe pa u marrë fare me esencën, me tendencën për TA luftuar korrupsionin. Nëse e kam përsëritur ndonjë koleg, i kërkoj falje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Ethem Çeku, le të përgatitet i fundit, deputeti Adem Hajdaraj.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndoshta opinioni im do të jetë pak më ndryshe se e kolegut Gjini. Unë së paku duhet t'i them faleminderit Ministrisë që e ka sjellë këtë ligj në Kuvend dhe unë shpreh mirënjohjen shumë të thellë personale timen, e besoj edhe të shumë kolegëve, të gjithëve për këtë projektligj që e ka sjellë.

Sa i përket çështjes së mangësisë, unë vetëm një duhet të them rreth çështjes së prejardhjes së pasurisë. Mendoj që kjo çështje duhet të trajtohet në mënyrë adekuate dhe mendoj që ky projektligj duhet të merret shumë më tepër, atë që e thanë edhe kolegët më herët, rreth çështjes së prejardhjes së pasurisë për arsye se ne të gjithë jemi në jetën publike dhe kemi për obligim të tregojmë, të jemi të hapur me opinionin rreth zhvillimeve tona në anën e zhvillimeve financiare brenda familjes, brenda vetvetes, sepse një kohë të gjatë është spekuluar, është bërë fushatë mediatike, fushata elektorale, fushata të ndryshme rreth çështjes së individëve të caktuar dhe, them edhe një herë, e përgëzojmë dhe komisioni besoj së do ta plotësojë me këto vërejtje të cilat u dhanë dhe ta kemi ligjin të aprovuar në Parlamentin e Kosovës dhe fillimin e implementimit të këtij ligji në jetën praktike.

Edhe sa i përket afatit, mendoj që afati kohor duhet të zgjerohet, jo vetëm në 5 vitet e fundit, por duhet të ketë, posaçërisht nga viti kur janë bërë kthesat e mëdha tek ne në Kosovë, kur institucionet e Kosovës kanë marrë përsipër dhe përgjegjësinë dhe ne kemi marrë për sipër dhe përgjegjësinë e udhëheqjes së vendit tonë. Prandaj, them në parim, unë e mbështes dhe edhe njëherë dua ta falënderoj Ministrinë për sjelljen e këtij projektligji.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Deputetë të nderuar, ministra, unë desha të them se ky ligj është i mirëseardhur dhe është i mirë, me gjithë ndonjë vërejtje që e dhanë kolegët, sidomos për atë pjesën ku mungon çështja e prejardhjes së pasurisë. Është një proces shumë i vështirë

që të hulumtohet prejardhja e pasurisë dhe do të ketë probleme, natyrisht, kur në një shoqëri s'ka mundur të hulumtohet prejardhja e pasurisë, nëse nuk e ka deklaruar vetë personi. Megjithatë, unë e tumir këtë ligj, më duket se është i mirëseardhur në këtë moment dhe duhet të japim një kontribut më të madh në leximin e dytë, jo vetëm në këtë lexim, sepse po humbim shumë kohë në leximin e parë dhe shumë gjëra po avullohen, mandej në leximin e dytë nuk po jepet kontributi, ndihmesa e nevojshme për tumiren e ligjeve.

Desha të ndalem, më në fund, vetëm në një çështje, kështu, që pak a shumë ka të bëjë me terminologjinë. Më duket se terminologjia “persona të lidhur”, që është në përkufizim, faqe 4, ku thotë se “personat e lidhur janë të gjithë personat fizikë ose juridikë, të cilët në bazë të hetimeve administrative rezultojnë që kanë pasur ose të kenë lidhje pasurore me personin që është i detyruar për deklarim në njërin nga format e përcaktuara me këtë ligj” dhe në fushën e veprimit, neni 2, thotë këtu, natyrisht përdoret “persona të lidhur”. Unë mendoj se as gjuhësisht, as logjikisht nuk është kjo në përputhje me termin për arsye se “person i lidhur”, nëse është mbiemri “i lidhur”, do me thënë a është lidhur me litar, me vargojë a si është lidhur dhe unë propozoj që ky term, zonja ministre, të zëvendësohet me termin “bashkëpunim”, do me thënë “persona bashkëpunëtor” në atë pjesën kur flitet për termin, ndërsa këtu poshtë, fusha e veprimit, neni 2, të jetë “personat që bashkëpunojnë”, në “bashkëpunim” ose “që bashkëpunojnë me ta”, sepse nuk janë të lidhur ata, lidhen në njëfarë forme, por jo në këtë kuptim që është caktuar me ligj. Unë këtë edhe në komision do ta them, në komisionin funksional, do të shohim, por mendimi im është ky. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Debati në parim ka ardhur në fund. Fjalën e ka kërkuar sponsorizuesja e Projektligjit. Fjalën e ka ministrja Nekibe Kelmendi. Urdhëroni!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Falënderoj komisionin funksional parlamentar, falënderoj grupet parlamentare, pjesëmarrësit në debat apo diskutim rreth këtij draftligji në lexim të parë.

Gjithashtu, falënderoj për të gjitha vërejtjet e ngritura këtu dhe si Ministri e Drejtësisë, nëpërmjet të zyrtarëve ligjorë do të japim kontributin tonë në eliminimin e të gjitha mangësive apo, thënë ndryshe, edhe në kompletimin e atyre që mungojnë e që nuk janë përfshirë këtu në ligj.

Duhet t'ju them se ky është një ligj, ta quaj lex-specialis dhe si i tillë nuk mëton që të kodifikojë të gjithë problematikën që lidhet me keqpërdorimet, me vepra penale, me korrupsion, sepse edhe vetë korrupsioni është vepër penale, e tjera. Ky ligj më tepër komplementohet edhe me dy ligje të tjera, që do të vijnë shumë shpejt në Parlament. Njëri është sot, kurse tjetri është Ligji antikorrupsion. Dhe, pikërisht këto tri ligje përbëjnë atë pakon ligjore e cila do të mundësojë luftimin e çdo forme të keqpërdorimit të parasë publike, por edhe të sjelljes së zyrtarëve të lartë, qoftë nëpërmjet pasurimit në mënyrë antiligjore e tjera, e tjera.

Unë dua t'ju siguroj se Ministria e Drejtësisë do të japë kontributin e vet dhe do t'i marrë edhe ato vërejtje që u përmendën nga kryetari i Komisionit për Legjislacion, Gjyqësi dhe çështje tjera ligjore të Komisionit Evropian, kështu që kur t'i shqyrtojmë nëpër komisione, kur të shqyrtohen këto ligje në komision funksional, ne do të japim kontributin tonë dhe sigurisht se do t'i harmonizojmë të gjitha qëndrimet në mënyrë që të

mos ketë dualizma nëpër ligje, nëpër këto tri ligje, por që secili ligj ta rregullojë atë fushëveprim, atë materie që e ka për qëllim të vetin.

Prandaj, ju kisha lutur që Ligjin ta votoni, ta miratoni në lexim të parë dhe i mirëpres të gjitha amendamentet që do t'i bëhen këtij ligji, sepse nuk është zaten ligj i parë që po amendamentohet, ne kemi pasur raste që një ligj t'i ketë 30 nene e 120 amendamente, por dhëntë zoti që ky ligj mos të ketë atë fat. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja ministre! Të nderuar deputetë, në sallë janë prezent 68 deputetë. Ju ftoj që të deklaroheni me votim për miratimin në parim të këtij projektligji.

Regjia, gati për votim! Votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, 2 “kundër” dhe 3 abstenime, u miratua në parim Projektligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve publikë.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Tash kemi pauzë deri në orën 14:30. Ju faleminderit për vëmendjen!

Lus deputetët që në 14:30 të jenë në sallë për shkak se do të zgjatet pastaj seanca deri vonë. Kemi ndërmend ta përfundojmë sot rendin e ditës.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI NAIM MALOKU: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë seancën. Në sallë janë 45 deputetë, që do të thotë se janë krijuar kushtet që të zhvillohet debat për pikën në vazhdim.

Pika e radhës e rendit të ditës është:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik**

Konstatimet hyrëse. Në bazë të rregullës 35.1 të Rregullores së Punës janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji. Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin. E keni fjalën zonja ministre.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kërkoj falje që s'po mund të ngjitem para foltores.

I nderuar zoti ministër, të nderuar të pranishëm,
Kam nderin që në emër të Ministrisë së Drejtësisë t'ia paraqes për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Ky projektligj është rezultat i punës dhe i përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e saj.

Konflikti i interesit të zyrtarëve në ushtrimin e funksionit publik mund të jetë evident dhe është evident, andaj me anë të këtyre plotësimeve dhe ndryshimeve të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, personit zyrtar duhet t'i ndalohet të ushtrojë funksione administrative, mbikëqyrëse apo përfaqësim në shoqëritë tregtare: firma institucione, kooperativa, fonde apo agjenci. Përfundimisht, atëherë kur personi zyrtar mund si përfaqësues i institucionit të tij të jetë anëtar bordi i një institucioni apo i një agjencie publike apo anëtar i bordit mbikëqyrës të një ndërmarrje publike, fondi publik apo shoqërie komerciale ku autoriteti qendror apo lokal është mbajtësi i aksioneve apo i të drejtave të tjera në bazë të cilave merr pjesë në menaxhim apo me kapital.

Ndryshime dhe plotësime të tjera në këtë projektligj kemi edhe tek sanksionet. Parashihet që Agjencia Kundër Korrupsionit kur ndeshet me rastin kur zyrtari është në gjendje të konfliktit të interesit të kërkojë nga institucioni në të cilin zyrtari ushtron veprimtarinë e tij që ndaj tij të fillojë procedura e shkarkimit, ndërsa në rastet kur shkelja ka dëmtuar interesin publik, atëherë agjencia në fjalë lajmëron organet e ndjekjes për ndërmarrjen e masave adekuata në pajtim me ligjin.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik sjell edhe disa ndryshime që deri më tani ligji ekzistues ka qenë vështirë të zbatohet. Përmes këtyre ndryshimeve përmirësohet gjendja e zbatimit të tij dhe sigurisht paraqet ndihmesë të domosdoshme për përmirësimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Ky projektligj është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, por edhe me ndihmën dhe bashkëpunimin e ekspertëve ndërkombëtarë.

Ky projektligj përcakton parimet themelore dhe krijon mekanizma efikas për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik të zyrtarit të lartë publik, të anëtarëve të ngushtë të familjeve të tyre dhe të personave të lidhur me ta duke synuar krijimin e një baze të mirëfilltë ligjore.

Fuqizimi i krejt këtij projektligji është i një rëndësie të veçantë, sepse do të shtonte efikasitetin në punën e Prokurorisë dhe të gjykatave në përgjithësi për parandalimin e konfliktit të interesit, marrjes së mitos dhe formave të tjera të kundërligjshme, gjë e cila do të ndikonte si preventivë si dhe do të shtojë besimin e qytetarëve për punën e institucioneve vendore në përgjegjësi.

Dua të them se me ligjin që do të vijë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Antikorrupsion e tërë infrastruktura ligjore për luftimin e korrupsionit në Kosovë do të plotësohet.

Prandaj, të nderuar deputetë, unë ju lus që në lexim të parë ta miratoni këtë ligj, pa pretendime se ky është ligj i përsosur dhe me respektim të mendimeve të cilat do të kontribuojnë në perfeksionimin e këtij ligji në amendamentimin e tij dhe bëjnë e këtij ligji sa më të zbatueshëm, por edhe sa më koherent me kohën në të cilën po jetojmë dhe punojmë. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Pasi që kryetarët e komisioneve nuk e donë fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka Ramadan Gashi.

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Pra, këto propozime për ndryshim të këtij projektligji janë të arsyeshme, të domosdoshme dhe shpresojmë se do të krijojnë mundësi më të mirë për zbatimin e këtij ligji. Duke pasur parasysh kompletimin e këtij ligji dhe natyrën e ngjashme me ligjin paraprak që u miratua në pjesën e parë të kësaj seance dhe ligjin tjetër që pritet të vijë, mendojmë se kompletohet mirë kjo fushë e kësaj natyre dhe si grup përkrahim aprovimin e tij në parim dhe kontributin tonë do ta japim në fazën tjetër të shqyrtimit të dytë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike deputeti Armend Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuar ministre,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Plotësimi- ndryshimi i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është paraqitur me arsye të plotësimit të zbrazëtirave juridike që janë parë të nevojshme për eliminimin e efekteve administrative për zgjedhjen e rastit të konfliktit të interesit publik dhe të interesit privat të zyrtarit publik gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i ka shqyrtuar këto ndryshim-plotësime dhe mendon se terminologjia e përdorur në nenin 1 si konsiston personi i afërt me zyrtarin duhet të definohet qartazi, shkalla e afërsisë familjare të konfliktit të interesit dhe dy, person i besuar, cila është baza që një njeri konsiderohet person i besuar?

Pastaj, duhet të definohet qartë neni 5 që ka të bëjë me ushtrimin e lejuar të funksionit publik për konflikt interesi dhe neni 9 që ka të bëjë me mënyrat dhe dispozitat ndëshkimore.

Grupi Parlamentar i LDK-së i mbështet në parim këto ndryshim- plotësime duke parë të arsyeshme nevojën e plotësimit të infrastrukturës ligjore për eliminimin e këtyre dukurive negative. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e Grupit Parlamentar të AAK-së. Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj se ka qenë e nevojshme të bëhen këto ndryshime të ligjit dhe është në rregull që kanë ardhur ndryshimet.

Sido qoftë i kam disa vërejtje që janë të ngjashme edhe me vërejtjet për ligjin të cilin paraprakisht e shqyrtuam edhe disa çështje të tjera që kanë të bëjnë me politikën e ligjit për të cilën fola edhe herën e kaluar.

Pra, nëse dikush e sheh raportin e Agjencionit për Integritim Evropian e sheh që ky agjencion është i njëjtë sikur thashë pak më përpara Agjencion për Përkthim. Vërejtjet e vetme të cilat i ka bërë kanë të bëjnë me përkthimin prej gjuhës shqipe në anglishte dhe nuk dua të merrem absolutisht hiq me tregimin e praktikave të ligjeve, të normave dhe çka do qoftë tjetër që ndërlidhet me legjislacionet e ngjashme në vendet e Unionit Evropian ose edhe me vetë *asquis communautaire*...

Një çështje tjetër për të cilën duhet të flasim është mundësia e ndryshimit përsëri të ligjit edhe politika e ligjit. Ne jemi mësuar të dëgjojmë tanimë prej ekzekutivit në Kuvend- thonë kështu po parafrazoj- Ndryshoni çka të doni në ligj, po vetëm lë të kalojë ligji. Nëse ekzekutivi e ka studiuar ligjin qysh duhet të studiohet ligji, nëse ka menduar për çdo detaj të ligjit e që duhet të mendojë për çdo detaj të ligjit, atëherë ekzekutivi është i obliguar që para nesh ta mbrojë çdo nen edhe çdo paragraf të ligjit, se nëse ekzekutivi vjen edhe i thotë Parlamentit- ndryshoni çka të doni, po vetëm lë të kalojë ligji, do të thotë që ekzekutivi realisht është i interesuar vetëm për të kaluar ligji dhe nuk ka as ide për detajet e ligjit i cili duhet të jetë një ndërlidhje shumë funksionale ndërmjet të gjitha neneve. Kjo nuk është duke ndodhur sot, në fakt sot ka ndodhur më së pakti, po kjo ndodh sa herë që kemi ligj para vetes dhe mendoj se tregon një mos seriozitet total.

Do t'ju jap edhe një shembull se çka na sillet këtu. Shihni pikën 8 të memorandumit shpjegues, i cili na ka ardhur dhe e di që nuk e ka bërë ministria, e di që nuk e ka bërë politika, por e ka bërë administrata. Faji i politikës është që as nuk e ka lexuar ligjin, nuk e ka këqyrë çka po sjell këtu. Shikoni çka thotë pika 8 te memorandumit shpjegues, po i lexoj veç 5 reshta i ka, risitë dhe avancimet e projektligjit thotë: “Si risi e këtij projektligji konsiderohen të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme për kompletimin e infrastrukturës ligjore në këtë fushë”. Çka na kanë kallëzuar, thuaj se nuk po i dimë ne që risi është çdo ndryshim, domethënë kjo është risia e ligjit, ndërsa vetë kompletimi i infrastrukturës ligjore në këtë fushë nënkupton avancim. A mund dikush të më tregoj mua pse është e vetëkuptueshme që çdo ndryshim nënkupton avancim. Ka ndryshime që nënkuptojnë edhe degradim, ka ndryshime që nënkuptojnë prishje. Pse nuk na shpjegojnë çka domethënë avancim, por na thonë vetë ndryshimi është avancim, edhe risi është vetë ndryshimi. Kjo që e thashë tregon se nuk ka kujdes, nuk ka aspak kujdes nga administrata e aq më pak nga ekzekutivi. Mos harroni që ky ligj ka kaluar me votën në Qeverinë e Kosovës para se të vijë këtu, kjo është procedura. Do të thotë në Qeverinë e Kosovës ku është votuar ligji asnjë prej ministrave nuk është ndalur edhe të thotë hej a e dini çka keni shkruar në pikën 8 të memorandumit shpjegues, po veç kanë thanë ka ardhur ligji, kush është për i kanë ngritur duart, realitcho edhe ka kaluar ligji.

Këto desha t' i them edhe pse mendoj se ligji duhet të kalojë, mendoj se duhet pasur seriozitet kur bëhen këto shpjegime, kur tregohet pse bre po e ndryshojmë ligjin, a është risi vetëm ndryshimi a çka na sjell ky ligj? Krejt çka tha ministrja sot vlen edhe sikur fjala e ministres të ishte në memorandumin shpjegues do të ishte prefekt, po fjala e ministres nuk doli në memorandumin shpjegues, në memorandumin shpjegues doli kjo që unë ju thashë juve. Ky është një paragraf me të vërtetë qesharak edhe tregon një joseriozitet total të ekzekutivit. Faleminderit!

KRYETARI: Shumë mirë po e di Ardiani qysh bën Qeveria. Faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të AKR-së. Kush e do fjalën prej jush? E ka fjalën Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, Kryetar!

Mendoj se kemi shumë nevojë për këtë projektligj, më mirë të them për këtë ligj, dhe natyrisht se grupi ynë parlamentar i përkrah në parim- plotësimet në këtë projektligj.

I kemi edhe vërejtjet tona. Në këtë projektligj mungojnë nenet me të cilat sanksionohet lidhja e një kontrate që ka të bëjë me konflikt interesi.

Lidhja e një kontrate si dhe të gjitha veprimet e ndërmarra në bazë të kësaj kontrate duhet të normohen si nule.

Sanksionet duhet të shqiptohen, varësisht nga shkalla e përgjegjësisë së personit që lidh një kontratë të tillë. Pa sanksione nuk ka norma juridike- por vetëm norma morale. Prandaj, nëse duam ta implementojmë këtë ligj, në të ardhmen duhet të parashihen këto sanksione. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e Grupit Parlamentar të LDD-së. Për fjalë është lajmëruar deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së e ka shqyrtuar këtë projektligj, në fakt ndryshimet dhe plotësimet e tij dhe mendon se janë pozitive, të dobishme dhe e bëjnë ligjin më të aplikueshëm.

Megjithatë ne kemi vërejtur se ende ka nevojë edhe për ndryshime dhe plotësime të tjera. Po ashtu, duhet të jetë një definim më i qartë i termeve që janë përdorur në këtë projektligj si dhe duhet ta diskutojmë ndoshta në parim edhe për projektligjet e tjera që na vijnë në Kuvend, çështjen e harmonizimit me standardet e bashkimit Evropian. Ne e dimë se Bashkimi Evropian nuk ka ligje unike që aplikohen në të gjitha vendet, po vendet veç e veç kanë ligje të tilla dhe ne gjithmonë marrim një vlerësim se Bashkimi Evropian nuk e rregullon këtë çështje me ligje të veçanta e tjera.

Po ashtu, ka mjaft gabime gjuhësore dhe logjike dhe kjo duhet të merret parasysh po thuaj se në të gjitha ligjet që na vijnë në Kuvend, sepse siç duket ata që e bëjnë lekturën nuk i kanë të qarta shumë gjëra në aspektin gjuhësor edhe logjik.

Megjithatë në parim ne e përkrahim dhe mendojmë që në procedurën e mëtutjeshme në Komisionin funksional mund të bëhen edhe ndryshime dhe plotësime të tjera dhe ky ligj mund të dalë për aprovim definitiv në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!
Në emër të Grupit Parlamentar “7+” Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala predsedniče!
Ovim Nacrtom zakona izmenjuje se i dopunjuje zakonodavna infrastruktura koja se odnosi na utvrđivanje pravila, subjekata i nadležnosti za identifikaciju, tretiranje i rešavanje slučajeva sukoba javnog i privatnog interesa zvaničnika tokom vršenja javne funkcije.

Parlamentarna Grupa „7+“ smatra da će ove izmene, ponuđene izmene i dopune doprineti efikasnijem sprovođenju ovog zakona u praksi i u na čelu ga podržava. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Bojan Stojanović, e ka fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!
Parlamentarna grupa SLS takođe je razmatrala Zakon o imenama i dopunama Zakona o sprečavanju sukoba interesa i vršenju javnih funkcija i smatramo da ga treba podržati i da će on doprineti kvalitetnijem radu mnogih nas koji učestvujemo u javnom životu. Naravno, posebna tačka će biti ono što će proizaći nakon usvajanja i onoga što treba da primenimo iz ovog zakona što smo sami usvojili. Ali mi ćemo svoje sugestije dati u funkcionalnim komisijama i pokušati da tako damo svoj doprinos. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, Bojan!
Tani është radha e deputetëve të lajmëruar për diskutim. Fjalën e ka kërkuar deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!
I nderuar Kryetar!
Edhe Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit, i cili është në funksion sot, ka vënë në mëdyshje shumë zgjidhje të problemeve që janë në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit. Por, prej amendamentimit të ligjit që është bërë, në këto dokumente që i kemi pasur disa prej pikave mungojnë e që do të kishin bërë një zgjedhje shumë adekuate.

Në njërin prej diskutimeve të mia të parafundit unë i kam cekur disa prej konflikteve të interesit, kryesisht nga funksionet e larta dhe kam menduar se kur të amendamentohet ligji do të sqarohet neni 13 i Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, i cili ka të bëjë me ushtrimin e veprimtarive të tjera nga ana e zyrtarëve.

Në pikën 13.2 të Ligjit të tanishëm për parandalimin e konfliktit të interesit është specifikuar se zyrtari mund të ushtrojë punë nga lëmi i arsimit, shkencës, kulturës dhe veprimtarive humanitare, me fjalë të tjera, nuk lejohen zyrtarët të ushtrojnë punë të tjera.

Dhe sipas nenit 2 të Ligjit të tanishëm që është sot në fuqi zyrtarë janë edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe ne kemi shumë raste në Kuvendin e Kosovës ku deputetët ushtrojnë edhe veprimtari të tjera. Me fjalë të tjera, nuk jemi ne, por janë specifik njerëzit që ushtrojnë veprimtari të tjera, po duke tentuar që ta komentojnë ligjin ndryshe, kështu që unë propozoj ose të sqarohet neni 13, pika 2 e Ligjit të tanishëm, sepse këtu në amendamente nuk është, ose të kërkohej nga Kuvendi që të

respektohet prej anëtarëve - deputetëve të Kuvendit të Kosovës- Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit. Kjo ishte njëra prej pikave.

Kurse pika tjetër që është po aq e rëndësishme sa edhe puna e Kuvendit, është edhe puna e ushtrimit të funksioneve të tjera nga ana e Presidentit të Kosovës, përpos që është me Kushtetutë, këtu edhe nga aspekti ligjor kemi të bëjmë me konflikt interesi. Si me humor si me shaka, por që ka bartur mesazh shumë të vërtetë, ka qenë fjala ime kur kam thënë se post i ngrirë është gjendja agregate –ngrirja. Nuk e kupton kush çka është - trupat mund të ngrihen, shkrihen, kurse në terminologjinë juridike, Ministria e Drejtësisë e di që post i ngrirë nuk ekziston, kështu që bëj ftesë që kur të amendamentohet, ose të lejojmë poste të tilla me amendamentim, të propozojmë ndonjë amendament apo Komisioni Funkcional të propozojë, pra, ka të drejtë ta bëjë këtë, nëse e bën ligjin ta respektojmë ashtu siç duhet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuara ministre,

I nderuar ministër,

Sot po e shqyrtojmë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, nr. 02-L/133 dhe mendoj se ky është në radhën e këtyre ligjeve të cilët krijojnë kornizën ligjore për luftimin e korrupsionit.

Aktualisht kjo sferë është e rregulluar me ligjin të cilin e përmenda dhe ndryshimet dhe plotësimet të cilat i propozon Ministria, duhet më tej të mundësojnë në praktikë zbatimin më strikt të këtij ligji, duke kontrolluar zyrtarët publikë që të mos kenë konflikt të interesit, gjegjësisht që gjatë ushtrimit të funksionit të tyre mos të kenë mundësi keqpërdorimi, gjegjësisht t'i përdorin për interesat private.

Në këtë mënyrë, po të zbatohet strikt dhe me rregulla plotësuese, jo vetëm duke marrë parasysh parandalimin, por duke zgjidhur edhe rast të cilat kanë të bëjnë me konfliktin e interesit, mendoj që projektligji do të ishte më i avancuar. Edhe këtu Agjencioni Kundër Korrupsionit është mekanizmi kryesor sa i përket buxhetit, ai është i përfshirë në kuadër të Agjencionit. Sa i përket harmonizimit të projektligjit me *acquis communautaire*, siç thuhet, është në harmoni me parimet e legjislacionit, por kjo sferë nuk rregullohet me *acquis communautaire* për arsye se çdo shtet anëtar e rregullon vetë këtë sferë.

Risia në projektligj, sa e shoh unë, dhe në përgjithësi ka të bëjë me shtimin e disa zyrtarëve publikë të cilët nuk janë të përfshirë në ligjin e mëparshëm, ndër këta: komandanti i Forcës së Sigurisë, drejtori i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, drejtori i Administratës Tatimore, drejtori i Doganave, udhëheqësit e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe të organit shqyrtues të Prokurimit Publik, udhëheqësi i Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Mendoj që kjo është risia pse janë shtuar këta zyrtarë.

Megjithatë, primare për këtë ligj duhet të ishte forma e rregullimit të parandalimit të konfliktit të interesit, të zgjidhjes operationale dhe procedurale për kryerjen e funksionit publik në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit.

Në parim, e përkrah për shkak të rëndësisë që e ka. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Radha është për deputetin Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zoti Kryetar,

Kolegë të nderuar,

Dihet se te juridika ekzistojnë dy masa apo dy tipa - preventiva dhe këto masat aplikative si sanksione, por asnjëherë preventiva, domethënë parandalimi nuk është treguar as që mund të tregohet i suksesshëm, represivja natyrisht. Prandaj, është çështje parimore se athua do të duhej të ishte ky ligj për parandalimin, përderisa e dimë ne fare mirë se numri më i madh i akteve kriminale të sanksionuara, të inkriminuara, nuk mund të ndalohen me parandalime, me preventivë. Pastaj, është fjala këtu për konflikt të interesave. Në esencë, nuk është fjala për konflikt, por është fjala për përputhje të interesave egoiste, se nuk është fjala për konflikt, bie fjala i konvenon, ai nuk është konflikt, përkundrazi, është konkordancë e interesave ama egoiste, kështu që titulli e jep përmbajtjen, ju lutem, aty është çështja te parimi.

Pastaj, çështje që na bie në sy të gjithëve, është mendimi i këtij projektligji, që tash vonë është miratuar, tash duhet të bëhet plotësimi dhe ndryshimi. Pse? Për shkak të ndjesisë, se është krijuar njëfarë trendi, njëfarë imperativi të bëjmë ligje sa më shumë. Numri nuk tregon kurrigjë. Prandaj, do të isha angazhuar që me të vërtetë, bile së paku tash e tutje, aktet që do t'i trajtojmë, t'i trajtojmë me shumë seriozitet, t'i përgatisim shumë më mirë, se ndryshe po dalin akte të zbrazëta, me zbrazëtira dhe me kontroversa.

Ja, po e zëmë, një dispozitë që është shumë problematike, në çdo pikëpamje. Neni 9, po e zëmë, ky ligj, se ligji duhet të mbështetet, të thirret, të apelohej në Kushtetutë, ekskluzivisht aty është burimi juridik, e këtu thirret në Rregulloren e Punës së Qeverisë, madje, madje shkon edhe më tutje -thotë: “në konformitet me Udhëzimin administrativ të Qeverisë”. Po kjo është qesharake, ju lutem. Prandaj, sikundër të ishte lexuar me një seriozitet, me një devocion, gjithsesi do të kishte rënë në sy ky dështim që është makro dështim kështu në nomo- teknikë.

Në këtë do duhej të inkorporoheshin dispozitat që propozohen të fshihen sipas rregullave nomo -teknike, të jenë ato ku thotë “fshihet”, nënvizohet, në mënyrë që lexuesi, deputeti ta ketë paralelisht, të mos kenë nevojë për ta marrë atë dhe për t'i qitur dy këso.

Te sanksionet, po e zëmë, formulimet janë aq problematike sa që janë edhe pa kurrfarë vlere. Bie fjala, thotë: “Në qoftë se ...” e atëherë domethënë do të dyshohej se ekziston konflikti i interesave, atëherë do të fillonte procedura për shkarkimin. Fillimi nuk thotë kurrigjë, nuk garanton bash kurrigjë, se mund të fillojë edhe mos të përfundojë kurrë, ... “Kur bën shelqja rrush”, prandaj duhet sanksionet të definohen qartë, në mënyrë që me të vërtetë, nëse konstatohet, jo të fillojë, por të bëhet shkarkimi, e kur thuhet bëhet, atëherë del diçka krejt tjetër. Edhe ai defekti që është, si të thuhet kështu, permanent. Gramatikisht ka shumë dështime, terminologjikisht shumë shprehje pa kurrfarë vlere juridike, kurse është fjala për dokument juridik. Ju faleminderit!

KRYETARI: Problemi është i Fakultetit Juridik, profesor. Ju faleminderit! Radha është e deputetit Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëendetje, të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Ne e kemi shqyrtuar dhe para se të lexohej në lexim të parë në parim në Komision për Legjislacion, mirëpo e kemi obliguar zoti Makolli ta bëjë një prezantim, nuk ishte prezent, mirëpo unë do të flas si deputet për disa çështje për të cilat kërkoj që deputetët, qoftë përmes amendamenteve, qoftë përmes formave të tjera, të na mbështesin rreth projektligjit për të cilin po bisedojmë.

Konsiderojmë se projektligji është i hartuar mirë si të gjitha ligjet që i bëjmë ne si zyrtarë. Nuk është shumë keq si po flasin disa, mirëpo konsiderojmë që duhet pasur parasysh në rastin e hartimeve të projektligjeve tani së paku të mos i bëjmë të paqarta sa i përket asaj a janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Unë do të kisha përmendur nenin 5, meqë po flasim për amendamentet e ligjit që e kemi në fuqi, që amendamenti 5, faktikisht flet për neni 10 të ligjit ekzistues, ku thotë: “Personi zyrtar nuk duhet të ushtrojë funksion administrativ mbikëqyrës apo të përfaqësimit në asnjë kompani, firmë publike e kështu me radhë”.

Amendamenti 10.2, menjëherë vazhdon, thotë: “Përfashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, personi zyrtar mund të jetë përfaqësues në institucionet e tij, të jetë anëtar bordi i një institucioni apo agjencioni publik apo anëtar i bordit mbikëqyrës atje ku ndërmarrja publike ka kapital edhe shtetëror”. Pse e ngrita çështjen? Pak më parë ky Kuvend aprovoi ligjin dhe decidivisht e kuptuam se kush janë zyrtarët e lartë në Kosovë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 72 nuk e lejon asnjë deputet të Parlamentit të Kosovës që të marrë pjesë në asnjë nga këto që i përmenda tash. Domethënë, pasi që ligji që e aprovuam paraprakisht, në kuadër të zyrtarëve të lartë ka paraparë edhe deputetët e Parlamentit të Kosovës që është në rregull, por do të ishte dashur që ky ligj, në këtë nen t’i specifikojë deputetët dhe t’i nxjerrë nga kjo kategori, sepse nenin 72 nuk i jep autoritet deputetëve të jenë më anëtarë të asnjë bordi, agjencioni, por edhe të kompanive publike.

Mandej, çështja është prapë diskutabile në nenin 10.3, ku thotë: “Zyrtari gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtrojë funksion tjetër, përjashtimisht vetëm me pëlqimin e institucionit i cili e ka zgjedhur apo emërtuar”. Domethënë, po e bëjmë prapë një shkelje kushtetuese. Asnjë institucion nuk mund të nxjerrë asnjë vendim i cili do të jetë në kundërshtim me Kushtetutën që e përmenda, por edhe me ligjin në të cilin bëjnë nxjerrje. Nëse në ligj kemi thënë që asnjë zyrtar nuk mund të jetë në asnjë bord, sepse është zyrtar i lartë, sidomos për deputetët, tash themi që ka mundësi të marrë pjesë nëse institucioni, po e marrim si institucion Kryesinë apo Kuvendin, ia lëshon një vendim që mund të merr pjesë. Prandaj, kjo çështje bie ndesh me atë që e thash deri në fund.

Dhe, krejt në fund, në nenin 21.6, thotë: “Organi kompetent ku personi zyrtar vazhdon të kryejë një aktivitet apo funksion të papajtueshëm, fillon procedurën për shkarkim nga funksioni në pajtim me propozimin e agjencisë për vendimin final dhe e informon Agjencinë” edhe kjo mendoj që nuk është as autoritet i agjencisë, por duhet të kemi përjashtim. Rastin po e përmendi prapë me deputetë, meqë jemi prezentë dhe e kuptojmë më mirë, domethënë mund të fillojë asnjë nismë ndaj shkarkimit nga institucioni për deputetin nëse ai ka konflikt interesi. Prandaj, edhe këtu ka qenë dashur të specifikohet, e nderuara ministre, me qëllim që ne të mos kemi mundësinë, se ju paraprakisht deklaruarat që po bëjmë shumë amendamente dhe nga kjo që e patë, vetëm për këtë moment ne jemi të detyruar diku t’i bëjmë nja 4-5 amendamente, kurse po

flasim për një plotësim, amendamentim të Ligjit, i cili i ka krejt 10,12-13 amendamente. Ju faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar, deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përkrah në parim qëllimin e këtij projektligji në parandalimin e konfliktit të interesit, por duke lexuar këtë projektligj, unë do t'i shtoj dy vërejtje parimore. E para ka të bëjë sigurisht me ndonjë gabim teknik tek pikat që e shpjegojnë projektligjin, ku u tha edhe më herët se, besoj duhet të korrigjohet që Rregullorja t'i përshtatet ligjit e jo e kundërta, ndërsa vërejtja e dytë ka të bëjë me konfliktin e interesit, mbetet tek dilema se është apo nuk është konflikt interesi kur në institucionet qeveritare, apo ndërmarrje publike, në borde menaxhuese, tek zyrtarët administrativ, tek të gjitha, tek ndërtimi i këtyre kapaciteteve, ka ndërhyrje dhe vendosje të pastra politike, spastrime politike nëpër institucione sipas qejfit të ndryshimeve, kur ka emërimë në baza familjare dhe rajonale. Pra, është ky konflikt interesi kur vendosin po e zëmë: dajën, nipin, hallën, tezen e gjithçka, nuk di si mund ta sanksionojmë, por unë kërkoj një minimum të përshtatjes dhe praktikave të cilat kishin për ta ndryshuar këtë gjendje në luftimin e këtij konflikti të interesit me të vetmin qëllim që vërtet në të ardhmen të kemi një mundësi për ndërtimin e institucioneve profesionale e jo ndryshime qysh thash sipas atij karakteri që e përmenda. Prandaj, mendoj që Komisionit profesional ka për detyrë që t'i kodifikojë këto konflikte të interesit që i përmenda dhe do të ndihmonte shumë në ndërtimin vërtet të një administrate dhe institucioneve të tjera që i përmenda me njerëz profesional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në sallë kemi 63 deputetë. Diskutimet i përfunduam. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim në parim. Votojmë, tash.

Me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr .02/2-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional,
2. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
3. Komisionin për Komunitete, dhe
4. Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural**

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportin me rekomandimet e Komisionit u janë shpërndarë deputetëve. Para se ta procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, deputetin Lulzim Zeneli. Më që nuk është këtu, atëherë vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni Funkcional si pas radhës së paraqitur në raport.

Radha është për të votuar për amendamentin 1.

Votojmë, tash:

Deputetët, le të kthehen në sallë! Kërkoj nga regjia që t'i bjerë ziles për të ardhur deputetët në sallë.

Ju faleminderit shumë për sugjerimet deputete por, realisht, ne kemi vizituar shumë parlamente me një traditë të gjatë të demokracisë, të funksionimit demokratik dhe i kanë zilet dhe i bien 3-4 herë për t'i ftuar deputetët për të hyrë në sallë, kështu që edhe ne po e bëjmë këtë.

Regjia, duhet ndërprerë se mjaft keni paralajmëruar

Lus deputetët, ne e filluam pikën e gjashtë të rendit të ditës më 63 deputetë. Në kohën e votimit mbetën minus 5 deputetë, do të thotë, nuk e kemi pasur kuorumin. Tani i kemi 68 dhe vazhdojmë edhe një herë me votimin e amendamentit numër 1, po e përsërisim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Amendamenti 1

Konstatohet se me 56 vota “për”, 5 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 1 “kundër” 5 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Me 60 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 5

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 2 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Më 54 vota “për”, 2 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Më 60 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Më 58 vota “për”, 2 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Më 57 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Në radhë është amendamenti 12.

Votojmë tash:

Më 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 6 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Më 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Dhe, amendamenti i fundit, 15.

Për amendamentin 15! Urdhëroni, Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: Zotëri, Kryetar!

Në këtë rast, shpresoj se nëse do të miratohej, do të vlente për të gjitha rastet e tjera. Kur thuhet për “kundërvajtje me gjobë”, nuk duhet të thuhet “me gjobë”. Është fjalë me proveniencë tjetër, por me “dënim me të holla”, se ka dënim me burg, ka dënim me të holla. Kjo është edhe terminologji juridike- penale dhe përkon me gjuhën. Propozoj të zëvendësohet “gjoba me dënim me të holla”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atë e votuam.

Votojmë amendamentin 15.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Tani votojmë tekstin në tërësi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime – Kuvendi miraton Ligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Vazhdojmë punën me pikat e radhës.

- Rregullorja e Punës së Kuvendit është hequr.
- Edhe pika 8 është hequr.

Pika e nëntë:

- **Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudence.**

Ministria e Drejtësisë, në pajtim me nenin 6, paragrafi 2 të Ligjit për provimin e jurisprudence ka propozuar kandidatët për anëtarë të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudence.

Komisioni funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar propozimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime.

Raporti i Komisionit, së bashku me propozim- vendimin e Ministrisë së Drejtësisë u është shpërndarë deputetëve.

Kryetari i Komisionit, a e do fjalën? Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar për herë të pestë raportin e Ministrisë së Drejtësisë, gjegjësisht të Qeverisë së Kosovës për formim të provimit të jurisprudence dhe me qëllim që t'i njoftoj edhe deputetët e Parlamentit, por edhe opinionin, sepse e dini që kohën e fundit pothuaj se vazhdimisht nëpër televizione publike ka qenë mos formimi i Komisionit për provim të judikaturës dhe barra kryesore iu ka mëveshur atij. Komisioni duhet t'i bëjë disa sqarime para se t'i lexoj emrat për të cilët kemi propozuar që sot Kuvendi t'i votojë.

Komisioni, për herë të parë këtë raport e ka dorëzuar në Kuvend më 27 maj 2008 dhe ju e dini që më 24 qershor, kur ka qenë dashur para votimit, ky raport është tërhequr para se të votohet nga ministrja e Drejtësisë. Rekomandimi, pastaj në Komision ka ardhur 5 muaj me vonësë, domethënë në dhjetor, rekomandimi tjetër me plotësim dhe Komisioni është detyruar që më 27 mars 2009 për shkak se ligji, neni 7.6 kërkon kritere për kandidatët të cilët propozohen të jenë anëtarë të Komisionit, jemi detyruar që të kërkojmë plotësim të raportit, sepse 3 kandidatë nuk i kanë plotësuar këto kritere si i kërkon neni 7. 6 i Ligjit për provimin e judikaturës.

Nuk do t' ju lodhi tash me kandidatët, por fjala ka qenë për Ruzhdi Berishën, Vjosa Osmanin dhe Robert Muharremin. Çështja u ndërlikua edhe më pastaj pas dorëheqjes së zotit Robert Muharremi, është dashur edhe një herë ne ta kërkojmë një shtesë, e kështu me radhë. Dhe, po vi deri në përfundimin e fundit, në shqyrtimin e fundit të Komisionit, të cilin e kemi bërë më 27 prill dhe 18 maj 2009, kemi marrë propozimet po thuaj çdo herë të njëjta nga Ministria e Drejtësisë, edhe pse kemi rekomanduar që kandidatët në fjalë nuk i plotësojnë kriteret dhe herën e fundit kemi 3 kandidatë për të cilët kemi dilema dhe unë e kam lënë që raportin me autorizim të Komisionit ta përcjellim në Kuvend dhe ne të vendosim si Kuvend. Por, kisha bërë një sqarim, raportin nuk e kemi pru pas

rekomandimeve që i dëgjova edhe në televizion publik se ministrja e Drejtësisë ka kërkuar që ne s'kemi drejtë si Komision ta shikojmë bazën ligjore, sepse pikërisht Komisioni për Legjislacion është ai komision i cili e shikon bazën ligjore. Propozimet janë kështu:

1. Zoti Rexhep Haxhimusa, propozohet kryetar i Komisionit. Do të pyes, të Drejtën Penale, kurse zëvendësi i tij, Mehdi Dehari.
2. Prof. Abedin Feroviq, do të pyes lëndën – Struktura Kushtetuese dhe Organizimi i Gjyqësorit, kurse zëvendësi i tij është mr. Rafet Haxhiaj.
3. Muharrem Shala, zëvendës anëtar i Komisionit – E Drejta Civile, Materiale dhe Procedurale, Familjare Trashëgimore dhe e Drejta Detyrimore. Sa i përket zëvendësit, ne nuk e kemi rekomanduar, se i kemi disa shqetësime rreth pikës 7.6 të ligjit, do t'i përmend.
4. Prof. dr. Suzana Kazazi – Sejdiu, anëtare e Komisionit, pyetëse e lëndës -E Drejta Tregtare Ekonomike.
5. Meleqe Behxheti, anëtare e Komisionit, pyetëse e lëndës -E Drejta e Punës, kurse zëvendëse e saj, Gylten Sylejmani.
6. Prof. dr. Mirlinda Batalli, anëtare e Komisionit, pyetëse e lëndës -E Drejta Administrative, kurse zëvendës i saj, Osman Tmava.
7. Prof. asistent dr. Iliriana Islami, anëtare e Komisionit, pyetëse e lëndës - E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vlen të përmendet se në momentin kur ne e kemi bërë rekomandimin për Kuvendin e Kosovës, ende nuk ka qenë e zgjedhur kandidatja për Gjykatën Kushtetuese. Tash është anëtare e Gjykatës Kushtetuese dhe ndoshta në të ardhmen mendoj që duhet gjithsesi të vijë propozimi për ndryshim, varësisht si vendos.

Kandidatët, për të cilët ende konsiderojmë se ka dilema ligjore, janë:

- Zoti Ruzhdi Berisha, për të cilin herën e fundit e kemi një raport plotësues, i kemi disa vërtetime që kanë ardhur prej gjykatave ku ka punuar dhe konsideroj se është çështje që ndoshta edhe deputetët e kanë lexuar dhe të shikojnë se si do të vendosin.

Po ashtu, e kemi një shqetësim për Fetije Sadikun, e propozuar- zëvendëse e anëtarit të Komisionit, në pikën 4 të propozim vendimit, sepse nuk i ka 10 vjet përvojë, ashtu siç i kërkon neni 7.6, ku thotë: Pyetësi i lëndës mund të jetë anëtar i Komisionit i cili lëndën e ka specializim të ngushtë, domethënë është fjala, nëse ka gradë shkencore – doktor i shkencave apo magjistr dhe nëse nuk e ka këtë, atëherë njohës i mirë i çështjeve juridike, por me përvojë, gjykatës, me përvojë 10 vjet pa ndërprerë në lëndën përkatëse.

Nga kjo shihet se Ruzhdi Berisha i ka pru disa vërtetime, por nëse i keni parë brenda, lëshohet një vërtetim ku thotë – Zoti Berisha ka punuar në Gjykatë, po për disa muaj thotë ka punuar edhe në Gjykatën Supreme, për disa muaj. Tash ne s'kemi mund, unë mendoj se vërtetimet nuk ka qenë dashur të lëshohen këtu, por le të jetë përgjegjësi e

institucioneve që i lëshojnë. Vërtetimi duhet të lëshohet qartë – ka punuar 20 muaj, 30 muaj, por jo të lëshohet vërtetim nga institucioni gjyqësor që për disa muaj ka qenë jashtë kësaj gjykate në një gjykatë tjetër- për disa muaj. Nuk e kemi kuptuar sa janë disa muaj.

Për Fetije Sadikun nuk e kemi pasur propozimin në kohën kur e kemi parë rekomandimin. E kemi pritur Ministrinë e Drejtësisë, pas dy jave na ka ardhur një propozim dhe nga propozimi që kemi marrë konsiderojmë se nuk i ka 10 vjet përvojë pune, duke u mbështetur në neni 7.6 - 10 vjet përvojë pune pa ndërprerë. Është për çudi, ju kisha thënë edhe këtu, para opinionit, është mirë për ta qartësuar edhe opinionin që Komisioni ka vepruar çdo herë me ligj, asnjë interes i asnjë anëtar të Komisionit nuk ka qenë për ta penguar, sepse interes ynë është që të kalojnë ligjet dhe të kalojnë propozime, por edhe propozimin tani që e kemi, që po ia rekomandojmë Kuvendit të Kosovës, është i nënshkruar nga këshilltari politik i ministres, gjë e cila është në kundërshtim me rregulloret në fuqi dhe me ligjet në fuqi. Dhe po të kishim dashur si Komision ne për herë të parë kishim kërkuar që këshilltarë politikë nuk e kanë të drejtën për të nënshkruar asnjë dokument zyrtar e në veçanti dokumente të cilat janë për formim të Komisionit.

Dhe, shqetësimi i fundit është në propozimin e tretë. Është fjala për Qerim Qerimin, që është këshilltar politik i ministrit të Punëve të Jashtme. Sa i përket kandidaturës së zotëri Qerimit, ky i plotëson kriteret, mirëpo ka qenë një përfundim, s'kisha mund të them i Kuvendit, por ka qenë një supozim i Kuvendit dhe një mbështetje pastaj e përbashkët e Komisionit që njerëzit të cilët janë në ekzekutiv si këshilltarë politikë, ministrat të mos jenë në Komisionin për dhënien e provimit të judikaturës... dhe në këtë aspekt Komisioni i ka shqetësimet. Dhe, natyrisht, kemi kërkuar për të gjithë ata të cilët punojnë për ekzekutivin të mos kenë të drejtë t'i nënshtrohen provimit të judikaturës. Qëllimi ka qenë që t'i ikim asaj pak ngjyrës politike.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi konsideron që këta njerëz të cilët i kemi propozuar për dhënie të provimit- i ka propozuar Ministria e Drejtësisë dhe ne nuk kemi vërejtje. Komisioni mund të jetë funksional, mund të veprojë, mund të mblidhet në çdo kohë dhe natyrisht e zgjedhim problemin e kësaj kohe që e kemi pasur që njerëzit s'kanë mund për t'iu nënshtruar provimit, kurse Kuvendi të vendosë për këta 3 kandidatë a i plotësojnë, a dëshiron për t' i votuar apo jo? Mirëpo, nuk është asnjë pengesë që t'i votojmë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe të fillojë punën Komisioni për provimin e judikaturës. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

E kam fjalën për shkresat që vijnë. Ne kemi bërë një shkresë si Kuvend për Qeverinë, që asnjë material nuk mund t'i adresohet Kuvendit as nga këshilltarët politikë, as nga ministrat. Materiali në Kuvend vjen nga Qeveria jo nga ministrat dhe ministrat, e aq më pak nga këshilltarët politikë dhe sa herë që ky komunikim nuk është në përputhje me standardin, duhet të kthehet prej nga ka ardhur. Kjo duhet të jetë një rregull edhe e komisioneve që të mos diskutojmë në Kuvend se s'është për të ardhur ai material as në komisione e as në Kuvend. Megjithatë, është radha e shefave të grupeve parlamentare që t'i japin mendimet e tyre në emër të grupeve që përfaqësojnë. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike... Më fal, fjalën e ka përfaqësuesja e Qeverisë, në këtë rast, zonja ministre Nekibe Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Është e vërtetë se pesë herë është kthyer propozim-vendimi i Ministrisë për provimin e jurisprudencës, çdo herë ka qenë në komunikim në komisionin e Parlamentit –

Komisioni funksional për Gjyqësi. Në Ministri nuk është propozuar asnjëherë, nuk është rekomanduar asnjëherë në Parlament që të votohet ose të mos votohet propozim-vendimi i Qeverisë. Mendoj se kjo nuk ka qenë në rregull, sepse kështu nuk e parasheh as Rregullorja e Punës së Kuvendit.

Si do që të jetë, lista e kandidatëve të propozuar mendoj se i plotëson të gjitha kriteret nga neni 7.6, i cili parasheh 3 mundësi, 3 alternativa për t'u përfshirë si pyetës i lëndës dhe faktikisht edhe si zëvendës pyetës.

Alternativa e parë ka të bëjë me atë që lëndën e ka specializim të ngushtë, që do të thotë se u mundësohet shumë personave, jo vetëm gjyqtarëve për të cilët po bëhet fjalë këtu, por shumë personave të tjerë që nëse lëndën e kanë specializim të ngushtë të mund të kandidohen, të përfshihen në listën për provim të jurisprudencës. Domethënë nuk i përjashtojmë as avokatët as shoqërinë civile, por njeriu i cili e ka lëndë të ngushtë.

Alternativa e dytë mund të jetë pyetës i lëndës edhe personi i cili ka gradë shkencore nga ajo lëndë. Për shembull është magjistër i shkencave ose doktor i shkencave dhe alternativa e tretë është të ketë përvojë pune pa ndërprerje 10 vjet si gjyqtar i lëndës.

Domethënë ligji kështu e ka rregulluar. Nuk kërkon ligji që në mënyrë kumulative të plotësohen të gjitha këto kushte, por kërkon që njëri prej këtyre kushteve të plotësohet. Nëse i referohemi kandidaturës së Ruzhdi Berishës, dua t'ju them se Ruzhdi Berisha në CV e vet e ka përshkruar lëvizjen e tij në punë, por edhe në bazë të vërtetimeve që ka sjell vërtetohet se ka 13 vjet e 6 muaj përvojë pune pa ndërpre në organet e judikaturës. Së pari ka filluar në Dragash, pastaj ka kaluar në Gjykatën e Qarkut në Prizren, për të kaluar në vitin 1984 ose 1985, nuk po më kujtohet në cilin vit në Gjykatën Supreme. Çdo herë është avancuar në punë pa e ndërpre marrëdhënien e punës. Domethënë po e theksoj, avancimi i tij ka qenë vlerësimi i punës së tij të mirë si gjyqtar dhe është avancuar. Nëse i ka skaduar mandati i gjyqtarit më 31 dhjetor, po e zëmë të vitit 1972, ai më 1 janar të vitit 1973 ka filluar në Gjykatën e Qarkut në Prizren. A konsiderohet kjo ndërprerje? Jo. Nën një.

Nën dy, ky është edhe i angazhuar si trajnues në Institutin Gjyqësor të Kosovës për çka edhe përgatit kuadro pikërisht për këtë provim të jurisprudencës. Ka sjellë prova edhe nga Organizata për Siguri e Bashkëpunim edhe nga NDI përkitazi me përfshirjen e tij në këtë Institut.

Ruzhdi Berisha me profesion është avokat dhe nga lënda të cilën ai do ta pyesë, nëse ju e votoni, është Pjesa e Përgjithshme, E Drejta Familjare, Procedurat 3- Përmbarese, Jo kontestuese, Kontestuese, E Drejta Detyrimore dhe e Drejta Trashëgimore. Dhe mendoj se Kosova për momentin nuk ka pyetës më të specializuar për praktikë, sa i përket praktikës se sa Ruzhdi Berisha.

Po i kthehem tani kontestimit të kandidates së Fetije Sadik. Kandidatja Fetije Sadik, gabimisht është shkruar Fetije Sadiku, sepse është e përkatësisë turke. Atë e ka thënë edhe në CV- e vet ku thotë – me kombësi turke. Ajo punon në Gjykatën e Qarkut Ekonomike të Prishtinës që 9 pa ndërprerë, nëse s'gaboj. Dhe, sipas kësaj, meqë të Drejtën Ekonomike e ka specializim të ngushtë, nuk mund të kërkohej nga kjo që të jetë gjyqtare 10 vjet, si gjyqtare e lëndës, sepse nuk është gjyqtare e lëndës, por është gjyqtare e një materie të caktuar.

Sa i përket kandidatës së tretë, kontestimit të Iliriana Islamit, profesoreshës, mendoj se këtu nuk ka asgjë të keqe që ajo, nëse është gjykatëse e Gjykatës Kushtetuese të jetë edhe e angazhuar për lëndën E drejta Ndërkombëtare... Ju lutem keni pak durim, unë 120 vetave juve po ju dëgjoj, ju s'po më dëgjoni mua një. Iliriana Islami është e vërtetë se është emëruar nga ky Kuvend i nderuar, për gjyqtare, por keni parasysh se ky komision është Komision profesional për aftësimin profesional praktik të kandidatëve të mundshëm që donë ta ushtrojnë funksionin e avokatit, të gjyqtarit, të prokurorit apo të një përfaqësuesi të biznesit ku e ka sipas ligjit të ndaluar përfaqësimin nëse nuk e ka të dhënë këtë provim të jurisprudencës.

Unë mendoj se rekomandimi i përgjysmuar nuk mund të votohet në Parlament, ose duhet të votohet në tërësi ose të refuzohet në tërësi. Në mënyrë parciale nuk mund të votohet, sepse dihet se kur një zëvendës pyetës mund ta pyesë kandidatin, jo nëse nuk e ka të zgjedhur pyetësin, por nëse pyetësi për shkaqe të arsyeshme mungon. Pra, ju mbetet juve, deputetë të nderuar, që t'i vlerësoni me shumë kujdes të tri alternativat që i kërkon ligji, mos t'i merrni dhe të përcaktoheni për një alternativë – jo s'i plotëson jo i plotëson kushtet. Është në interesin tonë të përgjithshëm, unë nuk dua t'ju mbaj ders juve, ju këtë më mirë e dini se sa unë, që të kemi kandidatë për t'i përfshirë në gjykata dhe në prokurori mu në këtë fazë kur duhet të bëhet reforma gjyqësore.

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Unë besoj se të gjithë jemi deputetë dhe në mesin e deputetëve ka edhe shumë juristë, por nëse nuk ka juristë, së paku dinë ta lexojnë ligjin. Ne nuk i kemi ngatërruar 3 propozimet, nëse ka doktorë shkence të propozuar, s'e kemi lypur fare përvojën e punës, as për magjistra. Ne kemi kërkuar nëse keni propozuar për pyetës lënde gjykatës, duhet t'i kenë 10 vjet pa ndërprerë, kështu e thotë ligji në lëndën përkatëse. Nëse e keni propozuar në penale, duhet t'i këtë dhjetë vjet pa ndërprerë në çështjet penale, jo të jetë kryetar gjykate, jo të jetë prokuror, dhjetë vjet pa ndërprerë në çështjet penale. Nëse keni propozuar në civile duhet t'i këtë dhjetë vjet në çështjet civile, kështu e thotë ligji dhe në bazë të kësaj 4 herë jemi detyruar për t'i diskutuar. Dhe një çështje, një sqarim, ju e dini që e kemi tërhequr propozimin. E kemi tërhequr propozimin para një viti, e nderuara ministre, pse ne kemi kërkuar që për Drejtën Detyrimore, siç kërkon ligji, të mos ketë pyetës lënde para doktorit të shkencës, nëse duhet për t'u përcaktuar për doktor të shkencave, atëherë vijnë të parët doktorët e shkencave, sepse ligjërojnë lëndën përkatëse dhe s'mundet asnjë avokat para një doktori të shkencës, nëse përcaktoheni për gradë shkencore, se kështu e thotë ligji, nëse përcaktoheni për ekspertë të gjyqësisë, atëherë gjykatësit të cilët i kanë dhjetë vjet.

Nuk është asnjë pengesë që sot të miratohet propozimi prej 7 vetave. Atë që po e thoni ju, zonja ministre, nuk shkruan kurrkund në ligj që nuk munde të funksionojë komisioni komplet. 7 veta janë, këtu keni më shumë se 7 veta, i kemi 10 apo 11, por 7 veta. Nëse ekzistojnë, për të gjitha lëndët janë, nëse aprovohen në Kuvend, Komisioni mund t'ia fillojë punën çdo herë pa asnjë problem, sepse ligji nuk e kërkon që vetëm atë, Rregullorja e Punës thotë: "Pyetësi i lëndës pyet në mungesë të, zëvendësi pyet në mungesë të pyetësit të lëndës. Në këtë rast po mungon pyetësi dhe duhet të pyes zëvendësi, nuk është asnjë problem. Dhe një çështje, ne nuk e kemi kontestuar Ilirianën, e kemi propozuar, por në kohën kur e kemi rekomanduar s'ka qenë gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese, pra, të mos i shtrembërojmë gjërat, sepse opinionin po e qesim në lajthitje. Tani është gjykatëse e Gjykatës Kushtetuese dhe unë konsideroj që është konflikt interesi, sepse duhet të japë interpretime juridike. Mirëpo ne mund ta votojmë

përkohësisht, por gjithsesi duhet të vijë propozimi për ta ndryshuar Ilirianën, sepse është konflikt i interesit, është organ i cili jep interpretime kushtetuese dhe çka nëse duhet të japë interpretim kushtetues për provimin e judikaturës apo për ndonjë çështje që ngritët rreth çështjes së judikaturës në të ardhmen? Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, ministre!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Ruzhdi Berisha, nuk propozohet si gjyqtar, por propozohet si avokat që e ka specializim lëndën. Tjetër është ajo që ka punuar 13 vjet e 6 muaj pa ndërprerë si gjyqtar dhe nuk është aktualisht as gjyqtar, është avokat dhe trajnues në Institutin Gjyqësor. Kjo është nën një.

Nën dy, Iliriana Islami ende nuk e ka dhënë betimin dhe nuk e ka statusin e gjyqtarit. Pasi ta japë betimin, atëherë është gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese dhe nuk është vënie në lajthim me opinionin, por kjo është realitet.

Dhe, nën tre, ky provim ka të bëjë me praktikën, tjetër është që ligji parasheh të merren edhe teoricienë. E Drejta Detyrimore është vetëm një nga 7 lëndët që pyeten në kuadër të Lëndës Civile për provimin e jurisprudence. Nuk është lëndë e veçantë, ju lutem.

KRYETARI: Po shkojmë me shefat e grupeve parlamentare, nëse ata janë të pranishëm, pastaj vazhdojmë me deputetët. Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

RAMË BUJA: Zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zonja ministre,

Unë besoj që nuk patëm fare nevojë të dëgjojmë një debat të tillë çfarë u dëgjua por, megjithatë, pak na sqaroi diçka që ne nuk duhet ta votojmë listën e këtyre gjyqtarëve apo këtyre njerëzve profesionistë që janë propozuar këtë herë për faktin që kontestohen në mënyrë të argumentuar. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike nuk e voton listën në tërësi.

KRYETARI: Pa revoltë! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuara ministre,

Kolegë të nderuar deputetë,

Pasi që jam autorizuar që edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së të jap mendimin për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudence, unë do të marr përgjegjësinë të flas dhe të jap edhe mendimin të cilin e kam mbajtur unë edhe gjatë gjithë kohës në komisionin funksional, në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Është e vërtetë se ka kaluar një kohë e gjatë që nuk funksionon Komisioni për Provimin e Jurisprudence, të cilit i ka kaluar mandati. Ky komision është organ i pavarur profesional, i cili organizon provime për kualifikimin e gjyqtarëve, të prokurorëve, të juristëve dhe specialistëve të tjerë ligjorë dhe mendoj që në këtë fazë të fillimit të reformës gjyqësore në sistemin gjyqësor është më se i domosdoshëm konstituimi i këtij komisioni. Duke marrë parasysh atë që e kam mbrojtur edhe në Komision, se në këtë moment është një numër i madh i atyre kandidatëve që kanë përfunduar ligjëratat dhe janë në pritje të formimit të këtij komisioni, me qëllim që ata t'i nënshtrohen këtij

provim, zvarritja e këtij komisioni, e formimit të tij, sipas mendimit tim do të krijonte pakënaqësi te këta kandidatë dhe e vonon reformën efikase me njerëz të rinj në sistemin tonë gjyqësor. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, për hir të gjithë atyre që presin dhe dëshirojnë që të kemi reforma efikase në sistemin gjyqësor, të cilat edhe tani janë të proklamuar, e mbështet listën komplet- propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e rimerr zoti Naim Maloku, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues! Situata është, domethënë, goxha serioze. Tanimë po krijohet njëfarë bindje që sa herë do që do të votohet dikush në ndonjë emërim, qoftë bord, qoftë komision ose çka do tjetër, kemi probleme. Ka kaluar një kohë shumë e gjatë që nuk e kemi Komisionin për Provimin e Jurisprudencës dhe dikujt mund t'i shkojë mendja pse po ndodhë kështu? Pra, pse po ndodhë kështu që të mos kemi njerëz të rinj në sistemin e drejtësisë, do të thotë, që tha një koleg deputet më herët, a mos ndoshta është edhe me qëllim për t'i mbajtur të vjetrit? Një pyetje tjetër që shtrohet tani është, pse është e kësaj rëndësie kaq të çuditshme e gjithë kjo çështje? Domethënë, nuk është e rëndësisë, për shembull, ta marrim sikur Kushtetuta ose gjyqtarët kushtetues kur shefat e grupeve, sidomos të atyre në pushtet, janë mbledhur dhe janë marrë vesh në mes veti se është çështje jetike dhe kanë ardhur me propozim, por nuk është as e një rëndësie sikur ligjet, ku askush nuk ia vë veshin, por e një rëndësie të çuditshme kur askush nuk merret vesh në mes veti dhe vijmë këtu dhe votojmë në mënyra të çuditshme tani që një vit e gjysmë edhe më tepër. Këto janë çështje që e brengosin Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, ne mendojmë se nuk është mirë kështu. Mendojmë se nuk është hera e parë, mendojmë se është duke u përsëritur qe shumë herë. Po e përsëris, sa herë do që ky Kuvend ka votuar për të emëruar njerëz, kemi përfunduar kështu, qoftë në agjencione, qoftë në borde, qoftë në komisione. Tani ne do të votojmë ashtu si jemi marrë vesh më herët në mes veti, do të thotë, nuk jemi mbështetës të mëdhenj të këtyre çështjeve që po ndodhin në këtë mënyrë në Kuvendin e Kosovës, mirëpo një këshillë do t'ia kishim dhënë, domethënë, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Partisë Demokratike të Kosovës, mos na sillni këso farë votimesh pa u rregullua të paktën koalicioni qeverisës. Nuk është praktikë për të ardhur kësioj këtu dhe të vihet Kuvendi në pozita për emërimet të çuditshme që as ne nuk i kuptojmë pse janë kaq të rëndësishme as për Lidhjen Demokratike të Kosovës, as për Partinë Demokratike të Kosovës dhe pse nuk po arrijnë që të merren vesh për asgjë, pikërisht kur vjen çështja te emërimet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Zoti kryesues,

E nderuara ministre,

Të nderuar kolegë,

Tash e pesë herë po shqyrtohet kjo çështje dhe ne, natyrisht, si grup parlamentar edhe si parti politike jemi të shqetësuar për një gjendje kësioj me këtë organ. Tashmë po shihet që subjektet politike dhe, në veçanti dy subjektet politike që janë pjesë e koalicionit, po përpiqen që brenda këtyre mekanizmave të zgjedhin jo njerëz profesional, por njerëz politikë dhe natyrisht tashmë edhe ky institucion është një prej segmenteve të cili, për fat të keq, në vend që të kishte profesionalizëm, ka njerëz të politikës.

Zonja ministre, disa herë me të padrejtë e keni kritikuar këtë institucion, pra Kuvendin e Kosovës, disa herë me të padrejtë e keni fajësuar edhe Komisionin për Legjislacion që po pengon krijimin e këtij institucioni dhe kësaj po mbeshin një numër mjaft i madh i të interesuarve për të kryer provimin e jurisprudencës dhe kësaj ka përpjekje që i gjithë faji ose mos puna ose përgjegjësia e Ministrisë të cilës i takon ju ose të cilën e udhëhiqni të bartet në një vend krejt tjetër. Sikur e dini, kolegë, në këtë institucion një herë janë kthyer disa emra prapa, pikërisht për shkak se kanë qenë të involvuar në politikë, madje ky Kuvend e ka hequr nga kjo listë edhe një prej deputeteve të Parlamentit të Kosovës, e cila ka qenë pyetëse ose ka qenë pjesë e kësaj liste dhe ne për herë të pestë kemi në këtë listë njerëz të politikës, njerëz të afërt me partinë politike. Në këtë vend nuk është e lehtë të dihet kush ka qenë dhe kush nuk ka qenë pjesë e politikës, seriozisht po ju lusim, edhe si grup parlamentar, edhe si parti politike, në veçanti juve dy grupeve më të mëdha parlamentare, që të keni kujdes dhe të mos bëheni pengesa të krijimit të këtyre organeve të cilat janë shumë të rëndësishme edhe për funksionimin e shtetit, por janë shumë të rëndësishme në veçanti për gjeneratat e reja për të cilat gjithë ne po flasim. Po e marr të drejtën, kolegë, që pikërisht t'i fajësoj dy grupet më të mëdha parlamentare, sepse jo rrallë herë keni qenë peng ose keni penguar krijimin e këtyre institucioneve me qëllime që herë njëra, e herë tjetra të dominojnë brenda këtyre institucioneve që nuk janë pak të rëndësishme. Po ju përkujtoj edhe pse nuk ka qenë vendim i Kuvendit të Kosovës, por po përpiqem ta citoj fjalën e Kryetarit të këtij Kuvendi, i cili një herë ka deklaruar në këtë Kuvend, që njëherë e përgjithmonë duhet të ndahet ekzekutivi, duhet të ndahet gjyqësori, duhet të ndahet legjislativi. Pushtetet janë të ndara dhe me këta emra që na ofrohen këtu dhe jo vetëm këtu, nuk kemi ndarje të pushteteve, por kemi përzierje të pushteteve. Unë e kuptoj shumë drejt, ne e kuptojmë shumë drejt që partitë që janë në qeveri, partitë të cilat janë mësuar dhe kanë krijuar në këtë vend një praktikë të tillë, natyrisht e kanë interesin dhe natyrisht herë-herë mund të tallen me ne opozitën, por po e them se talljen më të madhe bëjnë me veten dhe talljen më të madhe e bëjnë me qytetarin e Kosovës në emër të të cilit thirren. Faleminderit!

KRYESUESI: Për replikë, deputeti dhe shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, e ka fjalën.

RAMË BUJA: Unë dua t'i respektoj shumë kolegët e mi të nderuar, por unë edhe 55 herë po të vij në Parlamentin e Kosovës, nuk do ta votoj një listë që nuk thotë cilësi dhe që s'respekton ligj, pavarësisht prej kujt vjen dhe si vjen, ju lutem. Unë nuk e kam hallin e koalicionit, por i interesuar si gjithë qytetarët e Kosovës që lista prej atyre që duhet t'i pyesin njerëzit për të ardhur si gjyqtarë të nesërm në gjyqësinë e Kosovës, të jenë cilësisht të nivelit të caktuar dhe të respektojnë të gjithë ligjin. Unë po ju them se këtu ka konflikte interesash dhe kjo kur cenohet ligji, unë nuk dua para ligjit ta respektoj askënd. Këtu është problemi. Unë nostalgjinë e kolegëve të mi e kuptoj, domethënë, mbasi pozicioni ynë tash e bën që ata të jenë ata më nostalgjik kur të shprehen, por megjithatë po ju them, kur shkelet ligji, unë nuk dua ta respektoj askënd para ligjit.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Adem Salihaj e ka fjalën.

ADEM SALIHAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Megjithatë, konsideroj se është shumë e dobishme që propozimet që kanë ardhur nga Ministria e Drejtësisë, sot shqyrtohen dhe debatohen këtu në Kuvend dhe kjo vjen pas më tepër se një vit që kanë filluar të vijnë propozimet e para. Ky është propozimi i pestë dhe

është një odisejadë e madhe e formimit ose mos formimit të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës. Duke marrë parasysh se është dëmtuar shumë interesi i shumë njerëzve, i shumë qytetarëve të Kosovës të cilët kanë qenë të interesuar ta japin këtë provim dhe nuk kanë mundur ta japin, ne kemi bërë edhe prononcime publike, në mënyrë që opinioni të informohet saktësisht pse nuk po formohet Komisioni për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës. Pra, mendoj se është shumë e qartë sot, është sqaruar në mënyrë shumë të qartë edhe nga kryetari i Komisionit dhe nga shefat e grupeve se cilat kanë qenë arsyet e vërteta pse ky komision nuk është formuar deri më tash? Se sa joserioze ka qenë kjo punë nga Ministria e Drejtësisë, tregon edhe fakti që propozimet na vijnë të nënshkruara edhe nga këshilltarë politikë, që është thjesht një përçmim i rolit të madh të Kuvendit të Kosovës për këtë çështje. Dhe, nëse një këshilltar politik denjon t'i dërgojë propozime Kuvendit të Kosovës, ne e shohim nivelin e përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë.

Dhe, një çështje që është debatuar shumë herë në Komision dhe, t'ju them qartë, se në Komision kemi qenë unik të gjithë anëtarët e Komisionit dhe nuk ka pasur dallime pozitive - opozitive. Ruzhdi Berisha sa e sa herë është propozuar nga Ministria e Drejtësisë dhe ne kemi konstatuar se Ruzhdi Berisha, pa marrë parasysh që i ka 13 vjet e më tepër përvojë pune, ai nuk i plotëson kushtet ligjore, sepse duhet t'i ketë 10 vjet përvojë pune të pandërprerë. Në ligj shkruan shumë qartë dhe ministria di ta lexojë ligjin, do të thotë këtu po bëhet edhe një herë një përpjekje për ta vënë në lajthitje Kuvendin, sepse ne të gjithë këtu e kemi ligjin dhe shkruan shumë qartë që duhet të ketë 10 vjet përvojë pune si gjyqtar i lëndës dhe përvoja duhet të jetë e pandërprerë. Këtu janë sjell disa vërtetime me vonesë dhe aty dëshmohet se ky person nuk i ka 10 vjet pune të pandërprerë, sepse thotë ka punuar si gjyqtar i lëndës, me përjashtim të disa muajve që ka qenë në Gjykatën Supreme të Kosovës, do të thotë ka, megjithatë, ndërprerje.

Po ashtu, edhe Fetije Sadik nuk i plotëson kushtet ligjore, nuk ka 10 vjet pune si gjyqtare e lëndës pa ndërprerë, ka 9 vjet dhe përsëri ministria e sjell këtu ndonëse është shumë e qartë që nuk i plotëson kushtet ligjore.

Pastaj ne sa herë kemi debatuar këtu në Kuvend që të mos ketë njerëz me funksione politike, që të mos ketë ndikim dikush në këtë komision, që të mos favorizohen njerëz të partive të ndryshme politike e tjera. Pra, ky Kuvend i ka kthyer prapa disa propozime, disa janë tërhequr e tjera, tash përsëri na vjen një këshilltar politik i ministrit të Punëve të Jashtme dhe ne mendojmë se nuk është korrekte kjo që po ndodh me formimin e këtij komisioni.

Nëse është kusht që ne ta votojmë listën e plotë, pa përjashtim, ne nuk do ta votojmë këtë listë, sepse nuk është qëllimi ynë që ta formojmë domosdo një komision në formë jo ligjore, sepse personat që do t'i nënshtrohen provimit të jurisprudencës para këtij komisioni, do t'i nënshtrohen para një komisioni joligjor dhe nuk do ta kenë validitetin e plotë ligjor edhe me ato diploma që do t'i marrin.

Prandaj, ne mendojmë që Ministria e Drejtësisë ka përgjegjësinë kryesore dhe të vetme për mosformimin me kohë të këtij Komisioni dhe ky Parlament jo veç që duhet ta kthejë prapë edhe një herë këtë listë, por duhet t'ia bëjë një vërejtje shumë serioze Ministrisë, sepse nuk është korrekte për qytetarët e Kosovës që një komision, për më tepër se një vit e gjysmë, nuk formohet vetëm me arsyen e thjeshtë se dikush ka interesa të caktuara që të fusë aty njerëz të caktuar edhe pse nuk i plotësojnë kriteret ligjore.

Unë, mendoj që këtu nuk kishte asgjë personale ndaj askujt, këtu del shumë e qartë që propozimet që kanë ardhur nuk janë në tërësi në përputhje me Ligjin për formimin e Komisionit për dhënin e provimit të jurisprudencës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati e ka fjalën, shef i Grupit Parlamentar.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsedavajući!

Pozdravljam vas i ministarku,

Ostali ministri nisu u prilici da ih pozdravimo.

Zaista vodimo jednu debatu pred licem javnosti i došli smo u jednu tešku situaciju gde se držimo svakako slova zakona, a na drugoj strani imamo već jedno oduglvačenje formiranja ove komisije i da svi trpe zbog toga.

Ja stvarno u ime naše Grupe mogu da kažem da smo dovedeni u jednu tešku situaciju jer sam ja i sam član Komisije za zakonodavstvo i pravosudje. Usput da se sve ovo dalje zakomplikuje i to da recimo mi, naš kandidat koji je u komisiji, mi neznamo dali postoji vremensko ograničenje, ali mi ne znamo koliko ima godina, poznajemo ga ali prilično je možda na nekoj granici isteka vremenskih sposobnosti, odnosno granice starosti, i mi zaista kao grupa nemamo jedinstven stav kod ovoga, uvažavajući razloge prethodnih kolega koji su naveli to da se trebamo držati slova zakona, možda je neko bio sprečen da svih 10 godina, poveže vezano s obinom na vreme u kojoj je bilo teško, kada gospodin Berisha možda nije mogao da stoji 10 godina, s obzirom da bio izbačen iz posla slučajno, jer ja lično poznajem uvaženog advokata. Tako smo stvarno dovedeni u tešku situaciju ali trpe mnogi kandidati, što je rekao kolega Zemaj, koji treba da budu birani.

Evo toliko. Mi nemamo ovede sada zajednički stav i, nažalost, odgovornost pada na sve, pa i na nas. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla, le të përgatitet Riza Smaka.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë kisha dashur ta thërras Kuvendin që ta marrë shumë seriozisht dhe t'i marrë parasysh së paku tri çështje. E para, është që Komisioni për dhënin e provimit të jurisprudencës nuk është duke funksionuar që një vit e gjysmë. E dyta, është se sa i përmbushin kriteret ligjore dhe profesionale anëtarët e propozuar të Komisionit dhe, e treta, është se juristët në Kosovë kanë të drejtë për aftësimin e tyre profesional praktik dhe avancimin profesional.

Tani në listë i shoh së paku dy këshilltarë politikë. Unë e kam pyetjen se a ka edhe ndonjë këshilltar tjetër politik? Dhe, nga ana tjetër, mendoj se përgjegjësia sa është e Ministrisë, po aq është e koalicionit qeverisës, gjegjësisht e grupit parlamentar, duke e marrë parasysh se, mendoj që edhe vetë shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së është dashur më herët të merret vesh për këtë çështje. Mbase duhet të presim që edhe dy kandidatë t'i propozojë PDK-ja dhe të arrihet balanca. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ju lus që kush e ka ndërmend të flasë, ta dimë sa deputetë janë, është njëfarë korrektësie në pyetje.
Deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përderisa nuk do t'i aplikojmë studimet profesionale që do të duhej të ishin studime profesionale e ta kishim tejkaluar këtë komision e këtë procedurë, me të vërtetë e tejkaluar dhe pa efekte, ne duhet ta kemi këtë komision për provimet e jurisprudencës, sepse kemi shumë gjykatës që iu skadon mandati apo edhe mosha dhe do të duhej të përtërihej gjyqësori, medoemos. Kjo është një imperativë. Mirëpo, ana tjetër, unë flas me përgjegjësinë, natyrisht, korrekte, kam qenë një periudhë anëtar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësor, nuk jam tash, mirëpo ai është një ndër komisionet më të rëndësishme dhe tepër korrekt sa i përket kësaj teme, kështu që e di se në atë komision, kur është trajtuar kjo temë, nuk e kam vërejtur as më të voglën, si të them, diferencë të kujtudo qoftë që e ka pasur ndonjë tendencë të caktuar, vetëm ka qenë në pyetje interpretimi korrekt i ligjit edhe propozimi i kandidatëve në harmoni apo në konformitet me ligjin. Këtë e shoh edhe tash. Unë angazhohem, ju lutem shkurtimisht, kësisoj që t'i japim detyrë Ministrisë së Drejtësisë ta përcaktojë listën edhe të mos të shkojë për aq kandidatë sa duhet të zgjedhën, pos dy-tre se ajo është demokratike edhe ka, për 5 minuta do të mund ta bëja një listë me emra kompetentë, ju lutem ka shumë për fatin e mirë, ka njerëz kompetentë. Nuk është fjala që nuk kemi, është fjala që kemi. Qe konkretisht, e marr Të Drejtën e Detyrimeve. Ne e kemi këtu në këtë Kuvend kolegen e cila ka libra universitare me recensione serioze e publikime, e nuk është e propozuar, është i propozuar dikush tjetër, që në krahasim me te nuk është kurrkund afër, ose e marrë të Drejtën Tregtare. Është propozuar një emër, respekt, unë ushqej respekt më të lartë për bujkun e për blegtorin e për filozofin, por flas në kontekst me temën, emër i panjohur, ju lutem, nuk ka nevojë, i di unë, por ka të tjerë që edhe nuk di që ka emra kompetent. Ky komision do të duhej të ishte i përbërë nga anëtarë serioz apo jo, se është fjala për juristët e diplomuar e që kanë një eksperiencë, e që duhet të kualifikohen të jenë gjykatës, prokurorë publik, avokatë publik.

Edhe përfundimisht, unë do të kisha propozuar që Ministria e Drejtësisë të propozojë më shumë emra, të mos të ndodhë cirkus i paprecedencë negative çfarë ishte me Gjykatën Kushtetuese, në kundërshtim me Kushtetutën e me ligjin, e me moralin etj. Propozohen, votohen, deputetët edhe në qoftë se në gjiron e parë nuk marrin vota, shkojnë në të dytën, e formojmë Komisionin edhe le të punojë Komisioni. Ju faleminderit!

KRYESES: Ju faleminderit,deputet!

I fundit për fjalë është lajmëruar deputeti Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Izgleda da nisam trebao da se javim i ja ću ipak reći nekoliko stvari koje su važne sa ovog aspekta stvaranja komisije i njenog sastava. Dakle, Komisija za davanje, odnosno za polaganje ovih ispita o kojima se govori, u ovakvom sastavu kakvom jeste, očigledno je da obuhvata nekoliko krijterijuma. Naravno da nije jedino stručni kriterijum i naravno da pitanje eksperata nije jedini krijterijum i da je očigledno da ima i političkih implikacija i etničkih implikacija i drugih.

Ja sam imao potrebe da kažem da pošto najmanje jedan od kandidata, osim ovih svojstava koje ima kao ekspert, nameće se samo po sebi da se tamo predlaže kao predstavnik jedne od zajednica. Prema tome, ako se za gospodina Ferovića predlaže

osim što je ekspert, ima se na umu ona druga koja se tiče njegoj pripadnosti jednoj od drugih zajednica, onda o tom slučaju na njega ne treba računati uopšte, zato što prdstavnici ovih zajednica vrlo dobro znaju da je tokom pravljenja glavnih dokumenata, on upravo predlagao riješenja koja su bila na štetu drugih zajednica. Ovo želim da se zna tako da, kada se predlažu komisije koje su od nacionalnog značaja, onda je pošteno da razjasnimo da ljudi koji bi navodno trebaju da predstavljaju druge zajednice, da ustvari nemaju podršku tih zajednica. Hala vam ljepa!

KRYETARI: Ju faleminderit! Dhe, në fund, ftoj ministren Nekibe Kelmendi ta marrë fjalën!

NEKIBE KELMENDI: Ju faleminderit!

Së pari, edhe një herë po e përsëris, ky nuk është komision politik, nuk është bord drejtues i ndonjë ndërmarrjeje, është Komision për lidhjen e teorisë me praktikën dhe më tepër do të duhej të përfshiheshin njerëzit e praktikës, se sa njerëz të teorisë, sepse të gjithë studentët i kanë mbaruar studimet, kanë marrë çka kanë marrë njohuri teorike, tani duhet të dëshmojnë njohuri praktike, por meqë ligji lejon që në Komision të jenë edhe njerëz të tillë me grada shkencore, duhet respektuar ligjin.

E dyta, Ruzhdi Berisha, së pari nuk është gjykatës, po e përsëris, por është avokat, prandaj ai është specialist i lëndës. Kur është në pyetje Ruzhdi Berisha, mos e vëni në lajthim opinionin publik, ju lutem. Ruzhdi Berisha ka 13 vjet e 6 muaj punë pa ndërprerë prej vitit 1971 deri në vitin 1985 dhe dua t'ju njoftoj të gjithëve atë e ka cekur edhe në CV edhe e ka prur, po quhen do farë vërtetime, por nëse ne nuk ju besojmë institucioneve tona, mos i besoni as Ministrisë së Drejtësisë. Ky ka punuar prej nëntorit të vitit 1971 gjer në qershor 1972 në Gjykatën Komunale në Dragash, në cilësinë e praktikantit. Në qershor 1972-dhjetor 1974, dhjetor 1974 – korrik 1981, korrik 1981 – janar 1985, janar 1985 –shtator 1985 në Gjykatën Supreme. Nuk ka ndërprerje asnjë ditë. Si duket, doni edhe këtë Komision ta shndërroi në sindromin e Avokatit të Popullit dhe urdhëroni shndërronin në sindrom të Avokatit të Popullit. Nëse doni ta sakrifikoni ministren e Drejtësisë për interesat e tjera, atëherë dilni publikisht dhe 120 vetë sa jeni, thoni të vërtetën dhe jo të merreni me këto çështje.

Unë edhe një herë ju them, mbaj përgjegjësi për listën e propozuar. Ligji parasheh që Ministria e Drejtësisë t'ia drejtojë Kuvendit për miratim listën për Komision të Jurisprudencës. Është e dhe një gabim që nuk e përmendi askush. Suzana Sejdiu nuk është profesor doktor, por është vetëm gjykatëse e Gjykatës Ekonomike, jo profesor doktor, nuk ka grada shkencore. Kështu është thënë këtu në propozim- profesor, doktor Suzana Sejdiu.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në sallë janë 67 deputetë.

Të nderuar deputetë, e hedh në votim rekomandimin e Komisionit. Ju e keni përpara. Të gjitha grupet parlamentare kanë anëtarë në Komision.

Regjia, përgatitet për votim. Votojmë tash rekomandimin e Komisionit.

Është kryer debati, zoti Koci. Për sqarim mundet vetëm kryetari i Komisionit, nëse ka nevojë. Debati është kryer, keni dëgjuar të gjithë debatin. Rekomandimi i Komisionit, pika e parë të miratohet pjesërisht nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, propozim vendimi i Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës me anëtarët dhe zëvendësit e tyre. Rekomandimi ka ardhur, është votuar:

Me 20 vota “për”, 13 “kundër”, u krye votimi. Kalojmë në pikën ...

Ju lutem, unë para vetes dhe ju e keni pasur rekomandimin e komisionit, të cilin e ka arsyetuar kryetari i komisionit. Është qitë në debat sipas Rregullores së Punës së Kuvendit. Të gjithë, dikush pro, dikush kundër, debate të ndryshme. Unë jam i obliguar sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, rekomandimin e komisionit tonë, të këtij Kuvendi në të cilin janë të gjithë anëtarët e grupeve, të gjitha grupet parlamentare marrin pjesë në atë komision. E kamë qitë para jush në votim dhe rezultati i votimit e konstatoj: 20 “për”, 13 “kundër”, 5 abstenojnë.

Me këta emra:

1. Rexhep Haxhimusa, kryetar i Komisionit,
2. Prof. Abedin Ferović, anëtar i Komisionit,
3. Muharrem Shala, zëvendësanëtar i Komisionit,
4. Prof.doktor Suzana Kajtazi Sejdiu, anëtare e Komisionit,
5. Meleqe Behxheti, anëtare e Komisionit,
6. Prof. doktor Mirlinda Batalli, anëtare e Komisionit
7. Prof. asistent doktor Iliriana Islami, anëtare e Komisionit.

Me këtë përfundohet pika e 9-të e rendit të ditës. Janë procedurat e kontestimit të këtij vendimi. Është Rregullorja e Punës së Kuvendit. Nëse janë bërë gabime në udhëheqje të seancës, janë procedurat sipas Rregullores dhe ju mund t’i ndiqni. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën ...

(Reagime në sallë)

Debati për pikën e kaluar ka marrë fund. Vendimi me votë është marrë. Grupi Parlamentar i PDK-së është mësuar të lëshojë seancën nga mandati i kaluar dhe mund ta lëshojnë edhe tash, po. Nuk kemi këtu kundër kurrjë. Kalojmë në ...

(Ndërpritet incizimi)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me punën e seancës. Me kërkesë të ministrit përkatës. Pikat 10 dhe 11 shtyhen pas orës 17:00. Kalojmë në pikën e 12-të të rendit të ditës.

- Shqyrtimi i Raportit të Autoritetit Rregullator për Telekomunikacion për vitin 2008,

Konstatimet hyrëse:

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ka shqyrtuar raportin e Punës së Autoritetit Rregullator për Telekomunikacion për vitin 2008 dhe ka rekomanduar shqyrtimin e tij në seancë plenare.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar pjesën financiare të raportit të punës së Autoritetit Rregullator për Telekomunikacion për vitin 2008 dhe ka rekomanduar shqyrtimin e tij në seancë plenare.

Raportet me rekomandimet e komisioneve së bashku me Raportin e Punës së ART-së për vitin 2008 u janë shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional zonjën Myzejene Selmani, ta marrë fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për dy ministrat që janë këtu dhe për këtë numër të vogël të deputetëve që janë brenda seancës. Mund të them se Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion në mungesë të Bordit të ART-së nuk e ka shqyrtuar raportin, ia ka dhënë mundësinë Kryesisë së Kuvendit e cila do të vendosë a do të dalë në seancë plenare, që do të thotë, sot të merret vendim çka do të ndodhë me atë raport këtu brenda kësaj seance. Faleminderit!

KRYESUESI: Kur është votuar rendi i ditës, ju keni pasur mundësi ta bëni këtë kërkesë. Ftoj kryetarin apo raportuesin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Po ashtu, ftoj kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. A ka dikush në emër të grupeve parlamentare? Po, Gani Koci e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

GANI KOCI: Zoti kryesues!

Mendoj se pas kësaj situatë, nuk mund të vazhdohet kjo seancë. E keni ngatërruar komplet punën e Kuvendit në këtë pjesë të punës. Prandaj, është mirë që vërtet ta vazhdojmë një ditë tjetër këtë seancë, sepse nuk mund të vazhdohet në këtë mënyrë si e keni filluar ju si kryesues i kësaj pjese të seancës.

KRYESUESI: Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, kuorum ka për ta vazhduar seancën dhe ne e vazhdojmë me pikën e rendit të ditës, është Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe normalisht në bazë të Rregullores secili grup parlamentar, pra ka kuorum për debat. Në sallë janë 48 deputetë.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Grupi Parlamentar i LDK-së në parim e përkrah këtë raport vjetor të ART-së, edhe pse përgatitjen e tij e ka bërë Bordi i ART-së, i cili megjithatë as nuk e ka nënshkruar këtë dokument dhe askush prej atyre anëtarëve nuk ka ardhur, do të thotë, as në Komision, as në Parlament ta arsyetojë raportin vjetor. Por, me qenë se është proceduar, ne e vlerësojmë që këtë raport vjetor ta aprovojmë, sepse në këtë mënyrë i përgatitur, i ka përshkruar të gjitha aktivitetet e këtij agjencioni që kanë të bëjnë me politikat në sektorin e telekomunikacionit, me gjendjen, problemet dhe me shumë çështje të cilat nuk është arritur që në këtë fushë të përmirësohet situata, në mënyrë të veçantë kur është fjala për operatorët ilegalë, për mbulueshmërinë dhe ndarjen e brezit frekuencor, me të cilën përballen qytetarët, përballen ndërmarrjet me këtë problematikë. Mendojmë që kjo në të ardhmen është njëra ndër çështjet që duhet t'i interesojë më së shumti Ministrisë përkatëse për ta zgjidhur këtë problem e në radhë të parë i takon edhe Qeverisë, por edhe këtij Parlamenti që të kompletohet dhe të procedohet me zgjedhjen e Bordit të ART-së sa më shpejtë që është e mundur, në mënyrë që ky agjencion t'i kryejë detyrat dhe funksionin për të cilin ka ndikim të madh, do të thotë, në këtë fushë të ekonomisë së vendit.

Prandaj, ne po e përkrahim, po kërkojmë që të procedohet më shpejt me zgjedhjen e Bordit të ART-së.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sa i përket kësaj pike, edhe ne mendojmë shumë ngjashëm, nuk ka bord të ART-së. Po e diskutojmë raportin që realisht nuk e dimë legalisht kush e ka hartuar dhe kush e ka sjellë. Prapë po përsëritet e njëjta gjë, sa herë që flasim për borde, për komisione, e shohim që ka mungesë të vullnetit për t' i krijuar, ka mungesë të vullnetit për t' u pajtuar mes veti. Në të njëjtën kohë mendoj se sot duhet të shënohet se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, edhe pse e ka numrin ma të madh të deputetëve, nuk e ka shumicën absolute në Kuvend dhe duhet të fillojë të mësohet se nuk e ka shumicën absolute dhe nuk mund të marrë vendime krejt vetëm qysh po pretendon. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti dhe shefi i Grupit Parlamentar Ibrahim Makolli, e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderur kolegë,

Pas kësaj gjendjeje që u krijua, natyrisht, po shihet që ka rënë edhe përqendrimi, por unë do t' i them vetëm dy- tri fjalë, sepse të tjerët nga grupet parlamentare do të flasin konkretisht për këtë raport.

Vërtet, unë po shtroj një pyetje, përgjigjen e së cilës dikush do duhej ta japë. Po flasim për një raport që për mua është ilegal, sepse është ofruar nga një autoritet ilegal i cili nuk ka fuqi. Dhe, ky Kuvend, në asnjë rast nuk guxon të trajtojë dokumentet e tilla, materialet e tilla nga organe të cilat nuk kanë mandat. ART-ja, kolegë, është një prej institucioneve në Kosovë që i ka shkaktuar më së shumti dëm Kosovës. ART-ja ka pasur një bord, i cili asnjëherë nuk iu ka përgjigjur këtij Kuvendi dhe asnjëherë nuk i ka interesuar se kush është Kuvendi i Kosovës.

Propozimi dhe rekomandimi im është që të kthehet mbrapa ky raport, të shkarkohet në tërësi Bordi i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, pra ata që kanë mbetur, që ky Kuvend ta themelojë një ekip, një grup hetues i cili do të hetojë gjithë veprimtarinë e ART-së që nga fillimi deri tash. Të gjithë ne jemi të vetëdijshëm se sa dëme i janë shkaktuar Kosovës duke toleruar operatorët ilegalë në këtë vend dhe sa mjete ka shpenzuar ky Bord në përpjekje për të mbajtur rend dhe ligj në fushën e telekomunikacionit.

Grupi Parlamentar i AKR-së nuk e përkrah këtë raport si të tillë. Grupi Parlamentar i AKR-së kërkon një vendim, një qëndrim të këtij Kuvendi në raport me Bordin e ART-së dhe është koha e fundit që Kuvendi i Kosovës të ushtrojë kompetencat e veta ashtu siç përcaktohen me Kushtetutë dhe me ligj. Faleminderit !

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, për fjalë është lajmëruar Besa Gaxherri. Urdhëroni e keni fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, vërtet, pas situatës e cila është krijuar në Kuvend, nuk besoj që ka hapësirë aq më shumë për pikën për të cilën ky raport edhe ashtu nuk e vlen për të diskutuar në Kuvendin e Kosovës, por nuk mund të kalohet pa e theksuar sot ngjarjen e cila është në Kuvendin e Kosovës, pa e parë qytetarët e Kosovës se maxhoranca nuk funksionon në këtë legjislacion.

Edhe pikërisht kemi të bëjmë me pikën konkrete që po e diskutojmë, që institucionet e Kosovës nuk funksionojnë, nuk funksionojnë, domethënë dëshmi është edhe kjo. Ne sot mund të bëjmë debat këtu pa Qeverinë për pika të cilat janë shumë të rëndësishme, pastaj unë nuk po e kam të qartë pse u tejkalua pika- Shqyrtimi i kornizës afatmesme, është e qartë, sepse nuk është prezent as Kryeministri, i cili e sheh optimizmin e 67% të popullatës në Kosovë, e 67% janë të papunë në Kosovë. Ata nuk janë sot këtu prezent për t'u diskutuar këto pika dhe ne vërtet ashtu edhe aq më shumë si opozitë nuk kemi kujt t'i referohemi dhe nuk do ta lëshojmë veten në atë nivel që dikush vërtet, në qoftë se bën shaka me vetë maxhorancën që e ka këtu, jo me opozitën.

Ky raport edhe ashtu i ka rekomandimet nga komisionet funksionale që nuk ia vlen për të diskutuar. ART-ja s'ka funksionuar që prej fillimit aq më shumë që kjo Qeveri nuk ka qenë në gjendje as Bordin ta propozojë për Kuvendin e Kosovës dhe ky agjencion ta ketë bordin.

Unë nuk dua të hyjë në këtë raport, por vërtet shqetësuese për qytetarët e Kosovës dhe për këta deputetë që janë këtu në veçanti të opozitës duhet të jetë sot kjo seancë dhe qëndrimi i maxhorancës në seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Është deputeti i dytë ose i tretë që e vë në pah shqetësimin, pra, për ta vazhduar a jo seancën. Më lejoni të nderuar deputetë.

Të nderuar deputetë, për këtë pikë të rendit të ditës i kemi dy rekomandime, pra edhe nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, të nënshkruar nga vetë kryetari Gani Koci. Pra, pika e rendit të ditës është kjo pikë e rendit të ditës, në pajtim dhe me kërkesë të dy komisioneve.

Për fjalë është lajmëruar deputeti Eset Cakolli.

ESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Shefat e grupeve parlamentare, më fal zoti Eset!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+" Xhezair Murati, më falni, ju lutem, zoti Eset!

XHEZAIR MURATI: Izvinite kolega Cakoli, samo dozvolite gospodine predsedavajući da saopštīm da mi nemamo dovoljan broj prisutnih da bismo bilo koju preporuku ili odluku doneli. Ali ovaj broj koji je tu, mi možemo da debatujemo sada o ovome, ali pitanje je samo kojeg efekta ima ako nema nijednog predstavnika Vlade, niti su tu predstavnici resornih komisija, i onda mislim da mi samo sada na neki način budemo tu, znate ona francuska „lare pour lare“, (umetnost radi umetnosti) i mi samo 'prisustvo radi prisutva'. Mislim da bi moglo da u ovoj situaciji prisutnih šefova parlamentarnih grupa, tu su većina predstavnika PDK, Aleance, LDD, potom i AKR i imamo isto predstavnike i parlamentarne grupe SLS, kao i „7+“ da se možda povučemo i da ovu situaciju ne gnjavimo nego da zajedno u razgovoru sa vama možda nađemo neki izlaz iz ove situacije. Mislim da nije potrebno da ovakav prljav veš baš iznosimo pred javnost Kosova.

Moje je mišljenje da bi trebali pozvati šefove grupa ovih prisutnih ovde i da malo možda 10 minuta porazgovaramo šta dalje, mislim da ne bismo trebali ovoliko da građane

iritiramo dalje, radi mira u kući, radi građana, radi uvažavanja, moje je mišljenje i mišljenje naše parlamentarne grupe, da bi možda mogli neki konsenzus od prisutnih šefova da napravimo.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

I dëgjuam në emër të grupeve parlamentare. E kemi edhe SLS-në që nuk është lajmëruar. Po, Bojan Stojanović e ka fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Mi iz Parlamentarne grupe SLS se slažimo sa prethodnim govornikom, znači nema potrebno da ... atmosferu. Kao i svi parlamenti, desi se da i ovde nastane određena kriza ili možda nesuglasice po određenim pitanjima koje svakako ne samo da možemo, nego i moramo prevazići, ali ja ne vidim razloga da mi nastavimo sa tom pričom zato što, prvo, nemamo kvoruma, drugo, nema prisutnih ovde da bi razmatrali mi ovaj izveštaj i sve ovo odlazi u neku praznu pričuu, čak će se se i televizijski prenos prekinuti, tako da što se nas tiče, mi to možemo i u neformalnim sastanicima i razgovorima da raspravljamo. Naravno, mi smo oko nekih rešenja uzdržani i tražimo da se ipak i konsultujemo i sa našim koalicionim partnerom, to je sigurno Poslanička grupa PDK, tako da mislim da je moj predlog da bi privremeno mogli da prekinemo ovu sednicu. Hvala!

KRYESUESI: Kemi disa propozime në emër të grupeve parlamentare që përkundër faktit se ne kemi kuorum sipas Rregullores për të vazhduar debatin për këtë pikë të rendit të ditës, kemi pra propozime që të ndërpritet kjo mënyrë e trajtimit të kësaj pike të rendit të ditës.

Unë jam i detyruar ta qes në votim. Zoti Naser, ne kemi kuorum për debat, por jo për të marrë vendime dhe për ta qitur në votim raportin. Disa shefa të grupeve parlamentare ose në emër të grupeve parlamentare kërkuar që kjo mënyrë e trajtimit të kësaj pike të ndërpritet, unë jam i detyruar ta qes në votim. Kush është që të ndërpritet debati për këtë pikë të rendit të ditës dhe të marrim pauzën 15 minuta dhe pastaj Kryetari me shefat e grupeve parlamentar të vendos.

Shkojmë pauzën 15 minuta. Faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejtimin e seancës e merr zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Parlamentit

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, e vazhdojmë debatin lidhur me Shqyrtimin e Raportit të Autoritetit të Rregullatorit të Telekomunikacionit për vitin 2008

.Fjala është për deputetin Naser Rugova. Do të thotë, deputeti tërhiqet.

NASER RUGOVA: Jo, jo, për ART po vazhdojmë pikën, domethënë.

Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar me kujdes Raportin e punës për vitin 2008 të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit dhe duke u thirrur edhe në rekomandimet e Komisionit funksional të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili thotë në mënyrë të qartë se e ka shqyrtuar Raportin e punës së ART-së për vitin 2008

përkundër konstatimit të shumë mangësive e paqartësive si dhe në mungesë të përsëritshme të pjesëmarrjes së përfaqësuesit të Bordit të ART-së për sqarime, domethënë.

Unë kam informacione dhe e kam një letër të njërit nga anëtarët e Bordit, të ART-së, i cili iu ka drejtuar Komisionit, sepse kryesuesi i këtij bordi, do të thotë, për shkak edhe të problemeve të natyrave tjera që Parlamenti dhe opinioni i di, një kohë të gjatë nuk e ka ushtruar detyrën konform Ligjit të ART-së dhe po të shohim, do të thotë, se si i drejtohet kryesuesi i këtij bordi komisionit funksional, do të thotë, këtu shihet një përgjegjësi totale, por hiq më pak përgjegjësi nuk është as Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, e cila është dashur të marrë masa me kohë që konform Ligjit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit dhe Ligjit për telekomunikacionin është dashur t'i marrë hapat konkretë në kompletimin me kohë të këtij bordi. Në fjalën e tij drejtuar kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, kryesuesi i këtij bordi, thotë: “në ndërkohë administratës i kam deleguar autorizimet përkatëse”, kurse neni 1 i Ligjit për telekomunikacionin thotë në mënyrë decidive: autoritet ligjor, domethënë autoriteti ligjor – ART-ja, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit do të mbesë në bordin e tij, do me thënë të gjitha kompetencat i ka Bordi i ART-së dhe jo administrata dhe kjo është një shkelje flagrante pa përgjegjësi.

Vendimet e Bordit, po e citoj nenin 1 të Ligjit, “do të merren në mënyrë transparente të pavarur nga ndikimet politike, industriale apo nga ndikimet tjera”. Në këtë raport shumë të dobët, që nuk i ka kaluar procedurat as të vet Bordit të ART-së, shihen edhe mangësi serioze, sidomos të dhënia e licencave, ku dyshohet për keqpërdorime marramendëse, për shkelje të ligjit, për konflikt interesi si dhe për favorizime, e mos të flasim për operimin e operatorëve ilegalë, të cilët shfrytëzojnë brezin frekuencor të Republikës së Kosovës dhe territorin Republikës së Kosovës, është fjala për operatorët 064 dhe 063. Paramendoni se sa miliona e miliona euro ka humbur buxheti i Kosovës, sa është dëmtuar, domethënë operatorët tjerë dhe Operatori i dytë i telefonisë mobile edhe Vala 900 e të tjerë, po sa është lënduar edhe konkurrenca e lirë dhe interesimi për tregun e lirë në këtë fushë të telekomunikacionit, e cila është rregulluar në mënyrë decidive me ligj. Pastaj, ky bord edhe pse jo komplet dhe e ka hartuar këtë raport, lë në mënyrën dëshirore se do të marrë masa konkrete tani pas marrjes së kompetencave nga ish-administrata e UNMIK-ut, se do të bëjë këtë apo atë. Këtu nuk bëhet fjalë për formë dëshirore se do të bëjmë, por duhet, sepse është ligji, tani jemi shtet dhe duhet të merren masat adekuate që tregu i operatorëve të telekomunikacionit, pa marrë parasysh çfarëdo natyre qofshin, të jetë i sanksionuar me norma ligjore, ekziston Ligji mbi telekomunikacionin, ekziston Bordi i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit. Çka mbetet? I mbetet Qeverisë së Republikës së Kosovës që konform Ligjit ta kompletojë, sepse dy anëtarë të Bordit ekzistues duhet të vazhdojnë, edhe për një periudhë të caktuar kohore të mbeten, ta kompletojë këtë bord dhe t'ia sjellë propozimet Kuvendit në mënyrë që kjo fushë tejet e rëndësishme, edhe politike, edhe juridike, po edhe ekonomike, që thjesht të hyjë në binar institucional dhe të dihet çka po ndodhë me telekomunikacionin në shkallë vendi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Ju lutem, unë kërkoj që vërtet e kemi shqyrtimin e Raportit të ART-së dhe këtë me rekomandimin e Komisionit përkatës, i cili thotë: “I rekomandoj Kryesisë që në Kuvendin e Republikës së Kosovës të procedojë për shqyrtim Raportin e ART-së për vitin 2008”.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në rekomandimin e tretë thotë: “Komisioni i rekomandon Kryesisë së Kuvendit që raportin ta radhisë në rend të ditës dhe në seancën plenare të Kuvendit të debatojë lidhur me këtë”. Do të thotë, e kemi raportin.

Për çështjen tjetër mendoj që të gjithë po e dimë që bordi nuk ekziston, i ka dalë afati. Ne i kemi çuar rekomandimet Qeverisë që ta plotësojë bordin. Mirëpo, sot debati zhvillohet për Raportin e ART-së dhe raportin e keni përpara. Kisha lutur që vërtetë të debatojmë në lidhje me raportin. Fjalën ia jap deputetes Muzejene Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Gjatë shqyrtimit të këtij raporti mund të shihet mjaft qartë se raporti në përgjithësi ka mangësi shumë të mëdha, nuk është raport i cili është punuar prej Bordit të

(Ndërhyrje)

....a ka mundësi ta sqaroj një moment, në rast se më lejoni ta përfundoj, pastaj, Kryetar, vazhdo ti. Unë s’po flas në emër të Komisionit, po flas në emër të AKR-së, të lutem. Unë në emër të Komisionit kam folur pak më parë. Po, Kryetar, a ka mundësi ta kryej një herë, pastaj merremi vesh...

KRYETARI: Urdhëro, po realisht ke nënshkruar diçka tjetër, e po flet diçka tjetër.

MUZEJENE SELMANI: Të lutem, a ka mundësi ta kryej, veç kur ta kryej, pastaj reago menjëherë aq ashpër.

Komisioni s’ka pasur zgjidhje tjetër, mjaft mirë ne jemi konsultuar edhe me ju për çështjen e këtij raporti. Ky raport është punuar prej administratës së ART-së, por jo prej Bordit të ART-së dhe është shënuar prej kryetarit të mëparshëm të Bordit, zotit Anton Berisha, që do të thotë se do të mbetet përgjegjësi e këtij Kuvendi a do të diskutohet në çështje thelbësore raporti, se nuk ka të bëjë asgjë rreth Ligjit të telekomunikacionit dhe punës që e dedikon Ligji i telekomunikacionit për ART-në. Me një sinqeritet shumë të madh thamë se dëmet që i ka kushtuar ART-ja buxhetit të Kosovës nuk e di a ia vlen të merremi me këtë raport a jo. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Po ju njoftoj, të gjitha raportet i bën administrata, i nënshkruan politika. Prandaj, ta keni parasysh, mendoj që edhe këtë e dini. Fjalën e ka kërkuar deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Megjithatë, si kolegët mendoj se ky raport nuk i ka plotësuar kushtet. E para, në qoftë se nuk ka bord, si mund të përpilojë raportin. Administrata e bën teknikisht, zoti Kryetar, por përmbajtja do të varet nga bordi. Domethënë, duke mos dashur të hyj në detajet e raportit për arsye se mendoj që nuk i plotëson kushtet për t’u shqyrtuar sot, edhe njëherë e thërras Qeverinë që të kryej funksionin e vet konform ligjit dhe të plotësojë ose të komplotojë bordin.

Autoriteti rregullativ është shumë i rëndësishëm në sferën e telekomunikacionit dhe e thërras edhe njëherë në përgjegjësinë e Qeverisë, kurse Kryesisë i propozoj që edhe njëherë t’ia kujtoj Qeverisë përgjegjësinë që e ka në këtë aspekt. Faleminderit!

KRYETARI: Le të më lejohet edhe mua t'u rekomandoj deputetëve që Kuvendi punon mbi bazën e punës së komisioneve. Në këtë rast, dy komisione të këtij Kuvendi i rekomandojnë Kryesisë që këtë raport ta sjellë në seancë plenare dhe të debatohet për të, kështu kanë rekomanduar. Prandaj, ju lutem, është raporti, komisionet na kanë rekomanduar, ne bisedojmë për raportin. Heset Cakolli e ka kërkuar fjalën.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar, qenka vetëm ministri Shala,

Përshëndetje për ju!

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti i Auditorit Rregullator për Telekomunikacion për vitin 2008, sipas mendimit tim ka paqartësi të shumta, mungesë të të dhënave që paraqet vështirësi të shumta për të vlerësuar punën e Auditorit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin kalendarik paraparak.

Të nderuar deputetë,

Siq jeni në dijeni, mandati i Bordit të Auditorit Rregullator të Telekomunikacionit ka përfunduar në dhjetor të vitit 2008 dhe mungesa e mandatit të anëtarëve të bordit të këtij autoriteti shumë të rëndësishëm është një vështirësi shtesë për punën e ART-së. Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit ka hartuar dhe aprovuar 9 tipa të licencave të shërbimeve të telekomunikacionit dhe deri më tani ka lëshuar gjithsej 38 licenca. Nga raporti i këtij autoriteti shihet se edhe më tutje Republika e Kosovës nuk e ka kodin e saj telefonik thirrës ndërkombëtar, ku mungesa e këtij kodi paraqet vështirësi të madhe për punën e operatorëve të licencuar, por këtë problem ART-ja e ka zgjidhur shumë lehtë duke iu dhënë mundësinë operatorëve që atë ta bëjnë me marrëveshje me shtetet tjera për shfrytëzimin e kodeve telefonike, çka nënkupton se operatorët e licencuar u paguajnë shuma shumë të mëdha atyre shteteve.

Momentalisht në Kosovë shfrytëzohen 3 kode telefonike, ai i Monakos 377, slloven 386 dhe ai serb 381. Shtrohet pyetja, si dhe sa është angazhuar ART-ja për të siguruar kodin shtetëror, i cili do të ndikonte në zvogëlimin e shpenzimeve për operatorët e licencuar dhe zvogëlimin e çmimit për shërbimet e bëra të konsumatorit. ART-ja deri më tani ka licencuar dy operatorë për telefoni fikse, por niveli i shërbimeve edhe më tutje mbetet nën nivelin e dëshiruar, sepse operatori i dytë IPKO është licencuar në vitin 2006 dhe ky operator gjatë vitit 2008 ka filluar me shërbime të telefonisë fikse dhe aktualisht operatorët e PTK-së dhe IPKO kanë gjithsej 95.462 linja të telefonisë fikse dhe ky numër më së miri tregon për gjendjen e telefonisë fikse në Kosovë. Edhe shërbimet e telefonisë mobile në Kosovë i ofrojnë dy operatorë të licencuar Vala me 890.000 shfrytëzues dhe IPKO-net me 349.000 parapagues, por edhe më tutje nuk janë të siguruar operatorë që ofrojnë shërbime kualitative me çmime të arsyeshme, sepse ka munguar konkurrenca e mirëfilltë në mes të operatorëve. Unë mendoj se për një gjendje të tillë e cila mbizotëron në telekomunikacionin e Kosovës, janë anëtarët e Bordit dhe e mbështes edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të Aleancës Kosova e Re, domethënë, nuk e përkrahim këtë raport. Ju faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe një herë dua të sqaroj, të nderuar deputetë. Raporti që po e shqyrtojmë është për vitin 2008 dhe ART-ja ka pasur mandat të plotë për vitin 2008, prandaj këtë që po e thua për mungesë të bordit, mund të thuhet për raportin e vitit 2009, prandaj mendoj që duhet të jeni pak më konkret edhe më serioz në paraqitje, se dokumenti është për vitin 2008 e jo për vitin 2009. Do të thotë, koha kur i dedikohet raporti, mandati i ART-së ka qenë i plotë me ligj, a e kanë merituar apo s'e kanë

merituar, kjo është diçka tjetër, unë nuk dua të hy në atë anë. Por, ata kanë pas mandat dhe Kuvendi i ka zgjedhur.

Vazhdojmë me fjalën. Për fjalë është lajmëruar deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po e shqyrtojmë Raportin e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit. U bë shumë fjalë rreth këtij raporti, rreth paqartësive që u paraqitën këtu nga diskutantët, ndoshta me të drejtë apo me të padrejtë, sepse sipas ligjit, agjencionet e pavarura duhet t'i raportojnë Kuvendit më së fundi deri më 31 mars të vitit në vijim. Domethënë, ne jemi duke shqyrtuar raportin e ART-së për vitin 2008 dhe mendoj se asgjë s'ka të keqe edhe pse atij bordi i ka kaluar mandati, mirëpo raporti ka të bëjë me vitin 2008, kur ai bord ka qenë në mandatin e tij dhe është i nënshkruar prej kryetarit të Bordit të ART-së, zotit Anton Berisha.

Sfera e telekomunikacionit në dekadat e fundit ka shënuar rritje të shpejtë gjithkund në botë. Ndryshimet e mëdha teknologjike në kuptimin e avancimit të kësaj industrie, posaçërisht në fushën e digjitalizimit, paraqitja e produkteve të reja, përfshirë shërbimet e bazuara në internet, teknologjitë e informacionit e tjera çështje bëjnë që telekomunikacioni të jetë një ndër shtyllat më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik të një vendi. Andaj, një qasje serioze në këtë fushë nga ana e Kuvendit dhe Qeverisë do të ishte më se e domosdoshme për të shfrytëzuar këtë segment në kuptimin e respektimit të ligjit në fuqi.

Ne e kemi Ligjin në fuqi për telekomunikacionin e Kosovës, i cili dua të përkujtoj që, duke u bazuar në Ligjin për telekomunikacionin, detyrat dhe përgjegjësitë për sektorin e telekomunikacionit në Kosovë bien mbi:

a) Minsitrinë e Transportit dhe Posttelekomunikacionit, e cila ka përgjegjësi për hartimin e politikave, po e përsëris, për hartimin e politikave për këtë sektor, duke përfshirë edhe hartimin e legjislacionit, si dhe ushtrimin e të gjitha pushteteve që janë transferuar.

b) Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit të Kosovës, i cili ka përgjegjësinë për implementimin e politikave të Ministrisë, të udhëhequra nga ky ligj, si dhe të gjitha pjesët legjislative në pajtim me këtë ligj.

Sot, pra, kemi në shqyrtim një raport të një rregullatori që ka përgjegjësi ligjore në këtë sferë shumë të rëndësishme për ekonominë e Kosovës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e Autoritetit Rregullativ për Telekomunikacionin për vitin 2008. Me këtë rast do t'i paraqes edhe vërejtjet në lidhje me dështimet e këtij bordi.

Bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për telekomunikacion, si dhe mbi politikat e sektorit të telekomunikacionit, të miratuara më 13 qershor 1007 nga Qeveria e Kosovës, ART, përkatësisht Bordi i saj deri më tash ka dështuar në përmbushjen e obligimeve ligjore, si në vijim:

1. Bordi i ART-së dhe stafi i tij prej themelimit e deri më tash kanë dështuar që ta funksionalizojnë, promovojnë dhe lehtësojnë shërbimet e telekomunikimit, siç parashihet me ligji, me qëllim të krijimit të benefitit për qytetarët e Kosovës dhe institucionet. Gjendja kaotike në këtë fushë është treguesi më i mirë për qasjen të cilin e ka demonstruar Bordi i ART-së për jo profesionalizëm, jo transparencë dhe injorim të institucioneve dhe të politikave të Qeverisë.

2. Bordi i ART-së nuk ka bashkëpunuar me Ministrinë e Transportit dhe Posttelekomunikacionit sipas Ligjit në fuqi për të kryer obligimet e veta. Bordi ka punuar duke shkelur ligjin, procedurat e caktuara, duke vepruar krye në veti dhe në dëm të zhvillimit të sektorit të telekomunikacionit, si fushë e rëndësishme me interes për qytetarët dhe interes shtetëror.

Bordi ka dështuar të bëjë ART-në financiarisht të qëndrueshme siç është e përcaktuar me ligj. ART ka dështuar si rregullator i telekomunikacionit të krijojë kushte të barabarta në tregun e telefonisë fikse dhe mobile.

ART si organ përgjegjës ka dështuar t'u qaset problemeve thelbësore, siç janë, për shembull, sot në Kosovë pas disa tentativave dhe dështimeve të shumta, si pasojë e një menaxhimi të dobët dhe me vonesë shumë të madhe, kemi dy operatorë mobilë, njëri publik –Vala, dhe tjetrin privat –IPKO, që prapë se prapë nuk e ka liberalizuar thellësisht tregun. Nuk ka ndikuar që të përdorë qasje profesionale dhe konkrete në eliminimin e konkurrencës jo legale për derisa në tregun e telefonisë mobile operojnë operatorë të Serbisë, të Malit të Zi, të Maqedonisë dhe të fqinjëve për rreth, që pajisjet e tyre, si antena të vendosura gjithandej Kosovës, ndërsa të tjera interferojnë në mënyrë të theksuar në frekuencat e dedikuara për operatorët legalë.

Me këtë rast, ART ka shkelur nenin 22, ku shprehimisht thuhet: “Asnjë person nuk do të ofrojë shërbime të telekomit duke përzier një burim të kufizuar, duke përfshirë të drejtën për të shfrytëzuar numrin e caktuar të frekuencës pa marrë licencë nga ART për të ofruar shërbime të tilla”.

Mandej, ART ka dështuar të rregullojë edhe çështjet e telefonisë fikse, për deri sa në territorin e Kosovës operon Telekomu serb dhe antenat me pajisje që operojnë ilegalisht nga ky shtet fqinj.

Bordi i ART-së me këtë çështje ka dëmtuar rëndë buxhetin e Kosovës, duke kushtuar me milionë të humbura, duke qenë prezent me një kaos në tregun e kësaj fushe dhe pakënaqësi të qytetarëve dhe të investitorëve të brendshëm dhe të jashtëm.

ART ka dështuar të hartojë planin aksionar për implementimin e politikave të përcaktuara në dokumentin e hartuar në vitin 2007. Për të improvizuar se gjëja ky bord po punon diçka, në mënyrë të paligjshme dhe në kundërshtim me politikat e Ministrisë së Transportit dhe të Posttelekomunikacionit ka prezantuar para Komisionit parlamentar funksional të Kuvendit të Kosovës një dokument të ashtuquajtur Strategjia kombëtare për rrjetin e telefonisë pa tela, domethënë plotësisht një përzierje kompetencash në punën e Ministrisë. Të gjitha këto çështje, po edhe të tjerat që nuk u përmendën, në kursim të kohës, duhet të shërbejnë në esencë shqetësimet e Kuvendit dhe të Qeverisë, përkatësisht të Ministrisë së Transportit dhe Posttelekomunikacionit, e të cilat shqetësime duhet zgjidhur në mënyrë adekuate, të shpejtë për të mënjанuar këto probleme konform zbatimit të Ligjit në fuqi.

Në fund, i rekomandojmë urgjent Kuvendit dhe Qeverisë fillimin e procedurës për emërimin e përbërjes së re të Bordit të ART-së. Ju falënderojmë për vëmendjen!

KRYETARI: Ju njoftoj se Kuvendi me kohë e ka bërë kërkesën, është çështje se vonesa ka ardhur nga pala tjetër. Vazhdojmë debatin. Fjalën e ka kërkuar deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë vetëm një dy fjalë në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Është e vërtetë që ky komision i ka rekomanduar Kuvendit që të debatojë për Raportin dhe Raporti ka dy pjesë: pjesën e veprimit, pjesën analitike dhe pjesën që i mbulon shpenzimet buxhetore. Ne, si Komision, nuk kemi mund ta shqyrtojmë as pjesën e buxhetit për shkak të mungesës së atij që duhet të raportojë para komisionit dhe t'u përgjigjet pyetjeve dhe dilemave eventuale që i kemi pasur edhe si Komision për sa i përket formës së realizimit të buxhetit për vitin 2008. Por, kjo nuk e pengon Kuvendin absolutisht që të debatojë për të dhe pastaj të dalë me rekomandime të qarta, pavarësisht a është këtu, a janë kompetentë ata që duhet t'i përgjigjen Kuvendit në raportet e tilla.

Në përputhje me atë që i është ndarë, si buxhet, këtij agjencioni, diku realizimi ka qenë 62% dhe po të ndahet në linja se ku ka qenë 100%, realizimi zakonisht është te mallrat, shërbimet dhe pagat dhe mëditjet. Ka pasur një kërkesë në komision qysh në projektimin e buxhetit për ART-në për vitin 2008, një shumë për investime kapitale prej 1.600.000 euro, që është miratuar në Komision dhe është miratuar edhe në buxhetin e këtij agjencioni në emër të blerjes së pajisjes për menaxhimin e frekuencave dhe shihet se nga kjo linjë buxhetore tash na del se është paguar diçka tjetër, po ashtu në emër të një borxhi që është mbetur më 2006 dhe 2007 dhe sipas Raportit na del se pengesë e kësaj janë pikërisht disa raporte të krijuara në mes këtij agjencioni dhe, jo vetëm këtij agjencioni, por edhe agjencioneve tjera me Zyrën e Thesarit, si zyrë për ekzekutimin e buxhetit. Vërtet, e kemi këtë problematikë në ekzekutimin e buxhetit për sa i përket agjencioneve të pavarura, në këtë rast edhe të ART-së, dhe pengesat janë pikërisht edhe te ligji që i rregullon kompetencat e këtij agjencioni – Ligji i ART-së, po edhe në Ligjin për financat publike, në mënyrë që ne kemi kërkuar edhe nga Ministria përkatëse që vërtet kjo çështje të zgjidhet, qoftë me një vendim ose propozim Qeverisë dhe miratim nga Kuvendi ose me një ligj të veçantë për mënyrën e financimit të agjencioneve që krijojnë të hyra dhe krijojnë fonde nga këto të hyra.

Duhet të ju them një fakt se ky agjencion, po ashtu edhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë elektrike për sa i përket raporteve me Zyrën e Thesarit nuk po arrin që nga 1 janar i vitit fiskal të fillojnë realizimin buxheteve të tyre pikërisht për shkak të zbrazësive ligjore dhe këtë po e bëjnë me disa memorandume, që jo gjithherë po na japin rezultate të mira dhe të pritura. Dhe, këto çështje ne kemi kërkuar që vërtet të diskutohen me përgjegjësit e ART-së, me anëtarët e Bordit, por në mungesë të tyre ne s'kemi mund t'i diskutojmë.

Prandaj, edhe në emër të Komisionit, po edhe si deputet them se kjo çështje, ju lutem, duhet të zgjidhet sa më shpejt që të jetë e mundshme, që ky agjencion të jetë efikas në punën dhe veprimin e vet.

Edhe një çështje. Ne po e diskutojmë Raportin e vitit 2008. Zakonisht, raporti i vitit 2008 nuk ka përfunduar shkrimi i tij, bile i këtij raporti në dhjetor të vitit 2008. Ligji e thotë se 3 muaj pas vitit fiskal duhet të vijë raporti. Dhe, realisht nuk ka mund të jetë nënshkruar anëtari i Bordit ose kryesuesi i Bordit i këtij... Unë i kam disa letra në emër të krytarit, në

komunikime që i kam pasur me kryetarin e Bordit të ART-së dhe, siç e dimë, kryetari ka njoftuar edhe Kuvendin, edhe Ministrinë përkatëse, edhe Qeverinë përafërsisht 2 muaj përpara se kur i del mandati, në mënyrë që të merren masa që të mos krijohet vakum në menaxhimin e këtij mekanizmi. Ajo nuk ka ndodhur, prandaj nuk është e rastësishme që ka dal edhe rekomandim i Komisionit ose i dy komisioneve që sa më shpejt të fillojnë procedurat për plotësimin e vendeve të zbrazëta të anëtarëve të Bordit të ART-së, në mënyrë që vërtet të kërkojmë dhe të adresojmë përgjegjësinë që nganjëherë po e adresojmë edhe pa adresë, ose veç po e lëshojmë në eter dhe po mbetet pa përgjigje të caktuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë një datë po e shoh këtu, është 06.04.2009. Shikuar nga kjo, Raporti ka ardhur, është bërë me kohë. Do të thotë, kjo është një.

Dy, Komisioni që po e udhëheq Gani Koci konsideroj që i ka bërë dy rekomandime, që realisht janë pa adresë sepse nuk bazohen në Raportin e ART-së për vitin 2008, por mund të adresohen për vitin 2009 dhe është rekomandimi i tretë, që është i qëndrueshëm dhe këtë po e lexoj edhe një herë: “Bazuar në pikën 1 dhe 2 Komisioni i rekomandon Kryesisë së Kuvendit që Raportin ta radhisë në rend dite në seancën plenare dhe Kuvendi të debatojë lidhur me këtë”. Dhe, çka të debatojë? Ju e dini që komisionet duhet të rekomandojnë diçka dhe rekomandimet e komisionit janë këto që janë dhe ne si Kuvend s’mund të rekomandojmë, Kuvendi i miraton rekomandimet e komisioneve ose i hedh poshtë. Do të thotë, këto janë çështje që mendoj duhet t’i kemi parasysh. E kemi diskutuesin e fundit, deputeti Zef Morina e ka fjalën.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shikuar në përgjithësi, vërtet situata në fushën telekomunikuese edhe përkundër zgjerimit edhe përkundër rritjes së kapaciteteve, të themi, numerike të abonentëve, nuk ka ndryshuar pozitivisht aq sa është dashur të ndryshojë për shumë arsye. Njëri ndër ato arsye sigurisht është edhe pengesa që ART-ja ka pasur të kryej funksionin e vet.

Në raportin të cilin na është ofruar ne për vitin 2008, e që Autoriteti Rregullativ ka pasur mandat të plotë për ta përgatitur dhe për ta menaxhuar gjatë atij viti, jo vetëm që ka mangësi, por thjesht është një raport i cili, nëse shikojmë në aspektin e përgjithshëm ose në dy fusha, që tha edhe Ganiu, ajo financiare dhe çështja tjetër që është pikërisht strategjia e vet ART-së për telekomunikacionin, ka shumë mangësi dhe ne, si komision funksional, në kohën kur na ka ardhur raporti kemi kërkuar që, së pari, para se ne të debatojmë për të, të kemi një përshkrim të thjeshtë ose një elaborim nga vetë Bordi. Bordi nuk e ka parë të arsyeshme, duke u arsyetuar se i ka skaduar mandati dhe nuk kanë të drejtë tani më të flasin për punën që, edhe në kohën kur e kanë përpiluar raportin, kanë pas mandat.

Unë mendoj që Ligji shumë qartë e thotë – bordi është zgjedh me mandat pesëvjeçar, me mundësi rizgjedhjeje. Do të thotë, edhe pse i ka skaduar mandati, nuk iu ka ndërprerë mandati.

Nëse e shikojmë ligjërisht, ata kanë ende mandat deri në momentin kur mund të zgjedhet dikush tjetër. Kështu që, duke pasur parasysh jo disponimin e Bordit për të ardhur dhe për të raportuar në komision, ne si komision nuk e kemi shqyrtuar këtë raport. Bile, unë kam kërkuar që t’i kthehet mbrapa ART-së dhe ART-ja përveç se duhet ta përgatisë si duhet,

të merr seriozisht kërkesën e komisionit dhe të vijë e të raportojë këtu. Nuk e kanë parë të arsyeshme, natyrisht, sepse në atë mënyrë e kanë lexuar edhe Ligjin dhe në një farë mënyre është e drejtë e tyre.

Është marrë vendim në Komision ta bien këtu për të raportuar, gjë që unë mendoj se nuk është bërë mirë, nuk është e drejtë, sepse absolutisht nuk është diskutuar në Komision raporti i ART-së. Atëherë, nuk di çka kemi rekomanduar ne kur ne vetë s'e kemi analizuar për vetë faktin se raporti është jo i përgatitur dhe nuk ka raportuar askush për të.

Ajo që dëshiroj të them, nuk dua ta zgjas, Raporti në mes Ministrisë dhe ART-së nuk funksionon po thuaja që katër vjet. Nuk kanë raporte të mira, gjë që është shumë e vërtetë që kanë edhe probleme, edhe vetë natyra ose infrastruktura në telekomunikacion nuk është në nivelin që duhet.

Unë mendoj që ne, si Parlament, qoftë edhe si Komision, duhet shumë shpejt ta ndryshojmë ligjin dhe vërtet të sqarohen kompetencat e ART-së dhe të Ministrisë. ART-ja e konsideron veten krejtësisht të pavarur, ndërsa ligji ndryshe e komenton, ndryshe e thotë. Këtu është edhe arsyeja pse ky raport nuk meriton, unë nuk e di edhe pse është prurë të diskutohet sot në Parlament. Kështu që unë, vërtet, edhe kryetarin e Komisionit e dëgjova parëz, por ne kemi biseduar thjesht vetëm për ta kryer një detyrë, sepse është kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që raportet të sillen në kohë sa më të shpejtë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Rregulla 47, Komisioni përgjegjës raportues, po ua lexoj pikën 5 të kësaj rregulle: “Raporti përmban propozimet e komisionit përgjegjës raportues për, të cilat Kuvendi do të marrë vendim në mbledhjen plenare, si dhe pjesën e dytë, arsyet dhe opinionet e kundërta dhe komentet e komisioneve përkatëse”. Do të thotë, ne votojmë për rekomandimet e komisioneve. Ne i kemi do rekomandime, që i lexova pak më herët.

Po, tani për fjalë është lajmëruar deputetja Synavere Rysha, le të përgatitet deputeti Ethem Çeku, i fundit.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë, në fakt, nuk desha të debatoj rreth raportit të ART-së, por megjithatë po e ndiej obligim për disa sqarime rreth formës së raportimit. Si duket, gjërat më tepër janë ngatërruar se, ndoshta, edhe nuk po duam qëllimisht t'i sqarojmë dhe t'i kemi të qarta.

Sipas Ligjit mbi menaxhimin e financave, raportimi është pjesa më e ndjeshme, raportim apo llogaridhënie. Prandaj, duhet t'i pranojmë konceptet parimisht dhe ashtu siç janë. Mirëpo, si duket, me qëllim apo pa qëllim, shpeshherë po ngatërrohen dhe raportimet në Kuvendin e Kosovës e kanë humbur kuptimin, sipas meje. Kur e them këtë, unë e bazoj në fakte. Përderisa debatojmë për një raport dhe në fund nuk e votojmë, nuk ia japim notën, për mua është e pakuptimtë, është një punë boshe që, vërtet, nuk e di a ka nevojë të debatohet, a ka nevojë të diskutohet dhe në fund të mos presim rezultate konkrete.

Kemi pasur rastin kur në këtë Kuvend kemi debatuar me orë të tëra për një raport dhe në fund nuk është votuar. Prandaj, kjo ka humbur kuptimin. Ajo punë disaorëshe që është bërë, është hedhur, domethënë është e barabartë me zero.

Ne, vazhdimisht po flasim për transparencë, për llogaridhënie, në fakt kjo nuk po ndodhë. Rasti konkret, unë pjesërisht do të pajtohem me Kryetarin e Parlamentit, kur thotë se komisionet nuk e kanë bërë punën e vet. Është shumë e vërtetë se Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Energjetikë, Transport, Telekomunikacion nuk e kanë bërë punën e vet sepse, fundja, janë komisionet ato që duhet t'i kanalizojnë gjërat. Mirëpo, këtu na kanë ardhur disa, sikur që po na ndodhë shpeshherë, po na vijnë raporte dhe rekomandime aq të ngatërruara, sa edhe seanca nuk po di çfarë të veprojë me to.

Komisionet në fjalën nuk po merren drejt me raportet dhe po bien rekomandime vetëm sa për të thënë se u rekomandua diçka. Në fakt, këtu duhet të jenë gjërat e qarta. A është punuar drejt në atë ministri, apo nuk është punuar, a është punuar drejt në atë institucion, apo nuk është punuar, sepse raportimi është llogaridhënie dhe në bazë të asaj edhe këtu çështja kush duhet të raportojë është një çështje shumë e qartë dhe shumë strikte. Raporton menaxhmenti, raporton ekzekutivi, raporton ai që vërtet e ka bërë atë punë brenda një viti. Mirëpo, forma përmes kujt do t'i dorëzohet Kuvendit, është një çështje shumë dytësore, mendoj. A do ta bëjë atë përmes bordit, a do ta bëjë përmes komisionit apo këshillit – këshillëdhënës, sepse bordi në këtë rast luan rolin politik, më tepër, apo ka karakter të hartimit të politikave, ndërsa ekzekutivi është ai që duhet të raportojë. Prandaj, duhet t'i heqim këto dilema dhe të jemi shumë konkret në këtë rast.

Ajo që është shqetësuese, e thashë edhe më herët, po e potencoj, kur me orë të tëra po debatohet dhe në fund nuk po vihet te rezultati konkret. Dy komisionet nuk është dashur të na bien raportin në këtë formë. Është dashur të na bien rekomandime se në ART është punuar drejt apo nuk është punuar, mandej seanca të ketë të drejtë. Dhe, në momentin kur ky raport të hidhet në diskutim, të votohet dhe nuk e merr notën kaluese, domethënë nuk miratohet, automatikisht ai menaxhment duhet të japë dorëheqje apo duhet të iniciohet procedura e shkarkimit. Mirëpo, duke pasur parasysh që në këtë rast po shihet se Qeveria nuk është e gatshme të merret drejtpërdrejt me problemin vetëm për të bërë zhurmë, prandaj po na ndodhin këto gjëra në Kuvendin tonë.

Unë, parimisht nuk jam që raportet vetëm të diskutohen dhe të mos e marrin notën e vet, goftë pozitive apo negative, pavarësisht se si do të vlerësohen, por defekti megjithatë është te komisionet përkatëse që nuk po e bëjnë punën e vet, mandej këtu shpeshherë po debatojmë ndryshe, po flasim ndryshe dhe kur është puna për të votuar, po votojmë ndryshe. Mua po më duket kjo më tepër një maskë po i bëhet këtij Kuvendi, sepse me diskutime ne nuk po e përkrahim, por kur po është puna te votimi, po e votojmë. Ky është një absurd i llojit të vet, prandaj parimisht ne duhet t'i heqim këto dilema, të jemi më konkret dhe të veprojmë konform Ligjit mbi menaxhimin e financave dhe të jemi shumë real. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë duhet përsëri me Rregullore, sepse unë jam i obliguar me Rregullore të punoj, jo qysh kam qejf unë.

Rregulla 22, rendi në mbledhje të Kuvendit. Paragrafi 5, nën shkronjën g) në fund të diskutimeve propozuesi i projektligjit ose i mocionit përmbajtjesor ka të drejtë të përgjigjet dhe pastaj Kryetari i Kuvendit e mbyll debatin. Në këtë rast, ne nuk kemi rekomandime që do të duhej t'i votonim. Realisht, nuk kemi votime.

Çështja tjetër, këto rekomandime kështu qysh kanë ardhur, kanë ardhur nga komisionet, ku bëjnë pjesë deputetët e të gjitha grupeve parlamentare dhe të gjithë deputetët e grupeve parlamentare, që janë në dy komisione, janë pajtuar me këto rekomandimet që

janë, që në fakt s'janë rekomandime. Fjalën e ka kërkuar deputeti Ethem Çeku. Replikë Muzejene Selmani. Urdhëroni, Muzejene.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar!

Me sa më duket, shumë rekomandime të komisionit apo rekomandime të autoriteteve rregullative të pavarura që vijnë në seancë plenare, nuk lexohen me vëmendje.

Të them shumë sinjerisht se Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në rast se lexohet në fillim, në bazë të rregullave numër 36 dhe 46 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, më 26.05. 2009 e shqyrtoi Raportin e ART-së për punën gjatë vitit 2008 dhe përkundër konstatimit të shumë mangësive dhe të paqartësive, si dhe në mungesë të përsëritshme të pjesëmarrjes së përfaqësuesve të Bordit të ART-së për sqarime, komisioni nxori një rekomandim t'i drejtohet Kryesisë. Nuk e di kush është organi më i lartë në rast se Komisioni ia drejton përfaqësimin drejt Kryesisë, a të vendoset në rend dite, a jo. Unë nuk e di çka po flitet në Komision e çka s'po flitet, kur ne kemi bashkëbiseduar në lidhje me këtë raport të ART-së me të gjithë përfaqësuesit brenda Kuvendit çka do të bëjmë me të, për arsye se Bordi nuk vinte në mbledhje të Komisionit. Nuk është lehtë të merren akuza për njerëzit të cilët i kanë përfaqësuesit brenda komisionit. Është e drejtë e secilit të flet çka të dojë, por arsyeja është krejt tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Kryesia e Kuvendit nuk e luan rolin e seancës së Kuvendit, ta keni parasysh këtë. Diskutuesi i fundit për sot, për këtë çështje, është deputeti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, Kryetar!

Debati po merr ndonjëherë edhe disa nuanca të cilat nuk po mund të sqarohen realisht se si kanë shkuar punët në Komision. Unë flas tani edhe si nënkryetar i Komisionit. Unë kam qenë njëri nga ata të cilët kanë kërkuar që raporti të sillet në Kuvend për debat dhe kam kërkuar për arsye se ky raport i ART-së ka mbetur një kohë të gjatë në Komision dhe kemi bërë përpjekje që ta sjellim për ta diskutuar dhe kemi disa nga ato rekomandime për të cilat Kuvendi ose e jep anën pozitive, ose anën negative. Prandaj, mungesa e bordit ka qenë një nga..., Kryetar, nuk mund ta eliminojmë. Do të thotë, në qoftë se bisedohet çështja e një raporti, duhet të ekzistojë edhe mekanizmi përgjegjës, që është në këtë rast bordi. Dhe, është krejtësisht e pakuptueshme se si nuk mund të themelohen dhe të funksionalizohen bordet, kur e dimë se këto borde me veti bartin çështjet zhvillimore, çështjet më të rëndësishme. Por, unë nuk dua të ndalem këtu, sepse kjo është përgjegjësi e ministrive dhe e Qeverisë. Mirëpo, si Komision që e kemi mbështetur, që ky dokument sot të jetë në diskutim në Parlament dhe deputetët të marrin qëndrim a e votojmë apo nuk e votojmë Raportin që ka të bëjë me vitin 2008. Do të thotë, është dërguar tek ju që të diskutohet dhe të merret një vendim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Realisht, debati mori fund. Sipas rekomandimeve të Komisionit, mund të them që ne e kemi vetëm një rekomandim për ta votuar dhe ky është rekomandimi i dytë i Komisionit për Ekonomi dhe Financa. Komisioni i rekomandon Kuvendit dhe Qeverisë që të fillojë procedurën për emërimin e përbërjes së re të Bordit të ART-së për shkak të skadimit të mandatit të tyre. Do të thotë, ky është një rekomandim që ne mund ta votojmë dhe Qeveria ta plotësojë Bordin. Atëherë, ftoj Komisionin për Buxhet dhe Financa, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë, tash:

Mirë. Regjia e ndërpret. Votojmë rekomandimin e dytë të Komisionit për Ekonomi dhe Financa. Po ua lexoj edhe njëherë: “Komisioni rekomandon Kuvendit dhe Qeverisë që të fillojë procedurën për emërimin e përbërjes së re të Bordit të ART-së për shkak të skadimit të mandatit të tyre”. Do të thotë, vetëm këtë. Ne, sipas Rregullores mund ta votojmë, diçka tjetër për të votuar nuk kemi.

(Reagime nga salla)

Jo, jo është mbyllur debati. Urdhëro! Besa Gaxherri e ka fjalën!

BESA GAXHERRI: Për të mos u zgjatur tash biseda, nuk kemi ne nevojë të bëjmë amulli rreth këtij raporti dhe problemit të funksionimit të ART-së. Nuk është më krejt çështje teknike e diskutimit të raportit, zoti Kryetar! Problemet janë në mosfunksionimin e këtij organi edhe atë rekomandim që po e theksoni ju, fundi i fundit, atë e sanksionon ligji. Por, edhe rekomandimet e Komisionit në bazë të debatit, munden shumë shpesh të rrëzohen dhe të lind një propozim tjetër që është ndoshta më i fuqishëm. Në këtë radhë, rekomandimi shkoj e nuk shkoj, ajo është vonuar në zbatimin e ligjit, është vonuar edhe Qeveria, edhe ART-ja, edhe Kuvendi. Por, raporti qitet në propozim, a votohet a nuk votohet, dhe realisht duhet të marrim përvojë. Raportet diskutohen për problematikën, jo për çështjen teknike a është në nivel raporti a nuk është në nivel raporti. Problemet janë në ART, nuk janë zgjidhur, më 2003 është themeluar ky Agjencion, zoti Kryetar! Tash është e 2009-ta. Raporti i parë është që po diskutohet në Kuvend, më duket edhe më 2006 na ka ardhur një gjysmë raporti, edhe një gjysmë raporti në vitin 2006. Dhe, këtu është problemi, andaj ne duhet të sugjerojmë që Bordi duhet urgjentisht të zgjedhet, por raporti të qitet në votim. Nëse duhet të votohet, votojeni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Votojmë rekomandimet e komisioneve. Rregulla 47, edhe një herë po ua lexoj. Komisioni përgjegjës raportues, pika 5 e kësaj rregulle thotë: “Raporti përmban propozimin e komisionit përgjegjës raportues për të cilën Kuvendi do të marrë vendim në mbledhjen plenare, si dhe pjesën e dytë, arsyet dhe opinionet e Kuvendit dhe komentet e komisioneve përkatëse”. Ne realisht, sipas kësaj rregulle, ne votojmë rekomandimet e komisioneve. Urdhëro, Sabri. Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Më falni kolegë që dola këtu, por po më duhet pak të shihem me të gjithë. Zoti Kryetar, këtu evidencat dihen, deputetët i dinë, por nganjëherë edhe donë t’i bëjnë pak të paqarta edhe sendet që janë shumë të qarta. Në princip, kur votohet në Kuvend një raport, ekzistojnë zakonisht dy komisione themelore që raportojnë ose propozojnë amendamente, rekomandime që do të duhej të votoheshin. Në këtë rast, nuk kemi esenciale, ndonëse kemi sugjerime.

Zonja e Komisionit për Ekonomi dhe Tregti e tha, por kanë hezituuar. Këta thonë që ka shumë probleme. Nëse ka shumë probleme dhe nuk donë t’i shkruajnë në formë rekomandimesh, është seanca ku diskutohen thellësisht dhe brenda seancës ka mundësi të ndërtohen rekomandime, askush nuk e ndalon. Pra, ata sugjerojnë që ka, përkundër konstatimit të shumë mangësive, të paqartësive, mungesë, përsëritje e tjera, e tjera, që është një mal dyshimesh. Mirëpo, rekomandim Kryesisë, i thonë, që është rekomandim procedural, që nuk ka nevojë t’i bëjë Komisioni hiq, se dihet se ajo kalon, thotë, kaloni në seancë. Edhe tjetri komision, të cilin e udhëheq dhe unë e di që e udhëheq, di ta udhëheq Koci, prapë ka abstenuar totalisht. Tri pika që i bën Koci, nuk kanë të bëjnë me diskutimin e kësaj materie hiq. Në të parën thotë, nuk e kryen punën rreth buxhetit, se mungojnë personat kompetentë, thotë Koci. Në të dytën thotë se duhet të zgjidhet

Bordi, se i ka kaluar detyra. Ajo është punë ligjore. Në të tretën thotë, kur t'i mblidhni këto dy të parat, i thua Kuvendit, Komisioni i rekomandon Kryesisë që raportin ta radhisë, që është prapë procedurale. Të dy komisionet nuk japin kurrëgjë esenciale, kthehen procedura ...elementar dhe Kuvendit ia kanë lënë punën çelur totalisht, unë kështu e lexoj. Kjo hetohet qoftë edhe me formulimin e temës. Lexoni mirë, formulimi i temës në rend dite nuk thotë më - votim i rekomandimeve të Komisionit, por thotë - shqyrtim i raportit. Shqyrtim i raportit të Auditorit Rregullator për Telekomunikacion, jo shqyrtim i rekomandimeve. Pra, nuk është që nuk është parë kjo saktë, që rekomandime esenciale nuk ka. Unë kisha kaq për t'u bërë i qartë edhe me ju, kolegë të nderuar. Pra, çka shoh unë dhe nuk dua të bisedoj tutje. Unë shoh një hezitim të çuditshëm të deputetëve që të bisedojnë esencialisht për këto probleme. Është punë e tyre. Nuk jam unë që ju them - bisedoni. Por, nuk është mirë hezitimet të kthehen në abstenime të çuditshme duke u përpjekur të bëhen analiza të teksteve, se nuk ka çka bëhet analizë teksti.

Zotëri, njeri prej ministrave i tha dy tri fjalë, tjetri prapë, eks-ministra i thanë dy tri fjalë. E vërteta e madhe është se gjatë gjithë punës të këtij mandati, të këtij enti rregllativ, ka pasur tre ministra, të tretë rend janë ankuar që nuk po bashkëpunojnë mirë me këtë. Kjo është e vërtetë. Nëse nuk është kështu, dilni e thoni se nuk është kështu. Tre deri tash kanë qenë. Pse nuk kanë punuar mirë, unë nuk di. Po, unë e di një gjë, që ky Kuvend, qoftë në legjislaturat tjera, qoftë ky që ka ndërruar pamjen e vet, e ka të drejtën që t'i thërras edhe ministrat, edhe eks-ministrat, se i kemi brenda në Kuvend, dhe të thotë, ngadalë zotërinj, çka qenka ky hezitim të mos bëhen transparente këto mospajtime, sepse edhe eks-Qeveria dhe e tashmja, edhe Komisioni i ART-së ose emri nuk është me rëndësi, enti i ART-së, i përgjigjet njësoj këtij Kuvendi, sepse i ka zgjedhur edhe ata, edhe ministrat, eks-ministrat dhe ministrat e tashëm.

Unë, edhe një gjë duhet ta them. Jam në tri legjislatura. Ky bord si i tërë nuk ka punuar kurrë, dhe ju e dini mirë, ministrat dhe eks-ministrat kanë ... anëtarët e bordit, kanë punuar dy-tre vet. Njëri ka shkruar non -stop letra kundër të tjerëve dhe këtë histori e dini dhe këto duhet ta thoni ju, ministra. Unë këtu e mbarova këtë diskutim. Mendoj që është thirrje për sqarime, mos hezitoni, mos flisni me figura. Nëse Kuvendi sot nuk është i gatshëm ta analizojë deri në fund, le ta rilexoj dhe vazhdon diskutimi. Ky është propozimi im. Deputetët, le të bëhen të ndershmë e të thonë, ngadalë se edhe nuk e kemi lexuar bash mirë dokumentin, turp nuk është, Kuvend është ky, vazhdon diskutimi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju Faleminderit! Ne punojmë mbi bazën e një Rregulloreje të punës që e kemi në fuqi. Rregulla 41 për funksionimin e Kuvendit, po e lexoj një pjesë. Dëgjoni ju lutem: "Komisionet kanë për detyrë t'i rekomandojnë Kuvendit vendimet përfundimtare që kanë të bëjnë vetëm me çështjet ose me punët që u janë dërguar atyre apo për pyetjet që lidhen drejtpërdrejtë me ta".Kjo është Rregullorja e Punës së Kuvendit. Unë punoj mbi bazën e kësaj rregulloreje. Nuk ka rekomandim, atëherë kalojmë në pikën tjetër.

Pika e radhës:

- **Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010-2012.**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin dhe menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ka hartuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010-2012.

Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Integritet Evropian kanë shqyrtuar Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010-2012 dhe kanë rekomanduar për shqyrtim në Seancën plenare.

Raportet e komisioneve dhe Korniza afatmesme e shpenzimeve për periudhën 2010-2012 u janë shpërndarë deputetëve. Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë ta arsyetojë Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Urdhëro!

(Reagime)

Ju lutem, deputetë, ta dini se nesër e kemi Raportin e Qeverisë për vitin 2008. Këtë pikë mund ta vazhdojmë të shtunën, në orën 10:00. Vazhdoni, ministër! Pas fjalës së ministrit, mund të votojmë a duam të vazhdojmë sot apo të shtunën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Kam nderin dhe kënaqësinë që para jush të paraqes Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010-2012. Kjo është hera e parë që një Qeveri e Kosovës, në këtë rast Qeveria e Republikës së Kosovës, i dërgon Parlamentit një dokument të tillë, për diskutim apo aprovim, që në fakt sipas nenit 19 të menaxhimit të financave publike, është hera e parë, pra, deri më 15 prill të çdo viti kalendarik, Qeveria duhet t'ia dorëzojë Kuvendit Kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitin e ardhshëm fiskal, si dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme fiskale sipas periudhës buxhetore.

Të nderuar deputetë,

Jam i sigurt se të gjithë ju e dini se nevojat e qytetarëve të Kosovës janë të shumta. Po ashtu, ju e dini se nevojat dhe mundësitë për të përmbyllur me sukses, kërkojnë një angazhim maksimal të të gjithë neve. Andaj, për fillim po them që kjo kornizë afatmesme e shpenzimeve është përpjekur të bëjë një balanc të arsyeshëm dhe të mundshëm në mes të nevojave dhe mundësive fiskale të Qeverisë së Kosovës.

Qeveria e Kosovës, pas diskutimeve të shumta që ka pasur me të gjitha organizatat buxhetore, si dhe me aktorët tjerë të rëndësishëm për këtë aktivitet, është dashur të marrë një vendim jo të lehtë lidhur me atë se cilat nga fushat tona që do t'ju jepet prioritet. Ky dokument, shikuar në tërësi, si i tillë, në detale elaboron prioritetet e Qeverisë së Kosovës të cilat janë në linjë me Deklaratën e Republikës së Kosovës, përkatësisht të Qeverisë së Kosovës, të aprovuar një vit më parë, që është në harmoni edhe me Programin e Qeverisë së Kosovës dhe me prioritetet e Qeverisë së Kosovës.

Është e rëndësishme të thuhet se pikënisja e prioriteteve të Republikës së Kosovës është zhvillimi i hovshëm dhe i qëndrueshëm ekonomik i vendit me norma të larta të rritjes dhe punësim të qëndrueshëm. Pa diskutim se kjo qasje në masë të madhe do të përmirësonte kualitetin e jetës të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe do të mundësojë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Kjo kornizë e politikave dhe e shpenzimeve publike, konsideroj se i përmbush nevojat kryesore të të gjitha organizatave buxhetore dhe këtë e bën në mënyrë që demonstroi po ashtu përgjegjësinë fiskale ndaj atyre që

bëjnë sigurimin e resurseve për financimin e këtyre nevojave, përkatësisht bën sigurinë fiskale dhe të nevojave të domosdoshme të tatimpaguesve të Kosovës.

Në të njëjtën kohë, ky dokument merr parasysh obligimet tona ndaj çdo pale që është e interesuar ta ndihmojë Kosovën në rrugën e saj drejt zhvillimit dhe integritetit evropian.

Ne duhet të ballafaqohemi me faktin se jemi, po ashtu, të mbikëqyrur, të vëzhguar dhe mbase edhe të varur nga komuniteti ndërkombëtar. Në tërësi, ky dokument është i ndarë në katër pjesës. Pjesa e parë përcakton politikat prioritare të Qeverisë, pjesa e dytë kornizën makro-fiskale, e treta paraqet raportet ndërqeveritare, përkatësisht të niveleve qeverisëse, lokale dhe qendrore dhe e katërta paraqet prioritetet sektoriale.

Në kuadër të pjesës së parë, në mënyrë të përgjithësuar paraqesim gjendjen aktuale në të cilën ndodhet vendi ynë dhe më pas ofrohen informata mjaft detale se si ne kemi arritur deri tek prioritetet kyçe për periudhën të cilën e mbulon ky dokument.

Në kuadër të kësaj pjese, edhe njëherë rikonfirmohen prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të diskutuara dhe të aprovuara vitin e kaluar. Këtu po iu referohem katër shtyllave kryesore, të cilat tanimë besoj se janë të njohura për të gjithë ju, por më lejoni t'i përsëris edhe njëherë: rritja ekonomike, e cila përfshin, pra, investimet sektoriale publike, implementimi i statusit, pra implementimi i implikimeve, qofshin institucionale, qofshin buxhetore që dalin nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, qeverisja e mirë dhe stabiliteti social.

Përderisa në këtë pjesë ne shkurtimisht i elaborojmë këto fusha prioritare, në pjesën në vijim secila nga këto prioritetet janë shpjeguar hollësisht. Siç e thashë edhe më herët, pjesa e dytë do të bëjë me projeksionet makro-ekonomike, makro-fiskale. Këtu, duke u mbështetur në të dhënat statistikore, si dhe në supozimet tona mbi atë se si do të performojë ekonomia në të ardhmen, kemi bërë projeksionet e indikatorëve kryesor ekonomikë dhe fiskalë.

Rëndësia e kësaj pjese makro-fiskale qëndron në faktin se ajo ofron bazën për vlerësimin e nivelit të gjerë në të cilin mund të financohen politikat prioritare të Qeverisë dhe do të shërbejnë si bazë për zhvillimin e procesit afatmesëm buxhetor.

Përgatitja e këtij dokumenti është bërë në kohën kur kriza globale financiare ka përfshirë edhe regjionin, duke mos përjashtuar edhe përfshirjen më serioze edhe të Republikës së Kosovës.

Duke qenë se jemi një ekonomi e vogël dhe e hapur ndaj ekonomisë globale, patjetër se projeksionet tona reflektojnë edhe ambientin e tanishëm global ekonomik. Përkundër kësaj, gjatë periudhës së projektuar 2009-2012 presim që shkalla mesatare e rritjes reale të bruto produktit vendor do të jetë prej 5.1%. Përderisa mendohet se sektori privat do të jetë bartës kryesor i kësaj rritje të projektuar, në të njëjtën kohë një kontribut të mirë në këtë rritje pritet të japë sektori publik përmes investimeve të fuqishme të projekteve publike, i cili do të ndikojë në ngritjen e produktivitetit të secilit sektor veç e veç.

Kur flasim mbi projeksionet ekonomike të vendit tonë, është mirë që këtë ta shohim nga kontesti rajonal, pra të shohim se cilat janë projeksionet e vendeve rajonale dhe si ato interferojnë në zhvillimet tona ekonomike.

Përveç Shqipërisë, që për vitin 2009 ka projektuar një rritje ekonomike jo më të lartë se 0,4%, të gjitha vendet tjera të regjionit pritet të kenë një rritje, përkatësisht një zvogëlim prej -2 deri në -3%. Nuk e besoj se e keni në material, por përafërsisht në këtë grafikoni është Bosnja e Hercegovina -3; Bullgaria -2; Kroacia -3; Maqedonia -2; Mali i Zi -3; Serbia -2, është e vetmja Kosova që pritet të ketë një rritje ekonomike rreth 4,1%, në vitin e ardhshëm dhe në mesatare rreth 5% në tri vitet e ardhshme.

Kam edhe shtete të tjera, por nuk dua t'ju lodhi, siç është Gjermania -5,6; Japonia -6,2; Franca -3; Britania e Madhe -4,1 e tjerë. Në kuadër të kësaj pjese, të nderuar deputetë, ju mund të gjeni po ashtu një analizë, ku efektet e mundshme të disa variablave me rëndësi, nëse ato do të ... ndryshe nga skenarët e veçantë, sidomos të ndikimit të ekonomive regjionale dhe atyre evropiane, ku dihet se Kosova është një vend i importit dhe rreth 35% të shkëmbimit tregtar bën me shtetet e Unionit Evropian dhe pjesën tjetër me shtetet e regjionit, sigurisht që ndikimet e tyre do të jenë të ndjeshme.

Në skenar të mundshëm kemi paraparë po ashtu skenar mjaft konservativ, gjithnjë me qëllim që Buxheti i Kosovës, përkatësisht ne si Qeveri e Kosovës të jemi të sigurt, që në atë që planifikojmë, të jemi të qëndrueshëm ekonomikisht dhe të zbatueshëm praktikisht.

Kemi bërë ca simulime, sidomos në projeksionin e të hyrave nga qytetarët e Kosovës që jetojnë në botën e jashtme, përkatësisht nga remitencat, të cilat reflektojnë një ulje për vitin 2009 për 7%, një skenar i mundshëm. Fatmirësisht, deri më tani nuk kemi shënime nga Banka Qendrore që ka një rënie të remitencave, megjithatë ne kemi paraparë, gjithnjë me qëllim të projeksioneve tona të sigurt, një rënie prej 7%, por edhe me këtë rënie prapë një qëndrueshmëri e zhvillimit të GDP-së është rreth 4,1%.

Nga 942 milionë euro, sa ishin të hyrat totale në vitin 2008, ne presim që në fund të vitit projektues 2012, këto të hyra të arrijnë shumën prej 1 miliardë e 132 milionë euro. Ne terma relativ, këto projeksione do të realizohen në të hyra totale në vitin 2012, krahasuar me vitin 2008 për 20,2% më të larta, ndërsa në kuadër të të hyrave totale, ne presim gjatë periudhës projektuese të hyra tatimore vendore prej 29% më të larta.

Përkundër zvogëlimit të normave të tatimit që janë për 50% në mesatare të zvogëluara dhe përkundër ambientit të vështirësuar ekonomik në përgjithësi dhe atij global, në vitin e parë, pra në vitin 2009, presim një rritje të të hyrave buxhetore prej 6%. Në anën tjetër, të dalat buxhetore janë paraparë të rriten në vazhdimësi. Çka është më e rëndësishmja, ne kemi projektuar rritje të vazhdueshme të investimeve kapitale, ndërsa në anën tjetër shpenzimet rrjedhëse në përgjithësi respektojnë rregullën fiskale të pajtuara me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Sa i përket investimeve kapitale, në vitin 2012 ato priten të arrijnë shumën prej 465 milionë euro, që krahasuar me vitin 2008, është një rritje prej 34%. Ashtu si deri me tani, një pjesë e konsiderueshme e këtyre mjeteve pritet të investohen në infrastrukturën rrugore, në sektorin e energjisë, të arsimit, bujqësisë, shëndetësisë...

(Kryetari: regjia, ia vazhdoni ministrit fjalën)

... vlen të theksohen edhe analizat sektoriale. Qëllimi kryesor i këtyre investimeve masive, është që të krijojmë kushte më të mira për tërheqjen e investitorëve privat dhe rregullimin e jetës së qytetarëve të Kosovës.

Sa u përket shpenzimeve rrjedhëse, ato janë projektuar të kenë një rritje shumë më të vogël se sa shpenzimet kapitale dhe kjo plotësisht është në përputhje me prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës se do të bëjmë çmos për të kursyer në këto kategori, në mënyrë që të krijojmë hapësirë më të madhe për investimet e projekteve kapitale. Dua t'ju informoj që vetëm këtë vit, me aprovimin e buxhetit ne kemi zvogëluar mallrat dhe shërbimet në 15% në nivel qendror dhe 10% në nivel lokal.

Pjesa e tretë e kornizës afatmesme elaboron qasjen e Qeverisë ndaj ndarjeve buxhetore për aktivitete që menaxhohen nga komunat dhe, vetëm një fjali në këtë rast. Raportet e niveleve të qeverisjes lokale me atë qendrore, në tërësi respektojnë Ligjin mbi financat e pushtetit lokal. Shikuar në tërësi, grandit i përgjithshëm për vitin 2010 është rritur pothuaj për 11% në raport me buxhetin e vitit 2009, ndërsa financimi total për komunat është projektuar të rritet për 12%.

Prioritetet ndërsektoriale: Pjesa e katërt paraqet, siç e thashë, prioritetet ndërsektoriale. Më lejoni të theksoj se Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, siç e dini shumica prej jush, është vetëm koordinuese në mes të prioriteteve dhe punës që bëhet për të hartuar një kornizë apo një buxhet, ndërsa ministritë përkatëse janë ato të cilat rangojnë dhe veprojnë konform prioriteteve që i kanë në spektrin e vet. Gjatë hartimit të këtij dokumenti, ne natyrisht që kemi pasur parasysh edhe sfidat të cilat do të mund të paraqiten gjatë viteve në vijim. Ndër të tjera do të përmendja vetëm disa: mjedisin ekonomik botëror, situatën në sektorin e energjisë, si dhe natyrisht shërbimin e borxheve ndërkombëtare, që Kosova si shtet duhet t'i ketë parasysh.

Anëtarësimi ynë në Bankën Botërore dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar, natyrisht, paraqet një shans tonën për të financuar deficitet buxhetore dhe projektet, por në të njëjtën kohë paraqet edhe një obligim tonin për shërbimet ndaj borxheve që ka pasur Kosova në vitet e kaluara. Andaj, të gjitha janë të paraqitura edhe në Kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Duke marrë parasysh të gjitha shpenzimet e rregullta të cilat janë planifikuar në këtë dokument, si dhe nevojën për të financuar një numër aktivitetsesh që deri më tani nuk kanë qenë pjesë e buxheteve të rregullta, Kosova mund të ketë një deficit buxhetor të projektuar për vitin 2009 si dhe për vitet tjera në vijim. Për mbulimin e këtij deficiti të projektuar buxhetor, ne parashikojmë të shfrytëzojmë një pjesë të bilancit bankar që kemi në dispozicion, si dhe rezultatet e nënshpenzimeve nga vitet e kaluara si dhe, siç e thashë edhe më herët, mundësinë e marrjes hua ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare. Po ashtu, ne presim që të gjitha projeksionet e ndihmës buxhetore nga donatorët të realizohen konform planeve tona. Për të mos e zgjatur, unë, të nderuar deputetë, konsideroj që në materialin që ju kemi ofruar, është paraqitur në mënyrë të detajuar për secilin sektor, çdo element. Sigurish që Korniza afatmesme e shpenzimeve është një prognozë. Ne kemi qenë mjaft konservativ në parashikimet tona, megjithatë prapë konsideroj se të gjitha nevojat e shtetit të Kosovës janë reflektuar konform mundësive dhe prioriteteve që i ka paraqitur Qeveria e Kosovës. Është raport për të debatuar. Neve do të presim me shumë kënaqësi secilin sugjerim, kritikë të sinqertë dhe, natyrisht, do të përpiqemi t'i reflektojmë të gjitha sugjerimet e dobishme në projektet tona. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit! Radha është e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetit Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!
Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar propozimin e Kornizës afatmesme të shpenzimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe meqë është hera e parë, siç e tha edhe ministri, që një dokument i tillë i paraqitet Kuvendit, ne si Komision e kemi mbështetur dhe e kemi përkrahur këtë propozim dhe dua të theksoj, po ashtu, se ky është një propozim i hapur sipas ligjit që diskutohet në Kuvend dhe që plotësohet deri me dorëzimin bashkërisht me Ligjin e Buxhetit për vitin fiskal, në këtë rast 2010 prandaj, si i tillë, ne si komision nuk jemi lëshuar shumë në çështjet sektoriale duke menduar se edhe komisionet tjera, siç është Komisioni për Shëndetësi, Komisioni i Arsimit dhe komisionet tjera përkatëse, secili në fushën e vet do të japë kontributin në plotësimin eventuale të këtij dokumenti dhe në rekomandimet eventuale që do të dalin, në mënyrë që Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, në këtë rast si përfaqësuese e Qeverisë, të plotësojë dokumentin dhe, si i tillë, bashkë me Buxhetin për vitin 2010 të na silltet në afatin ligjor të përcaktuar, që është 31 tetor i vitit fiskal, do të thotë i këtij viti fiskal 2009 dhe deri atëherë mendoj se kemi mjaft kohë dhe mjaft mundësi që në çështje të caktuara ta plotësojmë këtë dokument

E mbështesim, po them, si dokument, si nismë, si propozim, me mundësinë e plotësimit dhe të përmirësimit të tij.

KRYETARI: Tash e ka fjalën kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian, zonja Zylfije Hundozi, ajo më duket nuk është këtu. Vazhdojmë me kryetarët e grupeve parlamentare. I kisha lutur kryetarët e komisioneve, në mënyrë të veçantë kryetarët e komisioneve, le ta lexojnë Rregulloren e Punës ku flitet për punën e komisioneve dhe rekomandimet na i bëjnë mbi bazën e kërkesave që i bën Rregullorja e Punës së Kuvendit. A jeni dakord? Ju faleminderit! Kush e do fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike? Safete Hadergjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje për ministrat prezentë,

Të nderuar deputetë,

Ne sot kemi në shqyrtim Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2010-2012, që nëse e analizojmë me kujdes, shohim se kemi një material që i plotëson standardet e një dokumenti që mundëson të shohim ndërlidhjen e qëllimeve dhe të objektivave të Qeverisë në periudhën afatmesme 2010-2012.

Në këtë material na janë ofruar të dhënat mbi planet për të hyrat dhe shpenzimet e Qeverisë për tri vitet e ardhshme, të cilat qojnë në arritjen e objektivave programore të Qeverisë. Përmes kësaj kornize është bërë rishikimi i politikave dhe planifikimi i shpenzimeve, pra janë identifikuar burimet, që do të shërbejnë për planifikimin e shpenzimeve operative dhe të shpenzimeve kapitale. Ministrat kanë përcaktuar prioritetet programore dhe kostot e tyre brenda kontestit të burimeve financiare.

Të nderuar deputetë,

Është për t'u përshëndetur gatishmëria e Qeverisë për të ofruar me kohë në debat në Kuvend këtë dokument që i paraprinë planifikimit të buxhetit për vitin 2010 dhe orientimeve programore për vitin 2011 dhe 2012. Siç duket, Qeveria e ka kuptuar që është e arritur e padiskutueshme debati dhe ekspozimi i politikave dhe objektivave qeveritare ndaj politikës së fshehtë që e kemi trashëguar.

Largimi nga politikat e mbyllura i hap rrugë transparencës në vendimmarrje, që është pjesë e një filozofie të re politike në Kosovë që po instalon Qeveria. Që nga 17 shkurti i vitit 2008, Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë hapa progresiv në aspektin ekonomik, fiskal dhe social. Është duke rritur besueshmërinë e institucioneve dhe ka hartuar një kuadër të mirë të ligjeve që favorizojnë ekonominë liberale të tregut, ka krijuar një sistem tatimor që karakterizohet me shkallë të ulët tatimore dhe me bazë të gjerë. Ka arritur të ruaj stabilitetin makroekonomik si garanci si garanci për zhvillimin e qëndrueshëm në vitet në vazhdim.

Rritja ekonomike në vitin 2008 ishte 5.4%, që pavarësisht nga baza krahasuese e kësaj rritjeje dhe kriza globale, ajo përbën tregues pozitiv dhe premtues edhe përkundër sfidave të shumta që janë trashëguar, si papunësia e madhe, suficiti, deficit i lartë tregtar, infrastruktura e pazhvilluar, evazioni fiskal dhe ekonomia informale.

Korniza afatmesme e shpenzimeve, që sot po e debatojmë, paraqet analizën mjedisit makroekonomik të Kosovës, e cila siguron bazën e politikave prioritare zhvillimore. Janë dhënë informata rreth zhvillimeve makroekonomike dhe fiskale, duke u mbështetur në analizën e faktorëve të cilët ndikojnë në këtë fushë, duke marrë parasysh edhe ndikimet që mund t'i ketë kriza globale.

Bazuar në indikatorët që janë analizuar, parashihet se në periudhën e ardhshme trevjeçare, rritja ekonomike që matet me rritjen e bruto produktit vendor, parashihet të jetë diku 6%. Në kornizën afatmesme të shpenzimeve janë parashikuar prioritetet e Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare, që është bërë prezantimi i financimit të komunave duke i marrë parasysh ndryshimet që kanë ndodhur në vijën vertikale dhe horizontale të sistemit të financimit komunal pas miratimit të Ligjit për menaxhimin e financave lokale.

Në kornizën afatmesme të shpenzimeve janë përcaktuar prioritetet e Qeverisë, të cilat i përmendi ministri. Në kuadër të këtyre prioritetëve zbërthehen prioritetet specifike përmes të cilave arrihet kanalizimi i burimeve që sjellin rritjen e bruto produktit vendor, disiplinën fiskale, tërheqjen e investitorëve që përcaktojnë kahun e zhvillimit ekonomik. Projektimi i të hyrave vërehet se është bërë duke u bazuar në performancën e indikatorëve kryesor makroekonomikë, si dhe në përmirësimin e efikasitetit të mbledhjes së tatimeve në Administratën Tatimore dhe në Shërbimin Doganor.

Vlen për të theksuar se deri në vitin 2012, totali i të hyrave pritët të rritet për 20% që paraqet diku 24% të bruto produktit vendor, kurse plani i shpenzimeve rrjedhëse bazohet në rregullën e pajtuar fiskale, e cila e kufizon shtimin e shpenzime rrjedhëse primare në 0.5% në aspektin real, duke pasur parasysh deflatorin e bruto produktit vendor për vitin përkatës.

Nga projeksionet e Kornizës afatmesme të shpenzimeve, projektet investuese publike që kanë nisur në vitet paraprake parashihet të vazhdojnë. Qeveria është e përkushtuar të përmirësojë infrastrukturën ekzistuese, sidomos në transport, arsim dhe energjetikë. Në sektorët për të cilët janë paraparë projektet nacionale, të cilat vështirë është të përfshihen brenda buxhetit, është paraparë ekzistimi i llojeve tjera të financimit, siç janë partneriteti privat-publik, koncesionet, kreditë, financimet private e tjera. Qeveria e Kosovës po inicion një numër reformash të zhvillimit ekonomik...

(Ndërhyrje e Kryetarit: Ne jemi Kuvendi i Republikës së Kosovës)

... po zbaton masa (po, po e diskutojmë Kornizën afatmesme të shpenzimeve që është plan kryesor për institucionet e Kosovës në periudhën e ardhshme).

Duke analizuar kornizën afatmesme të shpenzimeve, vërejmë se është një përkushtim në zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës, prandaj transporti është radhitur në prioritetet strategjike, duke mos lënë anash ndërtimin e kapitalit njerëzor, si faktor vendimtar në të gjitha sferat e jetës në shoqëri.

Në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, po ashtu janë qartësuar politikat që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, prandaj rritja graduale e investimeve, qoftë në shpenzimet operative, qoftë në shpenzime kapitale, lë për të premtuar shumë për të ardhmen.

Me qenë se rreth 60% e popullsisë jeton në zonat rurale, sektori i bujqësisë do të luajë rol të rëndësishëm në ofrimin e mundësive për punësim. Prandaj, këtij sektori është mirë t'i kushtohet një kujdes më i madh, sepse edhe për kundër gjendjes jo të lakmueshme në terren, kontribuon përafërsisht me 25% të bruto produktit vendor.

Investimet kapitale në këtë sektor parashihen të rriten në vitin 2011, por është e pakuptueshme pse në vitin 2010 shpenzimet kapitale zvogëlohen në krahasim me vitin 2009.

Të nderuar deputetë,

Konsolidimi i politikave të Qeverisë është një proces kompleks, por Korniza afatmesme e shpenzimeve që sot e kemi në debat i ka përfshirë prioritetet programore dhe fondet janë kanalizuar për politikat që janë shpallur si prioritetet e Qeverisë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe vlerëson hapjen e debatit për këtë dokument të rëndësishëm për rrjedhat e ardhshme të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të LDK-së, kush e do fjalën, Myrvete Pantina, e ka fjalën.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka analizuar Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010 – 2012 dhe ne e përkrahim këtë kornizë, por megjithatë kemi disa vërejtje.

Nga analiza e Kornizës afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010 – 2012 mund të vërehet se Qeveria ka qenë mjaft e matur në parashikimet e saj për periudhën e cekur. Mirëpo, edhe mund të vërehet se nuk mund të presim një rritje ekonomike të dëshirueshme, e cila do të jetë e aftë të përballë me sfidat me të cilat përballë Kosova. Sikurse krijimi i një ekonomie të qëndrueshme, ndryshimi i strukturës ekonomike të Kosovës, ulja e papunësisë, si dhe ulja e deficitit tregtarë, sfida këto të cilat me siguri kërkojnë një periudhë më të gjatë kohore për t'u përballur me to.

Nga të dhënat e paraqitura në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, shihet se planifikohet një rritje e lehtë e të hyrave buxhetore prej 1 miliardë e 29 milion euro në 1 miliardë e 133 milionë euro. Po ashtu, edhe shpenzimet buxhetore parashihet të kenë një rritje të

lehtë, por që janë të përafërta me të hyrat buxhetore ose parashihet pra thjesht një deficit i ulët.

Me këtë kornizë parashihet edhe më tutje rritja e importeve edhe pse parashihet edhe rritja e eksporteve në një shkallë prej 45%, gjë që thjesht duket se është vështirë të realizohet duke u nisur nga fakti se tani veç në vitin 2009 eksportet kanë shënuar rënie. Po ashtu, edhe nëse e marrim parasysh edhe se pa zhvillimin e prodhimit vendor është vështirë të realizohet një shkallë kaq e lartë e rritjes së eksporteve.

Në rënie po ashtu janë edhe remitenat për 7%, të cilat parashihen pra të jenë për vitin 2009, ndërsa investimet e huaja direkte pritet të shënojnë rënie për 10%. Të gjitha këto thjesht krijojnë një bazë të dobët prej të cilës ne nisemi në vitin 2009 që të mund të realizojmë pritjet e parapara për periudhën e cekur.

Ndërsa, shkalla e rritjes së bruto produktit vendor real për periudhën në fjalë është projektuar në 5.1%. Duke u nisur nga treguesit e cekur më lartë parashihet pyetja se si do të realizohet kjo rritje. Në kornizë ceket se kjo do të realizohet përmes shpenzimeve kapitale publike, si dhe të sektorit privat. Pjesëmarrja e investimeve private në bruto produktin e vendit pritet të shënojë një rritje të lehtë nga 22% në 22.2%. Në fakt, kjo tregon se këto do të mbesin në nivel të njëjtë. Ndërsa, investimet e planifikuara buxhetore pritet të shënojë një rritje të lehtë, si pjesëmarrje në bruto produktin e vendit, kurse konsumi mund të presim thjesht të ketë rënie në vitin 2009 për shkak të uljes së remitenave.

Në kornizë ceket sa është numri i të papunëve, por nuk ceket se sa do të jetë ky numër në vitin 2012. Duke ditur që në tregun e punës çdo vit shtohen rreth 29 mijë punëkërkuar të rinj, ndërsa kapaciteti i ekonomisë së vendit tonë për të krijuar vende të reja pune sillet rreth 4.000 deri në 5.000, atëherë mund të presim rritjen e shkallës së papunësisë mbi 40%, sa llogaritet të jetë aktualisht.

Qeveria parasheh se do të rritet edhe baza tatimore, gjë që edhe mund të argumentohet, në fakt, edhe me raportin tremujor të buxhetit për vitin 2009, por nuk ceket se sa është ekonomia, sa është shkalla e ekonomisë joformale dhe sa do të jetë ajo në fund të periudhës së parashikuar.

Edhe në këtë periudhë parashihet që të hyrat buxhetore të grumbullohen kryesisht nga tatimet indirekte, do me thënë tatimet në kufi. Edhe të hyrat vetanake komunale pritet se do të shënojë një rritje. Pjesëmarrja e tyre në të hyrat e tërësishme buxhetore është shumë e vogël në krahasim me tatimet që mbledhen në kufi, dhe kjo flet se ende nuk do të kemi një ekonomi të qëndrueshme.

Në kornizën afatmesme të shpenzimeve flitet edhe për themelimin e një fondi të trurit, i cili ka për qëllim tërheqjen e profesionistëve të cilësisë së lartë në fusha të veçanta të politikave në sektorin publik. Por, sa do të jetë e realizueshme kjo? Deri më tani e dimë që nuk kemi qenë në gjendje të ndalim largimin e kuadrave nga vendi, por megjithatë ekziston mundësia që gjatë diskutimit në kornizën afatmesme të bëhen edhe plotësime. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e Grupit Parlamentar të AAK-së, për fjalë është lajmëruar deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Për mua posaçërisht, ndoshta për shkak të profesionit, ky dokument që po e shqyrtojmë sot, është i rëndësishëm. Por, si duket, anëtarëve të tjerë të Qeverisë nuk iu duket shumë i rëndësishëm, se nuk po i shoh këtu, kurse flitet për të ardhmen fiskale të ministrive në tri vitet e ardhshme. Megjithatë, në dokumentin po e shqyrtojmë dhe të shohim se ku do të dalim.

Në nenin 19 të Ligjit për menaxhimin e financave publike, Qeveria obligohet që më së voni deri më 30 prill të vitit në vijim të përgatisë kornizën e shpenzimeve për vitin e ardhshëm fiskal, si dhe parametrat për dy vitet e tjera fiskale.

Paragrafi 1 i nenit 19 të këtij ligji përcakton se çka duhet të përmbajë Korniza afatmesme e shpenzimeve. Në bazë të nenit 19.1, këtij dokumenti i mungojnë dy kërkesa esenciale të përcaktuara në pikën (i) dhe (j) të nenit të cituar më parë, që kanë të bëjnë me kufijtë apo, siç thuhet decidivisht në ligj, tavanet e vlerësuara të shpenzimeve për çdo organizatë buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal. Në këtë dokument mungojnë parametrat apo kufijtë e shpenzimeve për shumë organizata qendrore buxhetore, si për Presidencën, Kuvendin, Zyrën e Kryeministrit, për të gjitha agjencionet e pavarura dhe komplet për komunat. Nëse iu referohemi prapë dispozitave të Ligjit për financat publike, në të cilat parametrat fiskal për vitin e parë buxhetor të përcaktuar në kornizën e shpenzimeve, që sot po e diskutojmë, janë obligativ për buxhetin e vitit të parë, pra për buxhetin e vitit 2010, në këtë rast, atëherë vijmë në konkludim se ky dokument nuk i plotëson kushtet për t'u shqyrtuar, sepse i mungon pjesa themelore - parametrat për shumicën e organizatave buxhetore për vitin 2010.

Është e qartë që korniza është produkt dhe dokument i Qeverisë, e cila këtë dokument e përgatit me qëllim që të sigurojë bazën ligjore për të siguruar bazën financiare për realizimin e synimeve të saj dhe këtu është krejt e qartë se Qeveria tenton të gjejë mekanizma që të realizojë këto objektiva.

Mirëpo, në qoftë se i marrim parasysh disa parametra kyç të cilët janë të përcaktuar nga vetë Qeveria në këtë dokument, do të shohim cilat objektiva dëshiron dhe sa do të mund të realizohen në bazë të parametrave të këtij dokumenti.

Të marrim, së pari, këtij dokumenti i mungojnë prioritetet e qarta zhvillimore dhe, kështu të paqarta, janë të shkëputura nga prioritetet sektoriale. Brenda prioritetëve sektoriale mungon prioritetizimi i tyre. Sipas parametrave të këtij dokumenti, Qeveria e Kosovës edhe këto katër vite, duke përfshirë edhe vitin 2009, jo vetëm që nuk do të zgjidh asnjë nga problemet aktuale ekonomike e sociale, por ato do të vazhdojnë të ashpërsohen.

Deri në fund të vitit 2012 do të realizohet shtimi ekonomik mesatar, unë kam llogaritur 4%, sipas të dhënave, ministri tha 5, po le të jetë 5, dhe kjo sipas një skenari më optimistë të mundshëm.

Varianti tjetër, skenari tjetër që jepet në këtë dokument, është më pesimistë, por ne nuk po merremi me te, por lusim Zotin që të ndodhë varianti optimist.

Me dinamikën e propozuar, sipas variantit optimist të Qeverisë, shtimi ekonomik që ka paraparë Qeveria nuk do të zgjidhë asnjë nga problemet që do t'i përmendi.

Disproporcionin mes prodhimit dhe konsumit, edhe më tutje Kosova do të konsumojë më tepër se sa do të prodhojë.

Tregu i punës nuk do të jetë i balancuar, më tepër do të ketë paraqitje të të papunëve në treg, se sa do të hapen vende të reja pune për fuqinë e re punëtore. Pra, do të rritet shkalla e papunësisë sipas parametrave gjithnjë të këtij dokumenti.

Ky trend i zhvillimit do të ketë për pasojë rritjen e varfërisë absolute të të dy kategoritë, edhe të përgjithshme, edhe ekstreme.

Nga viti 2010 për herë të parë, sipas këtij dokumenti, në buxhetin e Kosovës do të paraqitet edhe një dukuri e re, çekuilibrimi fiskal, pra Qeveria parasheh deficit buxhetor, më duket është diku 161 milion e paraparë.

Në pjesën që ka të bëjë me kornizën makrofiskale, Qeveria parasheh rritje të të hyrat buxhetore për diku rreth 6% mesatarisht në vit, që do të thotë se në vitin 2012 të hyrat do të jenë vetëm 20% më të mëdha se sa në vitin 2009. Në anën tjetër, shpenzimet priten të rriten gjithsej 3.6%. Këta parametra prodhojnë efekte negative në rritjen e boshllëkut financiar nga viti në vit, i cili boshllëk në vitin 2012, sipas parametrave të këtij dokumenti, do të arrijnë në 300 milionë euro.

Po ashtu, investimet e përgjithshme, përfshirë sektorin privat dhe sektorin publik, do të rriten gjithsej 20% për 4 vite, kurse investimet publike diku do të mbesin përafërsisht të njëjta me një ndryshim 30 milionë në vitin e fundit, që është shifër shumë simbolike në krahasim me nevojat.

Asnjë angazhim nuk shihet nga institucionet qeveritare për të aktivizuar mundësi të reja pas krijimit të kushteve pas shpalljes së pavarësisë, siç janë kthimi i fondeve dhe angazhimi i tyre në zhvillimin ekonomik, të Fondit të AKM-së, të Trustit të Pensioneve dhe të parave që i jep Banka Qendrore, duke blerë letra me vlerë ose duke i angazhuar jashtë vendit. Nuk parashihet asnjë aktivitet i Qeverisë që do të sigurojë shtim të investimeve direkte në projekte të mëdha dhe asnjë aktivitet nuk parashihet në këtë dokument që përcakton efektin që do të kishte hyrja në borxh e shtetit të Kosovës për nevojat e zhvillimit ekonomik në të ardhmen.

Më herët, periudha e moskonsistencës së prioriteteve u përmend, por kjo është vetëm një mangësi, përndryshe mungesa joserioze e qasjes në realizimin e projekteve vërehet dukshëm. Moskonsistencën e prioriteteve, unë do ta konkretizoj me një shembull konkret. Në qoftë se një sektor përcaktohet si prioritar, nuk do të thotë se çdo projekt investiv në atë sektor është me prioritet. Konkretisht, në qoftë se rrugët regjionale dhe magjistrale janë prioritet dhe paraqesin infrastrukturë bazë për zhvillimin ekonomik, rrugët lokale janë të një natyre tjetër dhe, mund të them me plotë bindje, që ato përveç se përmirësojnë kushtet e jetës së fshatarëve ose të një mjedisi të caktuar, nuk paraqesin realizim të asnjë lloji prioriteti dhe nuk paraqesin krijim të kushteve për një zhvillim dinamik ekonomik, përpos se mund të shërbejnë si projekte politike para fushatave zgjedhore.

Vënia në prioritet të projekteve të parëndësishme në kuptimin e krijimit të infrastrukturës ekonomike dhe heqja, siç e përmenda, nga prioriteti i shumë projekte të mëdha, siç është autostrada, e cila ka qenë e paraparë qysh në vitin 2008 të fillojë, pastaj zhargitja ose shlyerja e vendimit për përcaktimin e investitorit në projektet prodhuese në energjetikë,

konkretisht “Kosovën C” ose “Kosovën e Re”, pastaj rrugët e rëndësishme, siç janë rruga Prishtinë – Shkup dhe, siç thuhet në dokument, ruajtja e gjendjes aktuale në kompleksin e minierave të Trepçës, decidivisht po përmendi ruajtja e gjendjes aktuale, shkruan në tekst, ju lutem, edhe 4 vite kjo parashihet, paraqesin një humbje të shansit që Kosova, duke shfrytëzuar shansin për partneritet publiko – privat, të angazhojë mjete shtesë investive dhe këto mjete të zhvillojnë efektin e tyre multiplikativ edhe në zhvillimin tjetër të përgjithshëm ekonomik dhe social.

Nëse parametrat e kësaj kornize për vitin 2010 janë obligativ...

KRYETARI: A do të vazhdosh edhe pak? Regjia, ia vazhdoni pak kohën ta përmbyll diskutimin.

HAKI SHTATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nëse sipas ligjit parametrat e kësaj kornize vetëm për vitin 2010 janë obligativ për buxhetin, atëherë mund të them që pa buxhet do të mbesin komunat dhe pa buxhet do të mbesin gjysma e organizatave qendrore buxhetore.

Unë po ia përkujtoj ministrit që shkelja e rregullës për ta respektuar kornizën për vitin e parë fiskal është shkelje shumë esenciale e rregullave buxhetore. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Pasi dokumenti është në diskutim, ke shansin për ta plotësuar dhe ta ndihmosh Qeverinë, në këtë rast. Faleminderit!

Më emër të AKR-së, fjalën e ka kërkuar Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Përsëritet Kryetar, faleminderit për fjalë!

Përsëritet për ministrat këtu që janë dhe për gjithë deputetë!

Është e vërtetë që për herë të parë vjen në debat në seancë plenare një kornizë afatmesme e shpenzimeve, po kjo është fatmbarësia se pas 17 shkurtit Kosova është një shtet i pavarur dhe Qeveria e ka për obligim që parametrat se si do të shkojë në kornizën afatmesme të shpenzimeve zhvillimi ekonomik i Kosovës.

Faleminderit, ministër, për këtë punë që e ke bërë këtu në këtë kornizë afatmesme të shpenzimeve, mirëpo në rast se e analizon me vëmendje këtë kornizë afatmesme të shpenzimeve, është një gjendje joreale me shifra të cilat paraqiten në këtë kornizë dhe mbi parametrat e mundur në të cilët mund të ecën Kosova. Sa ka nevojë për prioritetet të cilat i ka qitur Qeveria në këtë kornizë afatmesme të shpenzimeve, nuk mund të them se është shumë e saktë, kur dihet se Qeveria pikë së pari s’e ka pasur një program të mirëfilltë, mandej të qesë strategjinë e shpenzimeve sektoriale dhe nënsektoriale.

Nëse shikojmë pjesën e parë mbi politikat prioritare të Qeverisë, paraqitet një pasqyrë me efekte negative të krizës, prandaj marr paragrafin, siç thuhet në kornizën afatmesme të shpenzimeve, zoti ministër, mbasi je këtu, Kosova si një vend i vogël me ekonomi të vogël dhe e hapur me një deficit të madh tregtar, perspektiva për këtë arsye mund të themi se është shumë e vogël e Kosovës edhe në këtë kornizë afatmesme të shpenzimeve, ku dihet mjaft mirë se Kosova eksporton më shumë para se mallra.

Nga kjo që po them deri më tani, mund ta vërtetoj edhe me tabelën, ku në faqen 24 shihet mjaft mirë përshkrimi i rritjes së bruto produktit vendor, ku për vitin 2008 ministri i Ekonomisë dhe Financave, kjo është çështje debati dhe po diskutojmë se është në të mirë e gjithë qytetarëve të Kosovës, thuhet se do të ketë rritje diku 5.1%, mund të them me

shumë keqardhje pse është vendi ynë edhe i gjithë juve këtu, nuk mund të kemi këtë rritje, kur dihen se parametrat e GDP-së në Kosovë llogariten më shumë nga remitencat se sa nga prodhimi vendor i Kosovës.

Në rast se e shohim për vitin 2009, këtu paraqitet se do të jetë 4.1, po mund të them me shumë keqardhje se do të jetë diku 3.9 ose 4 në bazë të të hyrave dhe të dalave vetanake.

Me një përgjegjësi shumë të madhe mund të them se edhe të hyrat ku janë paraqitur për buxhetin diku më 24.2, ndërsa për 2009 me 23.5, unë mund të them se do të ketë ulje akoma më të mëdha, se ministri e di mjaft mirë, me stafin e vet gjatë përpilimit të kësaj kornize afatmesme të shpenzimeve, si do të bie vlera e remitencave deri në vitin 2012, ku viti 2011 do të jetë viti më i keq, me 10.5.

Të kalojmë te konsumi i sektorit privat dhe të hyrat nga sektori privat. Zoti ministër, pasi je këtu, mund të them se edhe këtu kemi një rënie shumë të keqe, diku deri minus 10. Investimet, njëkohësisht planifikim, po planifikim shumë i dobët, me shumë keqardhje! Kosova është e të gjithëve, nuk është veç e ministrit, edhe pse e planifikon kështu, po duhet të ketë ndryshime, të them shumë sinqerisht, se kjo është një kornizë, e cila, mund të them se më shumë është kornizë e dëshirave, pa dashje, se sa një kornizë e realitetit, e cila mund të pritët në Kosovë.

Në rast se kalojmë te strategjia e shpenzimeve sektoriale dhe ndërsektoriale, aty mund të shihet se prioritet në vend që t'i jepet sundimit të ligjit dhe rendit, prapë se prapë i jepet prioritet infrastrukturës ligjore. Mund të them se e gjithë korniza duhet të pësojë një ndryshim mjaft të madh, ndoshta për arsye se do të kemi edhe numër shumë të vogël të investimeve. Ministër, po shihet se disponimi yt nuk është i mirë për vërejtjet që jepen në këtë kornizë afatmesme të shpenzimeve, mirëpo definitivisht janë parametra të dëshiruar, por jo të realizueshëm.

KRYETARI: Na duhen parashikime më pozitive. Radha është e Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa, a e ke fjalën ti?

BESA GAXHERRI: Jo, në emër të LDD-së, po, zoti Kryetar, qysh në fillim propozova që grupet parlamentare mos të vazhdojnë. Tash është ora 7,15 dhe sidomos nga ju mazhoranca dhe ministri u paraqit një dokument shume i rëndësishëm, që realisht është një dokument i rëndësishëm. Është një kornizë për të cilën qytetarët e Kosovës duhet ta dinë për jetën e tyre çka planifikohet deri në vitin 2012. Në qoftë se ne pretendojmë të diskutojmë për një dokument në këtë orë, me këtë përqendrim, me këtë lodhje që e kanë deputetët, nuk është korrekte dhe nuk jemi aspak serioz. Megjithatë, në qoftë se tash, unë jam e fundit prej grupeve parlamentare, asnjëri nuk e bëri këtë propozim dhe ju keni vendos të diskutojmë për këtë temë, shumë gjëra i thanë kolegët e mi dhe unë, në bazë të kësaj, duke parë moseriozitetin e këtij dokumenti nga vetë ju, që nuk i jepni hapësirë nesër të diskutojmë, të diskutojmë që qytetarët, jo ne të bëjmë bashkëbisedim këtu, po të dëgjojnë qytetarët ku janë për 4 vite. Këtu është, mendoj unë, i tërë qëllimi edhe i Qeverisë, por realisht kjo s'po ndodh. Në qoftë se duam ta vazhdojmë debatin, unë e kam ndërmend tash, sidomos mbas kësaj që është ora 7,15, krejt 2 – 3 fjali sa të mundem shumë shkurt, sepse s'po e shoh që ka fort peshë kjo punë.

Unë, ose Lidhja Demokratike e Dardanisë është shumë e vetëdijshme që vërtet Kosova është një shtet i varfër, edhe është i ri. Problemi tjetër është se vërtet tashmë është

paraqitur një krizë globale financiare në botë dhe, natyrisht, kjo implikon probleme edhe tek Kosova.

Megjithatë, në këtë dokument Qeveria ka pretenduar së paku të paraqesë një situatë deri diku, kisha për të thënë, optimiste për qytetarët e Kosovës. Megjithatë, edhe këtë dokument në qoftë se e shqyrtojmë, shohim se vërtet në Kosovë deri në vitin 2012 nuk ka asnjë zhvillim pozitiv.

Realisht, në këtë dokument Qeveria është fokusuar në katër prioritete. Rritjen ekonomike, thotë, prioritetin e parë, me shtylla përfundi pastaj do të shkojmë, implementimi i zgjedhjes së statusit, i nderuar ministër, kisha pasur qejf të jetë Kryeministri sot këtu, por s'po ka kohë të merret me këto punë. Kjo nuk bën të figurojë këtu, sado që është teknike, nuk bën të figurojë, sepse implementimi i zgjedhjes së statusit është kryer, ka përfunduar, ne jemi shtet i pavarur. Nuk bën në këtë formë të figurojë. Mund ta quani shtrirjen e pushtetit, mund ta quani tjetër ndryshe, por implementimi i zgjedhjes së statusit, statusin e kemi zgjidhur. Tash, sa e implementojmë, është tjetër, sa kemi mundësi dhe sa jemi kah e implementojmë, atë po e shohim.

E keni -qeverisjen e mirë, dhe e keni prioritetin tjetër -zbutjen e varfërisë dhe stabilitetin social. Në kuadër të rritjes ekonomike keni parashikuar infrastrukturën energjetike dhe mallra e transport, do të ndalem shumë shkurt.

Në këtë dokument, asgjë konkrete, duke e ditur që problem crucial për zhvillimin ekonomik në Kosovë është energjetika, tashmë të gjithë po e dimë. Dhe, në këtë dokument nuk ka asgjë konkrete kur do të fillojë, së paku, ndërtimi i atij termocentrali, që u bë tashmë çështje famoze, kur do të përfundojë dhe kur do të zbutet ose kur do të përfundojë kriza energjetike në Kosovë, këtu nuk ka kurrëgjë.

Transport. Po, tashmë e dimë që është bërë një punë në atë drejtim, por realisht, zoti ministër, ne si ekonomist dhe ju si qeveri, në këtë aspekt duhet të shikohet shtrirja ose asfaltimi i rrugëve të cilat gjenerojnë zhvillim ekonomik, jo shpenzim i asfaltimit në këtë formë qysh ka ndodhur.

Sundimi i ligjit. Kurrëgjë në këtë dokument, ne e dimë të gjithë që në Kosovë nuk funksionon ligji, nuk ka sundim të ligjit, nuk ka kurrëgjë konkrete në këtë dokument së paku për drejtësinë, gjykata, kur do të fillojë një reformë konkrete, kur do të përfundojë dhe kur vërtet mund të premtojë kjo Qeveri se në Kosovë do të ketë sundim të ligjit.

Arsimi. Po e tejkaloj.

Bujqësia. Asgjë konkrete, asnjë projekt me të cilin për këto katër vite kishim parë që ka për të pasur gjenerim të vendeve të punës, zhvillim ekonomik, e tjera e tjera, asgjë konkrete në bujqësi.

Politikat fiskale përmes të cilave ju parashikoni, zoti ministër, që nga viti 2008 buxhetin 942.3 milionë, që në bazë të politikave të juaja fiskale në vitin 2012 parashikoni të jetë vetëm 1 miliardë e 133 milionë. Realisht, e tërë ngritja buxhetore e të hyrave buxhetore parashikohet të jetë vetëm 20%.

Në kuadër të këtij 20% çka pretendohet për 4 vjet të ketë zhvillim, a ka koment më të madh se në Kosovë për 4 vjet zhvillim ose ngritje do të ketë 20%, kur realisht ne kemi

problem jo vetëm të papunësisë, por të ngritjes së pagave, e që nëse i fokusojmë veç te pagat 20%, punëtorja jonë nuk do të jetë e kënaqur, ndërsa ne realisht që e keni theksuar edhe në raport, nuk guxojmë të hyjmë të bëjmë ngritje pagash, dhe atëherë çka, qysh e shohim ne zgjedhjen e problemit, qoftë të papunësisë, qoftë të ngritjes së pagave me vetëm 20% për ngritje të tërësishme të buxhetit të Kosovës.

Implementimi i zgjidhjes së statusit, unë e thashë, me këtë nuk pajtohem dhe nuk është mirë të figurojë kjo kështu.

Decentralizimi, s'ka kurrgjë në raport konkret dhe po shohim edhe në terren që s'ka kurrgjë.

Siguria, institucionet e reja, minoritetet. Me keqardhje, asgjë konkrete nuk ka në këto projekte konkrete për 4 vjet, që vërtet ky projekt fillon tash, mbaron tash dhe kushton kaq.

Qeverisja e mirë. Edhe këtu më ka bërë përshtypje qeverisja e mirë, po të kishte qenë qeverisja e mirë, do të kishte qenë mirë, reforma në administratën publike, uroj që mund të bëjnë ndoshta një reformë, ka filluar diçka të bëhet, por prapë në këtë dokument s'ka kurrgjë konkrete.

Menaxhimi i financave publike, korrupsioni. Shtyllën e tretë –korrupsioni, bile kisha propozuar të shkruajmë lufta kundër korrupsionit, të mos e legjitimojmë korrupsionin këtu në qeverisje të mirë. Korrupsion nuk shkon, sado që është teknike, gabim teknik.

Përmirësimi i ekzekutimit të shpenzimeve kapitale. Shohim shumë qartë nga ky raport se rritjet te investimet kapitale prej vitit 2009 e tutje nuk ka, tek e fundit, edhe e arsyetoj, sepse nuk ka mundësi dhe ju nuk keni parashikuar në këtë plan qoftë bile së paku përmes luftimit të ekonomisë së zezë, informalitetit, që së paku aty të shihni një rritje më të madhe te buxheti i Kosovës, do me thanë asgjë konkrete as në këtë drejtim nuk ka.

Pastaj, e shohim, tregu i punës. Zoti ministër, te tregu i punës i ke 10 reshta, në këtë dokument janë vetëm 10 reshta sa i ka kushtua rëndësi Qeveria për 4 vjetët e ardhshme tregut të punës në Kosovë.

Dhe, po dua ta përmbyll me fjalën e Kryeministrit, sot, që doli e na tha se qytetarët e Kosovës janë optimistë 67%, qytetarët e Kosovës janë optimistë. Zoti ministër, me këtë dokument sot, veç sot janë 67% të pa punë. ndërsa me këtë dokument nuk shihet asnjë përqindje e zbutjes të kësaj papunësie. Unë kisha pasur qejf t'i them Kryeministrit këtu që me dokumentet që i keni paraqitur ju, 67% jo, po 80% e qytetarëve mund të jenë jo optimistë.

Megjithatë, unë nuk dua të shoh krejt bardh e zi. Realisht, ky dokument mendoj se duhet të plotësohet, ky dokument duhet të japë, së paku, edhe në qoftë se ne realitetin nuk mund ta ndryshojmë, sepse përveç mundësive edhe varfërisë që e kemi, politikat normalisht mund t'i ndryshojmë, mund t'i ndryshojmë, por jo të na vinë kështu në këtë dokument. Kur aprovohet një dokument i tillë, duhet të jetë konkretë, me këtë politikë fiskale ndryshohet kjo dhe me këtë bëhet kaq vende të punës, ka e tjera e tjera, e kështu me radhë.

S'po e theksoj më, se vërtet kam menduar që kur e diskutojmë këtë dokument, do të jetë edhe Kryeministri këtu, kam pas dëshirë pak edhe atij t'i drejtohem. Megjithatë, unë ju propozoj që këtë dokument ta rishqyrtoni, ta plotësoni, të jetë më konkret, edhe qytetarët e Kosovës së paku të shpresojnë deri në vitin 2012. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Naim Maloku, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zonja deputete!
Në emër të Grupit Parlamentar "7+" fjalën e ka deputetja Myfera Shiniq.

MYFERA SHINIK: Teşekkür ederim,

Meclis oturumunda olanları saygıyla selamlıyorum,

Elimizde 2010-2012 dönemi için harcamaların orta vadeli öneri çerçevesi bulunmaktadır. Bu Öneri Çerçevesini incelediğimizde Kosova genelinde ihtiyaçları göz önünde bulundurarak, uygun bir şekilde planlama yapılmış. Ancak başta bütün dünyada güncelliğini koruyan ve daha da sürmesi ve yaygınlaşması beklenen bir ekonomi kriz hüküm sürüyor. Onun dışında, iç yatırımların çok yetersiz olduğu bu dönemde olması gereken düzeyde de dış yatırımların olmadığını görüyoruz. Bu yüzden hazırlanmış olan bu çerçevedeki planlamaların gerçekleşmesinde beklenen ilerlemenin gerekli seviyeye ulaşması zor olacaktır. Çünkü Kosovada ilerdeki dönemde sağlık, eğitim bihasa tarımcılık alanlarda çok büyük gelişme beklentileri vardır. Mutlaka bu bir taslak olduğu için zamanın ve şartların gerektirdiğine göre değişebilir durumda hazırlanmıştır. Değişmelerle başarıya ulaşabileceğine inanarak, 7+ Parlamenter Grubu olarak 2010-2012 dönemi için harcamaların orta vadeli öneri çerçevesini kabul etmekteyiz.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete,
Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk kemi të paraqitur për fjalë.
Dhe, kalojmë në debat, ku do të marrin pjesë deputetët. Të paraqitur për fjalë janë 9 deputetë deri tani. Vazhdojmë debatin, nëse nuk ka propozim tjetër. Fjalën e ka deputetja Suzan Novobrdaliu, le të përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po bëhen 10 vjet që nga përfundimi i luftës në Kosovë dhe pothuaj se 7 vjet që nga formimi i parë i Qeverisë së Kosovës dhe vendi ynë, Kosova, akoma nuk ka një dokument, i cili quhet Strategjia zhvillimore e Kosovës, edhe pse ka pasur shumë përpjekje nga qeveritë e kaluara që të hartohet një dokument i tillë. Kjo Qeveri nuk ka bërë asnjë angazhim më të vogël në këtë drejtim edhe pse po bëhen gati 2 vjet qeverisjeje.

Të nderuar kolegë deputetë,

Miratimi i kornizës afatmesme sado që është e hartuar mirë dhe në një mënyrë të përgjigjet prioritetëve të vendit, ajo nuk mund të ketë efektin e duhur. Kjo kornizë e shpenzimeve që po diskutohet sot, është me shumë të meta, jo vetëm teknike, por edhe strategjike. Po iu referohem vetëm prioritetëve dhe materializimit të tyre në buxhet. Kjo tregon më së miri se kemi një disbalans në mes të këtyre kategorive.

Kemi një kujtesë të mirë, kur gjatë fushatës elektorale, pas formimit të Qeverisë deklarohet se arsimi është prioritet mbi prioritete dhe do të përdoret si instrument për zhvillimin ekonomik. Kjo jo vetëm që nuk reflekton, por fatkeqësisht edhe ai pak buxhet që ndahet, shkon në ndërtime të forta e shumë pak në rritjen e cilësisë. Po t'i referohem vetëm provimit të maturës të vitit të kaluar, tregon më së miri se çfarë arsimi kemi. Dihet shumë mirë se kalueshmëria ka qenë vetëm 35%.

Kolegë të nderuar,

Këtu u fol shumë për një mori defektesh të kësaj kornize, por unë po ndalem vetëm në një nga problemet, që jo vetëm që e rëndojnë jetën e qytetarit, por referuar edhe raporteve të institucioneve relevante ndërkombëtare, siç është sundimi i ligjit, u mundova të gjejë dhe të analizojë se sa për këtë problem ka rritje buxheti. Besoni, kolegë të nderuar, që është e papërfillshme. Këtu kam parasysh gjendjen e mirë të Gjyqësorit dhe Prokurorisë, sektor që kanë nevojë për investime strategjike dhe afatgjate. Kjo, jo vetëm që nuk po bëhet, po mjerisht po lihet në margjina të prioriteteve buxhetore.

Sot ky sektor përballet me numër të vogël personeli dhe me mundësi të kufizuara për rritje të stafit profesional dhe të trajtimit e të zhvillimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Një problem tjetër që, fatkeqësisht, nuk është futur në prioritet të kësaj kornize, është edhe politika e jashtme, pra lobimi. Ne po harrojmë se nuk ka shumë kohë që jemi të pavarur dhe Kosova ka nevojë urgjente që të jetë pjesë e mekanizmave ndërkombëtarë, siç janë organizmat rajonal dhe OKB-ja, por me këtë buxhet për këtë problem jo vetëm që nuk do të bëjë pjesë aktive në politikën e jashtme, por do të kemi një sërë problemesh edhe me vendet të cilat e kanë njohur Kosovën, por që në një mënyrë po e injorojnë dhe raste të tilla kemi sa të duash.

Një tjetër problem serioz dhe po thuaj se kryesori është që kjo kornizë nuk është dokument që e zhvillon Kosovën, por çdo ditë e më shumë e varfëron, sepse nuk po krijon kushte lehtësuese që investorët e huaj të vinë në Kosovë. Unë nuk kam dëgjuar që Kosova ka pasur ndonjë investim serioz direkt nga ndonjë kompani serioze ndërkombëtare, edhe pse po luftohet me të madhe që sa më shpejtë të privatizohen ndërmarrjet publike, pa menduar shumë për krizën financiare që e ka kapluar Kosovën.

Uroj që ky dokument të plotësohet dhe që Qeveria të angazhohet që gati mbi një miliardë euro që sot ekzistojnë jashtë Kosovës, të kthehen në vend dhe të hynë në tregun vendor.

Ashtu sikurse grupi ynë, edhe unë nuk do ta votoj këtë dokument. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për fjalë është lajmëruar shefi i Grupit Parlamentar AAK-së, Ardian Gjini, për një propozim.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në këto momente të fundit, në konsultim me shefat e grupeve parlamentare dhe zëvendës shefat që janë këtu, po propozojmë që pjesa e mbetur e seancës së sodit, me qenë se është tepër vonë dhe deputetët janë lodhur dhe shumicën nuk e kemi këtu, të vazhdohet nesër pas seancës së rregullt, të cilën e kemi në fillim, në ora 10:00. Gjatë bisedimeve u morëm vesh që kemi mundësi reale që në pjesën e paradites ta kryejmë

seancën e radhës, e cila është nesër, dhe në pjesën e pasditës ta kryejmë pjesën e mbetur të kësaj pike të rendit të ditës dhe 2 pikat e tjera të cilat janë më të shkurta dhe që kanë mbetur. Janë gati 8 orë që deputetët janë në sallë dhe po duket që janë të lodhur. Faleminderit! Kërkoj që të qitet në votim.

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas Rregullores së Punës, unë e qes në votim këtë propozim. Po ne, sa jemi këtu tash, këta që jemi.

Përgatitemi për votim. Pra, e qes në votim propozimin e shefit të Grupit Parlamentar të AAK-së për ndërprerjen e seancës dhe për vazhdimin e kësaj seance nesër, pas përfundimit të seancës së rregullt, të thirrur me rend të ditës për nesër.

Pra, regjia gati për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 35 vota “për”, 4 “kundër” dhe 2 abstenime, seanca ndërpritet. Puna vazhdon nesër, pas përfundimit të seancës së rregullt, të thirrur për nesër. Faleminderit!

Lus regjinë që të ruhen emrat e paraqitur për fjalë për këtë pikë të rendit të ditës.

Vazhdimi i seancës, më 18 qershor 2009

KRYETARI: Të nderuar deputetë!

I nderuari Kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 11 qershor 2009, me pikat e mbetura.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 67 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë. Urdhëro, Adem Grabovci, por duhet ta dini se është vazhdim i seancës...

ADEM GRABOVCI: Ju faleminderit, Kryetar!

Jam i vetëdijshëm që është vazhdim i seancës, por disa raste janë të jashtëzakonshme edhe nuk presin.

I nderuar Kryetar!

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që t’u drejtohem për një çështje krejt të pazakonshme dhe të papritur nga unë, familja ime, por besoj edhe nga të gjithë qytetarët tanë. Mbrëmë, pas një debati televiziv, në orën 17:39, kam pasur një thirrje telefonike nga një kryetar i komunës, saktësisht nga kryetari i komunës së Deçanit, ku më është bërë kërcënim për likuidim fizik, në rast se unë edhe njëherë i përmend emrat e tyre në mediat publike dhe më është thënë decidivisht: ” Unë dhe Ramush Haradinaj, edhe njëherë nëse na e përmend emrin, do të likuidojmë fizikisht”. Unë rastin e kam deponuar në Polici. Ju

besoj organeve të policisë. Jam i gatshëm të bashkëpunoj dhe ta vërtetoj ... Këtu e kam, pikërisht, edhe numrin e telefonit prej të cilit më është bërë thirrja, koha dhe mund të verifikohet nga kushdo dhe kur të dojë. Prandaj, unë kisha për obligim që t’ju informoj për këtë situatë dhe njëkohësisht i bëj thirrje edhe Ramush Haradinajt dhe kushdo qoftë, ta lëmë dhunën, t’i lëmë kërcënimet, t’i lëmë shantazhet. Urdhëro, kam shprehur

gatishmërinë që për çdo problem edhe për veprimtarinë time 30- vjeçare jam i gatshëm të përballem me këndo qoftë dhe kudo qoftë dhe kurdo qoftë dhe nëse ka dikush kundër Adem Grabovcit, le të urdhërojë, le të deponojë në organet përkatëse dhe ato vazhdojnë punën e tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ethem Çeku, e ka fjalën!

ETHEM ÇEKU: Unë nuk po dal atje si Ademi, veç dua t'ju shpjegoj kolegëve këtu, Musa dhe Ademi kanë qenë dhe kanë mbetur shokë, një nga shokët më të mirë. Unë dhe Ademi, bashkë, kemi kaluar gjithë jetën dhe punën bashkë me Musën. Unë nuk besoj që Musë Berisha i bën telefonatë kërcënuese Adem Grabovcit. Ata mund të kenë dallime politike, por këtë që sot Ademi po e thotë këtu, realisht, është tepër e rëndë dhe mendoj që edhe herën e kaluar i kam thënë Ademit: “Adem, kemi punuar bashkë, duhesh të jesh shumë korrekt në informacionet që i jep shefit tënd dhe në informacionet që i plasos. Prandaj, nuk i shkon për nder sot Ademit të dalë e të thotë që Musë Berisha e ka kërcënuar në telefon. Musë Berisha, me plot përgjegjësi, them, pavarësisht punëve, zhvillimeve, unë nuk dua të hyjë, unë po hy vetëm në këtë raportin që ka të bëjë, nuk e besoj që Musë Berisha ka kërcënuar Adem Grabovcin në telefon. E njohin të gjithë Musën, për jetën e tij, për punën e tij dhe veprimtarinë e tij. Dhe, mendoj se Ademi duhet të jetë shumë më korrekt në këtë drejtim. Sa i përket atyre konferencave për shtyp, ajo është çështje tjetër.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Konsideroj që edhe kjo që u tha sot, ishte jashtë rendit të ditës. Megjithatë, po e mbyllim këtë. Opinioni është njoftuar. Replikë, Adem, 2 minuta ke kohë.

ADEM GRABOVCI: Shiko, nuk e kontestoj bashkë veprimtarinë time me zotin Berisha, por e vërteta është se kam edhe dëshmitarë. Në banesën time kanë qenë prezentë gjatë emetimit të lajmeve, kur më është bërë thirrja, jam sharë dhe jam kërcënuar me likuidim fizik, në rast se edhe njëherë e përmend emrin e tyre në media. Prandaj, kjo është e vërteta dhe mund të verifikohet nga çdokush. Është e vërtetë se edhe për mua ka qenë e papritur, por ky është realiteti. Unë po i bëj thirrje edhe Musa Berishës edhe kujtdo qoftë, nuk kemi nevojë që t'i terrorizojmë qytetarët e vendit, po urdhëro i ballafaqojmë argumentet për çdo problem dhe çështjet që i kemi dhe meritojnë të trajtohen.

KRYETARI: Ju faleminderit!

A ka kundër replikë?

Mirë, Ethem, pasi Ademi e mori fjalën, merre edhe ti.

ETHEM ÇEKU: Po i them Ademit edhe njëherë: “Adem, qoje në polici Musë Berishën, padite, akuzoje për shpifje, për kërcënim, në polici, por jo në këtë formë të propagandës. Ju e dini se sa bukë keni hëngër në shtëpinë e Musë Berishës e tani vetëm për një dallim politik po i rrëzoni krejt ato që keni punuar bashkë.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë po e mbylli këtë formë të debatit, duke kërkuar nga subjektet politike që ta mësojnë demokracinë se vërtet janë bërë pengesë të zhvillimit të demokracisë.

Vazhdojmë debatin e mbetur. Ju njoftoj se debati gati ka pas përfunduar në seancën e kaluar.

Për debat kanë mbetur pa debatuar në seancën e kaluar 9 deputetë.

1. Fatmir Rexhepi,
2. Gjylnaze Sylaj,
3. Kaqusha Jashari,
4. Ethem Çeku,
5. Naser Rugova,
6. Rita Hajzeraj,
7. Ibrahim Makolli,
8. Gani Buçinca, dhe
9. Ardian Gjini

Këta nëse donë, mund të flasin ose jo, por këta kanë të drejtë të flasin sot për rendin e ditës që ka qenë në shqyrtim:

- Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovë për Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2010-2012

Ne vazhdojmë sipas radhës, pastaj shikojmë në fund. Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Rëndësia e debatit është vlerësimi në parim për dokumentin më të rëndësishëm politiko-ekonomik për vendin, që pasqyron politikat makroekonomike të investimeve, të zhvillimit të punësimit, të ngritjes ekonomike, menaxhimit të fondeve, politikat buxhetore si dhe transformimin dhe privatizimin e ndërmarrjeve publike.

Dokumenti i ofruar, po ashtu, tregon edhe performancën dhe kapacitetin e Qeverisë në përmbushjen e zotimeve programore për zhvillimin ekonomik të vendit, zvogëlimin e papunësisë, si dhe të shkallës së varfërisë që vazhdon të jetë mbi 40%.

Nga leximi dhe analiza e këtij dokumenti, vlerësimi ynë është se drafti i ofruar nuk përmbush synimet zhvillimore si dhe mundësitë e mëdha që ka vendi pas pavarësimit dhe integrimit në institucionet financiare ndërkombëtare.

Konstatimi mbështetet tek indikatorët kryesor makroekonomikë të Kornizës, por fatkeqësisht të planifikuar nën potencialet dhe resurset reale që ka ekonomia e vendit. Për shembull, bruto produkti vendor në shkallën e planifikuar është treguar se nuk mundëson zhvillim dinamik dhe zvogëlim të nivelit të papunësisë dhe të varfërisë.

Me deficit tregtar prej 2 miliardë eurosh, korniza tregon për mungesën e politikave të Qeverisë dhe shmangie programore nga përkrahja e eksportit dhe e prodhimit vendor.

Investimet e huaja direkte, po ashtu derisa planifikohen të zvogëlohen janë tregues për politikat e gabuara, sigurinë e investimeve dhe klimën e biznesit që duhet rivilizuar dhe ndryshuar, si dhe mungesa e strategjisë nacionale zhvillimore mbi shfrytëzimin dhe valorizimin e resurseve minerare dhe natyrore që posedon Kosova.

Zonja dhe zotërinj,

Dokumenti kornizë po të lexohet edhe nga drejtimi i politikave buxhetore, është nën potencialet reale që ka ekonomia e vendit. Buxheti me rritjen vetëm 10% për tri vjetët e ardhshme, është joreal dhe inkontabil me interesat ekonomike të vendit, sepse nuk mundëson investime dhe ngritje të standardit si dhe të pagave në asnjë veprimtari shoqërore.

Unë vlerësoj se buxheti real duhet të jetë me një rritje mes 30 dhe 40% apo rreth 1.4 miliard, i cili do të arrijë nëse Qeveria ndryshon politikat dhe masat e ekonomike në menaxhimin e doganave, sovranitetin dhe kontrollin kufitar, ngritjen e kapaciteteve profesionale në Administratën Tatimore, zvogëlimin e ekonomisë informate dhe zhvillimin e konkurrencës, zvogëlimi e krimit ekonomik dhe të korrupsionit, transparencë dhe menaxhim të mirë të parasë publike nga projektimi e deri te realizimi.

Me një buxhet real, do të kemi zvogëlim të deficitit primar si dhe mundësi për fonde dhe paga më të mëdha për prioritetet si: arsimi, shëndetësia, policia, drejtësia e tjera. Po ashtu nuk do të kemi zvogëlim të investimeve kapitale për 10% për rritjen e tyre dhe ngritjen më të shpejtë ekonomike nga ajo që ofrohet këtu.

Unë vlerësoj se ekonomia kosovare ka potencial për ngritjen e të ardhurave kombëtare dhe kjo obligon Qeverinë e vendit të rishikojë kornizën dhe strategjinë e politikave buxhetore, në mënyrë që mos të kënaqet me balance dhe konferenca vjetore para kamerave, derisa papunësia dhe varfëria në vend vazhdojnë të rriten. Prandaj, në parim kjo duhet të plotësohet dhe të ndryshohet para se të aprovohet në Kuvend, si dokumenti më i rëndësishëm për mandatin e një Qeverie si dhe ardhmërinë politike dhe ekonomike të vendit.

Të nderuar deputetë,

Tek politikat e strategjisë sektoriale, kjo kornizë, po ashtu, nuk mundëson investime dhe zhvillim harmonik për të gjithë vendin. Këtu, Qeveria edhe një herë ngelë në provim para qytetarëve duke ndarë Kosovën në regjione ku planifikohet të derdhen miliona euro dhe në zonat e harruara si të mos ishin pjesë e Kosovës të pavarur. Korniza nuk ofron planifikim dhe ndarje të drejtë të fondeve, sipas prioriteteve që ka vendi dhe qytetarët, si në: sektorin e energjisë, të arsimit, të bujqësisë, të shëndetësisë, të kulturës e tjera, si dhe infrastrukturë rrugore për një zhvillim të barabartë të gjithë vendit.

Kjo dëshmohet në faqen 41, tabela 1, me investime selektive në ndërtimin e rrugëve magjistrale dhe rajonale edhe atë mbi 200 milionë euro në magjistralet perëndimore, ndërsa nuk parashihen investime në gjysmën e territorit të vendit, si në: Prishtinë, Gjiilan, Ferizaj, Viti, Kamenicë, Bujanoc, Preshevë. Unë sërish po ju them se po e dënoni Gjilanin, afaristët, zhvillimin dhe ardhmërinë e mijëra qytetarëve të kësaj treve.

Po ashtu, në faqen 42, tabela 3, kërkesa për investime kapitale edhe këtu Kosova Lindore nuk përfshihet në investime, ku e keni harruar sikur të ishte ndonjë zonë në Afrikën Jugore. Unë si deputet nuk pajtohem me këtë strategji.

Zoti ministër i Financave, këtu po gaboni rënd, sepse kërkohen 1 miliard fonde për investime nga buxheti i vendit më të varfër në Evropë, më me pak se 1 dollar në ditë për kokë banori, me mbi 40% të papunëve dhe mbi 40% të popullsisë në varfëri të lartë.

Unë e pyes ministrin dhe profesorin e financave lidhur me këto fonde dhe financim të projekteve nga ky buxhet, në vlerësimin e tij të kësaj politike, si të drejtë apo të gabuar, mbetet ta thoni ju, zoti ministër.

Unë tani i propozoj Qeverisë, që bashkë me ndryshimin e domosdoshëm në politikat e investimeve regjionale, të gjitha projektet për investime kapitale t'i realizojë përmes dhënies me koncesion si dhe partneritetit publiko-privat, pa prekur në buxhetin e shtetit më të varfër në Evropë.

Zonja dhe zotërinj,

Në përfundim të kësaj fjale, më lejoni të konstatoj se argumentet e ofruara janë të mjaftueshme për ndryshime në Kornizën buxhetore dhe kërkoj nga Lutfi Haziri që ta marrë fjalën dhe si shef i Grupit Parlamentar të deklarojë, që me partnerin e koalicionit të rishikojë Kornizën, t'i harmonizojë politikat buxhetore dhe orientimin e investimeve në programin qeverisës ashtu që të garantojë zhvillimin harmonik dhe dinamik të ekonomisë dhe të vendit.

Në interes të kësaj që thashë, unë më shumë e dua zhvillim e vendit tim se çdo qeveri dhe do të kërkoj nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës vlerësimin në pasojave nëse nuk ndryshohet kjo dhe të qeverisjes në koalicion. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju njoftoj që kjo projekt-strategji nuk miratohet në këtë seancë, por miratohet kur të miratohet buxheti i vitit 2010. Do të thotë, veç sa për njoftim ta keni parasysht. Mos i jepni zjarr shumë.

Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja, le të përgatitet Kaqusha Jashari.

GJYLNAZE SYLA: I nderuari Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Korniza afatmesme e shpenzimeve duhet të ishte një dokument premtues trevjeçar për vjetët 2010-2012, i bazuar në vizionin e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe politikat zhvillimore që krijojnë ndjenjën e sigurisë dhe të mirëqenies të çdo qytetar i Kosovës.

Në vend të kësaj, kjo kornizë e hartuar nga Qeveria, tregon realitetin e zyrtarë se gjatë këtyre tri vjetëve jeta jonë nuk do të përmirësohet.

Çka pasqyron Korniza afatmesme e shpenzimeve?

E para, ekonomia nuk do të rritet;

E dyta, nuk do të ketë rritje të larta të pagave për punëtorët e administratës, të shëndetësisë, të arsimit, të policisë;

E treta, efektet e krizës globale do të ndihen dukshëm në Kosovë;

E katërta, ekziston rreziku i uljes së shpenzimeve kapitale;

E pesta, do të ketë deficit të lartë tregëtar;

E gjashta, do të ketë deficitin buxhetor.

Se nuk do të ketë rritje ekonomike është e qartë, sepse rritja ekonomike prej 4.8 % në vitin 2010 nuk do të ndodhë. Kjo drejtpërdrejt do të ndikojë në rritjen e mëtejme të

papunësisë dhe të varfërisë. Pra, nuk do të mund të mbahet as ky nivel i tanishëm i papunësisë, sepse, për t'u zvogëluar përgjysmë papunësia për 10 ose 15 vjetët e ardhshëm duhet të ketë rritje ekonomike prej 6%.

Deklarata e Qeverisë se kriza globale financiare nuk ka ndikim në Kosovë, bie, sepse KASH-i vërteton të kundërtën. Efektet e krizës vërehen edhe në remitencat e zvogëluara nga jashtë. Vlerësohet se dërgesat nga jashtë do të bien për 7% në vitin 2009.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave parasheh që në vitin 2010 të hyrat do të jenë 1,029.000.000 €, kurse shpenzimet 1, 111.000.000 €. Pra, parashihet deficitin primar afërsisht 82,000.000 €. Deficitin buxhetor do të përcillet gjatë të tri vjetëve.

Kjo do të thotë, se prioritet e përcaktuara nga Qeveria mund të financohen vetëm nëse gjenden mjete shtesë. Pra, nëse Qeveria rrit deficitin, më shumë se sa që ka mundësi ta mbulojë, me para nga buxheti, e që do të ndodhë, atëherë ekziston rreziku i uljes së shpenzimeve kapitale. Kjo do të thotë, se ulja e shpenzimeve kapitale për 100, 000.000 €, do ta ulë rritjen ekonomike rreth 2% dhe humbjen në të hyrat buxhetore për 15-20,000.000 € në vit. Kjo është humbje e madhe për Kosovën.

Gjithashtu, do të thellohet deficitin tregëtar, sepse në vend të rritjes së pritur të eksporteve prej 20%, në praktikë do të jetë 2%.

Investimet e huaja do të zvogëlohen për 10%. Efekti i përgjithshëm është se nuk do të ketë rritje të bruto produktit vendor, pra nuk ka përmirësim të jetës për qytetarët.

Për shkak të rënies së investimeve dhe remitencave, të hyrat neto do të vazhdojnë të zvogëlohen gjatë këtyre tri vjetëve.

Viti më i vështirë në kuptim të pozicionit fiskal do të jetë viti 2010.

Rreziqet potenciale në financim janë:

1) Pagat e shërbyesve civilë, që parashihet të rriten 5% në vitin 2010 dhe 2011. Por kjo rritje prej 5% nuk do të realizohet, pos nëse kërkohet financim shtesë nga buxheti, gjë që do të shkaktonte pozitë të pafavorshme fiskale për buxhetin, kështu që rreziku është se shërbyesit civilë mund të mos i marrin pagat me rritje në vitin 2010 e mëtej.

2) Indeksi i pensioneve: zbatimi i politikave sociale sipas letrës së bardhë, sidomos indeksimi i skemave pensionale dhe të asistencës sociale kërkon buxhet shtesë prej 20,000.000 €.

3) Policia: zbatimi i plotë i Ligjit të Shërbimit Policor të Kosovës kërkon buxhet shtesë prej 10,000.000 €.

Për rritjen e buxhetit, gjegjësisht, mbulimin e boshllëkut financiar, Qeveria ka paraparë si opsion një zgjidhje të mbrapshtë dhe më së paku në interes të popullatës, duke shitur asetet e popullit të Kosovës. Kështu, MEF ka paraparë që të mbushë buxhetin nga dividendat e PTK-së me shumën prej 150,000.00 €, t'i shesë tërësisht asetet e PTK-së rreth 500,000.000 € dhe njësitë e KEK-ut për 30-50,000.000 €. Kjo është mënyra më e mirë për ta bankrotuar shtetin. Qeveria nuk ka të drejtë t'i shesë këto asete, sepse nuk janë të Qeverisë, por janë pasuri publike, prandaj, duhet transparencë dhe debat të gjërë për mënyrën e privatizimit. Kjo është shkelje e të drejtave të njeriut.

Në vazhdim do të fokusohem në dy sektorë, në atë të shëndetësisë dhe të punës e mirëqenies.

Shëndetësia: për financimin e qëndrueshëm të sektorit shëndetësor, kërkohen 30,000.000 € shtesë më shumë se në vitin 2009. Gjithashtu, buxheti parasheh zbatimin e Ligjit për sigurimet shëndetësore, i cili kërkon mjete shtesë. Shpenzimet për tri vjetët 2010-2012, për Ministrinë e Shëndetësisë parashihen pak mbi 219,000.000 €. Kërkesat shtesë për financim janë: rritja e numrit të punëtorëve për 365 punëtorë, mbulimi i kujdestarive, rritja e kujdestarive prej 10%, pagesa e 44 € për të gjithë punëtorët shëndetësorë, plotësimi i nevojave me barna për shërbimet shëndetësore të onkologjisë dhe të kardiokirurgjisë.

Sektori i punës dhe i mirëqenies sociale: papunësia në Kosovë më 2008 ishte 43%. Me trendet e tilla të moszhvillimit ekonomik, indikacionet janë se papunësia do të rritet. Po ashtu, sipas të dhënave të Bankës Botërore për vitin 2007, 45% të popullësisë jetojnë në varfëri, dhe prej tyre 15% në varfëri të skajshme. Llogaritet se shpenzimet e përgjithshme për këtë sektor për tri vjetët do të jenë 506, 143, 522 M €.

Por, nga KASH-i shihet se për rritjen e punësimit për 3% të grupit të rinjëve duhet kosto shtesë prej 400, 000 €, për fillimin e zbatimit të Ligjit të punës nga fillimi i vitit 2010 duhen 6,000.000 €, zbatimi i ligjit për aftësim, riaftësim dhe punësimit e personave me aftësi të kufizuar duhet 1,000.000 € shtesë, fillimi i zbatimit të ligjit për sigurimet pensionale dhe invalidore në vlerë prej 12,000.000 € në vitin 2010, ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për skemën e ndihmës sociale kërkon kosto shtesë prej 2,700.000 €. Indeksi i skemave pensionale (pensionet bazë, të aftësisë së kufizuar dhe kontribut pagues) sipas inflacionit ka koston shtesë prej 10,000.000 M €.

Përfituesi më i madh nga të gjithë është Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit me afër 355,000.000 M €. Mbase deri më 2012 do në vend të bukës do ta hamë asfaltin. Kjo ministri ka kërkuar 480,000.000 € deri në vitin 2012, për autostradën Morinë-Merdare, vetëm për vitin 2010 ka kërkuar 50 M €.

Të nderuar deputetë,

Njerëzit në Kosovë janë të lodhur dhe të ngopur nga varfëria, papunësia, pagat e ulëta, edukimi i dobët, shërbime shëndetësore jocilësore. Njerëzit në Kosovë janë të zhgënjyer nga premtimet e kësaj qeverie. Ata e dinë se për të përmirësuar jetën e tyre duhet të kenë qeveri efikase, të aftë të zhvillojë ekonominë që punon për interesin e tyre. Ko qeveri punon për vetveten.

Prandaj, e kam vetëm një rekomandim që kjo qeveri të japë dorëheqje dhe të shkojë në shtëpi.

Ju faleminderit.

KRYETARI: Lutfi Haziri e ka kërkuar fjalën, por ai do ta marrë në fund? Veç është mirë dikush të flasë në emër të Grupit, e jo secili deputet të flas në emër të Grupit.

Fjalën e ka Kaqusha Jashari, le të përgatitet Ethem Çeku. Ethem Çeku e ka fjalën. Le të përgatitet Naser Rugova.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, Kryetar!

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë me vëmendje e kam analizuar këtë kornizë afatmesme të shpenzimeve 2010-2012 dhe them që kam qenë shumë i lumtur kur kam menduar që në fillim që zoti Shala e ka marrë ta udhëheqë Ministrinë dhe kam pritur shumë që përvoja e tij në zhvillimet në Sektorin e Financave, dhe posaçërisht përvojat që ka bërë në institucionet e ndryshme ndërkombëtare, do t'i ndihmojë që sot të kemi një kornizë afatmesme të shpenzimeve shumë më të mirë se sa këtë dokument të cilën e ka sjellë për ta diskutuar në Parlament. E ndiej vetën shumë keq, them, me këtë dokument, duke u bazuar në përvojat profesionale të ministrit dhe duke u bazuar në grupet profesionale që gjenden afër, në Ministrinë e tij, se çka ka ndodhur në këtë drejtim, unë nuk mund ta di ?

Mirëpo, një gjë dua të them që në këtë kornizë ka mjaft elemente të cilat janë transparente, që për herë të parë thuhet. Sa i përket zhvillimit ekonomik, është thënë që varianti më i mirë, në qoftë se shkohet, kemi një rritje 3 deri 4%, është kështu, do të thotë, varianti optimist i zhvillimit ekonomik të Kosovës në vitet e ardhshme mund të jetë 3 deri në 5%, kurse rritja e numrit të njerëzve që hyjnë në treg është diku 29.000 qytetarë brenda një viti. Dhe tani shtrohet pyetja, si mund të kemi një progres ekonomik ku rritjen në variantin më të mirë kemi 3 deri në 4%, kurse kemi brenda vitit, në tregun e punës hyjnë 29.000 njerëz të rinj dhe këtij problemi kur i shtojmë edhe problemin e arsimit, që është potencuar në këtë kornizë në mënyrën më të thukët, më decitive se kjo politikë dhe ky sistem i arsimit, nuk është duke përgatitur njerëz për tregun e punës, atëherë, realisht, kemi probleme me faktorin njeri në konceptin e ndihmës për zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Ky është një problem serioz të cilin ne duhet ta analizojmë dhe të shqyrtojmë, do të thotë, këto që unë sot po them, nuk e them nga zëri opozitar, por po e them nga dokumenti, i cili është sjellë për ta diskutuar, se politikat e arsimit janë politika të cilat, për momentin, nuk janë duke reflektuar zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe nuk janë duke përgatitur njerëz për tregun e ri të punës.

Një problem tjetër që për mua, e kam theksuar edhe herën e kaluar, është vizioni zhvillimor, çfarë, si dom të arrijmë që të kemi një buxhet më të fuqishëm për shtetin e Kosovës. Në qoftë se i kemi paraparë zhvillimet, të hyrat, shihet se në vitin 2010 sa do të kemi të hyra në vitin 2011 dhe 2012. Këto të hyra janë tepër të vogla. Kemi rënie të investimeve të huaja. Zoti Shala, duhet të bëjmë diçka që të mos kemi rënie të investimeve të huaja, sepse flasim për 10% të rënies të investimeve të huaja, në krahasim me vjetët 2007-2008. Më duket që këtu Qeveria ka gabuar në politikat që kanë të bëjë me tërheqjen e investimeve të huaja.

Po ashtu, kemi rënie edhe nga të hyrat nga diaspora, të cilat janë rreth 7%. Këto dy kategori janë ndikuese në krijimin dhe forcimin e mëtutjeshëm të Buxhetit të Kosovës. Problemi tjetër që unë e shoh, është Sektori i Energjisë dhe i Minerave. Ne kemi menduar se duke zhvilluar projektin "Kosova C", "Kosova e Re", do të arrijmë që shpenzimet në sektorin e energjisë të lirohen dhe sektori privat ta marrë përsipër, bashkë me Qeverinë, që ta realizojnë projektin dhe që brenda këtyre dy vjetëve ne u detyruam të ndajmë afër 200 milionë euro buxhet për Sektorin e energjisë dhe kjo është kostoja që po e paguajmë për shkak të vonesës që jemi duke bërë në projektin "Kosova e Re". Pra, në këtë drejtim, ky ngadalësim që është duke u bërë, do të na kushtojë në vitet

2010, 2011, 2012 edhe disa herë më shumë dhe atë që e kemi thënë do të jemi të detyruar që pjesën dërmuese të buxhetit ta ndajmë për blerjen e energjisë me çmime 112 euro megavatit. 112 euro sot blejmë një megavat orë energji elektrike nga kompanitë e huaja për furnizim më të mirë të qytetarët me energji elektrike. Shikoni sa shpenzojnë buxhet? Dhe problemi tjetër për mua që është shumë i madh, është çështja e “Trepçës.” Edhe këtu Qeveria duhet të marrë masa për riaktivizimin e plotë të kompleksit industrial të “Trepçës”. Të thuhet se përmes kësaj kornize, në tri vjetët e ardhshme do të tentojmë ta ruajmë gjendjen aktuale, është që minierat që dikur kanë sjell profite të mëdha ekonomisë kosovare dhe shtetit të Kosovës, të jenë ende të varura nga buxheti i Kosovës. Prandaj, këtu janë politikat e gabuara që kanë të bëjnë me menaxhimin e dy sektorëve më të rëndësishëm në energji dhe në miniera.

Prandaj, unë ftoj ministrin, ftoj Qeverinë që të bëjnë një plan se si do të përballojë krizën e mundshme buxhetore që është në tri vjetët e ardhshme të planifikuara. Me këtë buxhet, çfarë është planifikuar për tri vjetët e ardhshëm, zoti Kryetar, ne do të kemi një buxhet të varfër për shtetin e Kosovës dhe për të ardhmen tonë. Prandaj, duhet t'i ndërrojmë politikat sa i përket çështjeve më të rëndësishme siç është Sektori i Energjisë dhe i Minierave. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ishalla, pak i shërben shtetit të Kosovës, se deri tani nuk i ka shërbyer. Po e vazhdojmë debatin. Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, le të përgatitet Rita Hajzeraj.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Zoti ministër i Ekonomisë dhe i Financave,

Sot jemi në përfundim të debatit për një dokument shumë të rëndësishëm, që në njëfarë forme përcakton kornizat e zhvillimit ekonomik dhe të zhvillimit të gjithëmbarshtëm të vendit tonë për tri vjetët e ardhshme.

Vërehet, që në fillim, në hyrje të dokumentit, që mungon orientimi i qartë konkret, bile kemi hasur edhe gjuhë profesionale joadekuate. Ky është një dokument që dua të besoj që është hartuar nga profesionistët dhe duhet të keni kujdes tash e tutje si Ministri, por edhe si Qeveri, se çfarë dokumentesh sillen në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Unë dua të ndalem vetëm në disa fusha, në disa politika sektoriale që i ka paraparë korniza afatmesme e shpenzimeve. Ju i paraqitni edhe disa rreziqe, do të thotë financiare që mund ta përcjellin këtë kornizë afatmesme të shpenzimeve. Te importi i energjisë, po citoj: “KEK-u aktualisht pranon subvencione substanciale nga buxheti, vendimi se si do të ecet me “Kosovën A, dhe B” ende është në pritje.” Nëse aty do të ketë vonesë, thuhet në këtë dokument, “subvencionet e mëturtyshme për energji do të jenë të nevojshme”. Këtu është një mungesë totale e vizionit të Ministrisë së linjës dhe të Qeverisë se si duhet t'i qasemi problemit të zgjidhjes së furnizimit me energji të vendit, por edhe politikave sa i takon zhvillimit të sektorit të energjisë në përgjithësi. Qe një vit e gjysmë vonohet me një projekt që është trumbetuar shumë dhe keni premtuar edhe gjatë fushatës elektorale dhe po hymë në vitin e dytë, po e përmbysim edhe pak të qeverisjes dhe nuk ka asgjë konkrete, asnjë lëvizje substanciale drejt “Kosovës së re”, sepse iu ndërrua edhe emri. Dhe po të fillohet sot, zoti ministër, të ndërtohet Termocentrali “Kosova e Re” 500 megavat e tutje do të duhen 4 në 7 vjet dhe ju lutem kjo kornizë afatmesme e shpenzimeve, duhet t'i parashohë, nuk ka as dinamikë kohore as forma se si do të implementohet ky projekt.

Pastaj, te rezervat e stabilizimit, FMN-ja rekomandon që Qeveria duhet ta rrisë rezervën e saj të stabilizimit në 9% të bruto produktit vendor, që nënkupton 375 milionë euro në vitin 2010. Dihet që janë ndarë 200 milionë euro rezerva shtetërore dhe tash jemi anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe për pak ditë presim ta nënshkruajmë këtë marrëveshje dhe si anëtar me të drejta të plota dhe të barabarta kemi edhe obligime dhe duhet të respektohen kërkesat dhe kriteret, por edhe trendët që i përcjellin vendet anëtare të barabarta të FMN-së edhe ne si Kosovë. Nuk di ku do të gjenden këto mjete buxhetore që kjo kërkesë të respektohet.

Pastaj, edhe te anëtarësimi në FMN dhe në Bankën Botërore, 37 milionë euro duhet të paguhet, po citoj: “me nënshkrimin e anëtarësisë, gjersa vlera totale e shumës që duhet paguar është 154 milionë euro dhe duhet brenda 6 muajve pas nënshkrimit”. Ku do t’i merrni këto mjete, zoti ministër dhe si do ta kryejë këtë obligim ndërkombëtar Republika e Kosovës?

Pastaj, te indeksimi i pensioneve. Rekomandimi kryesor, po citoj: “që del nga dokumenti i fundit për politikën sociale, letra e bardhë që ende nuk është askund dhe është duke u hartuar, i hartuar nga Grupi punues ndërqeveritar, është indeksimi i skemave pensionale dhe të asistencës sociale për vlerë të inflacionit. Implementimi i këtij rekomandimi, do të rezultonte me kosto shtesë buxhetore në vlerë të rreth 20 milionë euro në vit” Edhe këtu nuk parashihet konkretisht se si do të mbulohet ky projekt dhe ku do të merren çdo vit këto 20 milionë euro, sepse nuk e dimë sa do të jetë fizibil projekti i letrës së bardhë, i hartuar nga Komisioni Ndërministror. Dhe një problem shumë serioz që po i shqetëson të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, është shëndetësia. Po e citoj dokumentin: “Financimi i qëndrueshëm dhe i mjaftueshëm i sektorit shëndetësor është rekomandim tjetër që del nga letra e bardhë. Ky dokument sugjeron që buxheti për shëndetësi të shtohet rreth 30 milionë euro, krahasuar me shumën e aprovuar për vitin 2009. Në të njëjtën kohë, buxheti parasheh implementimin e Ligjit për sigurim shëndetësor, i cili kërkon mjete shtesë. Kjo nënkupton që deri në vitin 2010, do të kemi gjendje të tillë shëndetësore, nuk do të kemi fond për sigurimet shëndetësore dhe ashtu sistemi shëndetësor i degraduar i vendit, do të kalojë në kolaps të plotë.

Pastaj, te sektori i Minierave dhe Mineraleve, zoti ministër, është një mungesë e vizionit edhe politikë e gabuar plotësisht që të thuhet se do të tentojmë ta mbajmë këtë gjendje, këtë status quo, në minierën e” Trepçës” po edhe sektorin minerar në vend. Nëse Kosova mund të krenohet se ka pasuri natyrore, ato janë minierat dhe mineralet e Kosovës dhe nuk ka asnjë lëvizje pozitive, asnjë hap konkret që do të jepte shpresë, por edhe do të krijonte një ambient të volitshëm edhe për investitorët e mundshëm të huaj dhe ky sektor pothuaj se është degraduar në tërësi.

Te Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që konsideroj se Qeveria do të duhej t’i kushtonte rëndësi të jashtëzakonshme, sepse dihet që rreth 25% të bruto produktit vendor vjen nga ky sektor, edhe këtu është një dokument i paqartë, pa mbulesa konkrete buxhetore, pa dinamikë të caktuar kohore.

Sa i takon Sektorit të Mirëqenies Sociale edhe këtu mund të shohim dëshira të mira të Kabinetit qeveritar, mungesë legjislationit adekuat. Kemi ligje bazike, të cilat as që ka gjasa të procedohen në Parlament, dhe me këtë trend dhe sipas këtij dokumenti që ne deputetët e kemi në dorë, do të kemi një gjendje katastrofale sa i takon: politikave sociale, skemave të ndihmës sociale, pensioneve, pensioneve invalidore, të drejtave në

punë e të tjera. Unë sugjeroj që këto ministri që i potencova, duhet urgjentisht të ulën dhe t'i rishikojnë politikat dhe orientimet e tyre.

Te Ministria e Shëndetësisë, po citoj: “Sisteme joadekuate të menaxhimit për sigurimin e një performance të kënaqshme dhe shërbime cilësore si dhe vështirësitë në llogaridhënie që rrjedhin nga mungesa e qartësisë së roleve dhe përgjegjësi të institucioneve shëndetësore dhe individëve”. Ju lutem a ka logjikë në këtë Qeveri dhe në atë Ministri se çka shkruhet në një dokument zhvillimor, që do të duhej të ishte si udhërrëfyes për zhvillimin e vendit gjatë tri vjetëve të ardhshme.

Vetëm shikoni se çka keni futur në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, zoti ministër! Kjo është për të ardhur keq. Thuaj se Ministria e Shëndetësisë funksionon në baza vullnetare dhe nuk ka fare përgjegjës në atë dikaster të Qeverisë së Kosovës.

Sa u takon investimeve kapitale në shëndetësi, vazhdon kënga e vjetër e investimeve joracionale në formë të piramidës së përmbysur. Ekonomistët e dinë këtë nocion çka është piramida e përmbysur, që do ta fundosë edhe më tej sistemin shëndetësor të vendit edhe ashtu mezi po mbijeton. Pastaj edhe në politikat e tjera sektoriale, siç janë: planifikimi hapësinor dhe mbrojtja e mjedisit, nuk janë paraparë politika kreative dhe aktive, që do të mund të ndikonin në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarit, por edhe në mbrojtjen e tij. Ka mungesë të dinamikës kohore, mungesë të legjislacionit adekuat dhe mungesë të qasjes se si do të implementohen këto dëshira që janë paraqitur në këtë dokument. Dhe për fund nga një analizë e kujdesshme e kësaj kornize afatmesme të shpenzimeve, dalin paqartësi të mëdha, qoftë në prioritet, qoftë në planifikime buxhetore, qoftë në dinamikën kohore. Ka disproporcion të madh në mes prioritetëve dhe parashikimeve buxhetore, po thuaj se në të gjitha ministritë e linjës, sidomos: te Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe decentralizimi, që sigurisht që do të dështojë edhe ky proces sipas kësaj kornize, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor dhe në parim i sugjeroj ministrit- Qeverisë që ta shikojnë realisht hartimin, plotësimin dhe vërejtjet serioze të deputetëve, sa i takon këtij dokumenti dhe unë në parim nuk e përkrah. Ju faleminderit!

KRYETARI: Unë kisha dëshiruar që t'i njoftojmë deputetët që të konsultohen me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, sidomos me nenin 19, ku shkruan:” Përgatitjet e Kornizës afatmesme të shpenzimeve”, është gati gjysmë faqe e pak më tepër dhe ta shikoni se cilat janë obligimet e Parlamentit me ligj.

Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj, le të përgatitet deputeti Ibrahim Makolli.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Korniza afatmesme e shpenzimeve, sot po e diskutojmë një dokument shumë të rëndësishëm dhe besoj se duhet të kemi më shumë vëmendje, me qëllim që të përmirësohet në shumë drejtime. U tha që në këtë dokument ka shumë probleme, sidomos në prioritet strategjike. Nxjerrja e prioritetëve në Kornizën afatmesme të shpenzimeve, pa një dokument zhvillimor të Kosovës afatgjatë, i bën këto prioritate pak

të besueshme dhe mundësia e efekteve direkte në sektorë të ndryshëm do të jetë shumë e vogël.

Un po ndalem në disa sektorë që për AKR-në janë prioritet i lartë, ndërsa në këtë dokument janë të papërfillshëm. Po filloj me rininë. Rinia është problem ndërsektorial dhe si i tillë kërkon një qasje ndërsektoriale. Po të analizohet mirë buxheti që rritet për Departamentin e Rinisë, është aq i vogël sa që po të llogaritet për kokë të riut, diku 54 deri në 56 cent për një vit i takon një të riut.

Ju e dini që për Kosovën rinia është aseti kryesor ekonomik. Ju lutem, kolegë të nderuar, keni vëmendjen për këtë kategori të shoqërisë. Po ju kujtoj këtu se në vitin 1978, në Kosovë është ndarë 1% e buxhetit për bursa për të rinjtë, sot shihni kolonat se sa ndahet buxhet në këtë drejtim. Një problem tjetër i madh i kësaj shoqërie është edhe edukimi shumë i dobët, këtë, fatkeqësisht, e vërtetoi edhe provimi i maturës. Me këtë kalueshmëri minimale dhe me këtë buxhet që po i ndahet prapë edhe për një kohë të gjatë, do ta kemi të njëjtin problem. Unë jam që arsimin, vërtet, ta shndërrojmë në prioritetin kryesor kombëtar si instrument zhvillimi, por jo me fjalë siç po ndodh sot, por me punë dhe buxhet.

Kosova ka shumë nevojë që të ketë një popullatë të edukuar mirë dhe të konkurrueshme në tregun rajonal dhe më gjerë, andaj, propozoj që ky buxhet të rritet dhe të shkojë deri në 5% të buxhetit të përgjithshëm.

Kolegë, ju po i përcillni mediat dhe pa ashtu, po t'i referohem tabelës së investimeve, mund ta shihni qartë se mjetet kryesore për arsimim shkojnë në ndërtimin e shkollave, ndërsa për sektorët e tjerë siç janë bursat dhe kërkimet shkencore, shumë pak e të mos them fare hiq. Një problem tjetër, i cili është shumë shqetësues është edhe shëndetësia, prapë nuk është prioritet i Qeverisë.

Duke parë buxhetin dhe duke parë KASH-in i cili i ka dhënë një vëmendje mjaft të pa veçantë dhe pafavorshme shëndetësisë, ne shohim se shumë ligje, sidomos Ligji për sigurimin shëndetësor, i cili është paraparë në strategjinë e Qeverisë që të vijë për vitin 2009, sipas KASH-it ky ligji nuk do të mund të vijë dhe nuk do të mund të aplikohet për shumë vjet me radhë dhe besoj se s'do të vijë as dy tri vjetët e ardhshme.

Një problem tjetër që po e përcjell shoqërinë kosovare që nga paslufta është edhe sundimi i Ligjit, problem që po përmendet në shumë raporte ndërkombëtare, sidomos në këtë të fundit që e propozoi Departamenti i Shtetit. Në faqen ku janë të vendosura prioritetet në formë grafike, sundimit të ligjit i është dhënë prioritet, por nëse ne e analizojmë sektorët të cilët janë të ndërlidhur me sundimin e ligjit se sa po ndahet buxhet, nuk u vëmë prioritet të besueshëm, sidomos kur kemi parasysh gjendjen e mjeruar të gjykatave dhe të institucioneve të pavarura, të cilat ndihmojnë që Kosova të jetë shtet ligjor dhe demokratik.

Ju lutem kolegë, ta analizojmë më mirë për këtë segment si pozitë dhe opozitë se është prioritet i të dyja palëve. Është prioritet i shtetit të Kosovës, është prioritet i qytetarëve të Kosovës, sepse në Kosovë jetojnë të gjithë, andaj propozoj që buxheti për Prokurorinë, shëndetësinë, gjykatat, Policinë dhe Agjencionin për Antikorrupsion të rritet, me qëllim që këta sektorë të mos jenë pika e zezë në shoqëri. Uroj që mbas diskutimit të Kornizës afatmesme të shpenzimeve apo të KASH-it, shumë shpejtë të diskutohet në këtë Kuvend edhe për strategjinë zhvillimore si dokument afatgjatë dhe kështu do të dinim se

në cilët sektorë kanë mbështetje të gjerë politike dhe shoqërore, se pavarësisht, me ndërrimin e qeverive apo kryeministrave, do të ishim sektor me prioritet dhe kështu aty do të mbetej dhe puna do të vazhdojë më tej. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Ibrahim Makolli, le të përgatitet Gani Buçinca.

IBRAHIM MAKOLLI: I nderuar zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

U tha shumëçka përkritazi me këtë dokument të cilin po e shqyrtojmë, e që me plot të drejtë u vlerësua si dokumenti me rëndësi të veçantë. Unë do të përqendrohem vetëm në një fushë, të cilën konsideroj se Qeveria do të duhej ta kishte në konsideratë, sepse paraqet një nga shtyllat më të forta për zhvillim ekonomik të vendit, e që ky sektor është bujqësia, gjendje në të cilin ne të gjithë tashmë jemi të vetëdijshëm që ekziston.

Në këtë dokument Qeveria ka paraparë katër synime themelore, të cilat do të ndihmonin në zhvillimin e këtij sektori, por që sugjerimi ynë do të ishte që pikërisht këtij sektori t'i kushtohet një rëndësi e veçantë, sepse mund të jetë profitabil, mund të jetë një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit, por po ashtu mund të jetë edhe një faktor shumë i rëndësishëm në krijimin e vendeve të reja të punës aq shumë të nevojshme për vendin. Besoj që Qeveria është dashur të ketë parasysh sidomos pakënaqësitë e këtij sektori, i cili ka mbetur pothuaj se i pambuluar deri me tash dhe sugjerimi ynë është që pikërisht në përpunimin e këtij dokumenti, kësaj fushe t'i kushtohet një rëndësi e veçantë që të jetë një nga shtyllat kryesore të cilat do të mund ta ndihmonte zhvillimin e Kosovës. Nëse Kosova nuk e ka mundësinë që të zhvillojë një teknologji të lartë të industrisë, megjithatë Kosova është e mjaftueshme, ka potenciale, ka resurse edhe njerëzore edhe natyrore që pikërisht këtë sektor shumë të rëndësishëm për zhvillimin e një vendi, ta ketë në vëmendje edhe ta caktojë si një ndër prioritetet kryesore në zhvillimin ekonomik të vendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Gani Buçinca nuk është këtu. I fundit nga lista e mbetur, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Shumë kolegë të mi edhe në pjesën e parë të kësaj seance, javën e kaluar, por edhe sot kanë thënë shumë, unë do të provoj të jem i shkurtër dhe ta jap vetëm përmbledhjen e mendimeve. Fillimisht duhet të vërej se nuk ka vullnet prej njerëzve të Qeverisë që të përgjigjen në pyetjet konkrete, e po gjithmonë duhet të hapet konteksti me çështje të çuditshme.

Tani, ajo që shohim ne në këtë kornizë, është se më tepër kemi të bëjmë me një ridrejtim të shpenzimeve qeveritare se sa me një Kornizë e cila në vete përmban një strategji zhvillimore afatgjatë, do të thotë, elemente të cilat në një afat më të gjatë do të jenë projeksion i një afati më të gjatë të zhvillimit, do të thotë nuk ekziston një zhvillim dhe korniza nuk shërben për atë që është paraparë, që të ridrejtojë ose të bëjë ndryshime të vogla në proceset afatgjata zhvillimore. Përkundrazi, në proceset afatgjata zhvillimore të parapara më herët, janë ndërprerë dhe me këtë kornizë realisht, sikur në shumë sfera të tjera tentohet që të niset krejt nga zeroja dhe të minimizohet krejt çka ka ndodhur në të kaluarën, në fund të fundit edhe të fshihet.

Nëse i shihni projeksionet e viteve të kaluara, vetëm prej 1 janari të vitit 2005 deri më 1 janar 2008, do të thotë, për tri vjetët e Qeverisë së kaluar, prej 600 milionë eurove, buxheti ka shkuar 1.1 miliard dhe shihet se cila ka qenë rritja vjetore. Tani, nëse e shihni rritjen vjetore për tri vjetët që vijnë, të projektuar nga kjo Qeveri, i kemi diku 100 milionë, që do të thotë se ka ulje të projekcionit për diku 80%. Tani dikush e shtron pyetjen pse ka ndodhur kështu, pse mund të ndodhë kështu? Një përgjigje të cilën mund ta marrin e vetme është se Qeveria është nisur në projektion 3 -vjeçar prej performancës të vitit të kaluar, performancë për të cilën kemi folur në Raportin e buxhetit të vitit të kaluar.

I kisha sugjeruar ministrit të Financave që ta tërheqë këtë kornizë, se kjo nuk është kornizë fare, ka shumë defekte edhe teknike. Nuk do të mund të implementohet absolutisht fare, për shkak se nuk është harmonizuar me asnjë politikë sektoriale. Nëse dikush fillon dhe i bën analizë sektorëve të ndryshëm, do të shihni se është një pësjtjellim total i asaj që mund të quhej si pjesë e strategjisë.

Kryetari i Kuvendit tha se sot nuk aprovohet ose sot nuk përfundon aprovimi. Ashtu qysh e kuptojmë ne, kur i vjen për miratim Kuvendit një dokument i Qeverisë, në momentin që Kuvendi voton, ai dokument është i aprovuar dhe sot, nëse Kuvendi voton, korniza aprovohet ose nuk aprovohet dhe atëherë mundet ministri të vazhdojë ta kryejë punën ndryshe. Mendoj për ta përmbyllur, mund të them vetëm dikush mund t'i shohë politikat në miniera dhe politikat në energji që janë dy sektorë më strategjik të zhvillimit afatgjatë të Kosovës. Pra, e shihni në miniera, ashtu siç ka ndodhur që 20 muaj, është bllokim total i zhvillimit, ndërsa në miniera taksativisht kjo Qeveri kërkon ta ruajë gjendjen ekzistuese, e keni të shkruar në dokument, nëse dikush dyshon, kjo është diçka që me të vërtetë duhet të potencohet disa herë. Nuk guxon të jetë as gabim i një Qeverie në Kosovë, as gabim po them, as gabim teknik nuk guxon të lëshohet kur dikush thotë se duhet ruajtur gjendjen ekzistuese në minierat e Kosovës.

Çështjet që do t'i kisha cekur prapë, është se nuk parashihen rritje sukseseve as të pagave, as të pensioneve, as të ardhurat e tjera për njerëz të cilët janë realisht në gjendje të mjerueshme. Nuk parashihet as përmirësim i gjendjes së policëve, as përmirësim i gjendjes të mësuesve, e të mos flas për shëndetësi. Shihni se çka ofrohet për 3 vjet që vijnë. Edhe një herë po them, jo vetëm se nuk e votojmë një gjë të tillë, por sugjerimi ynë është të tërhiqet, të mblidhen njerëzit që dinë pakëz ta hartojnë një projektion tjetër dhe të na e sjellin në Kuvend dhe të shohim atëherë çka ndodh. Kjo që e kemi sot, me të vërtetë është, jo vetëm qesharake, por është e mjerueshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Të nderuar deputetë, nga ajo që na njofton administrata, debati ka mbaruar. Dëgjoni, ju do të vendosni, se unë shumë e respektoj demokracinë, por dëgjoni se unë i kam dy tri fjalë t'i them. Shikoni, me ligj, edhe pse Komisioni dhe Qeveria në materialet që i kanë sjellë, kanë thënë për miratim, por ligji nuk parasheh miratimin e Kornizës afatmesme të shpenzimeve. Kjo miratohet me Buxhetin e vitit 2010. Unë po flas në bazë të ligjit, nuk po flas sipas dëshirave dhe vullnetit tim, por me ligj. Ligjin e keni, lexojeni neni 19, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. A jeni dakord ta mbyllim debatin dhe t'ia japim fjalën ministrit të përgjigjet... Unë veç dua t'ju them edhe një gjë, administrata më njofton se edhe disa që po e kërkojnë fjalën, e kanë marrë fjalën, pra e kanë kryer në seancën e kaluar. Disa, nuk po them krejt. Kjo është e para, e dyta, nuk mund kur të donë ta marrin fjalën, kanë qenë të lajmëruar për debat, emrat i lexova.

(Reagim nga salla)

Unë nuk i kam hequr, administrata m'i ka prurë dhe unë po flas....

(Reagime)

Unë i kam në letër dhe po flas në bazë të saj. Urdhëro, deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zëvendëskryeministër,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Zoti ministër Shala,

Do të doja për të konfirmuar edhe një herë që Kryetari konfirmoi vetëm aspektin ligjor të diskutimit, të debatimit të Kornizës afatmesme të shpenzimeve sipas ligjit dhe ne e kemi dhënë qëndrimin tonë në parim për mbështetje të kësaj kornize dhe kontributin tonë përmes deputetëve që vërtet të pasurohet kjo kornizë, në mënyrë që procesi i dëgjimeve, i debateve dhe i angazhimeve të tjera institucionale rreth përgatitjes së Projektbuxhetit për vitin 2010 të shkojë sipas tabelarit apo sipas angazhimeve që kërkon ligji në fuqi.

Këtë parim, KASH- i sigurisht është pjesë procesit shumë të rëndësishëm dhe përfshirja e Parlamentit në këtë proces, në mënyrë që me kohë të jetë i përgatitur dhe i diskutuar ky proces.

Më lejoni të konfirmoj edhe njëherë që prioritetet janë shumë të rëndësishme për këtë proces, prioritetet që vendosen nga ana e Qeverisë, e cila, jo vetëm që i involvon obligimet e saj përmes letrës të nënshkruar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, tashmë është edhe anëtare e këtij institucioni ndërkombëtar, sepse Kosova ka qenë e përfshirë edhe më herët përmes këtij institucioni në vendosjen e kriterëve të domosdoshme. Ne e mbështesim plotësisht angazhimet tona në rishikimet eventuale të prioritetëve, meqë: shëndetësia, arsimi, sundimi i ligjit, bujqësia, pushteti lokal, janë prioritate të domosdoshme që duhet të shikohen edhe në procesin e Projektbuxhetit për vitin 2010, por do të kenë kohë që me ministrin, përmes ministrit në Qeveri, angazhimet tona konkrete edhe në shikimin e investimeve kapitale që parashihen nga ministrinë përkatëse, në regjione përkatëse, sektorë përkatëse, në infrastrukturë dhe angazhimet krejt konkrete.

Edhe njëherë dëshiroj ta konfirmoj qëndrimin parimor të Grupit Parlamentar të LDK-së, që ne jemi që ky proces të mbarëvajtë ashtu siç e parasheh ligji dhe zotohemi që do të përfshihemi, do të involvohemi domosdoshmërisht në rishikimin e prioritetëve, domosdoshmërisht në mënyrë që ky proces, vërtet, të përmbyllet në fund të këtij viti- në nëntor sipas kalendarit me votim dhe me miratim dhe jemi të gatshëm që në vitin tjetër të fillojmë zbatimin e këtij buxheti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! A jeni dakord ta vazhdojmë debatin?

Mirë, atëherë vazhdon debati. Naim Maloku do ta udhëheq seancën.

Drejtimin e seancës e merr Naim Maloku, anëtar i Kryesisë.

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit!

Vazhdojmë me debatin me pikën e dhjetë të seancës. Fjalën e ka deputeti Driton Tali, përgatitet deputeti Adem Salihaj.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Të nderuar të pranishëm, pasi që kemi këtu ministrin, do t'ia jepja një përgjigje, se shpesh ky dhe disa ministra të tjerë arsyetohen sa herë që t'iu bëhet një pyetje konkrete, për një çështje të caktuar për ndonjë agjencion apo për ndonjë institucion të caktuar të rëndësishëm shtetëror, me atë se ju, të nderuar deputetë, keni votuar. Unë do të doja ta lusja ministrin që të jetë i saktë, thotë se ju, të nderuar deputetë të shumicës apo të koalicionit qeveritar, keni votuar, e të mos na fus të gjithëve me një thes për shkak se unë, në rastin konkret ishte rasti, pyetja për letrat me vlerë, nuk kam votuar për këtë Bankë Qendrore me këto kompetenca që i ka, por edhe disa të tjerë afër meje. Po ashtu, nuk kemi votuar për bordet e ndryshme të agjencive, andaj nuk është faji ynë për gabimet e mundshme që i bëjnë ata, apo për shkeljet që i bëjnë dhe zoti ministër, por edhe ministrat e tjerë le të përgjigjen në pyetjet konkrete të cilat u parashtrihen.

Sidoqoftë, sa i përket Kornizës afatmesme të shpenzimeve, për shkak se shumë gjëra u thanë këtu, unë do të ndalem vetëm te projektimi dhe parashikimet apo prognozat, për shkak se kjo është ajo që më së miri e shpjegon nivelin e ekspertizës apo të profesionalizmit në këtë ministri, po edhe në këtë Qeveri, në përgjithësi. Por, paraprakisht më lejoni që ta bëj një pyetje se kush ishte ai gjeni, kush ishte ai ekspert që e vlerësoi Postën 500 milionë euro dhe shpërndarjen, distribuimin për 30 milionë apo 50 milionë euro? Them këtë, duke pasur parasysh se Posta vjet ka pasur vlerën 1 miliard dhe ky menaxhment i tashëm, ditë për ditë na deklaronte se bën rritje të vlerës së Postës, domethënë, pritet që sipas deklaratave të përgjithshme të menaxhmentit të Postës, që vlera e Postës të jetë më e madhe se vjet, të paktën 1 miliard e 200 milionë, e jo 500 milionë. Mbase, dikush ka pasur për qëllim që një herë ta testojë opinionin me 500 milionë, që pastaj të thotë se vlen 250-300 milionë, për ta shitur në fund 150 milionë, 200 milionë, do domethënë, njëfarë hajnie, siç po shkon gjithmonë me këto ndërmarrjet tona publike.

Sidoqoftë, po i kthehem Kornizës afatmesme të shpenzimeve. Siç thashë, prognoza apo parashikimi i indikatorëve tregon atë farë profesionalizmin që është në MEF. Të nderuar, ta marrim ta krahasojmë këtë kornizë me seancën e 25 nëntorit. Kush nuk e di, më 25 nëntor e kemi miratuar këtë buxhet nga votat e deputetëve, zoti ministër, të koalicionit shumicë, domethënë opozita nuk e ka votuar këtë. Do të shihni se sa shumë ndryshime të parashikimeve ka pasur, domethënë, brenda 5 muajve, për shkak se kjo kornizë afatmesme, siç po shihet, është miratuar më 30 prill nga Qeveria, dhe derisa ka shkuar te Kabineti qeveritar, kanë qenë disa javë në pyetje. Veç merreni dhe shikoni, po them, Buxhetin e vitit 2009, vlerat, figurat, shifrat apo merreni transkriptin e asaj seance, faqen 12, paragrafin e fundit.

Ja, se çka deklaronte ministri Shala për vitin 2009. Parasheh rritje ekonomike për 6%, po flasim për 4 muaj më parë, rritje të konsumit 6%, rritje të investime për 27%, rritje në eksport për 17%, rritje të importit për 13%, ndërsa rritja reale e bruto produktit për 6%. Pra, këto prognoza, këto parashikime, me kryelartësi, me krenari, eksperti Ahmet Shala i jepte më 25 nëntor të vitit 2008, atëherë kur edhe fëmijët e klasave, të mos them të foshnjores, por të klasave fillore e kishin kuptuar se është një krizë shumë e madhe në Kosovë dhe Kosova është shumë e vonshme në kuptimin e konsumit ndaj produkteve të jashtme.

Nëse ju kujtohet, unë këtu e kam pas konfrontuar ministrin për mosdije, disa deputetë bajagi u rebeluan dhe thanë se do ta lëshojnë mbledhjen, e tjera, e tjera, por ja se unë

kam pasur të drejtë. Dhe, tash çka thotë eksperti Ahmet Shala, në Kornizën afatmesme, e kemi në faqen 12, mund ta lexoni. Siç po shihet, numri 12 për zotin Ahmet Shala është baksuz. Ja, çka thotë: "Nuk do të kemi rritje të investimeve për 27%, por do të kemi 12.2%", veç analizoni numrat. Unë ua kam llogaritur, ndonëse nuk i keni dhënë me përqindje, por unë ua kam llogaritur ato, domethënë ia ka huqur në prognozë për 56%. Pastaj thotë, nuk do të ketë rritje të eksportit për 17%, por për 1.81% , pra këtu huqje kemi apo gabim në parashikim 89.4%.

Shikoni, një ministër, po e marrim i Amerikës të kishte qenë Ahmet Shala, kishte për ta bankrotuar krejt ekonominë globale me këto parashikime, me këtë ekspertizë të tij që e ka. Po vazhdojmë. Thotë se rritja e importit do të jetë, nuk do të jetë 13% tash me këtë kornizë, por do të jetë 7.7%, do me thënë, edhe këtu ia ka huqur prognozës për 40.7%, gjersa thotë konsumi tash nuk është 6%, ashtu siç tha para 4 muajve, por 4.5%, domethënë, po ashtu, këtu ndryshime apo huqje, gabim në parashikim për 25%, kurse thotë, rritje reale të bruto produktit nuk do të jetë 6% por 4%, domethënë 33.3% huqje të parashikimeve. U mor vesh, nëse edhe 4% do t'i kemi pra, unë as këtyre shifrave të kësaj kornize nuk jam kah u besoj për shkak të nivelit. Domethënë për 4-5 muaj janë këto ndryshime, tash, ec e besoj për 2-3 vjet e ardhshme këtyre statistikave që na i kanë dhënë këta ekspertë.

Shikoni, sipas Entit Statistikor, këtë muaj kishim deflacion apo inflacion negativ 4.4%. Ngjashëm ishte muaji i kaluar, në realitet 3.5% kishte deflacion. Muaji i kaluar, po ashtu, po flas për janar e shkurt, domethënë ulja e çmimeve apo deflacioni do të vazhdojë nga fakti se çmimet e mallrave janë duke rënë në tregun evropian, por edhe më gjerë, për shkak të krizës dhe, siç dihet, në Kosovë pothuaj se çdo gjë konsumojmë, domethënë atë që e konsumojmë, e ka prejardhjen nga jashtë, domethënë deflacioni edhe më tutje do të importohet, gjersa remitencat, po i marr dy indikatorë, do me thënë paratë që na i sjellin diaspora, si një faktor shumë i rëndësishëm në konsumin kosovar, krahasuar me kohën e njëjtë të vitit të kaluar, janë shumë më të ulëta dhe ky trend do të vazhdojë. Pra, në njërin anë do të kemi çmime më të ulëta dhe, në anën tjetër, do të kemi kërkesë më të ulët se vjet për shkak se konsumatorët kosovarë kanë para më pak, do me thënë kjo nënkupton konsum më pak, çmime më të ulëta, që nënkupton tatim më pak dhe buxhet më të vogël.

Andaj, unë nuk jam kah e kuptoj se si keni ardhur deri te shifra 4.5% të rritjes së konsumit sivjet, apo rritjet e të hyrave në buxhet për 8%, ashtu siç kishit premtuar, zoti ministër, me 25 nëntor. Gjithmonë i referohem faqes 12 të, mendoj të buxhetit atje. Tash në këtë Kornizën afatmesme të shpenzimeve, na premtoni se në vitin 2010 do të ketë rritje të të hyrave për 8% më shumë se në vitin 2009, saktësisht 7.6%, e kemi tabelën 4, faqe 16, kurse rritja e të hyrave tatimore do të ketë 8.6%, saktësisht 8.59% më shumë 2010 ose 2011. Madje, parashihen që të hyrat në kufi që rriten për 40% në vitin 2012, krahasuar me vitin 2008.

Sinqerisht, kur njerëzit e këtyre gjërave i lexojnë këto shkraba, thonë me vete pse merren këta njerëz, këta të gjorë me këto punë kur nuk e dinë, pse prodhojnë kësi dokumenti që është i kotë, nuk i vyen kujt kurrgjë hiq. Asnjë statistikë nuk është e saktë.

Shikoni, veç ta marrim vitin 2007-2008, krahasimi dhe pastaj do të dal atje që po dua ta them. Nëse e marrim, po them, në faqen 7 e kemi të raportit, buxhetin, kishim rritje 12.7% apo rritje 13% të të hyrave. Pastaj, t'i krahasojmë të hyrat doganore, do të shohim se në vitin 2008, rritje kishte 13.65 apo 14%. Ngjashëm ishte edhe rritja në totalin e të

hyrave tatimore 14%, do me thënë 2007-2008, por inflacioni, të nderuar, ishte 14% vetëm se deri në korrik, do me thënë inflacioni i ka përcjellë në mënyrë të drejtë të gjitha rritjet në fushat buxhetore, sepse po e përsëris edhe një herë, kosovarët të gjithë atë që e konsumojnë, shumicën absolute i konsumojnë produktet huaja...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Adem Salihaj, le të përgatitet deputeti Gani Buçinca.

ADEM SALIHAI: Zoti kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë,
Anëtarë të Qeverisë,
Korniza afatmesme buxhetore është një dokument i rëndësishëm në të cilin janë projektuar vijat kryesore të zhvillimit afatmesëm të Kosovës. Ky dokument kap shumë aspekte, por unë do të ndalem vetëm në disa prej tyre.

Meqë Ministria e Transportit dhe të Postë -Telekomit është vendosur e para në këtë kornizë, unë do të ndalem së pari në këtë pjesë.

Janë disa çështje që më brengosin dhe kërkojnë sqarim. Së pari unë kërkoja me vëmendje, por askund nuk e gjeta vazhdimin e rrugës QMI – Ferizaj – Hani i Elezit, që tregon se nuk është në projekt të Kornizës afatmesme buxhetore të Kosovës dhe kjo jo veç është për brengosje jo vetëm për qytetarët e Ferizajt, por mendoj të gjithë Kosovës, sepse arteria Prishtinë-Ferizaj-Shkup ende është dhe do të mbetet edhe për një kohë arteria kryesore e qarkullimit rrugor të Kosovës për deri sa të mos futet në funksion autostrada Morinë-Durrës.

Mjetet buxhetore të kësaj autostrade janë orientuar në pjesë të tjera të Kosovës sado që, siç thashë, kjo rrugë është e një rëndësie të veçantë për Kosovën. Asnjë rrugë tjetër për nga rëndësia nuk mund të krahasohet me rrugën Prishtinë-Shkup për derisa, siç thashë, nuk hyn në funksion autostrada në drejtim të Durrësit.

Po ashtu, në këtë kornizë katërvjeçare nuk mund ta gjejmë askund autostradën Morinë – Merdar. Pra, sado që e kërkon, nuk do ta gjeni, do ta gjeni diku ku kërkohen mjete shtesë 480 milionë euro, por nuk thuhet ku kërkohen, askush nuk e di ku do të kërkohen këto mjete shtesë, pra nuk janë në Kornizën buxhetore dhe kjo e dëmton, mendoj, shumë aspektin strategjik të zhvillimit të Kosovës dhe integrimin e Kosovës në rajon dhe në Bashkimin Evropian. Kjo tregon, po ashtu, se kjo qeveri ende nuk po ka sens për çështje të mëdha nacionale, që kanë rëndësi strategjike për ne. Ne duhet ta përsërisim punën e Qeverisë së Shqipërisë, e cila po e kryen me sukses autostradën Durrës-Morinë dhe dalja e Kosovës në portin e Shëngjinit ishte dhe do të jetë një sukses shumë i madh dhe mos të harrojmë se kjo ishte pjesë e vizionit largpamës të Presidentit Rugova, i cili me kohë e kishte projektuar këtë.

Sali Berisha dhe Qeveria e Shqipërisë po e kryen me sukses pjesën e saj, sa do që ne e dimë shumë mirë se kishte pengesa, sabotime dhe bojkot nga socialistët e Shqipërisë, të cilët nuk ishin të interesuar të lidhet Kosova dhe Shqipëria me autostradë, por ishin të interesuar që kjo autostradë të shkojë në drejtim të Greqisë.

Ne kemi parë përpjekje nga kabineti i Qeverisë që të thuhet se autostrada Morinë-Merdar është në kornizën afatmesme. Urdhëroni, lexojeni disa herë, nuk do ta gjeni askund përveç që thuhet se kërkohen mjete shtesë diku. Do të thotë, nuk kërkohen kurrkund në

një adresë të saktë dhe unë mendoj që vetëm me mjetet e buxhetit që janë dhënë për KEK-un në vitin e kaluar, këtë vit dhe vitin e ardhshëm do të mund të ndërtohej më shumë se gjysma e autostradës Morinë-Merdar. Nëse këtu i fusim edhe disa mjete që janë dhënë për minierat, për të cilat s'kam asgjë kundër, por ne e dimë që minierat nuk punojnë fare, atëherë do të kryhet në tërësi kjo autostradë.

Por, ne e dimë, po ashtu, që të gjitha këto mjete rreth 400 milionë euro do të avullohen dika, nuk do të kemi përmirësim të furnizimit me energji, s'do të punojnë minierat dhe nuk do të ndërtohet autostrada Morinë-Merdar.

Për importin e energjisë dhe për KEK-un vetëm për vitin 2010 janë planifikuar 77 milionë euro, por për vitin 2011 nuk janë planifikuar mjete buxhetore, sepse planifikohet të shitet KEK-u. Pra, në vitin 2011 nuk do të kemi një kompani publike. KEK-u do të shitet dhe ne do të mbetemi edhe pa këtë resurs të rëndësishëm nacional. Ne e dimë shumë mirë se në KEK janë investuar jo miliona, jo qindra miliona, por miliarda euro dhe sigurisht do ta shohim në fund që do të shitet për një shumë qesharake dhe asnjë efekt pozitiv nuk do të ketë për ekonominë e Kosovës, por do të ketë efekte pozitive për xhepat e shumë njerëzve të cilët, me shitjen e KEK-ut dhe të PTK-së, ndoshta, do të krijojnë pasuri përrallore që s'kanë mund t'i imagjinojnë para dhjetë vjetësh.

Bujqësia është sektori më i përshtatshëm për investime dhe për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në kornizë afatmesme parashihen për investime – quhen investime kapitale - 28 milionë euro, pra për katër vite 28 milionë euro, nga 9 milionë për një vit, dhe këto mjete nuk investohen drejtpërdrejt në zhvillimin e bujqësisë. Këto mjete parashihen të investohen për trajnime, për seminare e tjera, të cilat, siç e dimë, deri tash nuk kanë dhënë ndonjë efekt shumë të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë së Kosovës. Pra, edhe për vitet e ardhshme ne do të konsumojmë prodhime të Serbisë, të Maqedonisë e nuk e di prej nga vijnë dhe nuk do të kemi prodhime tona vendore. Dhe, është një gjë interesante që duhet ta shohim, repartet prodhuese në Serbi kanë vija të veçanta prodhimi për Kosovën. Pra, Kosova furnizohet prej vijave të veçanta prodhuese të Serbisë dhe nuk furnizohet prej atij prodhimi të përgjithshëm që e bëjnë repartet prodhuese në Serbi. Dhe, kjo na shtyn të pyesim - pse ndodh kjo dhe mos është ndonjë qëllim i caktuar për të cilin, natyrisht, kjo Qeveri nuk mendon fare, por mendoj se ka vend të mendojnë qytetarët e Kosovës.

Janë disa përllogaritje se nga bujqësia në Kosovë ose në bujqësi përmes familjeve janë të punësuar rreth 500 mijë njerëz. Me një investim shumë të vogël vjetor, ndoshta, prej nga 50 milionë eurosh do të bëhet një bum në zhvillimin e bujqësisë së Kosovës dhe ne jo vetëm nuk do të importonim prodhime bujqësore, por do ta ruanim fondin tonë të buxhetit dhe do të punësonim një numër shumë të madh të njerëzve në Kosovë. Natyrisht, ka pasur premtime tepër të mëdha nga kjo parti dhe ky koalicion për investime në bujqësi, por ne e shohim që deri në vitin 2012 nuk do të ketë asnjë investim në zhvillimin e bujqësisë në Kosovë.

Edhe të dhënat për Ministrinë e Punëve të Jashtme janë shumë interesante dhe e meritojnë një analizë. Për blerjen e ambasadave janë paraparë një 25 milionë euro...

(Ndërhyrje)

Jo, të lutem, nuk është i saktë ai. Buxheti për ambasada për vitin 2009 është 10 milionë, kurse për vitin 2012, -16 milionë, domethënë, ka një rritje shumë të vogël dhe kjo është

shumë e parëndësishme, tregon se nuk do të ketë një zhvillim serioz të diplomacisë së Kosovës as brenda, as jashtë.

Po ashtu, pensionet e pleqërisë nuk parashihen të rriten gati asnjë cent dhe vetëm pleqtë do të mund të mendojnë si do të jetojnë deri në vitin 2012 me një pension kaq të vogël, siç është tash!

Unë do të ndalem pak edhe te Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Në kuadër të kësaj ministrie janë paraparë të ndërtohen Kompleksi memorial “Adem Jashari,” Projekti memorial i Reçakut, Projekti memorial Morinë-Skenderaj, Kompleksi i varrezave në Krushë të Madhe, Kompleksi “Beteja e Koshares” dhe Kompleksi i varrezave në Kleçkë. Askund në Kornizën afatmesme deri në vitin 2012 nuk parashihet ndërtimi i Memorialit për Presidentin Rugova. Pra, as nuk është paraparë deri tash, as nuk parashihet dhe është e qartë se dikush po tenton ta fshijë memorien, jo vetëm të një partie politike, por edhe të popullit të Kosovës, të cilët me një shumicë gati 100% ishin të radhitur pas projektit dhe vizionit të këtij njeriu. As LDK-ja nuk bën asgjë, sillet si satelit i partisë në pushtet dhe unë kam përshtypje që këta tash as që guxojnë ta përmendin emrin e Presidentit Rugova. Mendoj se s’është në rregull dhe mendoj se kjo është në dëm drejtpërdrejt, jo të një partie politike, po të vetë historisë dhe të interesit nacional të Kosovës dhe të historisë sonë më të re. Ju faleminderit!

KRYESUESI NAIM MALOKU: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, të përgatitet deputetja Mimoza Ahmetaj.

GANI BUÇINCA: I nderuar zoti kryesues,
Të nderuar kolegë,

Vërtet është kënaqësi, e në të njëjtën kohë është edhe paksa e mërzitshme t’i dëgjosh disa eksponentë të ish- qeverive të kaluara, të cilët, sukseset e Qeverisë i përfetojnë si humbje personale dhe nuk kanë të bëjnë asgjë me realitetin për të cilin po diskutojmë, as me dokumentin, as me interesat e qytetarëve, por ekskluzivisht me interesat personale dhe me mentalitete regjionaliste. Regjionalizmin, si një pjesë më të errët të kanunit, dëshirojnë ta shndërrojnë në një normë moderne politike e demokratike, duke përdorur pjesën më të errët të kanunit për interesa mesquine- personale edhe ngrenë këtu ndasi të cilat fare nuk ekzistojnë. Kosovën, Zoti e ka krijuar të atillë që është e pandashme, si në aspektin regjional, sikur në aspektin gjeografik dhe është vetëm sa një lagje e Munihut dhe nuk ka mundësi të bëhen ndarje të tilla dhe të krijohen probleme në mënyrë artificiale për interesa personale. Para se gjithash, ne nuk po e shqyrtojmë një projektligj të buxhetit, por një kornizë buxhetore, jo për katër vjet siç e theksoi disa herë njëri që foli këtu se si duket iu ka ndalur ora atje diku para dy vjetësh. Disa herë tha Korniza afatmesme e shpenzimeve katërvjeçare dhe i frikoi qytetarët dhe i minimizoi shifrat duke i shpërndarë në katër vjet e jo në dy vjet, mirëpo ndodh edhe kjo, këtu ndodh e dëgjon edhe gjëra të tilla. Unë e përgëzoj Qeverinë për të gjitha ato projekte buxhetore, shpenzime afatmesme që janë shumë reale, shumë konkrete, shumë modeste duke u bazuar në rrethanat ekonomike dhe politike në Kosovë edhe në rajon e më gjerë. Dhe, për një gjë tjetër e përgëzoj, veçanërisht, që disa i ish- qeveritarë të qeverive të kaluara prej së ka ardhur kjo qeveri në pushtet janë bërë shumë të mençur, kanë avancuar në aspektin intelektual shumë. Janë bërë shumë ekspertë, janë bërë ekspertë sa që, ndoshta, ia kanë zili edhe shtetet më të zhvilluara në botë, kurse sa ishin vetë në Qeveri nuk i dinin këto gjëra dhe ky është një kontribut shumë i rëndësishëm i kësaj qeverie që i ka nxitur këta ish- qeveritarë që të mësojnë, studiojnë dhe të bëhen ekspertë dhe të propagojnë në mënyrë profetike të ardhmen e qytetarëve të Kosovës. Domethënë, parashikimet e tyre

dhe paragjykimet e tyre për ecuritë politike dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë shkojnë deri aty sa që këta në mënyrë profetike e prognozojnë dështimin e Qeverisë, dështimin e qytetarëve të Kosovës, të popullit të Kosovës dhe e parashikojnë njëfarë kataklizmi, apokalipsi që do të ndodhë në Kosovë. Dhe, a e dini, zonja dhe zotërinj, pse vjen kjo? Kjo vjen vetëm për shkak të miskinitetit të tyre personal, sepse s'ka asgjë të sinqertë në raport me qytetarin e Kosovës, as me zhvillimin ekonomik të Kosovës, asgjë të sinqertë nuk ka aty.

Këtu dëgjova edhe herën e kaluar edhe tash, vetëm diskutime paragjykuese, prejudikuese, me konotacione të theksuara negative. Nuk gjeta asnjë shprehje të këtyre njerëzve që së paku me një fjali thonë këtu kjo qeveri ka bërë diçka të mirë. Dhe, unë ju thashë edhe në seancën e kaluar se teoria politike i identifikon edhe opozitarët edhe oponentët politikë çfarë mentaliteti kanë. Një prej postulateve, një prej kriterëve të mentalitetit tipik komunist është himnizimi ose varrosja e kundërshtarit. Këto janë dy, në sistemet totalitare nuk ka të mesëm. Nuk ka diskutim racional, nuk ka diskutim të balancuar dhe objektiv, mirëpo gjithçka bazohet në propagandë ose e himnizon kundërshtarin e qon në qiell, ose e varros. Dhe, duke u nisur nga kjo përvojë e teorisë politike, të mendimit politik, të përvojave në tranzicion të shteteve, unë vi në përfundim që kjo është një opozitë, me pak përjashtime, është një opozitë tipike- komuniste, e cila nuk zgjedh mjete për ta diskredituar Qeverinë aktuale, programin e saj qeverisës dhe vizionin politik që e ka. Dhe, duke e përfunduar, ju kisha lutur, të nderuar kolegë, ndryshojeni vizionin për pushtetin, ndryshojeni strategjinë për të ardhur në pushtet se qytetari i Kosovës nuk jeton në Mars, por jeton në Kosovë dhe çdo ditë i prek sukseset e Qeverisë dhe është shumë më racional, shumë më objektiv, shumë më mirënjohës se ju, dhe ai shumë mirë e di në çfarë shtate po kalon Kosova dhe vendi. Ju po flisni sikur Kosova të ishte shtet i pavarur që 200 vjet, të kishte demokraci të konsoliduar, institucione të konsoliduar, të kishte buxhet të konsoliduar. Dhe, ju po harroni që Kosova ende po lufton për ta forcuar shtetësinë e vet, subjektivitetin ndërkombëtar dhe integrimin e vet në strukturat edhe euroatlantike edhe në tregjet financiare. Dhe një sfidë e madhe për Kosovën do të jetë pa dyshim edhe mendësia juaj tipike komuniste. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Mimoza Ahmetaj e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Naim Rustemi.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Korniza afatmesme e shpenzimeve është dokument i cili i hap rrugë Qeverisë dhe ministrive që paraprakisht të kenë një parashikim dhe parapërgatitje të situatës brenda resorëve të caktuar në periudhën trevjeçare, si dhe i kontribuon një stabiliteti ekonomik dhe fiskal.

Nga e gjithë analiza, do të ndalesha me theks të posaçëm në sektorin e shëndetësisë, meqenëse u fol e u përfol shumë deri tani, i cili edhe më tutje është më së shumti ka nevojë për investime kapitale e po ashtu edhe për ato operative.

Do ta përgëzoja Qeverinë që përkundër krizës globale ekonomike në botë, zvogëlimit të numrit të punësuarve në kompanitë e ndryshme, si dhe mbylljes së kompanive të mëdha në botë, Qeveria, jo vetëm se ka arritur të mbajë numrin e të punësuarve që janë deri tani, por parasheh me këtë kornizë punësimin e punëtorëve të rinj si dhe vazhdon me investime kapitale. Kur e them këtë e kam fjalën te Sektori i shëndetësisë, i cili llogaritet

si më i ndjeshmi dhe që shërbimet shëndetësore që i ofron ende nuk janë në nivelin e dëshirueshëm për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm, mungesës së barnave, pamundësisë së rekrutimit të stafit të rinj profesional për shërbime aktuale si dhe ato të reja, mungesa e sistemit informativ në shëndetësi, fondet e kufizuara për investime në sektorin e shëndetësisë.

Prandaj, me këtë planifikim Ministria e Shëndetësisë vetëm për vitin e ardhshëm ka planifikuar që buxheti i saj të rritet për 24 milionë euro dhe atë, 22 milionë parashihen për shpenzimet operative siç janë: pagesat për mjekët, kujdestaritë e mjekëve, punësimi i 360 mjekëve të rinj në fusha të reja që parashihen të hapen si onkologjia e kardiokirurgjia, ndërsa 2 milionë të tjera janë kërkuar për investime kapitale. Vetëm për vitin 2010 nga e gjithë kjo analizë del se kësaj ministrie parashihet t'i rritet buxheti për 35% në shpenzime.

Rritja e shpenzimeve operative për vitin 2010 paraqet vazhdimin e zgjerimit të politikave ekzistuese dhe politikave të reja, shërbimeve të reja shëndetësore në onkologji dhe kardiokirurgji, gjë që Kosova nuk i ka pasur deri tani, ndërsa, për vitet 2011 – 2011, zgjerimi i politikave ekzistuese si dhe politikave të reja në kuadër të planit të Ahtisarit, siç janë ndërtimi i spitalit në Mitrovicë dhe në komunat e tjera, duke e llogaritur edhe Mitrovicën.

Meqenëse ndërtimi i spitaleve të reja dhe integrimi i atyre ekzistuese do të kërkonte punësimin e kuadrit të rinj shëndetësor si dhe personelit mjekësor ashtu edhe atij të mesëm infermier, më vjen mirë që Qeveria i jep përparësi kësaj ministrie dhe kërkesave të parashtruara nga ajo në të gjithë sektorët, duke i marrë parasysh nevojat e mëdha për shërbime shëndetësore.

Për fund, po jo më pak më e rëndësishme, do të kërkoja të rishikohej mundësia që të përfshihej në kuadrin e kësaj kornize edhe pagesa e kujdestarive të specializantëve, gjë që është parashtruar edhe më herët, që përfshin koston buxhetore në kategorinë e pagave dhe mëditjeve deri në 1 milionë e 500.000 euro.

Të nderuar deputetë,

Më herët e hasa në fjalën e kolegëve kërkesën dhe ankesën se shumë nga resorët e sidomos Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk është e pasuruar me ligje. Për të gjithë ata të cilët kanë qenë të përfshirë në punën e letrës së bardhë e dimë se pritet që dokumenti i letrës së bardhë, me kalimin në Kuvend, t'i paraprijë ardhjes edhe të një mori ligjeve të tjera.

U përmend se skema sociale aspak nuk ka ndryshuar. Ia bëj të ditur opinionit të gjerë dhe po ashtu besoj se shumë nga deputetët këtu ose është dashur ta dinë ose e dinë se me ndryshimet që parashihen të bëhen brenda skemës sociale, parashihet edhe rritja... që do të arrijë vlerën deri në 11 milionë euro. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi, të përgatitet deputeti dhe ministri Fatmir Limaj.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

I nderuari kryesues,

Shumëçka u tha nga parafolësit e mi. Unë nuk do të ndalem në shumë të dhëna që në mënyrë shumë profesionale i parashitroi deputeti Driton Tali dhe bëri që të mendohem

edhe më thellë, edhe pse e kisha ndarë mendimin e njëjtë se parashikimet nuk kanë qenë shumë të bazuara.

Nëse veç e shikojmë Kornizën afatmesme të shpenzimeve me të cilën Kosova ka shkuar në Konferencën e Donatorëve, e shohim se në shumë vende s'i ka 5-6 muaj që ka ndryshuar.

Duke mos shkuar shumë larg, unë do t'ia kisha dhënë një sugjerim ministrit të Financave dhe të Ekonomisë që, së paku, disa prej tabelave të përputhen, sepse është një thënie e kontabilistëve që e thonë ata, se të hyrat dhe të dalat do të balancohen, kurse këtu në shpenzimet operative dhe kapitale në sektorin e arsimit e njëjta tabelë që përshkruan të njëjtat gjëra nuk përputhet. Pra, pse nuk përputhet, për shembull, tabela 1, që thotë-shpenzimet operative dhe kapitale brenda KASH-it, që është një tabelë shumë e thjeshtësuar, është 181 milionë, kurse në tabelën më të zgjeruar, versioni i zgjeruar i kësaj table është 185 milionë. Me fjalë të tjera, kjo të lë të kuptosh se diçka kështu prej mendjes së shëndosh janë bërë parashikimet apo edhe janë mbushur tabelat.

Unë do ta shfrytëzoj një të çarë, të them, në Kornizën afatmesme të shpenzimeve në sektorin aty ku është paraparë privatizimi i “Valës” dhe një pjese të KEK-ut. Aty është paraparë se sipas kësaj kornize thuhet se një 500 milionë euro do të ngritën nga shitja e aseteve të PTK-së dhe të KEK-ut. Në privatizimin e Distribucionit ne kemi debatuar kështu në Kuvend dhe në njëfarë forme është dhënë një votë formale, ashtu si kërkohet në Ligjin për ndërmarrje publike, kurse, në inicimin e procedurave, sepse edhe përpunimi i materialit tenderues, me fjalë të tjera, është tenderim.

Tenderimi i “Valës” apo përgatitja për shitjen e “Valës” nuk është diskutuar në Parlamentin e Kosovës. Unë do të ndalem pak sa në dimensionin politik të saj. Transparenca në proces të privatizimit të “Valës” unë mendoj se do të ndihmonte në preventimin e interesave vetjake të individëve të pushtetshëm dhe qeveritarë prej dominimit të procesit të shitjes dhe kështu do të bënte që “Vala”, si aset i tërë popullit të Kosovës, t'i kthehet popullit sipas vlerës së saj maksimale.

Edhe një herë do ta përsëris, sepse shumë shpesh thuhet se Qeveria është pronar – aksionar i vetëm. Nuk është aksionar. Aksionar i ndërmarrjeve publike është populli i Kosovës, është Republika e Kosovës. Së paku t'i lexojmë ligjet me vëmendje, sepse këtu ka mungesë profesionalizmi.

Kosova është vendi më i varfër në Evropë dhe me ngulm po reziston në ngritjen e transparencës dhe hapjes së debatit për procesin e privatizimit të kompanive të pakta që mund të jenë fitimprurëse dhe njëkohësisht të jenë forca që shtyjnë drejt një transformimi të suksesshëm ekonomik.

Kërkesa për mbyllje dhe e përcjellë me eko monotone dhe bajate nga ana e liderëve institucionalë dhe kompanive publike, udhëheqësve të kompanive publike, me slogane që shpesh përsëriten, me parulla si dhe thirrjet që vështirë është për t'iu dhënë kuptim në fillim të shekullit XXI, si për shembull më ka rastisur të dëgjoj prej tyre deklaratimet rreth armiqve të brendshëm dhe të jashtëm. Është hiq më shumë dhe as më pak se të thuash – as nuk pe as nuk dëgjove, me fjalë të tjera, bre vëlla këqyri punët tuaja. Pra, është mentalitet stalinist që ka tendenca krijimin e një shoqërie mentalisht të tredhur.

Pa vendosur qytetarët dhe liderët që të ngrenë debatin dhe që të lejojnë zhvendosje nga udhëheqja autoritare, me një qasje më participative nuk mund të flitet për transformim shoqëror, por edhe ekonomik.

Mos na ofroni shifra që kush nuk e din se nga vijnë dhe si janë derivuar, së paku unë nuk kam pa si janë derivuar shifrat këtu. Ndoshta edhe nuk mund të pritet diçka më e mirë, përpos një letër e bardhë e cila mund të mbajë çfarëdo ngjyre që vendos ti për t'ia qitur. Po unë kisha për të thënë, mos keni problem, përderisa ju nuk vendosni të ndryshoni, nuk ka kush çka ju bën.

Të nderuar, që të mos e zgjas më shumë, pavarësisht se a shkruhet një dokument me stil dhe i këndshëm për t'ua lexuar, apo edhe duke tentuar që t'i jepen epitete vend e pa vend kujtdo e kujt të duash, implementimi i politikave për një transformim dallon shumë dhe transformimi i suksesshëm i ekonomisë së Kosovës nuk shihet, nuk pritët së paku nga dokumenti i ofruar dhe dallon shumë prej asaj se çka është shkruar në letër. Pa rritje të transparencës dhe hapje të debatit në të gjitha nivelet e shoqërisë nuk mund të presim transformim.

Nëse i kthehemi edhe një herë opsionit që ju e keni paraqitur se "Vala" vlen apo do të shitni diku një 500 milionë aksione, keni bërë një përafrim të çuditshëm dhe nuk keni afruar asnjë bazë për vlerësimin e kësaj pjese të korporatës -PTK. Me Ligjin për ndërmarrjet publike, neni 9 – aksionet në një ndërmarrje publike qendrore mund të shiten lirisht nëse Qeveria e miraton një vendim me shkrim me të cilin autorizohet një komision qeveritar për privatizim për të vazhduar me tenderimin dhe shitjen e aksioneve, me kusht që ky vendim të miratohet me shumicë të thjeshtë votash nga Kuvendi i Kosovës. Dhe, vetë iniciimi i procedurës së vlerësimit dhe përcaktimi i kushteve të tenderit është pjesë përbërëse e tenderimit. Qeveria nuk e ka marrë votën formale dhe nuk është diskutuar në Kuvendin e Kosovës, duke e anashkaluar dhe trajtuar si të pavlerë diskutimin që mundësisht do të ndodhte në Kuvend, gjë që e bën transparencën në udhëheqje vetëm fjalë bosh.

Kush e bëri këtë analizë dhe, pyetja ime do të ishte: Çka do të bëjë Qeveria nëse "Vala" shitet 100% të aksioneve me më pak se 500 milionë euro?

Të nderuar, në vende ku funksionon ligji, ekzistojnë penalltitë për ata që janë përgjegjës dhe japin deklarata të rrejshme. Kjo është pyetja të cilën unë do t'ia parashtroj ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Edhe një herë po përsëris – nëse "Vala" shitet 100% të aksioneve dhe me më pak se 500 milionë euro, çfarë do të jetë qëndrimi? Edhe pse ndoshta nuk pres se do të jep përgjigje, sikur në rastin kur unë kërkoja të deklarohet ministri dhe drejtori i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në rastin kur kemi diskutuar për raportin për ngritjen e debatit, që është iniciuar nga njëri prej deputetëve dhe i përkrahur nga më shumë se 6 deputetë, rreth privatizimit, që të sqarohen këta dy rreth marrëdhënieve të tyre me shumë të përfolur dhe shpesh të paraqitur në media – ish- këshilltarin e Kryeministrit, Fogel, gjatë kohës sa ministri ka qenë në AKM, dhe në kohën sot, kur është si ministër i Qeverisë së Kosovës.

Ministër, hapur po të them, sot Kosova nuk ka nevojë për diskutime patetike, sipas fjalës tuaj të fundit të mbyllur në procesin e privatizimit dhe të stërmbyshura me sjellje teatrale, por me fakte konkrete dhe për qasje pragmatike, duke minimizuar numrin e fjalëve që mund të ngjallin shpresa të rrejshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka ministri dhe deputeti Fatmir Limaj, të përgatitet deputeti Bajram Kosumi.

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë besoj që këtu është e panevojshme të flasim çka nënkuptojmë me KASH, sepse ne, një pjesë e madhe jona kemi përvojë disavjeçare, përsëritje e vazhdueshme çdo vit, strategjia e KASH-it dhe të gjithë e dimë se çka parashikohet dhe si përpilohet, çka përfshihet dhe çka s'përfshihet në KASH.

Për të mos zgjatur shumë diskutimin tim, unë do të mundohem t'i jap disa sqarime të nevojshme të cilat, besoj, do t'u ndihmojnë edhe deputetëve të cilët kanë ngritur çështjet, por njëkohësisht edhe për ta informuar opinionin.

Unë do të ndalem më tepër te infrastruktura rrugore. Në KASH është paraparë, parashikohet të kemi rrugë të reja të ndërtuara, rehabilitim të rrugëve dhe mirëmbajtje të rrugëve, zgjerimin e rrugëve, që futen në kuadër të rehabilitimit, pastaj ka rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve regjionale dhe magjistrale, kemi bashkëfinancimin me komuna dhe në fund projektin nacional, projektet nacionale autostradat.

Normalisht, ne do të vazhdojmë, e unë jam i bindur se do të vazhdojnë edhe ata që vijnë pas nesh për të ndërtuar rrjetin rrugor të këtij vendi. Do të vazhdojnë të rehabilitojnë në vazhdimësi dhe të mirëmbajnë rrugët regjionale dhe magjistrale. Ne do të vazhdojmë edhe këto vite që të ndihmojmë në përmirësimin dhe t'i ndihmojmë komunat tona, në ndërtimin e infrastrukturës rrugore. Ne do të mundohemi të jemi prezentë për atë sa kemi mundësi financiare dhe këtu janë paraparë, në këtë pasqyrë, që t'i ndihmojmë komunat në financimin e projekteve të rëndësishme, me të cilat i lidhin fshatrat e tyre me qendrat e tyre administrative, domethënë, me komunat që kanë për qëllim drejtpërdrejt edhe përmirësimin edhe të jetës së njerëzve, edhe mundësinë për të jetuar atje dhe të hiqen shkaqet e një migrimi të pakontrolluar nëpër qendrat urbane siç ka ndodhur në të kaluarën, por jam i bindur se do të ndihmojë edhe në përmirësimin në kuadër të strategjisë së përgjithshme, do të ndihmojë në zhvillimin ekonomik të vendit, sepse siç dihet sektori i transportit është një nga segmentet e fuqishme që ndihmon në përmirësimin e jetës dhënie impuls të zhvillimit ekonomik nëpër zona të ndryshme. Posaçërisht kjo strategjia jonë është e lidhur në mënyrë të veçantë me Ministrinë e Ambientit, të Bujqësisë dhe të Arsimit për faktin se janë sektorë të cilët drejtpërdrejt, jam shumë i bindur se do të fillojmë me investime të fuqishme, sidomos në zonat rurale për të përmirësuar kualitetin e jetës së njerëzve që jetojnë atje dhe, në anën tjetër për t'i ndihmuar në edukimin e gjeneratave të reja në ato zona dhe, kështu që mendoj që ky segment i infrastrukturës rrugore do të ndihmojë në përmirësimin e jetës së këtyre njerëzve.

Të nderuar deputetë,

Për të qartësuar juve dhe ata që janë të interesuar, unë do të them se ne do të vazhdojmë zgjerimin e rrugëve në drejtim të Pejës, kështu është paraparë, që ka një qëllim ta nxjerrim këtë vend nga një izolim. Unë mendoj që është një qëndrim që e ka kjo Qeveri e Kosovës, që vendi ynë ka qenë në një farë mënyre e izoluar, ka pasur një rrjet jo të mirë të rrugës brendapërbrenda Kosovës dhe ka pasur një qasje shumë të dobët jashtë saj me vendet tona fqinje. Prandaj edhe qëllimi i zgjerimit të rrugës në drejtim të Pejës, jo vetëm që do t'i ndihmojë këto qendra të mëdha të vendit tonë, jo vetëm që do të shkojë mes përmes Kosovës dhe do t'i ndihmojë qytetarët tanë, por ka edhe qëllimin

përfundimtar të lidhet me vendin tonë fqinj, me Malin e Zi. Pra, si arsye kryesore është zhvillimi dhe krijimi i lehtësirave të komunikimit të njerëzve dhe të mallrave në mes dy vendeve tona, kjo është rrugë e cila e nxjerr, sikur në çdo drejtim tjetër, edhe këtu e ndihmon Kosovën për ta larguar nga një izolim i brendshëm dhe njëkohësisht e bën këtë vend shumë atraktiv dhe komunikues dhe krijon një qasje shumë të lehtë me vendet e tjera me qytetarët e vendeve tjera që janë të interesuar të kalojnë përmes Kosovës.

E njëjta gjë do të bëhet edhe në drejtim të Mitrovicës. Ka filluar dhe do të vazhdojë. Ne nuk do të ndalemi deri sa kjo rrugë të zgjerohet deri në kufi me Serbinë. E ka të njëjtin qëllim, të hapim porta dhe të komunikojmë me vendet fqinje, në njërën anë, dhe në anën tjetër t'u ndihmojmë qendrave tona, regjionale që të kenë impuls të zhvillimeve të tyre ekonomik dhe në qasje sa më të lehtë, më të afërt në treg dhe vetë qytetarët e atyre regjioneve.

Kur është fjala për autostradën Prishtinë-Ferizaj-Shkup, dëgjova këtu që u tha se nuk është i paraparë zgjerimi i rrugës Prishtinë-Ferizaj. Është e vërtetë. Nuk është e paraparë zgjerimi i rrugës Prishtinë-Ferizaj, sepse tani në këtë kohë kur ne flasim është në zhvillim e sipër realizimi i dizajn projektit për autostradën Prishtinë-Shkup dhe kjo autostradë do të ketë një trase komplet të re, për atë arsye nuk është paraparë zgjerimi i rrugës Prishtinë-Ferizaj-Shkup. Magjistralla e tanishme do të jetë, do të qëndrojë si e tillë për t'u ofruar alternativë qytetarëve për të qarkulluar në autostradë apo në rrugë regjionale, magjistrale, lokale si do që ta quajmë. Për këtë arsye ne nuk kemi paraparë zgjerimin e më tutjeshëm të rrugës Prishtinë-Ferizaj-Kaçanik-Han i Elezit.

Unë jam i bindur se ju këtu e keni, e keni në një nga parashikimet tona këtë rrugë, domethënë, autostradën, e cila përfundimisht Kosovën e lidh me korridorin 8. Rruga ose autostrada Prishtinë-Shkup është në rrjetin e Sitos. Autostrada ose korridori Prishtinë-Morinë ose Morinë-Mendare është në rrjetin e Sitos- dhe ne përfundimisht vendin tonë po e lidhim me dy korridore tepër të rëndësishme, me Korridorin 10 dhe Korridorin 8. Dhe, përfundimisht këtë vend do ta nxjerrim nga ky izolim që fatkeqësisht nuk ka mbetur për fajin e asnjërit prej nesh që sot jemi këtu dhe ata që janë jashtë, por shkaqet dihen. Prandaj, do të kisha dashur që këto gjëra, që unë jam i bindur se ju edhe i lexoni edhe i shihni dhe një pjesë e madhe e këtyre punëve që sot po i flas unë si ide janë zhvilluar qysh më herët, sot ne jemi në konkretizim të këtyre ideve. Prandaj shumë nga ish-qeveritarë dhe ish- deputetë të sesioneve të tjera parlamentare, domethënë të mandateve të tjera të mëhershme parlamentare këtë e dinë, sepse ka kaluar nëpër duar tona disa herë.

Dua t'i them edhe dy fjalë rreth financimit. Në këtë Parlament vazhdimisht është thënë, që është më se e logjikshme dhe normale. Buxheti i Republikës së Kosovës nuk ka fuqi, nuk ka mundësi të financojë dhe të marrë përsipër financimin e tërësishëm të autostradave. Besoj se këtu jemi të qartë, është thënë nga shumë deputetë, nga ish-ministra, është thënë edhe nga ne. Financimi i autostradave duhet të gjenden burime alternative financiare për të cilët Qeveria e Kosovës është duke punuar, prandaj edhe nuk është paraparë në ato pasqyrat buxhetore të këtij vendi, sepse në njërën anë i themi s'kemi kapacitete buxhetore në anën tjetër kërkohet se s'është në buxhet. Është fut si prioritet dhe ne po punojmë në burime alternative që do të thotë mund të ketë një kombinim të financimit, mund të kemi diçka nga paratë tona, mund të gjejmë burime tona financiare por në asnjë mënyrë ne nuk mund ta marrim mbi sipër që me buxhetin e Republikës së Kosovës të përballohet këto dy projekte të cilat janë të papërballueshme për fatin se dihen mundësitë tona buxhetore.

Regjionet, strategji e kësaj Qeverie ka qenë lidhja dhe largimi edhe nga një izolim që kanë pas regjionet e Kosovës. Po e marr shembull regjionin e Gjilanit. Praktikisht regjioni i Gjilanit, në qoftë se nuk ka akçes sa më të lehtë, më të shpejtë në tregun, pjesën tjetër të Kosovës rrezikohet që Gjilani të izolohet sikur që ka qenë e izoluar Gjakova një kohë. Sikur që rrezikohet sot Peja. Rruga e Malit të Zi, nëse mundem ta quaj kështu, Aeroporti përfundimisht Pejën e nxjerr nga një oazë e izoluar. Gjilani është në një gjendje siç ka qenë dhe është fatkeqësisht ende Peja por Peja shpejt do të... Peja dhe Gjakova shpejt do të dalin nga kjo gjendje. Rrugën që ne sot përfundimisht dhe për herë të parë po e lidhim Gjilanin me Lipjanin dhe ai projekt ka dalë, është rrugë magjistrale, imagjinoni Gjilan – Lipjan për 45 minuta do të kalohet dhe do të ketë drejtpërdrejt qasje në rrugën qendrore. Kjo tregon që jo që po hapet një zonë e pa shkelur, e harruar me të kaluarën por përfundimisht po jep një akçes të ri komunës së Gjilanit, regjionit të Gjilanit në zhvillimin e agrobiznesit.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi, të përgatitet deputetja Flora Brovina.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, kryesues!

Unë isha njëri prej atyre që insistova që të vazhdohet debati, duke pasur parasysh faktin që Korniza afatmesme e shpenzimeve është një prej dokumenteve themelore të vendit tonë. Duke pasur parasysh se Korniza afatmesme e shpenzimeve, po ta përkthejmë me fjalë të thjeshta, është vizion ekonomik dhe politik, i politikave ekonomike të një vendi për një periudhë të caktuar, prandaj unë edhe insistova që të vazhdohet debati, e mund t'ju them sinqerisht, tash isha në dilemë a po ka efekt debati ynë këtu, a po krijon efekte debati që po e bëjmë në Kuvendin e Kosovës. Duhet të konstatoj me keqardhje që në Kuvendin e Kosovës ka fjalime, nuk po them çfarë fjalime, mund të jenë panagjerik, mund të jenë kritika, ka fjalime, por mungon debati. Në kuvendin dhe në shoqërinë ku ka fjalime e mungon debati, ka abstenim nga demokracia, është ikje nga demokracia. Ne në Kosovë ende s'e kemi krijuar demokracinë, ende jemi në hapat e parë të krijimit të demokracisë dhe duhet të pajtohemi me fjalën që sot e tha kryetari i Kuvendit të Kosovës, në fillim të kësaj seance, kur tha se po rrezikohet demokracia në Kosovë, përafërsisht po parafrashoj kështu. Dhe, më duhet të pajtohemi dhe të them se po, demokracia në Kosovë po rrezikohet prej partive politike, pa dallim prej të gjitha partive politike. Institucionet e Republikës së Kosovës po rrezikohen prej interesave të ngushta të grupeve të vogla politike, qofshin parti politike, qofshin pozitë ose jashtë qeverisë, demokracia po rrezikohet ende pa u krijuar dhe kjo është një situatë e papranueshme për të gjithë qytetarët e Kosovës, një situatë e papranueshme për të gjithë ata që kanë investuar dhe vazhdojnë të investojnë në krijimin e një shoqërie demokratike dhe të një shteti stabil. Kosova nuk ka të ardhme me modele tjera jashtë modelit demokratik.

Kjo ishte arsyeja pse unë isha në dilemë, a po ka efekt a jo diskutimi ynë në Kuvendin e Kosovës dhe tash do të kthehem te diskutimi i Kornizës afatmesme të shpenzimeve.

Diskutimi për cilëndo kornizë afatmesme të shpenzimeve apo për cilindo projektbuxhet mund të bëhet në dy mënyra, në një me shifra, sepse buxheti është shifër dhe, nën dy, në bazë të politikave ekonomike që trason një kornizë afatmesme e shpenzimeve ose një projektbuxhet. Kjo kornizë afatmesme e shpenzimeve tenton të jetë, do të thotë, krijuese e një vizioni politik për ekonominë e Kosovës në vitin 2009, 2010, 2011. Por, do të

rrumbullakoj disa shifra që u përdorën shumë herë me të drejtë prej kolegëve deputetë këtui për të parë në fund se cili është vizioni ekonomik që ofron Korniza afatmesme e shpenzimeve.

Të hyrat sipas kësaj kornize në vitin 2008 janë 942 milionë euro. Në vitin 2011 janë 1 miliardë e 133 milionë. Ka një ngritje prej 190 milionëve. Edhe shpenzimet janë përafërsisht njëjtë, që të mos i përmendi. Për 3 vjet, do të thotë, në të hyra në buxhetin e Kosovës do të ketë rritje 190 milionë. Meqenëse shumë kolegë këtui po bëjnë krahasime me qeverinë e kaluar, edhe unë po e bëj një krahasim, pra. Në vitin 2004, kur ka filluar mandatin qeveria e kaluar, buxheti ka qenë 612 milionë euro të hyra, të hyra vetjake, po flas, të Kosovës. Në vitin 2008, kur ka përfunduar mandati i qeverisë së kaluar, të hyra vetjake kanë qenë 942 milionë euro. Rrafsh 330 milionë euro janë shtuar të hyrat buxhetore vetjake në qeverinë e kaluar, ndërsa për 3 vjetët e ardhshme, në bazë të kësaj kornize planifikohet shtim i të hyrave për 190 milionë.

Po e elaboroj pak këtë shtesë dhe pastaj në fund do të them, çka do të thotë kjo. Rritja e tatimeve parashihet prej 805 milionë eurove në vitin 2008, 991 milionë euro në vitin 2011, do të thotë tatime do të ketë më shumë 186 milionë, ndërsa të hyrat komunale, do të ketë vetëm 4 milionë më shumë për 3 vjet e ardhshme. Prej 137 milionëve, sa ka në 2008, do të ketë 141 milionë në 2011. Do të thotë, 4 milionë do të ketë më shumë. Këto janë planifikimet që parashihen në këtë kornizë afatmesme të shpenzimeve. Unë nuk u besoj këtyre planifikimeve, por do ta them në fund pse. Do të ketë të hyra më shumë, por do ta them përsëri në fund, pse.

Tash do të ndalem me pak fjalë tek politikat dhe qasja e hartuesve të kësaj kornize për politikat ekonomike. Lexoni në faqen e pestë të deklaratës politike të kornizës, çeleni faqen e pestë, i nderuar ministër dhe tjerët, në cilën flisni me të drejtë për disa shtrëngesa të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Ne e dimë të gjithë që ka disa pengesa të zhvillimit ekonomik dhe duhet t'i trajtojmë ato pengesa që të ketë një zhvillim të theksuar. Nën një, e përmendni me të drejtë energjinë elektrike. Por, fjalia që ju i jepni shpresë qytetarit të Kosovës për energjinë elektrike është vetëm një fjali, kjo furnizimi i rregullt me energji elektrike është një nga katër synimet tona kryesore. Asnjë fjali tjetër nuk ka qysh të eliminohet kjo pengesë e zhvillimit të ekonomisë së Kosovës.

Ose, merreni ta zëmë arsimin, që është prioritet jo veç për Qeverinë, por për gjithë shoqërinë tonë, ose merreni sundimin e ligjit, që i keni theksuar të gjitha në faqen 5, si shtrëngesa. Hajde të bëjmë, do të thotë, në bazë të kësaj kornize një krahasim, nëse energjia është prioritet dhe është pengesë e cila duhet të eliminohet, nëse arsimi është prioritet dhe duhet të investohet, nëse sundimi i ligjit është prioritet dhe duhet të investohet, hajde të shikojmë sa parashihet investimi për 3 vjetët e ardhshëm. Në arsim, prej 43 milionëve investimet kapitale, e kam fjalën për vitin 2008, parashihet në vitin 2011 të ketë 52 milionë investime kapitale. Vetëm 9 milionë më shumë. Investime kapitale do të ketë në arsim vetëm 9 milionë më shumë, sipas kornizës. Ndërsa, në sundimin e ligjit prej 39 milionëve në 2008, do të ketë 44 milionë në 2011, vetëm 5 milionë më shumë.

Shtrohet pyetja, si – me çfarë logjike politikat prioritare që janë deklaruar prioritete edhe të Qeverisë, siç janë: arsimi, energjia, sundimi i ligjit, po me të drejtë them janë edhe prioritete për krejt shoqërinë tonë, do të thotë, qysh është shkuar me këtë investim aq të vogël, që po ta kthejmë në përqindje, del me zero përpara.

Çka do të thotë kjo dhe pse po e përmend. Hartuesi i kornizës afatmesme nuk ka bërë analizë dhe nuk ka pasur parasysh qëllimet politike dhe politikat ekonomike për të cilat Qeveria ka deklaruar se do të angazhohet. Kjo është njëfarë zbërthimi i asaj pse ka ndodhur kjo. Dhe, tash ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit deputet! Fjalën e ka deputetja Flora Brovina, të përgatitet deputeti Lulzim Zeneli.

FLORA BROVINA: Së pari, më lejoni që ta përgëzoj Qeverinë që ka përpiluar projektin për shqyrtimin e shpenzimeve afatmesme për këtë periudhë, domethënë për vitin 2010 – 2012, që shpreh një vizion të qartë të zhvillimit të Kosovës. Ky dokument që vjen pikërisht në qershor, na jep hapësirë dhe mundësi që lirshëm të debatojmë për mundësi të ndryshimit ose të plotësimit të këtij vizioni dhe kjo meriton çdo respekt.

Gjithashtu, respektoj përfshirjen në këtë projekt edhe të sfidave që parashikohen gjithsesi, duke e përfshirë edhe krizën globale që nuk do ta anashkalojë regjionin, pra edhe Kosovën. Ky optimizëm i matur për krizën meriton çdo respekt dhe për mendjen time është thënë shumë butë, krahasuar me situatën në të cilën ndodhet e gjithë bota. Respekt që Qeveria nuk heq dorë nga promovimi i synimeve të saja, e që në rend të parë përfshin prioritetet shumë të nevojshme që mos të stagnojnë, së paku: energjia, sundimi i ligjit, ndërtimi i infrastrukturës rrugore, arsimi, pastaj dy prioritetet e domosdoshme që është zhdukja e varfërisë, stabiliteti social dhe shëndetësia, për të cilat unë sigurisht jam shumë e interesuar që janë futur në prioritate. Janë shumë sfida që nuk kanë marr, domethënë, vendin e merituar ose nuk janë thënë në gjuhën e merituar në këtë projekt. Ndoshta nuk është theksuar se Kosova përjetoi fazën e rehabilitimit dhe rimëkëmbjes pas luftës në mënyrë shumë të ngadalshme si dhe periudhën e protektoratit ku nuk pati investime të mjaftueshme për një zhvillim të mundshëm ekonomik. Dhe, pikërisht, tani në këtë fazë të ndërtimit të shtetit po ballafaqohemi me sfidën më të madhe e që është kriza globale edhe pse të pa integruar në shoqërinë globale neve nuk po na kursen kriza globale.

Në Kornizën afatmesme të zhvillimit kriza thuhet si diçka e butë, e matur dhe mbase mund të thuhet në gjuhën nga kriza dolëm, në krizë hymë, ose ne nuk do të na prek kriza-jemi të sigurt.

Duke përmendur vetëm çështjet, se përmendet remintenca 7%, që është një sfidë dhe kjo shifër për mua nuk është e sigurt, sepse nuk e di realisht remintenca sa për qind merr pjesë në buxhetin e përgjithshëm të Kosovës dhe ma merr mendja se kjo duhet të jetë një shifër më e lartë, prandaj edhe nuk e dimë saktësisht sa do të na godet remintenca dhe sa do të jetë ajo pas përfundimit të krizës e kthyeshme për buxhetin e Kosovës, sepse këtu nuk ndikon vetëm faktori ekonomik, por ndikon edhe ai social dhe psikologjik. Nëse gjysmë milioni popull i Kosovës ndodhen në vendet ku kriza tanimë është në fazë të lartë, pra ë Evropë, në Amerikë e tjera, atëherë e dimë se nga kjo do të atakohemi edhe ne. Problemet e tjera që nuk janë përmendur sigurisht është edhe çështja e përjashtimit nga puna e popullatës që ndodhet në vendet ku janë atakuar nga kriza e që këta njerëz mund të kthehen për shkak të problemeve të pazgjidhura të qëndrimit në këto vende, pra dokumentacioneve si qytetarë të përkohshëm në këto vende dhe që do të ngarkojë edhe njëkohësisht situatën e punësimit në Kosovë. Andaj, kërkoj një angazhim më të madh, jo vetëm të shtetit të Kosovës, por edhe të diplomacisë që kjo mos të ndodhë dhe të ndikohet në këto shtete, të paktën këta njerëz të mos kthehen dhe t'i gëzojnë të drejtat që

mund t'i kenë edhe punëtorët e këtyre vendeve në kohë të krizës. Kështu mund të bëjmë presion edhe tek ata të cilët na premtuan investimet dhe të cilat po vijnë shumë ngadalë. Kështu mund të ndikojmë të jemi më të zëshëm në zbatimin e marrëveshjeve për ekonomi të lirë, sidomos për zbatimin e CEFT-ës e cila po has në pengese. Kosova duhet të jetë më e përgatitur dhe më vizionare pikërisht për shkak të përvojës së ballafaqimit me krizën. Duhet t'i studiojë mundësitë e veta dhe shfrytëzimit të vetë infrastrukturës së vet. Në këtë nënkuptoj të ketë më shumë informata në lidhje me krizën, të ketë më shumë bashkëpunim me vendet ku ka ndodhur kriza dhe si ka dal nga kjo, të bashkëpunojë me shoqërinë civile dhe me qytetarët, ata të marrin më shumë shpjegime se çka mund të ndodhë dhe si të ballafaqohen.

Në lidhje me këtë, sigurisht thashë edhe një herë, e përkrah, sepse edhe masat që i merr edhe me planin afatmesëm Qeveria sa i përket rritjes së vendeve të punës, arsimimit, infrastrukturës, sundimit të ligjit, zhvillimit në bujqësi dhe masave fiskale janë rrugët që ajo parasheh për zvogëlimin e papunësisë dhe varfërisë e cila është shumë e lartë sipas Bankës Botërore- 40%. Jo të gjithë të papunët janë të varfër dhe jo të gjithë të varfrit, domethënë, janë të pa punë. Punësimi, në tregun e punës, domethënë çdo vjet parashihihen 29 mijë të rinj që dalin në tregun e punës dhe tregu i punës nuk mund ta absorbojë këtë shumë. Megjithatë, sa janë marrë masa që të përgatiten dhe sa po zbatohen, a ka masa Qeveria që të fillojë punësimi institucional në vendet ku kërkohen këta punëtorë? Kjo po shkon shumë ngadalë dhe kujtoj që në këtë aspekt duhet vënë një dritë të kuqe që Qeveria, secila ministri veç e veç të lidhë marrëveshje dhe kontrata me vendet ku kërkohen punëtorë dhe këto të zbatohen edhe pse ne nuk jemi pjesë integrale e Evropës.

Nëse 50% e tokës nuk shfrytëzohet në Kosovë dhe nëse dihet se 60% e popullatës është popullatë rurale, 60% e kësaj popullate janë femra, domethënë edhe një herë nxirret përfundimi ku ose vihet diagnoza se ku qëndrojnë të metat tona dhe ku mund të bëjmë përmirësime. Pra, gjithsesi potenciali ynë për ta luftuar varfërinë qëndron në subvencione që duhet të bëhen për bujqësinë dhe mbrojtja e bujqve nga kjo situatë dhe tregu i lirë. Bizneset tona gjithashtu kërkojnë një mundësi dhe ambient më të mirë dhe përkrahje institucionale. Bankat janë të sigurt dhe kanë kthim të kënaqshëm, domethënë, kanë kredi të këqija e shumë të ulëta, por kreditë janë me kamata shumë të larta dhe ndonjëherë e pamundur që ato të shfrytëzohen për nevojat dhe qytetarët më të varfër. Dhe, Kosovës, sidomos i nevojitet një bankë bujqësore për të ndihmuar pikërisht sektorin më të ndjeshëm dhe më të mundshëm për zhvillim që është bujqësia dhe zhvillimi i ekonomive që dalin nga bujqësia. E thashë edhe një herë, diagnoza është shumë e rëndësishme për paradigmat, për përcaktimin e paradigmave të zhvillimit, të forcimit të zhvillimit të kapitalit social dhe për mundësitë dhe guximin për investime sociale dhe sistematike për promovimin e ndërmarrjeve sociale në të cilat mund të inkuadroheshin: gratë, shoqëria civile, sindikata dhe popullsia në përgjithësi dhe të iniciohet stimulimi i tyre. Shembull konkret që ta kuptoni pak më mirë. Dihet se në Kosovë në dhjetë fëmijë, nëntë fëmijë nuk shkojnë në çerdhe, në kopshte, nëse kjo është kështu atëherë pse të mos shfrytëzohet mundësia që edhe në fshatrat më të largëta të hapen kopshte dhe të stimulohen hapjet e....

(ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli, të përgatitet deputeti Berim Ramosaj dhe pas tij, i fundit, deputeti Ibrahim Gashi. Ju lus, ta kemi parasysh këtë.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke pasur në konsideratë që edhe përqendrimi i këtij Kuvendi për të vazhduar me këtë debat veç ka rënë në nivelin më të ulët të mundshëm, atëherë konsiderojmë që sjellja e Kuvendit, por edhe e Qeverisë në raport me këtë temë nuk është serioze karshi krejt seriozitetit që përmban ky dokument dhe në këtë plan mund të parashikojmë kështu në bazë të asaj që Qeveria e Republikës së Kosovës ka paraparë në këtë kornizë afatmesme të shpenzimeve deri në vitin 2012. Nëse të hyrat buxhetore për këtë periudhë parashikohen të rriten vetëm për 10% apo përafërsisht 10% pak më shumë, atëherë cili mund të jetë begrandi i implementimit të krejt këtyre politikave dhe orientimeve që kjo Qeveri e Republikës së Kosovës i ka paraparë për këtë periudhë të mandatit të vet?

Lidhja Demokratike e Dardanisë, Grupi i saj Parlamentar, konsiderojnë se jo vetëm sot mungesa e vizionit dhe kapaciteteve qeverisëse që po determinohen edhe në këtë dokument, mirëpo ky planifikim apo ky parashikim dhe sidomos kur kemi për bazë treguesit makroekonomikë vij në një konkludim që për Kosovën dhe qytetarët e saj i parashikohet një perspektivë e zymtë. Ne konsiderojmë se politikisht dhe ekonomikisht ky projekt është i dëmshëm, profesionalisht u tha prej shumë parafolësve është shumë i diskutueshëm. Nëse i kemi të gjitha këto kriterë apo këto elemente bazë, atëherë shtrohet pyetja për çka nevojitet ky dokument? Shumë parafolës thanë se nuk e ka asnjë vlerë duke pasur për bazë se statistikën apo të dhënat që i ofron ky dokument janë shumë të diskutueshme, atëherë a po ia bëjmë qejfin vetvetes apo dëshirojmë të ndërtojmë politika të qëndrueshme që mund të bazohet edhe zhvillime të sektorëve të ndryshëm? Në bazë të këtij parashikimi politika për skemën sociale në Kosovë nuk do të ketë. Në bazë të këtij parashikimi politikat sektoriale në sferën e shëndetësisë, në sferën e arsimit, në sferën e bujqësisë do të jenë të njëjta, e të mos të flasim për krejt atë kontingjent të papunëve apo numrin e ri që i shtohet çdo vit numrit të tërësishëm se cila do të jetë zgjidhja apo alternativa për zgjidhjen e të gjitha këtyre problemeve? Kjo është shqetësuese për Lidhjen Demokratike të Dardanisë, jo pse kemi të bëjmë me një dokument të tillë, por shqetësuese për ne është mungesa e vizionit dhe qasjes serioze të Qeverisë së Kosovës që këtë buxhet sado që e kemi të trajtojë me nikoqirllëk dhe në qoftë se kjo nuk trajtohet seriozisht atëherë cila do të jetë porosia sot për qytetarin e Kosovës?

Ne jemi të bindur se kapacitetet buxhetore të Kosovës janë shumë më të mëdha, por jemi shumë të bindur se kapacitetet qeverisëse të Kosovës me këtë vizion çfarë po demonstroi, mungojnë. Atëherë, porosia do të ishte që të trajtohet seriozisht kjo çështje, deputetët e Kuvendit kanë dhënë shumë në mënyrë përmbajtjesore qasjen e vet kritike ndaj të gjitha këtyre sektorëve që sot përfshihen në KASH, mirëpo është momenti i fundit që derisa vendet e rajonit kanë shënuar rritje të hyrave buxhetore thuaja se 100% brenda një mandati dhe ne brenda këtij mandati qeverisë, përafërsisht sillet 12 deri 13%, atëherë cila është perspektiva në kuptimin e shtigjeve më të gjata. Prandaj, porosia është jo e mirë dhe frikohemi se me këtë qasje dhe me këtë kulturë po edhe mentalitet të veprimit politik Kosova politikisht po destabilizohet, kurse në aspektin e ndërtimit të ekonomisë së qëndrueshme apo politika fiskale një gjë e tillë as nuk jemi afër. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj dhe, i fundit, deputeti Ibrahim Gashi.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë u mundova prej asaj që kemi përvojë në këtë fushë dhe asaj që kemi dije, të mund ta japim një kontribut sado modest në këtë drejtim në Kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Dua të jam, për momentin, shumë i pangjyrosur politikisht veç me qëllim të japim kontributin tonë në aspektin e një kornize.

Së pari, Kosova vuan prej mungesës së strategjisë së zhvillimit ekonomik, e cila strategji kishte për t'i paraprirë kornizës afatmesme të shpenzimeve. Tash i them ministrit nga kjo foltore se nuk mundet të zëvendësojë strategjinë e zhvillimit ekonomik të Kosovës Korniza e shpenzimeve, edhe nëse ajo kornizë e shpenzimeve mundohet të ketë projeksione edhe më të gjata kohore, duke marrë parasysh edhe aspektet e planeve buxhetore që janë bërë brenda një viti dhe duke marrë parasysh Kornizën afatmesme të shpenzimeve që e kemi prezantuar para donatorëve. Mirëpo, në qoftë se e shikojmë këtë kornizë afatmesme të shpenzimeve dhe e shikojmë anën e fortë dhe anën e butë të saj, anë e fortë e saj qëndron ajo se në mënyrë mjaft modeste ka planifikuar të ardhmen në kuptimin edhe të hyrave të mundshme potenciale edhe të shpenzimeve, që në një farë forme ja jep anën pozitive.

Mirëpo, krejt ato që u mundua kjo kornizë të na i sqaroj të metat, vërtet ato dobësitë që do të na përcjellin në periudhën e ardhshme që pa dyshim janë të natyrës së përgjithshme të karakterit, normalisht të mungesës së vizionit, të mungesës së zhvillimit në përgjithësi ekonomik, rajonal dhe botëror dhe mungesave të tjera, sidoqoftë nuk ka përmendur, ndoshta, fenomenin kryesor në këtë proces që si do të reflektojnë rreziqet e tjera potenciale që dalin si rezultat i mosfunksionimit të institucioneve tona, kjo është problematika. Për shembull te pagat e shërbyesve publik, vërtet e pranon se rritja 10% do të reflektojë deri në vitin 2011 negativisht që nuk mund as 5% ta rrisë mbi këtë që e ka planifikuar, që bie në kundërshtim me propozimet buxhetore që i ka bërë në fillim të vitit kur e ka propozuar buxhetin, që ka thënë në këtë vit ne kemi 10%, po në vitet e ardhshme do të ketë edhe 20, e 30, domethënë, është në kundërshtim të plotë, sepse tek e fundit na e dimë mirë se FMN-ja çfarë sugjerimesh ka dhënë edhe kur e ka planifikuar rritjen 10% ka dhënë sugjerime se shkalla e produktivitetit të punës së punëtorëve në administratën publike është shumë e ulët në krahasim me të hyrat.

Huan për KEK-un e parasheh prapë rrezik, importin e energjisë elektrike prapë rrezik, rezervat në stabilizim që i ka rezerva 200 milionë, FMN-ja planifikon të ketë rezerva më shumë. Anëtarësimi në FMN dhe Bankën Botërore, që jemi vetëm në atë stadin e parë, domethënë, diku 30 – 40 milionë llogarit shpenzime e në fakt ato do të jenë 154 milionë. Indeksimin e pensionistëve që ka paralajmërua e të mos flasim për shëndetësinë dhe arsimin që vetëm ajo baza e projeksionit për sigurime shëndetësore do të na kushtojë, minimum 50, milionë. Të gjitha këto të cilat, vërtet, paraqesin rreziqe potenciale për të ardhmen.

Projeksionet që janë paraparë në anët pozitive, respektivisht faktorët e ndikimit pozitiv, gabimi më i madh në këtë kornizë që duket edhe nga qytetari i thjeshtë është projeksioni i privatizimit të PTK-së dhe projeksioni i privatizimit të Distribucionit, që në një farë forme këto e dëmtojnë kornizën afatmesme të shpenzimeve, sepse në asnjë kornizë nuk mund të planifikosh. Për shembull, prej shitjes së PTK-së thotë -planifikohen 500 milion të hyra, që në një farë forme dhe në raport me ata të cilët ishte dashur të kyçen në këtë proces të privatizimit, është një indikator jo i mirë, e lerë më për kornizën afatmesme deri në 2011.

Mandej, për KEK-un 30 deri 50 milion i planifikon të ketë të hyra nga shitja e Distribucionit, që në fakt ky është një gafë, ndoshta është i pavetëdijshëm, por është gafë në aspektin e proceseve zhvillimore.

E, pa u lëshuar në ato që i thanë kolegët e nderuar, unë prapë po them, me qenë se korniza reflekton në vete edhe krizën globale financiare, duhet të shikohet me kujdes dhe po e vërej pa dashur këtu të be në konflikt me kolegët e mi deputetë, këta kanë të drejtë të flasin çka të donë, por kur janë në pyetje dokumentet e tillë, të mos bëjnë fjalime, ju lutem, dëshirojmë debat, debat edhe atë bile sa të ketë mundësi në baza profesionale, se është fjala për projeksione të zhvillimit, bile për një 3 – 4 vjet. Andaj, ne mundemi, ministri apo korniza ka mund të planifikojë të hyra 20% më shumë apo 30%, por kaq është mundësia, nuk ka mundësi të planifikohen me analiza dhe variantet ekzistuese një gjë më e madhe. Ky projektion që është bërë, është bërë në bazë të projekcionit të buxhetit, e ky buxhet në fakt nuk është buxhet zhvillimor, le ta dijë edhe Qeveria aktuale, është buxhet i mbulimit të veprimtarive shoqërore në Kosovë. Domethënë, për të ekzistuar në bazë të kësaj kornize dhe në bazë të këtij buxheti, ne edhe për 3 vjet e ardhshme kemi garantuar jetë të tillë çfarë ekziston sot, nuk jep shans për zhvillim, nuk jep shans për rritje të mirëqenies.

Mirëpo, duke marrë parasysh zhvillimet globale, krizën globale në përgjithësi, edhe shtetet më të zhvilluara kanë projektionet e mbetjes në statuskvo. Mirëpo, projektioni e ka një të metë që nuk bën shpërndarje të mirë. Shikoni, qytetarët e Kosovës nuk e kanë mendjen vazhdimisht për të hëngër asfalt, në qoftë se ka shans që një pjesë të shpenzimeve të orientohen si shpenzime kapitale me qëllim ta mbajmë GDP ekzistuese, duhet të orientohen edhe në veprimtaritë e tjera, e jo me kryeneçësi të shkojmë në ato ministri të cilat koalicioni ka vu prioritete që janë për ne prioritete jo shumë racionale, janë më shumë të orientuara nga politika apo nga individët që janë mbajtës të atyre ministrive.

Ajo çka më bën në përgjithësi të shoh fenomenin e kornizës, edhe prioritetet që i ka vu, nuk i ka vu mirë. Për shembull, ka prioritet rritjen ekonomike, në fakt, nuk e ka prioritet në bazë të kësaj kornize derisa rritja ekonomike parasheh rënie, këtu nuk ka. Më mirë t'ia kishte vënë vetës prioritet 20 orë rrymë, hajde të dijë konkretisht qytetari i Kosovës që për tri vjet do të ketë 20 orë rrymë, ose 24 me 0, ose 15 me 15, ose implementimi i zgjedhjes së statusit, faktikisht më mirë konsolidimi i institucioneve të qeverisjes në Kosovë, domethënë ndërtimi i një skeme qeverisëse të plotë, çfarë ekziston në shtetet normale. Qeverisja e mirë, kjo është e nënkuptueshme, nëse e respekton ligjin, s'ke qare pa pasur qeverisje të mirë.

Zbutja e varfërisë mund të jetë prioritet e vërtetë, kjo ndoshta ishte dashur të jetë prioriteti kryesor në Kosovë që dihet në çfarë niveli të zhvillimit ekziston.

Unë i kisha dhënë një sugjerim shumë kolegial ministrit dhe Qeverisë, të vë në prioritet privatizimin. E vetmja shans që të rrisim nivelin e GDP -së, e vetmja shans të krijojmë rritje ekonomike për Kosovën ekzistuese janë investimet direkte, investimet kapitale, sepse ato gjenerojnë të hyra më të mëdha, shpenzime më të mëdha, ato na gjenerojnë vende të reja të punës, që normalisht Kosova vuan prej problemit të papunësisë. Ne këtë e kemi mundësi, mundësia e investimeve direkt përmes privatizimit të ndodhë sa më parë në Kosovë ...

KRYESUESI: Një minutë, ia vazhdoni deputetit!

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, ta di për nder,
Duke marrë parasysh, domethënë, unë ju thashë në start që nuk e ka qëllimin diskutimi im politik. E kam kuptimin e asaj se Kosova duhet të shesë apo Kosova duhet të hyjë në marrëdhënie të transaksioneve ekonomike me çka ka mundësi, mundësitë janë privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe publike ekzistuese dhe mundësia e hyrjes në partneritet privat – publik të minierave të energjisë dhe në përgjithësi. Kjo na siguron edhe një strategji të ardhshme të mirë edhe një kornizë të mirë e sigurisht edhe një mirëqenie për qytetarin e Kosovës, sigurisht edhe për Qeverinë rahat më të madhe. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, 45 sekonda i ke pasur më shumë.
Deputeti i fundit, Ibrahim Gashi e ka fjalën.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!
Unë po e shfrytëzoj foltoren, se e kam harruar kartelën.
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,
Zoti zëvendëskryeministër,
U paraqita krejtësisht në fund për një dimension të kësaj kornize buxhetore për vitet 2010 – 2012, thjesht për të sensibilizuar paksa, domethënë, vendimmarrësit që në një segment aq të rëndësishëm, që këtu është paraqitur si prioritet, por që për mendimin tim e kanë titulluar gabimisht dhe duhet korrigjuar sa më shpejt të zgjidhja e statusit dhe njohjet ndërkombëtare. Konsideroj se në këtë fazë statusi është i zgjidhur, ndoshta ka edhe diçka që të zgjidhet, por sigurisht që kështu ky formulim s'mund të qëndrojë dhe natyrisht njohje ndërkombëtare mund dhe duhen të jenë pa tjetër prioritet.

Dhe, duke e analizuar më në detaje atë çka është paraqitur te ky prioritet, kur dola te aktivitetet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Jashtme, në këtë periudhë kohore e ka renditur ndër prioritetet e saj në numër një lobimin dhe aktivitetet diplomatike për intensifikimin e njohjeve të shtetit të Kosovës, gjë që plotësisht pajtohem se është prioriteti numër një dhe, në këtë kuadër, ndoshta jo vetëm Ministria e Punëve të Jashtme, por edhe mekanizma të tjerë politikëbërës në Kosovë duhet të jenë të inpenjuar që në këtë dimension të angazhohen dhe të investojnë më shumë energji, më shumë kohë, më shumë angazhim, sepse pavarësisht që Kosova ka kaluar pjesën më të vështirë të rrugëtimit të saj për të ndërtuar shtetin, mendoj që ka edhe një pjesë të gjatë të rrugës të cilën nuk e ka kryer.

Dhe, njohjet ndërkombëtare janë ndër prioritetet kryesore për ta quar Kosovën atje ku ajo synon. Dje ishim dëshmitarë të një seance në Këshillin e Sigurimit, ku nga kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës kërkohet vazhdimi i misionit të UNMIK-ut dhe vazhdimi i përfaqësimit të Kosovës nga ky mision në mekanizma multilateral dhe bilateral ndërkombëtar. Çka do të thotë kjo? Do të thotë kontestim i pavarësisë, kontestim i statusit të Kosovës.

Natyrisht, përshëndes reagimin e palës kosovare që është për shkurtimin e këtij mandati, në fakt, duke falënderuar për punën që ka bërë, po duke konsideruar se misioni i tij ka kryer punën në Kosovë dhe duhet t'ua lëshojë vendin konform Kushtetutës, autoriteteve të Kosovës dhe konform Pakos së Ahtisarit, Misionit të EULEX-it për dimensionet e caktuara.

Pra, në këtë kornizë të planifikimit buxhetor për lobimin dhe për intensifikimin e njohjeve ndërkombëtare, shoh se Ministria e Jashtme, thjesht, ka paraparë fare pak dhe Ministria e Jashtme, në fakt, Qeveria ka paraparë fare pak buxhet, fare pak financa e kostoja e lobimit dhe kostoja e angazhimit për të siguruar njohje të reja është bukur e lartë për ata që e kuptojnë. Nuk po dua kurrkujt t'i mbaj leksione, e dinë më mirë, por nëse provojnë për të hapur dyer dhe kanale komunikimi të drejtpërdrejtë me shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën, do të shohin se ka kosto kjo punë.

Është përmendur një herë nga qeveritarët, nuk e di saktësisht nga cili, nga zyrtarët më të lartë të Qeverisë se për lobimin, për njohjet janë ndarë 20 milionë euro. Unë nuk shoh që ajo shumë figuron diku këtu, madje edhe për ndërtimin dhe funksionalizimin e shërbimit diplomatik të Kosovës prapë nuk del ajo shumë. Nga kjo ka një rritje mes vitit 2010 dhe 2011 për shpenzimet operative dhe për ambasadat, që prapë nuk e tejkalon, diku 13 milionë euro varion kjo ngritje për këtë afat kohor 2010 – 2012, do të thotë, prapë nuk e di në fakt se a ka qenë ajo, do të thotë, veç një dëshirë e mirë që në moment të caktuar, domethënë të inkurajohet një farë mënyre, të inkurajohemi të gjithë se jemi të përgatitur që të punojmë në drejtim të legjitimitetit të shtetit dhe statusit të ri të Kosovës, po ka rezultuar që këtu në këtë tabelë parashikuese të buxhetit për këtë segment nuk figuron.

Përgjithësisht, objektivat që i ka paraqitur Ministria e Jashtme, janë mjaft ambicioze, por kur dalim te shifrat që janë paraparë për realizimin e këtyre objektivave, prapë do të jemi skeptikë se mund të realizohen të gjitha këto me këtë buxhet. Dhe, nëse për vitin 2010 buxheti tërësishtëm i kësaj Ministrie është 2.3, unë tash po e marrë në mbrojtje këtë Ministri, në një farë mënyre po flas në emër të tyre, është 2.3% e buxhetit të përgjithshëm të Kosovës, mendoj se është pak për këtë fazë nëpër të cilën po kalon Kosova, nuk do të thosha se është pak mbas 10 vjetësh, ndoshta, kur Kosova do të ketë një buxhet tjetër dhe do të ketë zgjidhur çështjet që kanë të bëjnë me njohjen dhe me anëtarësimin e saj gjithë mekanizma ndërkombëtar, dhe me një aktivitet të konsoliduar diplomatik kur nuk kërkohen shpenzimet për ndërtim, por vetëm për mirëmbajtje.

Në këtë kuadër u mundova që të kontribuoj dhe në një farë mënyre të sensibilizoj hartuesit e këtij projekti buxhetor që për këtë periudhë kohore të kenë parasysh se Kosova ka shumë punë ende pa bërë në planin e ndërkombëtarizimit në planin e krijimit të atij subjektivitetit të saj legal- formal në marrëdhënie ndërkombëtare. Kosova është aktualisht subjekt legal, por është ende jo plotësisht formal në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe kjo është rrugë që duhet trasuar sa më shpjet. Këtë na kanë sugjeruar edhe të gjithë miqtë tanë që kanë folur në këtë foltore dhe ata jashtë kësaj foltoreje që duhet të ndërgjegjësohemi se është rrugë e gjatë që duhet bërë. Është rrugë që niset më së pari me vendet e rajonit, me vendet e Bashkimit Evropian dhe pastaj vazhdon me vendet anëtare të OKB-së. Pra, është një rrugëtim i cili ka një kosto dhe mendoj që të gjithë do të jemi të ndërgjegjshëm për këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar ministri Ahmet Shala, e keni fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Po përpiqem që brenda afatit kohor, që e kam të përcaktuar, t'i sqaroj disa gjëra dhe, mbase, të përgjigjem në disa nga çështjet të cilat u shtruan mbase në mënyrë të përgjithësuar dhe pa emra për të mos nxitur edhe një debat tjetër, kështu që do të përpiqem t'i rumbullakoj.

I nderuar zoti kryesues,
I nderuari zoti zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,

Për të ekzistuar një dialog, nevojiten të paktën dy palë. Me përjashtime të vogla, mund të them se këtu pati pak dialog. Është e vërtetë dhe unë prita që nga sugjerimet e secilit nga ju, nga fjalitë e juaja, të kem diçka të re, të shtoj në kornizën afatmesme të shpenzimeve që konsideroj është një dokument i gjallë, i cili është një projeksion i përafërt dhe, përveç fjalimeve, siç u definuan edhe këtu, pati shumë pak impute profesionale dhe mund të shpreh keqardhjen time dhe besoj që kur të dëgjojë secili edhe në televizion këtë, do ta shoh secili veten se çfarë ka kontribuar për të qenë kjo kornizë më e mirë.

Sido që të jetë, unë i falënderoj të gjithë ata që u përpoqën të japin një kontribut dhe të cilin jam shumë i gatshëm të përpiqem ta inkorporojmë edhe në Kornizën afatmesme, edhe në planet tona buxhetore, por disa tone dhe kualifikime nuk do të doja t'i komentoja.

Dua të shpjegoj, gjithashtu, se më vjen keq që, bile prita nga disa profesionistë, të paktën, që konsideroj se janë profesionistë, të mos i ngatërrojnë disa gjëra, siç janë çështja e pagesës së anëtarësisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe çështjet e reflektimeve të tyre në buxhet. Po t'i lexojnë më mirë ato gjëra, atëherë nuk do t'i paraqitshin para juve si shifra skeptike se ne nuk kemi ditur t'i parashohim 156 milionë euro si anëtarësim në Bankën Botërore dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Anëtarësimi në këto dy institucione, në fakt, hap dyert që të kemi mundësi për mbështetje financiare, qoftë nga Fondi, qoftë nga Banka, natyrisht, me një depozitim të përkohshëm me të drejtë tërheqjeje të kostos, përkatësisht të kuotës në të cilën anëtarësohemi. Duke pasur kohën e kufizuar, nuk do të përqendrohem më gjatë me definicione dhe sqarimin e kësaj, por kolegëve të mi dhe deputetëve të respektuar, që konsiderohet që i dinë këto gjëra, jam i gatshëm t'u jap përgjigje në çfarëdo kohe.

Sa i përket çështjes që, u ngritën këtu disa aspekte të tjera, sidomos problemi i energjisë elektrike, që është vërtet problem, që duhet ta zgjedhim dhe do ta zgjedhim, një ndër arsyt pse nuk e kemi zgjidhur dhe pse s'kemi mund ta zgjidhim, ka qenë, sepse është pështjellë aq shumë sa që nuk ka qenë në gjendje ndoshta të ç'shptillet më shpejt dhe më vjen keq që dua ta them këtë për ata që e ngritën këtë çështje, sidomos ata që kanë qenë aktorë në vendimmarrje të caktuara, e kanë pështjellë aq shumë sa që ne sigurisht do ta ç'pshtjellim, por na ka marrë shumë kohë dhe janë momentet e fundit mbase që Qeveria do ta marrë vendimin e vet. Jam i sigurt që ajo zgjidhje do të jetë në favor të zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe në favor të asaj që është ngarkesa më e madhe sot. Çdo qytetar i Kosovës përafërsisht ka paguar deri më tani në vjet 100 euro për energjinë elektrike, në vend që ne të kemi dritë, ende jemi në terr, por thashë është pështjellur dhe le të jetë në ndërgjegjen e secilit që e ka pështjellur, se ka ndodhë ajo, por unë nuk dua të debatoj më shumë.

U tha edhe një çështje tjetër që, mbase me të drejtë është paraqitur, vlerësimi i ndërmarrjeve publike. Prognozat e të hyrave nga një proces që ende nuk ka ndodhur në çdo formë që prognozon, të paktën ata që konsiderojnë, besoj, veten konservativ, duhet të jenë më konzervativ se sa që do të duhej të planifikonin për dy – tri arsye.

Një është qasja jonë pra, që qasja ndaj shumës që ne do të përfitojmë ndaj privatizimit të ndërmarrjeve publike është mjaft konzervative dhe reflekton edhe realitetin në tregun global financiar.

Dhe dy, është çështja se Qeveria e Kosovës, e ka thënë edhe ky para jush dhe është koncept edhe i imi, që nuk do t'i shet 100/100 të aksioneve. Unë, të paktën personalisht, nuk jam ministër i cili do të rekomandojë që të shesim 100/100 të aksionet të asnjë nga asetet strategjike të Kosovës dhe se sa do të jetë përqindja e shitjes së atyre aksioneve, ne, siç kemi premtuar, do të debatojmë këtu bashkë. Dhe, ana tjetër është procesi i privatizimit të Postës nuk ka filluar, po them, ne jemi në procesin e fillimit të shpalljes, përkatësisht të marrjes së një kompanie konsulente edhe për KEK-un, edhe për Postën dhe Telekomunikacionin dhe vetëm kur të shqyrtohen të gjitha modalitetet, do vijmë dhe do t'i shqyrtojmë këtu bashkë qoftë nëpër grupet parlamentare, qoftë në debat publik.

(Reagim nga salla)

Po, ju shpjegova pse e kemi shkruar, po unë shqip fola.

Investimet kapitale, autostradat dhe investimet kapitale të tjera, Qeveria e Kosovës nuk konsideron që t'i zgjidhë përmes buxhetit të Kosovës dhe nuk do ishte as e mençme, as e mundshme. Çdo autostradë do të kushtojë të paktën 1 miliardë euro, ndërsa konsideroj që sektori privat është ai i cili do të na mundësojë atë, ndërsa ne më 25, sa mora vesh unë, është Ligji për partneritetin publiko-privat, i cili hap të gjitha këto mundësi, kurse ana tjetër është qasja në institucionet financiare ndërkombëtare.

U përmendën edhe investimet kapitale në arsim. Tri vjet, po thuajse, në qoftë se shikohen sa para janë investuar nëpër shkolla, unë konsideroj që edhe brenda tri vjetëve të ardhshme do të duhej të përmbyllej, të paktën, nga buxheti i Kosovës investimi nëpër objekte më dhe do të ishte absurde që të vazhdojmë të ndërtojmë shkolla edhe pas 10 vjet, sigurisht do të nevojitet mirëmbajtja e tyre. Orientimi ynë, pra, në investime kapitale do të shkojë me një trend të rënies, qoftë për dy arsye, një sepse ato do të përfundojë dikur misioni i ndërtimit të ndërtesave dhe do të fokusohemi në kualitetet e kurrikulave, e tjera, dhe në anën tjetër do hapim mundësi që partneriteti publiko-privat dhe kapitali privat t'i bëjë ato dhe jo buxheti i Kosovës. Buxheti duhet të orientohet dhe këto janë politika që, dikush e theksoj, se këtu s'ka politika.

Ishte çështje, u përgjigja më duket, dhe dua të them edhe diçka se e kam vetëm edhe një minutë, po e shoh orën, e kam vetëm edhe një minutë dhe s'dua ta tejkaloj.

Dua të them edhe diçka në disa nga diskutimet që u bënë se a kemi qenë të saktë apo jo në vlerësimet tona dhe prognozatat tona. Nuk pretendoj të jem ekspert, sikurse disa shokë dhe miq të mi, por nuk konsideroj se është dështim i ndonjë prognoze të devijuar për pak në qoftë se shtetet e caktuara, po jap vetëm njërin nga këto dhe nuk besoj që do të shihet në ekran, do të lus regjinë në qoftë se mundet, por në qoftë se ministri gjerman, në qoftë se ministri britanik, në qoftë se ministri japonez ka dështuar të bëjë një prognozë për 8% karshi asaj për tetë herë, pra, për tetë herë nga ajo që ka planifikuar, gjermani për 5,6 herë, që kanë qenë të gjithë mbi këtë, pas krizës kanë reviduar të gjitha prognozatat e tyre, e në qoftë se Qeveria e Kosovës nga 4,1 ose nga 5,1 ka rënë në 4,1, nuk e konsideroj si të turpshme, kështu që do t'ju kisha lutur shumë, pa marrë...

(Reagime nga salla)

...unë nuk po e kuptoj as menaxhmentin e Kuvendit, si do që të jetë... dhe unë vetëm dua ta shikoni me vëmendje këtë, nëse mund ta shihni dikush, janë të gjitha shtetet që kanë ...

(Reagime nga salla)

KRYESUESI: Për shkak se po pengohet, e ka edhe një minutë shtesë.
Edhe një minutë i vazhdohet ministrit fjala.

MINISTRI AHMET SHALA: Zoti kryesues, do të ishte në nderin e këtij Kuvendi që të keni një korrektësi ndaj Rregullores, si do që të jetë, do të mbetet edhe ajo në vlerësimin dhe ndërgjegjen tuaj.

Si do që të jetë, më lejoni për opinion dhe për juve të shpjegoj. Të gjitha këto shtete vetëm deri më 8 tetor, pra para krizës, faktikisht, kanë qenë të gjitha në prognozatat e tyre mbi këtë vijë, që është zero, që është zero zhvillim ekonomik dhe të gjitha këto kanë riprogramuar prognozatat e veta për tetë herë më poshtë, faktikisht. E vetmja Kosova ende mbetet, fatmirësisht, në regjion po flas, edhe në bazë të vlerësimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, i vetmi shtet në regjion që do të ketë edhe në tri vitet e ardhshme rritje ekonomike, të paktën, pozitive dhe ne konsiderojmë që do të kemi një rritje mesatare për 5,1%, nuk guxoj të garantoj dhe s'kam garantuar kurrë se do të jetë 6, 6,1, 5,1.....

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Dua vetëm t'ju them se unë ndërgjegjen mirë e kam, kryesimin e seancës e bëj në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit. Nëse keni vërejtje, keni ku të drejtoheni. Me këtë, të nderuar deputetë, mbyllet debati dhe pika e dhjetë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

- Shqyrtimi i Raportit vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë, për vitin 2008

Konstatimet hyrëse:

Komisioni për Buxhet ka shqyrtuar Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë për vitin 2008 dhe ka rekomanduar miratimin e tij në seancë plenare. Raporti me rekomandimet e Komisionit, së bashku me Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë për vitin 2008, u janë shpërndarë deputetëve.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin e Ekonomisë dhe Financave, zotin Ahmet Shala, që para deputetëve të Kuvendit të Kosovës ta arsyetojë Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë për vitin 2008. E keni fjalën zoti ministër!

Ju nuk keni kërkuar pauzë, nuk e keni kërkuar. Ju e keni fjalën zoti ministër. Nuk keni thënë në fillim të seancës që në ora kaq, kaq. Ju jeni të zënë. Faleminderit!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, shumë!

Si do që të jetë, do të doja që të kemi një pauzë, po ju respektoj absolutisht ju!

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që para jush të paraqes Raportin e parë për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Republikës së Kosovë për vitin 2008.

Sigurisht që auditimi i brendshëm është pjesë themelore e qeverisjes së mirë dhe Qeveria e Kosovës konsideroj që ka bërë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim.

Qeverisja e mirë fillon me përcaktimin e një strategjie udhërrëfyese të politikave operacionale, alokimin e burimeve te ministritë, komunat dhe entitetet publike për t'i përdorur ato në përmbushjen e objektivave që ka përcaktuar Qeveria.

Hartimi i këtij raporti është rezultat i raporteve të marra nga njësitë e auditimit të brendshëm nëpër organizatat buxhetore që financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Raporti në pika të shkurtra prezanton historikun e zhvillimit dhe të arriturat në fushën e auditimit të brendshëm në nivelin qendror dhe atë lokal, aktivitetet e njësisë qendrore harmonizuese të auditimit të brendshëm, gjetjet, konkluzionet, rekomandimet dhe anekset tabelore për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Republikës së Kosovës për vitin 2008.

Aktiviteti i auditimit të brendshëm në Kosovë ka filluar në maj të vitit 2000 në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, pra si njësi, në kuadër të Departamentit të Auditimit të Brendshëm, në përputhje me nenin 8 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësiive 2003/2, Departament i cili ka kryer auditimet e brendshme në gjithë sektorët publikë.

Pas shpalljes së Ligjit nr. 02/L-74 për auditimin e brendshëm, në qershor të vitit 2007, kërkohet pra, në bazë të ligjit që ka miratuar Kuvendi i Kosovës, krijimi i Njesisë Qendrore Harmonizuese për auditimin e brendshëm, misioni i së cilës është ngritja e kapaciteteve profesionale dhe ngritja e cilësisë së auditimit në përputhje me standardet dhe praktikrat më të mira ndërkombëtare, njësi kjo e cila është krijuar më 1 prill të vitit 2008, si dhe decentralizimi i auditimit të brendshëm, me ç'rast çdo organizatë duhet të krijojë njësinë e vet për auditimin e brendshëm dhe si rezultat i kësaj tani janë krijuar 50 njësi për auditim të brendshëm në nivel qendror dhe lokal.

Aktivitetet dhe iniciativat për zhvillimin e auditimit të brendshëm gjatë vitit 2008, kryesisht janë përqendruar në krijimin e infrastrukturës ligjore dhe ngritjen e kapaciteteve të auditimit të brendshëm, si dhe në harmonizimin e infrastrukturës ligjore për auditim të brendshëm me standardet dhe praktikrat ndërkombëtare.

Harmonizimi i udhëzimeve për kryerjen e auditimit të brendshëm në bazë të standardeve dhe të praktikave më të mira është bërë, po ashtu, përmes decentralizimit të auditimit të brendshëm, trajnimit të auditorëve të brendshëm, promovimit të rolit të auditorit të brendshëm.

Është rishikuar Ligji për auditim të brendshëm, leximi i parë i të cilit në Kuvend është bërë më 29 janar të vitit 2009 dhe tani presim që së shpejti, besoj, të miratohet edhe në këtë Kuvend.

Doracaku i ri për auditimin e brendshëm është botuar, nënshkruar dhe publikuar në Web faqen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave në tri gjuhët, i cili përfshin të gjitha udhëzimet e nevojshme për kryerjen e auditimit të brendshëm, si: standardet ndërkombëtare të auditimit, kodin e etikës, modelin e statusit të njësiive të auditimit të brendshëm, praktikrat më të mira për Komitet të auditimit, modelin e statutit të Komitetit të Auditimit e tjerë.

Është përfunduar, po ashtu, me sukses trajnimi i 105 auditorëve të brendshëm në këto fusha: auditimi i brendshëm, vlerësimi i rrezikut, kontrolli i brendshëm, planifikimi strategjik dhe vjetor, komunikimi masiv, buxhet, e tjera, e tjera, si dhe janë organizuar 25 pilot-auditime të monitoruara nga ekspertët ndërkombëtarë.

Projekti ka përfunduar në gusht të vitit 2008 dhe pas përfundimit të trajnimit auditorët e brendshëm janë pajisur me certifikata për kryerjen me sukses të trajnimit.

Gjatë vitit 2008 Njësia Qendrore Harmonizuese për auditim të brendshëm ka organizuar trajnimin me hartimin e planit strategjik ... rezultat i të cilit është 88% e organizatave buxhetore tani kanë planet e auditimit.

Njësia Qendrore Harmonizuese, po ashtu, vazhdimisht ka bashkëpunuar me auditorët e brendshëm, auditorin gjeneral, menaxhmentin e lartë si dhe me ekspertët e ndryshëm ndërkombëtarë. Në bazë të raporteve të marra nga Njësiti i Auditimit të Brendshëm, kemi këto rezultate: gjatë vitit 2008 janë kryer 292 auditime, në këto auditime janë dhënë 1937 rekomandime, prej rekomandimeve të dhëna 1047, përkatësisht 54,05% janë implementuar, 491 ose 25,35% janë implementuar pjesërisht dhe 399 ose 20,6% nuk janë implementuar.

Nga analiza e këtyre raporteve janë vlerësuar një varg i të arriturave, por edhe kërkesat e domosdoshme për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të auditimit të brendshëm në Kosovë.

Në kontest të kësaj sa u tha, dua t'ju informoj se tani pritet të fillojë projekti për trajnimin, certifikimin dhe licencimin e auditorëve të brendshëm sipas standardeve ndërkombëtare për auditim, projekt ky i cili do të financohet nga Komisioni Evropian.

Të nderuar deputetë,

Të vetëdijshëm për rolin dhe rëndësinë e auditimit të brendshëm, komentet, sugjerimet dhe rekomandimet tuaja do të kontribuojnë në ngritjen e performancës së auditimit të brendshëm në përgjithësi.

Unë lexova pak më shpejt se sa është ritmi im i zakonshëm, thjeshtë për të zënë kohën e akorduar. Faleminderit shumë dhe kam kënaqësinë që t'ju përgjigjem, në qoftë se ka ndonjë pyetje ose sugjerim. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë,

Shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së kërkon që të fillojë pauza tani. A ka kush kundër? Nuk ka. Deri në orën 15:00 pauzë. Në orën 15:00 do ta marrë fjalën Safete Hadergjonaj. Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejtimn e seancës e rimerr zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë me debatin.

Radha është e shëfave të grupeve parlamentare. Për grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, Safete Hadrgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADRGJONAJ: Përshëndetje për ju Kryetar!

Për ministrin që është këtu dhe për gjithë deputetët!

Edhe pse auditimi i brendshëm në Kosovë ka filluar në vitin 2000, që ka pasur për detyrë të kryente auditime të brendshme në të gjitha njësitë organizative buxhetore të sektorit publik, Kuvendi i Kosovës asnjëherë nuk ka pasur ndonjë raport për punën e kësaj njësie të auditimit.

Auditori gjeneral në të kaluarën në vazhdimësi ka raportuar për shkelje të shumta financiare në punësim, në ndërmarrjet publike dhe në institucione, por auditori i brendshëm kryesisht ka heshtur.

As në Komisionin për Buxhet dhe Financa, as në Kuvend nuk është shqyrtuar ndonjë raport i auditimit të brendshëm edhe përkundër asaj që disa herë është kërkuar në mandatin e kaluar në gjë e tillë.

Informatat se si funksionon ky departament në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si është i organizuar Auditori i brendshëm në secilin institucion, na kanë munguar.

Është hera e parë që kemi një raport të auditimit të brendshëm dhe është për t'u përkrahur ky komunikim në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Kuvendit. Përmes këtij raporti ne kemi mundësi të shohim apo të dimë se si funksionon Auditori i brendshëm, ku janë problemet dhe çka mund të bëjmë ne si Kuvend që të ketë efektivitet në punën e Auditorit të brendshëm, sepse nuk mund të mendohet një menaxhim i mirë i institucioneve nëse nuk është funksional auditimi i brendshëm, i cili sinjalizon për shkeljet e bëra, jep rekomandime për evitimin e atyre shkeljeve që reflektojnë në efikasitetin e menaxhimit të institucioneve publike duke eliminuar abuzimin, shpërdorimet dhe korrupsionin.

Nga raporti vërejmë se janë duke u bërë përpjekje në përafrimin e kuadrit ligjor me standardet ndërkombëtar, janë për t'u vlerësuar hapat e parë të ndërmarrë në këtë drejtim dhe në drejtim të krijimit të kuadrit institucional në përputhje me ligjin dhe ndërtimin e kapaciteteve njerëzore të cilat do të kryenin më së mirë punën.

Ligjin e auditimit të brendshëm e kanë karakterizuar mangësi, për çka është hartuar Projektligji i ri për auditimin e brendshëm që pak a shumë iu përshtatet standardeve ndërkombëtare. Po ashtu, nga raporti vërejmë se janë nxjerrë edhe rregullativa të cilat e bëjnë të mundur punën e auditivit, të cilat veç i theksoi edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave.

Vërehet se është bërë punë edhe në drejtim të ngritjes së kapaciteteve njerëzore me përkrahjen e mekanizmave ndërkombëtarë.

Megjithatë, mbetet shumë për të bërë në këtë drejtim që auditorët e brendshëm të pajisen me certifikata ashtu që të mundësohet licencimi dhe certifikimi i auditorëve siç e kërkon ligji.

Në faqen 10 të Raportit shohim se nga 50 organizata që i kanë të formuara njësitë e auditimit, komitetet e auditimit i kanë formuar vetëm 24 organizata buxhetore. Njësitë e auditimit nuk i kanë të formuara këto komitete dhe aty ku janë formuar janë jo funksionale, ka paqartësi rreth formimit, si dhe konflikt interesash aty ku janë formuar.

Një gjë të tillë e konstatuar edhe Kuvendi gjatë monitorimit të Ligjit për auditimin e brendshëm, i cili është kryer nga Kuvendi.

Mbetet që problematika e formimit dhe funksionimit të komiteteve të auditimit të rregullohet më mirë në Ligjin për auditimin e brendshëm, të cilin veç e kemi në procedurë në Kuvend.

Njësitë e auditimit nuk janë të formuara në të gjitha organizatat buxhetore, pra janë të formuara vetëm në 50 shosh, kurse 10 organizata buxhetore janë pa këto njësi. Në raport paraqiten arsyetimet për mos formimin e njësive të auditimit, por është mirë që të ketë angazhim më të madh në drejtim të krijimit të njësive të auditimit funksionale, sepse nga raporti vërehet se disa njësi të auditimit funksionojnë pa drejtorë dhe pa numër të mjaftueshëm të auditorëve, për çka rrezikohet efektiviteti i punës së auditorëve të brendshëm, gjë që ndikon edhe në efikasitetin e institucioneve në përgjithësi.

Sipas raportit të vitit 2008, Auditori i brendshëm ka bërë 292 auditime të brendshme, ku janë dhënë 1937 rekomandime, ku nga menaxhmenti janë implementuar 1047 prej tyre, kurse janë në implementim e sipër edhe 491 rekomandime. Në përgjithësi vërehet që është një performancë pozitive në drejtim të implementimit të rekomandimeve.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah Raportin e Auditorit të brendshëm dhe inkurajon Qeverinë të vazhdojë edhe në të ardhmen me objektivin për të siguruar pavarësinë e auditorëve, krijimin e kushteve që auditorët të kenë qasje në dokumentet zyrtare, si dhe në krijimin e kushteve të mjaftueshme për punë, sepse vetëm kështu mund të konkretizohet suksesi i reformës në financat publike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike, Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: I nderuar Kryetar,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dola këtu sepse dëshiroj të paraqes një opinion që reflekton bardh, sepse deri më tani mu duk se po paraqitet që gjithçka që zhvillohet në Kosovë është zi.

Presidenti historik dr. Ibrahim Rugova thoshte, citoj: “Zot, fali ata që pavetëdije i bëjnë dëm këtij vendi”. Prandaj, unë e them se Kosova është vend me perspektivë dhe sidomos për gjeneratën e re. E thashë këtë, sepse Lidhja Demokratike e Kosovës punon me bazë të vizionit politik të trashëguar dhe përkujdesjen institucionale e bën duke miratuar Ligjin për Presidentin e Kosovës, duke bërë Shtëpinë e pavarësisë, duke ndërtuar objektin dhe duke ndarë mjetet për Teatrin, Operën dhe Baletin “Ibrahim Rugova” dhe vitin e ardhshëm do të realizohet busti, i cili me krenari do të vendoset në Sheshin “Ibrahim Rugova”, ku janë të ftuar edhe gjithë ata që e përdorin emrin e tij për konsum politik.

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së ka shqyrtuar Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Republikës së Kosovës për vitin 2008. Pasi që ky është raporti i parë i Njesisë Qendrore Harmonizuese për Auditorin e brendshëm, përgëzoj autorët e tij për hartimin konciz dhe përmbajtësor. Sipas opinionit tonë, raporti përmban të gjitha informatat e nevojshme dhe është gjithëpërfshirës, duke filluar nga historiku i auditimit, misioni, vizioni i auditimit të brendshëm dhe të Njesisë Qendrore Harmonizuese për auditimin e brendshëm. Të arriturat, të gjeturat, konstatimet dhe rekomandimet për përmirësim të sistemit të auditimit të brendshëm me qëllim të ngritjes së vlerës të qeverisjes më të mirë të të gjitha subjekteve të sektorit publik.

Duke marrë parasysh se ne kemi bërë monitorimin e Ligjit për Auditorin e brendshëm nr. 02/L-74, dëshiroj të theksoj të arriturat kryesore të Njesisë Qendrore Harmonizuese për Auditorin e brendshëm.

Përgatitja dhe harmonizimi i Draftligjit për auditim të brendshëm me standardet ndërkombëtare për auditim të brendshëm, rifreskimi i doracakut të auditimit të brendshëm, i cili doracak do të shërbej si udhëzues për auditorë të brendshëm për të zhvilluar aktivitetin e tyre në fushën e auditimit. Ngritjen e kapaciteteve të auditimit të brendshëm përmes projekteve të ndryshme nga Komisioni Evropian, projekt ky që do të krijojë mundësinë që edhe në Kosovë për herë të parë auditorë të brendshëm të trajnohen sipas standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare për auditim të brendshëm dhe pajisja auditorëve të brendshëm me certifikata nga një organizatë e pranuar ndërkombëtarisht, e cila parashihet edhe me ligjin në fuqi.

Gjithashtu, dëshiroj të theksoj edhe monitorimin dhe vlerësimin e auditimit të brendshëm nga ana e Njesisë Qendrore Harmonizuese, kjo gjë në këtë raport mendoj se është përmbledhur shumë mirë edhe në aneksin në fund të raportit. Aneksi përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për të vlerësuar funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe nga vetë ne. Këto të dhëna pasqyrojnë në mënyrë detaje gjendjen e çdo organizate veç e veç, duke filluar nga krijimi i njësive të auditimit, komiteteve, planeve strategjike dhe numrin e auditimeve, rekomandimet, të dhënat dhe kërkesat e njësive të auditimit të të gjitha organizatave buxhetore më se të nevojshme për auditorë të rinj.

Në këtë raport janë paraqitur edhe të metat dhe pengesat për arritjen e rezultateve të mira. Andaj, opinionin jonë kryesor në këtë raport është se funksionimi i auditimit të brendshëm në mënyrë efikase dhe efektive për kundër të arriturave nuk mund të ketë sukses të mirëfilltë pa përkrahjen e vazhdueshme nga nivelet më të larta të Qeverisë. Nëse ne dëshirojmë një qeverisje të mirë dhe transparente, atëherë auditimin e brendshëm duhet ta mbështesim maksimalisht, duke i krijuar kushtet për një reputacion, cilësi, gjykim dhe mendim të pavarur.

Grupi Parlamentar i LDK-së e vlerëson dhe e mbështet Raportin në tërësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Me gjithë respektin, deputet Zemaj, tjera herë është mirë të diskutohet vetëm materiali, për çka është përcaktuar rendi i ditës.

Diskutuesi i radhës është në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Siç është theksuar edhe në raport, nevoja për formimin e njësive profesionale kompetente të auditimit të brendshëm është vërejtur që në ditët e para të pas luftës, kur janë formuar

disa njësi më të thjeshta të auditimit të brendshëm, atëherë në kuadër të Autoritetit Qendrorë Fiskal, e më vonë me mbështetjen e AER-it dhe të Bashkimit Evropian janë organizuar trajnime dhe mbështetje tjera profesionale me qëllim që organizatave buxhetore t'u ndihmohet në menaxhimin më të suksesshëm të parasë publike. Për këtë qëllim edhe është përgatitur dhe është nxjerrë Ligji për auditimin e brendshëm, i cili në Kuvend është aprovuar në mesin e vitit 2007, i cili ligj ka paraparë formimin e njësive të veçantë të auditimit të brendshëm. Të gjitha këto janë veprime të mira që janë bërë dhe që duhet të mbështeten dhe të përkrahen në vazhdimësi.

Mendoj që pak në mënyrë neglizhente është respektuar nevoja për formimin dhe krijimin e mirëfilltë të këtyre njësive sepse, nga hyrja në fuqi e ligjit, tash në verë bëhen 2 vite dhe mendoj që ka pasur hapësirë kohore formimi i mirëfilltë edhe me kuadër, edhe me mbështetje të gjithanshme edhe materiale dhe të hapësirës të mbështetur dhe të organizuar në këto njësi në mënyrën si kërkohet dhe si është e nevojshme.

Raporti i ka disa mangësi, por me qenë se është raporti i parë, ne do t'i shohim me tolerancë mangësitë dhe mendojmë që raportin duhet ta mbështesim, sepse është raporti i parë dhe besojmë që raportet tjera, në bazë të përvojës, do të jenë më komplete në këtë drejtim.

Megjithatë, edhe pse është në mangësi, raporti tregon se në organizimin e njësive të auditimit të brendshëm ka shumë mangësi, që edhe parafolësit i përmendën, ndër to janë përgatitja e planeve strategjike, pastaj nuk janë pajisur auditorët me certifikata, me licenca e tjera. Nuk janë krijuar komitetet dhe strukturat tjera të auditimit të brendshëm, gjithnjë flas sipas raportit. Shumë komitete nuk janë funksionale, po flas nëpër organizata qendrore buxhetore, ku hynë mes tjerash edhe Kuvendi, Zyra e Presidentit, e tjerë.

Ka edhe disa komuna, po ashtu, që si ka formua këto njësi dhe ajo që është më e keqe dhe që mendoj se duhet këtu të kritikohet si dukuni, është se në shumë organizata buxhetore këtyre njësive nuk ju kanë siguruar as mjetet buxhetore për paga. Pra, duket që këto njësi janë formuar në shumë organizata buxhetore sa për të plotësuar aspektin formal, por në realitet s'ju kanë krijuar mundësitë për të funksionuar, pagat nuk ua kanë siguruar, hapësirat e tjera.

Prandaj, ne si grup parlamentar konsiderojmë se formimi i njësive të auditimit të brendshëm është shumë i rëndësishëm për t'i ndihmuar organizatat buxhetore në menaxhimin e mirë të buxhetit dhe kërkojmë pra që të mbështetet në mënyrë të gjithanshme krijimi i kushteve për funksionim më të mirë të këtyre organizatave buxhetore, pra të auditimit të brendshëm të tyre.

Po ashtu, e mbështesim edhe nevojën për ridraftimin e ligjit në pjesët ku është vërejtur se ka mangësi. Krejt kjo, me qëllim që të kemi një strukturë të auditimit të brendshëm që na ndihmon të menaxhojmë më mirë paranë publike. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të AKR-së, shefi i grupit, Ibrahim Makolli e ka fjalën!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së i mbështet deklaratimet e deritashme, në veçanti mbështesim çdo veprim i cili çon në përmirësimin e qeverisjes të mirë të Kosovës, që një nga këta faktorë është pikërisht edhe ky instrument. Natyrisht, në bazë të këtij raporti

shihet zhvillimi i një aktiviteti të pjesshëm të kësaj, por unë do të përqendrohem vetëm në 2 – 3 çështje të cilat më tepër paraqiten edhe në rekomandimet në pjesën e fundit, në të cilat vërehet moskompletimi i këtyre njësive të auditimit të brendshëm në disa prej institucioneve, që gjithsesi do të duhej të ishin tashmë funksionale sepse shtrohet pyetja pse nuk janë krijuar dhe pse nuk respektohet ligji.

Po ashtu, në shumë prej tyre nuk janë zgjedh përgjegjësitë e njësive të auditimit të brendshëm dhe, natyrisht, për t'u kompletuar ky aktivitet nevojitet që në të gjitha këto njësi të krijohen njësi të auditimit të brendshëm në mënyrë që të jenë më funksionale dhe mund ta zhvillojnë aktivitetin e vetë në pajtim me ligjin.

Grupi Parlamentar i AKR-së i bashkohet zërit se ky është raporti i parë i këtij autoriteti në Kuvendin e Kosovës dhe, natyrisht, e mbështesim me të gjitha këto vërejtje të cilat u thanë dhe do të thuhën edhe në të ardhmen, por me qëllimin më të mirë që tashmë edhe ky Kuvend të detyrojë këto institucione që në mënyrën dhe në afatin sa më të shpejtë kohor të kompletohen për të mundësuar zhvillimin e aktivitetit të tyre dhe respektimin dhe zbatimin e ligjit në praktikë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, Synvere Rysha e ka fjalën.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar me kujdes Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë për vitin 2008.

Mendojmë se është një raport mjaft i përmbledhur, është konciz, i saktë dhe i drejtë në formën se si është përgatitur dhe përmbajtjen e tij.

Ne, gjithashtu, e përshëndesim edhe themelimin e sektorit të veçantë apo rregullatorit të veçantë të kësaj sfere, të Njesisë Qendrore Harmonizuese për auditimin e brendshëm, e cila edhe si rezultat i themelimit të kësaj zyre ka pasur mundësi të na paraqes këtë raport të punës së tyre dhe të punës së auditorëve të brendshëm në institucionet publike në Kosovë, duke përjashtuar ndërmarrjet publike.

Ajo që vërehet nga të gjitha grupet parlamentare, po vërtet mbetet theksohet edhe nga ana e partisë sonë, është kompletimi i stafit të auditimit, sepse në shumë institucione publike, komuna, ministri, Qeveri, Kryeministri, nuk janë themeluar komitetet e auditimit dhe nuk është i kompletuar stafi i auditimit. Kemi raste kur ka vetëm një auditor, ndërsa me ligj kërkohet që të jenë zyra të veçanta të auditimit sepse do t'i shërbejnë në mënyrë më efikase dhe efektive këtij departamenti.

Gjithashtu, ne do të ndalemi ndoshta te pjesa e fundit, që është pjesa më e ndishme dhe do të kishim pasur dëshirë që, si Lidhje Demokratike e Dardanisë, në të ardhmen institucionet e Kosovës të jenë më përgjegjëse, sidomos te kjo pjesa e fundit ku thuhet - rekomandimet e auditorëve, sepse kemi rastin kur auditorët kanë lëshua më tepër se 28 rekomandime brenda vitit, mirëpo nga ato vetëm 8 rekomandime janë implementuar, apo kemi raste të tjera kur nga 53 rekomandime që janë lëshuar, asnjë nga ato nuk është përfillë. Do të kishim dashur që në të ardhmen të jetë një bashkëpunim më i ngushtë i institucioneve me auditorin e brendshëm dhe të shihet në një kënd pozitiv. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit “7+”, deputetja Shpresa Murati.

ŠPRESA MURATI: Hvala!

Pozdrav svima,

Danas pred nama je prvi izveštaj o delovanju unutrašnje revizije u javnom sektoru na Kosovu za 2008. godinu, koji u sažatim tačkama sadrži analizu, procenu aktivnosti, zaključke i preporuke o poboljšanju funkcionisanja sistema unutrašnje revizije.

Aktivnosti za razvoj unutrašnje revizije tokom 2008. godine bile su u glavnom usmerene ka stvaranju zakonske infrastrukture i podizanju kapaciteta unutrašnje revizije.

U izveštaju je data i tabela 25 izvršenih pilot revizija, od 50 budžetskih organizacija koje imaju jedinice unutrašnje revizije, 44 od njih su pripremile njihove strateške i godišnje planove.

Od 50 budžetskih organizacija, odbore za reviziju osnovale su samo svega njih 24. I ako su većina budžetskih organizacija osnovale jedinice unutrašnje revizije, one uglavnom nisu efikasne, jer većina od njih funkcionišu samo sa jednim revizorom.

Uprkos poteškoća, unutrašnji revizori su postigli izvesne rezultate. Parlamentarna grupa „7+“ podržava izveštaj uz napomenu da je neophodna veća podrška unutrašnjoj reviziji i od strane domaćih i međunarodnih institucija kako bi bila efikasnija i funkcionalnija u vršenju svojih obaveza. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputetja Radmila Vujović.

RADMILA VUJOVIĆ: Hvala!

Predhodne diskusije su pojasnile funkcionisanje sistema unutrašnje revizije, izveštaj je značajan i Parlamentarna grupa SLS će podržati ovaj izveštaj. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Kemi të lajmëruar disa deputetë, 5deputetë, por unë jam i obliguar ta them se grupet parlamentare, shefat e grupeve parlamentare dhe qëndrimin e grupit parlamentar nuk e bëjmë për t'i qitur në syret shefat e grupeve, por për ta prezantuar politikën e grupeve parlamentare. Megjithatë, pasi janë lajmëruar, po ua jap fjalën. Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje te nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Natyrisht që ne i mbështesim rekomandimet e Grupit Parlamentar, mirëpo është e rrugës që të ngrehim disa shqetësime të cilat i kemi për raportin.

Së pari konsideroj se të gjitha organizatat buxhetore duhet sa më parë ta kompletojnë çështjen e auditorëve, duke marrë parasysh që funksionimi i auditorëve në Kosovë do të krijonte situatë që, jo vetëm menaxhimi i financave publike, mirëpo çështja e prokurimit, çështja e personelit, çështja e shfrytëzimit të veturave zyrtare dhe të gjitha dukuritë do të ishin parandalim që të mos lejojnë menaxhmentin e organizatave buxhetore të bien në

situata që të tejkalojnë procedurat apo t'i shkelin procedurat pa nevojë dhe ndoshta në këtë aspekt duhet ta kuptojmë qëllimin e auditimit.

Unë e kuptoj që vlen të përmendet suksesi i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa që, për herë të parë, ndoshta për shkak të angazhimit të madh kanë krijuar situatën që sot deputetët e Kuvendit të Kosovës para vetes të kenë një raport të auditorit të brendshëm, gjë e cila nuk ka ndodhur në takimet e kaluara apo në legjislacionet e kaluara.

Mirëpo, unë e kuptoj ministri për Ekonomi dhe Financa e ka trashëguar një numër të personelit të auditorëve të cilët kanë qenë të pranishëm dhe e di që, me qëllim të funksionalizimit të këtyre auditorëve ka organizuar edhe trajnime. Mirëpo, vlen të përmendet një fakt, zoti ministër, që ndoshta duhet të kemi parasysh që në të shumtën e rasteve, nuk po flas për këtë raport, sepse ne nuk e kemi raportin në detale, ato do të kemi mundësi ta shohim raportin e Auditorit gjeneral, në shumicën e rasteve konkludimet e auditorëve, që po flas, kanë qenë nganjëherë edhe me konkluzione dhe përfundime politike. Prandaj, unë i respektoj përfundimet dhe seminarët që i keni bërë për auditorët, por në të ardhmen është mirë t'ju bëhet e qartë që auditorët, përveç çështjeve profesionale, nuk duhet të nxjerrin rekomandime dhe përfundime politike.

Kjo ka ndodhur në shumtën e rasteve dhe, ju e dini, për shkak të mos angazhimit të auditorëve me kohë, sot ju si Qeveri detyroheni të paguani me miliona euro për shkak të shkëputjes së kontratave të paligjshme dhe për shkak të mos intervenimit me kohë të auditorëve.

Vlen të përmendet edhe një fakt. A duhet të jetë në objektin të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa të mendojë se ku duhet ta organizojë funksionimin e auditorëve në të ardhmen.

Çështja e funksionimit të auditimit brenda Ministrisë për Ekonomi dhe Financa konsideroj që ndoshta është e rëndësishme, mirëpo në të ardhmen duhet të mendohet sepse, nëse i merrni dhe i shikoni organizatat buxhetore, të cilat janë audituar, vlen të përmendet që thesari është audituar vetëm nga auditorët e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa.

Ministria për Ekonomi dhe Financa është audituar vetëm nga auditorët e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa. Shërbimi Doganor i Kosovës është audituar nga auditorët e Shërbimit Doganor të Kosovës. Ministria e Shëndetësisë është audituar vetëm nga auditorët e Ministrisë së Shëndetësisë. Prandaj, përderisa Ligji lejon që t'i kemi auditorët brenda organizatave buxhetore, nëse dëshirojmë të funksionojnë, do të ishte mirë që për auditimet specifike, së paku, të ketë përzierje të auditorëve që mos të dalin nganjëherë ndoshta edhe në konflikt të interesit për shkak që, nëse ndonjë epror i organizatës buxhetore kërkon që të mos shkruhen në raport, sepse kjo nuk i ndihmon në rend të parë menaxhmentit brenda organizatës buxhetore dhe kjo e di që nuk është me fajin tuaj, mirëpo ka qenë një zakon, traditë që ka mbetur nga e kaluara dhe kemi pasur rastin që auditorët janë ftuar edhe vetëm me telefon.

Vlen të përmendet edhe një fakt. Jemi në vitin 2009 dhe jemi duke folur për raportin për vitin 2008. Në vitin 2008 për një organizatë buxhetore ka deri në 135 rekomandime. Kjo është çështje mjaft shqetësuese, 135 rekomandime. Auditori ka filluar të punojë nga viti 2000 dhe pothuaj të gjitha organizatat buxhetore i kanë auditorët dhe, të jenë 135 rekomandime, është mirë zoti ministër që në të ardhmen të kërkonin që nuk vlen dhe nuk

është e rëndësishme që auditori vetëm të shkojë e të konstatojë një gjendje, por e rëndësishme për ne në Kosovë, për institucionet këtu është që këto rekomandime të zbatohen në praktikë dhe duhet të marrin masa adekuate pse nuk zbatohen rekomandimet në vitin 2008. Janë me nga 130, ka 90, 50 e kështu me radhë.

Dhe, krejt në fund, do të ishte me interes që të krijojmë kushte për auditorët, sepse e kuptojmë që aktualisht nuk i kanë kushtet, do të ishte mirë që të shikojmë edhe certifikatat të cilat janë lëshuar për auditorët, por të pajisjen edhe njerëzit tjerë, sepse e kuptojmë se si ka ardhur certifikimi për auditorë deri në këtë periudhë.

Andaj, është mirë që, zoti ministër, ndoshta në të ardhmen të mendoni, meqë shumica e organizatave buxhetore e kanë numrin e pakompletuar për auditor, kanë vetëm një auditor dhe kanë me dhjetëra departamente, është e pamundur një auditor t'i mbikëqyrë dhe të japë kontribut në parandalimin e dukurive negative që mund të shfaqen para auditorit gjeneral, të krijohet situata që të ketë certifikim edhe të auditorëve të rinj. Të krijojmë auditor profesionalë, auditorë të cilët bazën ligjore e marrin mbi të gjitha dhe jo ndikimet e atyre që i thërrasin në telefon, nuk po flas për këtë periudhë, po flas, ne që nuk kemi pasur rast t'i shikojmë auditimet dhe raportet e auditorëve që kanë edhe viteve dhe qeverive të kaluara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kisha kërkuar që vërtet më shumë se 5 minuta të mos debatojmë për këtë pikë të rendit të ditës. Ju e dini që çështja e largimit të papunës nuk është çështja e editorit të brendshëm, ajo është çështje politike dhe auditori pak ka mundësi të bëjë kur s'po mundet t'i kthejë në punë ata që janë larguar pa drejtë, Gjykata e shkallës së parë, që është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, mendoj se fuqia e auditorit është tepër e vogël, do të thotë, mos të hyjmë në sfera auditori i brendshëm s'mund të bëjë gjë prej gjëje. Vazhdojmë, fjalën e ka, por ju kisha lutur 5 minuta, se për 5 minuta mjaftojnë nëse jeni të përgatitur. Fjalën e ka Kaqusha Jashari, të përgatitet Muzejene Selmani.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pikërisht për këtë fjalë që thatë ju, unë kam dashur t'i them vetëm dy tri fjalë, shumë shkurt.

Funksionimi i auditimit të brendshëm është shumë i nevojshëm dhe shumë me rëndësi në këtë kohë kur e kemi përgjegjësinë, se institucionet tona vendore e kanë përgjegjësinë

KRYETARI: Ftoj deputetët që janë këtu pari, le të kthehen në sallë!

KAQUSHA JASHARI: prandaj nga ky raport shihet a janë krijuar kushtet për veprimin e këtij sektori. Prej këtij raporti kemi parë që sa për ligjin është, sa për urdhëresat administrative, gjithashtu, për doracakun, për përdorimin e tyre në punë, gjithashtu, trajnimet kanë qenë dhe struktura organizative mendoj se është bërë gati në të gjitha institucionet. Prandaj, mendoj se prej këtij raporti e kemi marrë vetëm informatën e gjendjes dhe të krijimit të bazës për punën e sektorit të auditimit.

Në raport kemi parë që për një viti, në vitin 2008 kanë qenë edhe aktivitetet plotësuese për plotësimin e ligjit, gjithashtu për plotësimin e doracakut dhe formimin e strukturës organizative. Po, ajo pjesa për të cilën desha të them unë, ku janë konkluzionet dhe rekomandimet në raport, mendoj se nuk janë përfshirë edhe cilat janë problemet me të cilat ballafaqohet kjo strukturë.

Ato që i thatë edhe ju, baza është e krijuar, por mundësia e funksionimit është diçka tjetër. Unë shpresoj se në raportin e ardhshëm do të dalin në shesh edhe problemet tjera, se fuqia e auditorit nuk është vetëm vendi i punës dhe kontrata, por edhe certifikata për të cilën kanë diskutuar dhe kanë shprehur mendimin diskutues të mëparshëm, por fuqia e tyre është e lidhur shumë ngushtë edhe me pranimin e tyre në institucionet nga shefat e resorëve. Prandaj, këtë raport mendoj se është mirë të pranojmë si raport dhe ta marrim me dije a është krijuar baza apo jo, po jo edhe fuqia e tyre për veprim.

Në qoftë se me një anë kemi shumë vërejtje për korrupsion, kemi pasur diskutim edhe veprimin dhe raportin e Agjencionit kundër Korrupsionit, ky raport mund të jetë vetëm një segment që u krijua baza për veprim, por jo edhe mundësia e tyre. Prandaj, në të ardhmen mendoj se duhet përfshirë edhe problemet të cilat janë, e ky raport fare nuk e ka cilat janë problemet për funksionimin e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Muzejene Selmani, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar! Përshëndetje për dy ministrat që janë prezent dhe përshëndetje për të gjithë deputetët brenda seancës.

Në raportin vjetor të funksionimit të sistemit të auditimit të brendshëm kemi një përmbledhje statistikore rreth aktiviteteve në sektorin publik të Kosovës për vitin 2008, po ashtu edhe pasqyrat në vija të trasha të rekomandimeve, tabelat e pilot-projekt auditiveve të kryera në disa institucione publike, mirëpo duke marrë parasysh se auditimi i brendshëm është pjesë apo të themi pjesë themelore e qeverisjes së mirë, në këtë raport shihet mjaft qartë se kemi mungesë të auditorëve, ku Qeveria është e obliguar të ketë auditor që të shihet se si po shpenzohen mjetet buxhetore në të gjitha njësitë buxhetore të Kosovës.

Unë kisha për t'u ndalur, pasi është prezent këtu ministri, vetëm te gjendja e pilot auditiveve - 25 pilotë të auditiveve, ku janë kryer lloje të ndryshme të auditimeve, siç është auditivi i sistemit të paluejtshmërisë, nuk është sqaruar mjaft mirë këtu në raport, financiar, teknologjisë informative dhe auditim të preformancave, ku do të thotë se sa janë përmbushur detyrat e auditimit, janë shumë, vetëm të cekura, ndërsa të sqaruara në përgjithësi jo dhe çështja e rekomandimeve, edhe një koleg këtu i imi pak më parë e potencoi, janë disa lloj rekomandimesh këtu të potencuara, mirëpo pse nuk janë kryer, atëherë do të mbetet çështja e gjithë ish-ministrave të mëparshëm dhe të ministrit të tanishëm, ku të gjithë auditorët çdo herë duhet të vendosen nën ndikime politike – thotë organizatat buxhetore të planifikojnë buxhetin e nevojshëm për plotësimin e njërive të auditimit me staf të ri, konform planeve të reja për auditim. Si do të vendoset ai staf i ri në Kosovë, kur çdo person do të vendoset në anën politike, me shpresë që auditorët do të jenë të pavarur në përgjithësi dhe të kryejnë punën e vet për vijat buxhetore, mbetet të shihet në të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet Rita Hajzeraj, e fundit për këtë debat.

RIZA SMAKA: Të nderuar, Kryetar i Kuvendit, Ministra dhe deputetë të respektuar,

Nga ky raport që ne tani e trajtojmë, shihet se ka shumë njësi buxhetore të cilat, të themi kështu figurativisht, nuk dinë ç'është auditimi intern. Disa që i kanë konstituuar komitetet apo njësitë, ose të mangëta ose të paqarta, me paqartësi, pa statute stabile, e

tjera. Nga raporti reflektohen shumë çështje të cilat auditimit të brendshëm i shkaktjnë pengesa serioze për ta ushtruar funksionin sa dhe si duhet. Në rrethanat e këtilla unë, së paku vetveten do ta kisha pyetur – a thua na duhet neve auditimi i brendshëm apo s’na duhet në këtë mënyrë dhe në këtë stil apo jo, në këtë përmbajtje. Për derisa auditori i brendshëm varet krejtësisht nga punëdhënësi të cilin do të duhej për ta audituar dhe atëherë apriori është çështje e hapur se duhet gjithmonë të jetë konformist dhe çka më pastaj, në shumë raste që dihen, auditimi i brendshëm i shërben punëdhënësit për t’ia rregulluar, siç thuhet në popull, letrat në mënyrë që auditimi i jashtëm, në qoftë se ndonjëherë do të bënte njëfarë revidimi, t’i gjente ato të gatshme dhe të thoshte se është në rregull. Ndryshe, unë di, po ka të tjerë që dinë më shumë, që në punën e auditimit të brendshëm ka shumë shantazhe të formave më të ndryshme. Dhe, po e zëmë, aktin të cilin do ta miratojë auditimi i brendshëm, është rekomandimi. Ç’është rekomandimi? Për atë që është i ndërgjegjshëm dhe i përgjegjshëm- është shumë, po për atë që nuk është i ndërgjegjshëm dhe i përgjegjshëm- asgjë, sepse nuk ka sanksione juridike.

Do të duhej që, së paku tani kur ta rishikojmë edhe ligjin, që të përqendrohemi të krijojmë bazë juridike në favorin e ushtrimit të funksionit nga auditori i brendshëm në mënyrë efikase dhe eficiente, që të obligojmë ne institucione çfarë kemi Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, bie fjala, Bankën Qendrore dhe Prokurorinë që ato, tani për tani rekomandime, t’i merrnin tepër seriozisht, t’i përpunonin dhe të ndërmerrnin masa institucionale.

Ushtrimi efikas i funksionit të auditorit të brendshëm do të ishte preventivë e mirë, e dihet në doktrinë se preventiva është shumë e dobishme dhe shpeshherë eviton nevojën e represives. Dhe, përfundimisht, trajnimet nuk janë forma për afatësimin e duhur të auditorëve. Ne do të duhej të meditonim, se kjo është çështje që reflekton obligime edhe në sfera tjera, po e zëmë, që në sistemin e edukacionit të krijojmë, po e zëmë, shkolla, t’i quaj shkolla kështu apo jo, do me thënë departamente për krijimin e këtij profili shumë të rëndësishëm, se me trajnim ne fare mirë e dimë çfarë mbahen, si mbahen, kush i mban e tjera. Dorën në zemër, ka respekte për raste të caktuara, por ka shpeshherë kur ato formalizohen asisoj sa që banalizohen.

Dhe, përfundimisht, raporti konsideroj kështu dhe ngjashëm diçka, edhe Komisioni për Buxhet e ka pranuar, apo jo, natyrisht me shpresë që në të ardhmen të kemi raporte më serioze, më cilësore. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja e fundit është Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Edhe unë, gjithashtu, sikurse shefi i grupit parlamentar dhe sikurse anëtarët tjerë të grupit tim parlamentar e përkrah raportin vjetor për funksionimin e auditorit të brendshëm. Gjithashtu, auditimi i brendshëm është një masë preventive për parandalimin e keqpërdorimeve në institucion. Unë konsideroj se auditimi është shumë i nevojshëm dhe se ky auditim do të bëhej një masë preventive, gjithashtu, për punëdhënësin. Një element të cilin desha ta cek, është se auditimi duhet t’i japë status të fortë auditorit dhe punëmarrësi të mos bëjë auditimin e punëdhënësit, nëse do të mund të gjente një formë tjetër se si auditori i brendshëm ta kontrollojë institucionin në të cilin punon apo të jetë si institucion i pavarur, sepse atëherë është auditim i subordinuar dhe nuk kryen funksionin e duhur.

Unë mendoj se raporti i auditimit do të duhej të jepej në bilancin periodik dhe, gjithashtu, MEF dhe Banka Qendrore t'i marrin konstatimet e auditorit dhe të nxjerrin konkluzionet dhe të ndërmarrin masa adekuate për auditimin e brendshëm. Pra, këto ishin disa vërejtje të cilat desha t'i cek. Faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

MYRVETE PANTINA: Kolegë të nderuar deputetë,

Meqenëse është konstatuar nga ana e Komisionit ndërministror se ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit aktual për Auditim të Brendshëm kanë tejkaluar shkallën prej 40% të ndryshimeve të lejuara në bazë të Udhëzimit administrativ Nr.14/2008, atëherë është marrë vendimi që të përgaditet projektligji i ri, i cili i është dorëzuar Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe është në fazën e amandamentimit në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Në Ligjin aktual për auditim të brendshëm kërkohet që të hiqet lidhshmëria e auditimit të brendshëm me konceptin e vjetër të inspektimit. Në vend të kësaj, menaxherët duhet ta konsiderojnë auditorin e brendshëm si një partner që do të ndihmojë në zvogëlimin e rreziqeve me të cilat përballen.

Në raport thuhet se momentalisht në sektorin publik, pa përfshirë ndërrmarjet publike, janë të angazhuar 84 auditorë të brendshëm në 50 njësi të auditimit të brendshëm (NjAB). Për të mbuluar të gjitha fushat e auditimit, kërkesat e njërive të auditimit të brendshëm janë edhe për 63 auditorë të rinj.

Vlen të përmendet se një numër i auditorëve të brendshëm (31 sish) kanë ikur nga auditimi dhe kanë shkuar në organizata tjera për paga më të mira, si në: KEK, banka komerciale, kompani sigurimi, si dhe në pozita të tjera, gjë që pengon kryerjen e rregullt të punëve të auditimit të brendshëm.

Edhe pse shumica e organizatave buxhetore kanë krijuar njësitë e tyre të auditimit të brendshëm në bazë të kërkesave ligjore, ato ende nuk janë mjaft efektive, sepse shumica e këtyre njërive funksionojnë me një auditor. Por, nëse mbështetemi në standardet profesionale për auditim të brendshëm, njësitë e auditimit me një auditor nuk janë treguar efektive, sepse auditori i vetëm nuk mund të ketë pavarësi të plotë gjatë kryerjes së auditimit dhe është e pamundur të mbulohen të gjitha aktivitetet e nevojshme të organizatës me auditim të brendshëm.

Nga raporti shihet se për vitin 2008 në nivelin qendror dhe lokal janë kryer gjithsej 292 auditime. Janë dhënë 1937 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Prej këtyre rekomandimeve, nga menaxhmenti janë implementuar 1047 (54.05%), në proces të implementimit janë 491 (25.35%) kurse nuk janë implementuar 399 (20.60%) rekomandime, d.m.th. një numër mjaft i madh i rekomandimeve kanë mbetur pa u implementuar. Ndërsa, njëra nga arsyet për mos implementim të këtyre rekomandimeve, sipas raportit në fjalë, qëndron në përfshirjen edhe të një numri të rekomandimeve nga auditimet që janë përfunduar në tremujorin e fundit të vitit 2008, kështu që implementimi i këtyre rekomandimeve do të bëhet gjatë vitit 2009.

Numri më i madh i rekomandimeve të pa implementuara paraqitet në këto organizata buxhetore: Zyra e Kryeministrit (15 rekomandime të pa implementuara), Administrata Tatimore e Kosovës (21 prej 75 rekomandimeve të dhëna), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (31 prej gjithsej 144 rekomandimeve të dhëna), Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (30 prej 123 rekomandimeve të dhëna), Ministria e Punëve të Brendshme (20 prej 56 rekomandimeve të dhëna).

Të gjeturat kryesore nga auditimet e kryera nëpër organizata buxhetore janë:

- planifikimi jo i mirë i buxhetit për të hyra dhe shpenzime
- grumbullimi i pamjaftueshëm i të hyrave vetjake
- buxheti jo gjithëherë është shpenzuar në bazë të planifikimit
- proceset e prokurimit nuk janë udhëhequr në pajtueshmëri me ligjin e prokurimit,
- nuk barazohen raportet financiare të organizatave buxhetore me raportet e departamentit të thesarit
- transaksionet nuk regjistrohen nëpër kode adekuate
- nuk ka regjistrim të mirëfilltë të pasurisë
- nuk zbatohen udhëzimet për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare si dhe
- rekrutimi i stafit nuk bëhet në bazë të procedurave ligjore.

Andaj, edhe rekomandimet e dhëna kanë të bëjnë kryesisht me këto të gjetura.

KRYETARI: Faleminderit! A kemi numër të caktuar për të votuar? Urdhëro, ministër, falënderohu, se deshe të falënderohem edhe unë, por falënderon ju.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar Kryetar!

I falënderoj të gjithë diskutuesit dhe desha para se të falënderohem, përfundimisht t'ju siguroj që të gjitha vërejtjet serioze dhe të mundshme do t'i inkorporojmë në punën tonë të ardhshme. Është raporti i parë, pra, që përgatitet nga Njësia Harmonizuese Qendrore e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Desha të informoj opinionin se u ngrit këtu nga një deputet që certifikimi për auditor të ri fillon më 1 korrik, e unë kam insistuar nga donatori i Komisionit Evropian që mos të certifikohen dhe të mos trajnohen vetëm auditorët që janë duke punuar, por të kemi një certifikim të paktën edhe 50 të tjerë nga tregu i lirë i punës, në mënyrë që ne si ministër, udhëheqësit e njësive buxhetore të kenë mundësi që të përzgjedhin edhe nga tregu auditorë të ri. Problemi është që janë krijuar disa profesione, siç është auditori, ekspertët e buxhetit e tjera, që nuk gjen në treg të lirë ekspertë, jo të paktën të certifikuar. Kështu që, përmes këtij procesi ne do të kemi një treg më të gjerë të mundësive tona për të përzgjedhur kualitetet dhe për të ndërruar edhe strukturën, atë që e tha deputeti i nderuar.

Me kaq po e përfundoj, duke ju falënderuar për kontributin tuaj. Faleminderit, Kryetar që ma dhatë këtë rast. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Në sallë kemi 61 deputetë. Konsideroj se mund të votojmë. Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 61 votë “për”, 2 “kundër”, Kuvendi miratoi Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës për vitin 2008. Ju faleminderit!

Pika e radhës është:

- Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për përkrahjen e Projektit multietnik për komunën e Novobërdës

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për përkrahjen e Projektit multietnik për komunën e Novobërdës dhe ia ka rekomanduar Kuvendit, për miratim.

Raporti me rekomandimet e Komisionit, së bashku me Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për përkrahjen e Projektit multietnik për komunën e Novobërdës u janë shpërndarë deputetëve.

Kush e do fjalën në emër të Qeverisë dhe në emër të Komisionit A ka në emër të grupeve parlamentare? A e mbështesni? Mirë, atëherë lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 49 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për përkrahjen e Projektit multietnik për komunën e Novobërdës. Ju faleminderit!

Dhe njoftimet e fundit:

- Njoftimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionin parlamentar.

Ju njoftoj se Grupi Parlamentar i AAK-së ka vendosur që anëtar në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur dhe Peticione, emërohet deputeti Danush Ademi, në vend të deputetes Vezira Emrush.

Njëkohësisht, ju njoftoj se Grupi Parlamentar i LDK-së ka vendosur që deputetja Fatmire Berisha të emërohet anëtare e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të deputetit Armend Zemaj.

2. Deputeti Naser Osmani, emërohet zëvendëskryetar në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

3. Deputeti Armend Zemaj, emërohet anëtar në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Të nderuar deputetë, me kaq konstatohet përfundimin e punimeve të kësaj seance plenare. Mirupafshim në seancën më 23 qershor.

Përgatiti:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale